



Bashkia Pogradec

**ANALIZA DHE VLERËSIMI
I TERRITORIT**

Përmbajtja

I. Gjendja ekzistuese dhe problematikat e territorit	4
1. Vështrim i përgjithshëm	4
1.1 Profili i qytetit Pogradec	6
2 Profili i njësive administrative të Bashkisë Pogradec	11
1.3 Zhvillimi i territorit të bashkisë Pogradec në vite	50
2. Dokumentet e planifikimit	51
2.1 Konventat Ndërkombëtare, Marrëveshjet bilaterale dhe projekte të tjera.....	51
2.2. Strategjitë dhe Programet në nivel ndërkombëtar	53
2.3 Analiza e planeve dhe instrumenteve në nivel kombëtar	55
2.4. Analiza e planeve dhe instrumenteve në nivel vendor	59
2.4.1 Plani Rregullues i bashkisë Pogradec	61
2.5 Analiza e elementëve përjashtues	61
3. Veçoritë Fizike dhe Mjedisore.....	63
3.1 Topografia dhe Relievi	63
3.2. Klima	66
4. Mjedisi dhe ekosistemet	75
4.1 Habitati dhe Biodiversiteti.....	75
4.2 Territori toka dhe nëntoka	83
4.3 Burimet Ujore	93
4.4 Pasurite Minerale	98
4.5 Pyjet.....	103
4.6 Ajri.....	122
4.7 Mbetjet.....	128
4.8 Problemet mjedisore të tokës, ujit dhe ajrit	130
4.9. Fenomenet e Rrezikut Gjeologjik.....	139
5. Përdorimi i Tokës dhe Infrastruktura	142
5.1 Sistemet në territorin e bashkisë Pogradec	142
5.2 Përdorimi i tokës në bashkinë Pogradec	147
5.3 Infrastruktura rrugore	149
5.4 Rrjetet inxhinierike të Infrastrukturës.....	160
5.4.1 Të dhëna mbi infrastrukturën e rrjetit elektrik.....	160


5.4.2 Të dhëna mbi rrjetin e ujesjellesit	160
5.4.3 Të dhëna mbi rrjetin e kanalizimit të ujrave të zeza.....	160
5.5. Analiza e periferialitetit	162
5.6 Analiza e tipologjisë hapësinore.....	172
5.7 Analiza e cilësisë së strukturave dhe territoreve	181
5.8 Analiza e mënyrës së përdorimit të pronave publike	186
5.9 Analiza e marrëdhënieve të pronësisë mbi tokën, përfshirë konfliktet dhe situatat e informalitetit	187
5.10 Analiza e elementëve të rëndësishëm territorialë	192
6. Zhvillimi Social dhe Ekonomik.....	194
6.1 Demografia	194
6.2.1 Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë	203
6.2.2 Personat me aftësi të kufizuar.....	206
6.2.3 Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social.....	207
6.3 Analiza e nevjave për Strehim.....	220
6.4 Aspektet ekonomike	223
6.4.1 Identiteti ekonomik i Bashkisë Pogradec	223
6.4.2 Bujqësia	226
6.4.3 Analiza e bonitetit të tokave	282
6.4.4 Sektori i Industrisë.....	283
6.4.5 Turizmi	284
7. Zonat e rëndësisë kombëtare në territorin e bashkisë Pogradec	286
7.1 Përshkrimi i zonës.....	286
7.1.1 Monumentet Arkeologjike të bashkisë Pogradec	287
7.1.2 Tipet e gjeomonumenteve të bashkisë së Pogradecit.....	287
7.2.3 Monumentet kulturore, historike dhe natyrore të peisazhit të mbrojtur	290
8. Situata financiare e bashkisë	292
8.1 Shpenzimet dhe Investimet.....	292
8.2 Detyrime te papaguara.....	294
9. Konkluzione/Rekomandime dhe SWOT	296
Shënime dhe Referenca.....	303

I. Gjendja ekzistuese dhe problematikat e territorit

1. Vështrim i përgjithshëm

Bashkia e Pogradecit shtrihet në juglindje të Shqipërisë, në anë të bregut jugperëndimor të liqenit të Ohrit (695 metra mbi nivelin e detit). Ai kufizohet në veri me bashkinë e Prrenjasit, në juglindje me bashkinë e Pustecit, në jug me bashkinë e Maliqit dhe në perendim me bashkinë e Gramshit. Sipërfaqja¹ e tij është 595 km² dhe ka 90,726² banorë në përbërjen e territorit të tij.

Figura 1. Pozicioni Strategjik i bashkisë Pogradec



Burimi: IDRA, 2016

Pogradeci spikatet për një pozitë gjeografike mjaft të favorshme, sepse shërben si një urë kontakti duke lidhur shumë qytete mes tyre, por edhe një pikë kalimi për në Republikën e Maqedonisë dhe anasjelltas. Në bashkinë e Pogradecit kalon rruga nacionale Tiranë – Korçë pjesë e korridorit të VIII-të, rruga e re lidhëse Qafë Thanë – Qafë Pillocë, si dhe linja hekurudhore Pogradec – Elbasan. Në bashkinë e Pogradecit gjenden edhe dy pikat doganore me Republikën e Maqedonisë ajo e Tushemishtit dhe e Qafë Thanës. Në territorin e bashkisë gjenden elementë të fortë territoriale; artificialë dhe natyrore si: liqeni i Ohrit, Parku i Drilonit, Kalaja e Pogradecit, lumi Shkumbin , malet e Mokrës etj³.

Bashkia e Pogradecit para ndarjes territoriale përbëhej nga qyteti i Pogradecit dhe lagjet e tij periferike dhe kishte një popullsi prej 38653 banorë⁴ ndërsa pas ndarjes territoriale pësoi ndryshime në territor duke bërë pjesë të bashkisë dhe shatë njësi administrative të tjera si: Udënisht, Buçimas, Proptisht, Trebinjë, Velçan, Çërravë dhe Dardhas.

1.1 Profili i qytetit Pogradec

Qyteti i Pogradecit, i pozicionuar në zonën lindore të vendit dhe në pjesën jug-perëndimore të liqenit të Ohrit, ka gjatësinë gjeografike lindore 20 gradë 38 minuta e 48 sekonda dhe gjërësinë gjeografike veriore 40 gradë 54 minuta e 05 sekonda. Ndodhet 696 m mbi nivelin e detit. Kufizohet në veri dhe veri-lindje me liqenin, në jug dhe perëndim e rrethojnë kodra e male e pyje me dushk, gështenja, njësinë administrative Trebinjë, jug-lindje nga njësia administrative Buçimas dhe veri-perëndim me njësinë administrative Buçimas. Përjashtuar zonën ekonomike, ndërtimet e parregullta, qyteti shtrihet në sipërfaqe të përgjithshme rreth 234 ha.

Gjeneza –historiku i qytetit

Qyteti është i vendosur prej shekujsh në të ashtuquajturën Gropa e Pogradeci, e cila zë pjesën jugore e jugperëndimore të gropës së Ohrit, që bën pjesë në zinxhirin e gropave tektonike. Aktualisht ajo ulet me një amplitudë deri në 2-3 mm/vit.

Nisur nga zbulimet arkeologjike, bashkia e Pogradecit rezulton e banuar që në epokën e Neolitit të Vonë (6000-2000 vjet para Krishtit) Këto territore kanë qënë të banuara nga fiset ilire: Enkelejtë dhe Desaretet, gjë që e vërtetojnë edhe zbulimet arkeologjike të vendbanimeve të ndryshme në Blacë, Tushemisht, Selcë e Poshtme, Lin, Kalaja e Pogradecit etj.

Kalaja e Pogradecit (*vend arkeologjik*), me lartësi 889 m mbi nivelin e detit (205 m mbi niv.liqenit), ndodhet në pjesën perëndimore të qytetit dhe ka filluar të banohet në shek.V para Krishtit deri në shek.IX. Kjo qëndër banimi ilire u pais me mure mbrojtëse, gjurmë të cilëve ka dhe sot. Kalaja e Pogradecit ka pasur kështu funksionin e banimit për një periudhe prej 1400 vjetësh.

Gjetjet arkeologjike tregojnë për vazhdimësinë etnike të saj, dhe dëshmojnë që banorët e saj janë marrë me bujqësi, peshkim, e zeje të ndryshme dhe kanë pasur marrëdhënie me qendrat e banuara fqinje. Në vitet e mëvonshme qyteti u shtri në rrëzë të kalasë, në Gradishtë e në veri të qytetit të sotëm. Në përshkrimet e Elvia Celebiut, i cili kaloi në këtë trevë në shekullin e XVII,thuhet:

“Pogradeci ka katër lagje, katër xhami, një medrese, dy shkolla fillore, një teqe, tre hane, një banjë e gjashtëqind shtëpi”



Figura 3 Pamje të rrugës “Çeta e Mokrës”



Figura 3 Pogradeci në vitet '60

Në vitet 1878 Pogradeci kishte 2000 banorë, të cilët merreshin me bujqësi, vreshtari dhe artizanat (*marangozë, rrobaqepës, leshpunues, bakërxi, etj*). Gjatë kësaj periudhe qyteti formoi fizionominë e tij si qendër tregtare – zejtare, dhe u kristalizuan banesat qytetare me tipare të veçanta arkitektonike lokale (*sot këto vlera historike ndërtimore gjenden në rrugën “Çeta e Mokrës” dhe “Burimat”*).

Pogradeci ka përmbledhur rreth 140 fshatra, me shtrirje që nga Quksi i Elbasanit deri në Pirg të Korçës e evidentuar kjo në vitin 1919 në një protestë të delegacionit shqiptar në konferencën e paqes në Paris, ku midis të tjerave thuhet: “... *populli i qarkut të Pogradecit, i përbërë nga 140 fshatra ...*”

Ndërsa në vitet ‘30, në kohën e mbretërisë së Ahmet Zogut, evidentohet se qarku i Pogradecit ka patur Bashki si njësi administrative politike .

Gjatë fillimeve të shekullit të XX, ndërtimet janë shtrirë perreth xhamisë dhe më pak buzë liqenit. Mbas luftës së dytë botërore qyteti shtrihet me ndërtime të reja buzë liqenit, nga hyrja e rrugës së Elbasanit deri në qendër, ndërsa në pjesën tjetër të bregut të liqenit bëhen kryesisht ndërtime turistike. Në këtë kohë ndërtohet qendra industriale në rrugën që shkon në fshatin Vërdovë, sot rruga “Industriale”.

Në vitet e fundit, ndërtimet në qytet e njësinë administrative Buçimas, kryesisht banesa individuale, janë vendosur në Gradishtë, Përroin e Çaprazit, dhe ndërtime pa lejë në dy krahët e rrugëve që përshkojnë fushën e Buçimasit.

Demografia

Treguesit e lëvizjes demografike për një qytet janë ndër më kryesorët në përcaktimin e politikave të zhvillimit të tij dhe kanë peshë të madhe në zgjidhjet e ndryshme të planeve e sidomos PPV.

Popullsia banuese në qytetin e Pogradecit është 36842 banorë (*Burimi: Gjendja Civile 2016*)

Persona me aftësi të kufizuar – 1945 persona (*Bashkia Pogradec, janar 2016*)

Familje në ndihmë ekonomike – 808 (*Bashkia Pogradec, janar 2016*)

Komuniteti rom dhe egjiptian në ndihmë ekonomike 224 familje(*Bashkia Pogradec, janar 2016*)

Lëvizjet demografike (*Burimi: Bashkia Pogradec*)

- Në vitin **2006** popullsia 39605 banues ne Pogradec / kanë ardhur 2239 persona / janë larguar 2152 persona / 462 vdekje / 1301 lindje
- Në vitin **2007** popullsia 39902 banues ne Pogradec / kanë ardhur 1405 persona / janë larguar 1594 persona / 413 vdekje / 1215 lindje
- Në vitin **2008** popullsia 40138 banues ne Pogradec / kanë ardhur 1430 persona janë larguar 1748 persona / 429 vdekje / 1193 lindje
- Në vitin **2009** popullsia 40178 banues në Pogradec / kanë ardhur 1570 persona / janë larguar 1685 persona / 523 vdekje / 1161 lindje
- Në vitin **2010** popullsia 38505 banues ne Pogradec / kanë ardhur 77 persona / janë larguar 1600 persona / 178 vdekje / 381 lindje

- Në vitin **2011** popullsia 38764 banues ne Pogradec / jane larguar 2591 persona / 15 vdekje / 259 lindje
- Në vitin **2012** popullsia 38645 banues ne Pogradec
- Në vitin **2013** popullsia 38653 banues ne Pogradec

Vlen për t'u përmendur fakti që përveç popullsisë banuese, sidomos në sezonin veror, qyteti pothuajse pesëfishohet në popullsi nga turistët që frekuentojnë hotelet, si dhe banorët jo të përhershëm (*ata të cilët kanë shtëpi të dyta në qytet por banojnë në qytete të tjera*). Nga viti 2007, ku numri i turistëve në qytetin e Pogradecit për të gjithë vitin ishte 50200, në vitin 2012, numri i turistëve ka arritur në 150000. (*Burimi: Drejtoria e Turizmit, Bashkia Pogradec*)

Aktivitetet kryesore ekonomike

Në qytetin e Pogradecit ushtrojnë aktivitetin 1064 biznese në total, prej nga 925 janë biznese të vogla e të mesme (*bar bufe, restorante, klinika, mobileri, shërbime të ndryshme, etj*) dhe 139 biznese të mëdha (*shoqëri transporti, hotele, industri, Tv kabllor, etj*).

Zona industriale, ku janë vendosur pjesa më e madhe e objekteve ekonomike të industrisë së lehtë jondotëse, kufizohet me territoret e zonës së banimit, në drejtimin verior, jugor, jug-perëndimor dhe lindor.

Transporti

Ekzistojnë disa vende qëndrimi (*stacione informale*) të mikrobuseve – furgonave

- Vendqëndrimi i furgonave të Korçës / Maliqit (lindjes)
- Vendqëndrimi i furgonave të Tiranës / Elbasanit / Prrenjasit (perëndimit)
- Vendqëndrimi i furgonave të fshatrave të Pogradecit / rrethinave

Linja transporti urban në qytet nuk ka. Ka patur nje linjë sezonale **Tushemisht-Lin** gjatë sezonit turistik veror, por ajo nuk është më funksionale.

Ekziston edhe transporti me mjete private, kryesisht drejt Maqedonisë (*carsharing*), dhe është mënyra kryesore e turizmit drejt Ohrit / Strugës / Shën Naumit.

Qyteti i Pogradecit ka rreth **650 vende parkimi** (vetëm ato në rruget kryesore), nga te cilat rreth **250** janë me orar ne sezonin e verës. (*nga ora 18-24 Bulevardi Dëshmorët e Pojskës kthehet në shëtitore dhe qëndrim- parkimi në këtë periudhë është i ndaluar për këtë rrugë*)

Të dhëna për zonën e pushimit

Zona e Bregut Liqenor përfshin territoret në lindje të qytetit të Pogradecit, buzë liqenit. Në drejtimin verior (paraqitur në skemën e zonimit funksional të gjendjes ekzistuese) kufizohet, nëpërmjet shëtitores “Dëshmorët e Pojskës”, me zonën e parkut buzë liqenit.

Janë territore të mbuluara me rërë ose me guricka, me përdorim kryesor pushimin dhe argëtimin. Zona e plazhit ka një brez rëre që ze një territor rreth 4.8 ha. Per numrin e pushuesve të ardhur dhe banorët e qytetit, që e shfrytëzojnë këtë brez, sipërfaqja e tij (sipas normave te Rregullores se Urbanistikes) duhet të jetë shumë herë më e madhe.

Zona sportive

Zona sportive e qytetit të Pogradecit pozicionohet në pjesën Qendër - Lindore të qytetit, në brendësi të zonës së banimit, dhe lidhet direkt me rrugën “Reshit Çollaku”. Përfshin një minimum terrioresh prej 4.06 ha, ku bëjnë pjesë stadiumi i qytetit, një fushë stërvitore dhe disa anekse sportive. Për shkak të sipërfaqes së kufizuar nuk ka terrene për përdorime për zhvillimin e aktiviteteve masive.

INFRASTRUKTURA**Rrjeti i ujësjellësit**

Rritja e pakontrolluar e numrit të banorëve të qytetit të Pogradecit, rrjeti i amortizuar i furnizimit me ujë i cili nuk përballonte më nevojat me ujë të popullatës, bëri të domosdoshëm ndërtimin e një sistemi të ri furnizimi me ujë të financuar nga KFW (qeveria gjermane) gjatë viteve 2005-2007. Projektzbatimi i furnizimit me ujë është mbështetur mbi Detyrën e Projektimit të Planit të Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Pogradecit i cili parashikon dhe furnizimin me ujë të zonave ku do të shtrihet qyteti në perspektivë dhe zbatimi e tij konsiston në tre faza:

1. Faza e parë është ndërtimi i stacionit të ri të pompave, depove, dhe tubacionit kryesor. Stacioni i pompave realizon prurjen 142 l/s dhe furnizon depot e qytetit.
2. Faza e dytë është zbatimi i rrjetit shpërndarës.
3. Faza e tretë është projekt-zbatimi për zonat që do të zhvillohen në perspektivë.

Aktualisht furnizimi me ujë i qytetit të Pogradecit dhe komunës Buçimas, e cila përbëhet nga fshatrat Starovë, Vërdovë, Tushemisht, Gurras, Rëmenj e Gështenjas, mbulohet nga dy burime të mëdhenj: Burimi i Tushemishtit me kapacitet 150-200l/s dhe ai i Gurras-it 30l/s. Me vënien në funksion të këtij sistemi të ri të furnizimit me ujë të popullatës u rrit norma e konsumimit për banorët, nga 80l/banorë/ditë në 120 l/banorë/ditë për qytetin e Pogradecit. Gjithashtu, ky sistem i ri furnizimi siguron furnizimin me ujë të popullsisë pa ndërprerje dhe të një cilësi shumë të mirë.

Sistemi i ri furnizimit me ujë përbëhet nga Kaptazhi i mbledhjes së burimeve, stacioni i ri i pompave në Tushemisht, i cili furnizon tubacionin kryesor që furnizon depot kryesore me kapacitet 2000m³, 1000m³, 400m³ që furnizojnë qytetin e Pogradecit. Nga ky sistem furnizohen dhe depot e tjera që furnizojnë fshatrat Vërdovë, Kabash, Rëmenj, Gështenjas, Tushemisht. Sistemi i ri i furnizimit është projektuar për furnizimin me ujë të rreth 70 000 banorë deri në vitin 2026.

Rrjeti i kanalizimeve (+kanalizimet e ujrave të shiut)

Rrjeti ekzistues i kanalizimeve të qytetit të Pogradecit u ndërtua në vitet 1970, me tuba betoni ku shumica prej tyre nuk janë vendosur në thellësinë e kërkuar dhe shpesh këta tuba janë të ekspozuar ndaj ngarkesave të trafikut. Pusetat e rrjetit në të shumtën e rasteve janë të bëra me tulla dhe të mbuluara me kapak gize ose betoni. Vihen re pjerrësi të pamjaftueshme të tubave, sipërfaqe të brendshme jashtë standarteve, mirmbajtje dhe riparime të pamjaftueshme ndaj bllokimeve dhe përmytjeve. Rritja e numrit të ndërtimeve, rrjeti i amortizuar i kanalizimeve dhe derdhja e ujrave të zeza me anë të kanaleve të patrajtuara në liqen, bëri të domosdoshme dhe urgjente projektzbatimin e një sistemi të ri për kanalizimet e ujrave të zeza, i cili zëvendeson në masën 90% rrjetin ekzistues. Sasia e ujit me të cilën është llogaritur Impianti është 90 l/banorë/dite. Projekt-

zbatimi i kanalizimeve të ujrave të zeza të qytetit të Pogradecit filloi në vitin 2005 dhe është mbështetur mbi Detyrën e Projektimit të Planit të Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Pogradecit i cili parashikon dhe kanalizimin e ujrave të zeza të zonave ku do të shtrihet qyteti në prespektive

Aktualisht sistemi i kanaleve të ujrave të shiut në disa pjesë të qytetit është i përzier me ato të ujrave të zeza pra, në shumë pjesë të tij ka bllokime, që e nxjerrin jashtë funksioni këtë sistem kanalizimesh.

Të dhëna për rrjetin elektrik

Lidhja e përdoruesëve të energjisë elektrike të qytetit të Pogradecit në anën e TL.110 kV me sistemin elektroenergjitik të Shqipërisë realizohet nepermjet N/ST. elektrik 110/35/10kV Pogradec, në të cilin ka dy transformatorë fuqie dhe pjesërisht nga N/ST. elektrik 110/6 kV të Gurit të Kuq. N/ST. elektrik 110/35/10kV i Pogradecit është i lidhur me linjën elektrotransmetuese (me TL.110kV) Elbasan–Korçë, pra me ushqim të njëanshëm vetëm nga Elbasani.

Rrjeti ekzistues i TM.10kV dhe TM.6kV i ndërtuar që nga viti 1968 është me linja ajrore dhe kabllore. Seksionet e linjave në rrjetin shpërndarës të TM. nuk lejojnë në rast nevojë rezervim të plotë të furnizimit me energji elektrike të përdoruesëve ekzistues reciprokisht nga dy federa të ndryshëm, sepse, në rrjetin kabllor seksionet e përcjellsave janë Cu 35, 25 mm² dhe Al me 50 mm². Simbas kushteve teknike në fuqi kohëzgjatja e shfrytëzimit të linjave është 20 vjet. Rrjeti shpërndarës i TM.10kV dhe TM.6kV i kësaj zone ka rreth 48 vjet që janë në shfrytëzim dhe në pjesën dërrmuese të gjatësisë së tyre janë tejet të amortizuara dhe kanë nevojë për rinovim.

2 Profili i njësive administrative të Bashkisë Pogradec



1.2.1 Profili i njësisë administrative Dardhas

Gjeneza – historiku i fshatrave

Fshati Niçë është një ndër qendrat e para të banuara të njësisë administrative Dardhas. Fshati i vjetër lidhej me fshatin Llëngë (*sot në njësinë administrative Trebinjë*), por edhe me qendra të tjera të banuara të Mokrës, Gorës dhe me qytetin e Voskopojës nëpërmjet një rruge të vjetër që ishte degëzim i “Via Egnatias”. Në këtë fshat ishin zhvilluar mjaft zejtaritë e ndryshme, dhe kishte një numër të madh hanesh ku pushonin karvanet e udhëtarëve, dhe prishja e Voskopojës ndikoi keq edhe në ekonominë e këtij fshati, dhe solli largime të banorëve nga fshati drejt zonave të tjera.

Në dokumentet turke të vitit 1583 fshati Niçë rezulton me 63 subjekte taksapaguese, ndërsa më vonë në regjistrimin e popullsisë të viteve 1921-1922 në Niçë ka patur 57 shtëpi dhe 316 banorë.⁵

Përsa i përket ndërtimeve të zonës, zona e fshatrave të Pogradecit e Mokrës njihet për mjeshtrit gurgshendës e muratorë. Banesat ndërtoheshin përgjithësisht me mure guri të lidhura me breza druri, ndërsa dyert e dritaret bëheshin me qemerë guri ose me arkitrarë druri. Mjeshtrit pogradecarë ishin veçanërisht të njohur për ndërtimin e mureve të tullës apo gurit, ndërsa ata mokrarë për skalitjen dhe gdhendjen e gurëve, sidomos të pjesëve dalluese si gurët e qoshes, arkitrarët, kornizat e dritareve, etj.⁶



Figura 4. Banesa karakteristike të zonës

Demografia

Njësia administrative Dardhas ka **3566 banorë / 1175 familje** (*Burimi: Njësia Administrative Dardhas, 2015*)

Dardhasi përbëhet nga 9 fshatra: Dardhas, Osnat, Stopckë, Grunjas, Prenisht, Dërdushë, Lekas, Niçë, Stërkanjë. Popullsia është ndarë në 9 fshatrat e njësisë si më poshtë:

Dardhas – 1052 banorë / 366 familje
Stropckë – 1033 banorë / 370 familje
Grunjas – 368 banorë / 99 familje
Prenisht – 109 banorë / 22 familje
Dërdushë – 110 banorë / 20 familje

Osnat – 358 banorë / 129 familje
Lekas – 165 banorë / 33 familje
Niçë – 284 banorë / 87 familje
Stërkanjë – 87 banorë / 39 familje

Persona me aftësi të kufizuar: Të paaftë 72, të verbër 20, paratetraplegjikë 23 / Invalidë pune 69

Lëvizjet demografike

Popullsia që rezulton në gjendjen civile nuk përkon me atë reale për shkak të lëvizjes të vazhdueshme migratore drejt qyteteve si Tirana, Durrësi dhe Pogradeci (*kryesisht Durrësi*). Banorët janë larguar për të siguruar kushte më të mira jetese, por një pjesë e tyre vijon të kthehet në stinën e verës, për të punuar tokat, për të mbledhur bime mjekësore, apo për të përgatitur zahiretë e dimrit. Gjatë dimrit banorët e kanë të pamundur të kthehen, pasi vetëm në verë funksionon rruga.

Përveç lëvizjeve larguese, ka patur edhe të ardhur nga zonat malore të Velçanit dhe Mesmalit, të cilët janë vendosur në fshatin Stropckë, i cili është më afër me rrugën nacionale Pogradec Korçë.

Lëvizja migratore ka filluar që pas mbylljes të minierës të qymyrgurit në Dardhas, e cila punonte me tre turne para viteve '90 dhe, ishte burim punësimi për një pjesë të mirë të banorëve të zonës.

Bujqësia, Blegtoria

Aktivitetet kryesore ekonomike në Njësinë Administrative Dardhas ditët e sotme janë **Bujqësia** dhe **Blegtoria**. Njësia zotëron 2412 Ha tokë bujqësore, e cila ndahet në 2184 Ha tokë arë, 187 Ha pemtore, 41 Ha vreshta, dhe 176.6 Ha gështenja. Në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë të kësaj zone ka disa faktorë kushtëzues e pengues si: ndarja e tokës në shumë pjesë, infrastruktura e dobët, largësia nga qendrat urbane (*qytet, rrugë nacionale*), amortizimi i vazhdueshëm i infrastrukturës bujqësore (*shkatërrimi i rezervuareve dhe bllokimi i kanaleve vaditëse*), emigrimi i fuqisë punëtore të re, njohuritë e pakta mbi ekonominë e tregut, mungesa e linjave të grumbullimit dhe përpunimit të produkteve, erozioni i tokave bujqësore, subvencionimet e pakta nga shteti, çmimi i lartë i karburanteve dhe inputeve bujqësore etj. Megjithë mungesën e infrastrukturës së përshtatshme, burimet e shumta ujore dhe përrenjtë e zonës, e lehtësojnë disi procesin e ujitjes së tokës bujqësore.

Figura 5. Toka bujqësore në fshatin Stropckë



Dardhasi njihet për **drurët frutorë** si: qershitë, dardhat (*prej nga ka marrë edhe emrin*), lajthitë e kumbullat e egra. Kultivimi i tyre është bërë ndër vite nga banorët e zonës, por shitja e prodhimit në ditët e sotme, has një seri vështirësish, si mungesa e pikave të

grumbullimit, mungesa e një pike frigoriferike për konservim, dhe lënia e fatit të prodhimit në dorën e blerësve të rastësishëm privatë, të cilët përgjithësisht u ofrojnë fermerëve çmime shumë të ulëta e aspak të leverdisshme.

Në këtë njësi kultivohen edhe **bimë mjekësore** si murrizi, lule mëllaga, lule ciani, dëllinja e sherebela. Mbjellja bëhet në mënyrë spontane e të paorganizuar nga banorët e zonës në tokat e tyre, dhe blerja, grumbullimi e shpërndarja bëhet nga subjekte të licencuar (*të regjistruar kryesisht në Maliq, Çërravë apo Pogradec*) Grumbullimi fillimisht bëhet në një pikë në Çërravë, e më pas shpërndahet në tregjet e vendit, apo përgatitet për eksport. Për shkak të rënies të çmimit në treg, disa prej këtyre bimëve (*si mëllaga e sherebela*) nuk mbillen më.

Kafshët që mbarështohen në Dardhas janë 587 lopë, 1972 krerë dhi, 6180 krerë dele, 300 kafshë samari, 780 shpendë, 650 koshere bletë. Në njësi ka dhe një baxho, që ndodhet në fshatin Osnat.

Ekonomia

Në njësinë Administrative Dardhas janë 22 biznese të vogla të regjistruara, kryesisht shitore, apo lokale-kafene. Ka patur një kërkesë për një pikë grumbullimi frigoriferike (*për mollët, dardhat e qershitë*) por aplikuesi nuk e ka ndërtuar dot për arsye ekonomike.

Figura 6. Pamje nga rruga për në fshatin Dardhas



Infrastruktura

Uji i pijshëm

Furnizimi me ujë të pijshëm është zgjidhur në mënyrë personale nga banorët që në vitin 1992, duke shfrytëzuar burimet që vijnë nga mali. Matësat nuk janë vendosur, madje në disa raste nuk ka as rubineta, dhe uji që derdhet në mënyrë të vazhdueshme, nuk shkon në kanale por në rrugë, duke dëmtuar shtresën e asfaltit. Uji që merret nga këto burime futet edhe për vaditje, pra shpërdërohet.

Shirat e rrëmbyeshëm shkaktojnë rrëshkitje dhe të konsiderueshme. Mbi formacionin shkëmbor ka një shtresë dhe rreth 2m, dhe mungesa e kanaleve të sipërm të kullimit (ndërtimi i të cilëve nuk arriti të përfundohet para viteve '90) shkakton rrëshkitje të herëpashershme.

Ujërat e zeza

Ujërat e zeza shkojnë në lumenjtë që derdhen më pas në liqenin e Ohrit. Sistemi i kanalizimeve është një problem dhe nevojë imediate, duke qenë se liqeni i Ohrit është në program mbrojtje nga UNESCO.

Elektrifikimi

Problemet me elektrifikimin janë të shumta dhe sistemi është i amortizuar, dhe shtyllat janë në të rënë (*për shkak edhe të rrëshkitjeve të dheut*). Për shkak të këtij amortizimi, në stinën e dimrit fshatrat e thellë (si fshati Pirg) mbeten pa energji elektrike për javë të tëra.

Telefonia / Televizionet

Linja për telefoni fikse nuk ka, por punojnë operatorët celularë (*edhe pse ka zona ku mbulimi me valë për shkak të thyerjeve të relievit është i vështirë*). Kartat rimbushëse të celularëve shiten në dyqane. Ka një TV kabllor që është i regjistruar në Çërravë dhe operon në Stropckë.

Vendgrumbullimi i mbetjeve

Mbetjet grumbullohen në një shesh grumbullim informal pranë ish minierës të qymyrgurit. Për shkak të mungesës të rrethimit, mbetjet përhapen nga kafshët e bagetitë edhe në zonat përreth duke u bërë burim ndotje.

Transporti

Rrugët e njësisë janë në gjendje të mirë deri në fshatin Dardhas, ndërsa fshatrat e thellë nuk janë të arritshëm për shkak të mungesës së infrastrukturës të përshtatshme. Disa rrugë janë të kalueshme me makinë vetëm në stinën e verës (*rruga për në fshatin Niçë, po të ishte në gjendje të mire, mund të bëhej më makinë për 15-20 min; më këmbë bëhet për më shumë se një orë*)

Linja të transportit publik mes fshatrave nuk ka. Ka një linjë private furgonësh, që bën linjën Pogradec - Dardhas. Kjo linjë ka 6 orare në ditë: i pari 6-7 dhe i fundit 15-16.

Shërbime***Arsimi***

Në njësinë administrative Dardhas mungojnë çerdhet. Kopshte ka vetëm në 4 fshatra, në Dardhas, (35 fëmijë), në Osnat (8 fëmijë), në Grunjas (13 fëmijë) dhe në Stropckë (33 fëmijë). Shkollat fillore e 9 - vjeçare ndodhen në Dardhas (81 nxënës / 9 mësues), Grunjas (28 nxënës / 5 mësues), Osnat (35 nxënës / 3 mësues), Niçë (9 nxënës / 1 mësues), Dërdushë (8 nxënës) dhe Stropckë (109 nxënës / 12 mësues). Shkollat e mesme mungojnë, dhe nxënësit detyrohen të shkojnë në Çërravë ose në Pogradec.

**Vihet re shpesh, që edhe pse fëmijët figurojnë banorë të zonës në gjendjen civile, familjet i dërgojnë tek të afërmit në Pogradec për t'u arsimuar.*

Shëndetësia

Në çdo fshat të njësisë administrative ka nga një qendër shëndetësore, përveç fshatit Stropckë që ka 2 qendra. Fshatrat Stropckë, Dardhas e Dërdushë kanë staf mjekësor fiks, ndërsa fshatrat Grunjas e Prenisht, Lekas e Osnat, dhe Niçë e Stërkanjë stafi mjekësor është levizës.

Zona tërheqëse për turistët

Guri i Kamjes

Festa e Gurit të Kamjes është në 23 korrik.

Kisha e Shën Mërisë

Kjo është kisha më e vjetër e zonës (mendohet të jetë ndërtuar në shek. XVI). Për festën e Shën Marisë, në 15 gusht vijnë vizitorë edhe nga qytete të tjera si Elbasani e Pogradeci.

Ura në Niçë

Mendohet që fshati i vjetër Niçë ka qënë i ndërtuar më pranë urës (jo aty ku është sot), mbi të cilën kalonte udha e vjetër. Vendit ku ka qënë i ndërtuar më parë fshati, i është vënë emri “Murishë”, pasi aty duken ende rrënojat e themeleve të ndërtesave të vjetra. Për këtë urë, këndohej “Balada e murosjes”, si për kalanë e Rozafatit.

Kisha e Shën Gjergjit në Grunjas

Kisha e Shën e Premtes, Niçë

Kishë e tipit bizantin, që është rindërtuar në vitin 1845.

PROGNOZA E ZHVILLIMIT

Zona ka shumë elemente tërheqëse për turistët shqiptarë e të huaj. Zona e Gurit të Kamjes, është e pëlqyer nga çiklistë dhe motoçiklistë të huaj për shkak të terrenit të thyer dhe elementeve të peisazhit. Në 2015 është zhvilluar edhe Rally Albania në zonën Dardhas – Niçë - Mesmal.

Me zgjidhjen e disa problemeve më **immediate**, zona do të merrte një zhvillim të konsiderueshëm. Ndër problemet më **immediate** veçohen:

- Sistemimi i rrugës Lekas- Osnat – Dërdushë - Stërkanjë – Niçë
- Mbjellja e arrorëve dhe vjelja e tyre
- Krijimi i një baxhoje sipas standarteve bashkëkohore
- Sistemimi i kanalizimeve të ujërave të zeza



Fig. 1 Ura në fshatin Niçë



Fig. 2 Kisha e Shën Mërisë në Niçë




Fig. 3 Kisha e Shën e Premtes, Niçë



Fig. 4 Pranverë në fshatin Kalivaç (foto A. Fezollari)

1.2.2 Profili i njësisë administrative Trebinjë

Gjeneza – historiku i fshatrave

Territori i njësisë administrative Trebinjë përfshin zonën e Mokrës së Sipërme. Për prejardhjen e emrit Mokër ka një të dhënë në testamentin e lënë nga Gjin Muzaka, ku emri i krahinës përmendet si vendi i mullinjve (*në gjuhën shqipe, fjala “mokër” do të thotë “gur mulliri”*). Dhe vërtet, zona ka përrenj të shumtë e ujë të bollshëm, dhe ka qënë e njohur për mullinjtë e shumtë. Karakteristikë tjetër e kësaj zone është folklori shumë i pasur, veshjet karakteristike, dhe ruajtja e këngëve të vjetra legjendare të përhapura në tërë Shqipërinë (*kënga e Ymer Agës, balada e murosjes, etj.*).

Zona e Mokrës Sipër ka një terren të thyer malor, ku mbizotëron mali i Kozicës, prej të cilit rrjedhin përrenj të shumtë, që bashkohen në rrjedhën e lumit Shkumbin. Pikërisht ky terren, bëri që zona të arrijë t’i shpëtojë disi ndikimit të pushtuesve otomanë.

Nga qendrat e para të banuara të kësaj njësie ka qënë fshati Llëngë, pranë të cilit kalonte një degëzim i rrugës Egnatia (*e cila bënte lidhjen me fshatin Niçë, e më tej më Voskopojën*). Në shek. XVII-XVIII Llënga pati një zhvillim të madh ekonomik, dhe u kthye në një qendër të rëndësishme

zejtarie e tregtie, që rreth vitit 1750 numëronte rreth 10000 banorë. Prishja e Voskopojës ndikoi pashmangshmërisht edhe në fatin e Llëngës.

Qendra të tjera të banuara që në kohë të hershme janë fshati Potkozhan, i cili ndodhet nën malin e Kozicës (*mendohet të ketë qënë i banuar që para shek. X*), fshati Dunicë, për të cilin mendohet që ka qënë qendra kishtare e zonës (*episkopatë*), fshati Trebinjë, nën të cilin duhet të ketë ekzistuar një vendbanim edhe më i vjetër.

Veç bujqësisë e blegtorisë, banorët e kësaj zone (*kryesisht të fshatrave Pleshisht, Pevelan e Potkozhan*) kanë qënë mjeshtër gurgdhendës e muratorë të shquar, dhe një pjesë e mirë e tyre kanë punuar edhe në mërgim, kryesisht në Rumani. Kontaktet që krijuan me Rilindasit shqiptarë në Rumani, bënë që në këto fshatra të çelen të parat shkolla shqipe për zonën e Mokrës. Në fshatin Potkozhan është çelur dhe shkolla e dytë shqipe në vitin 1908, që kish 20 nxënës.



Fig. 5 Ndërtime karakteristike të zonës

Përveç fshatrave që janë të banuar dhe sot, tregohet për ekzistencën e fshatrave Çorodol (nën fshatin Pleshisht) e Vermiran (diku pranë fshatit Pevelan), që mendohet se janë shkatërruar rreth mesit të shek XIX. Aty ende mund të shihen gërmadhat e muret e themeleve, burimeve e banesave të dikurshme të veshura me bimësi.

Demografia

Njësia administrative Trebinjë ka **3197 banorë / 1097 familje** (*Burimi: Njësia Administrative Trebinjë, 2015*) Trebinja përbëhet nga 15 fshatra: Çezëm e Madhe, Çezëm e Vogël, Hondisht, Selcë e Sipërme, Llëngë, Pleshisht, Hoshtecë, Zemçë, Trebinjë, Potkozhan, Malinë, Kalivaç, Pevelan, Dunicë, Guri i Bardhë.

Popullsia është ndarë në **15 fshatrat** e njësisë si më poshtë:

	GJENDJA CIVILE	NUMRI REAL
Çezëm e Madhe	146 banore / 42 familje	19 familje
Çezëm e Vogël	200 banore / 69 familje	21 familje
Hondisht	238 banorë / 76 familje	28 familje
Selcë e Sipërme	113 banorë / 40 familje	17 familje
Llëngë	60 banorë / 13 familje	7 familje
Pleshisht	361 banorë / 127 familje	61 familje
Hoshtecë	202 banorë / 73 familje	34 familje
Zemçë	30 banorë / 12 familje	9 familje
Trebinjë	430 banorë / 129 familje	75 familje
Potkozhan	210 banorë / 79 familje	33 familje
Malinë	64 banorë / 20 familje	11 familje
Kalivaç	438 banorë / 156 familje	78 familje
Pevelan	118 banorë / 33 familje	13 familje
Dunicë	355 banorë / 138 familje	48 familje
Guri i Bardhë	232 banorë / 90 familje	52 familje

Persona me aftësi të kufizuar: Të paaftë 88, të verbër 19, tetraplegjikë 11 / Invalidë pune 65

Lëvizjet demografike

Popullsia që rezulton në gjendjen civile nuk përkon me atë realen për shkak të lëvizjes së vazhdueshme migratore drejt Vërdovës, Starovës, qytetit të Pogradecit, dhe emigrimit (*kryesisht drejt Greqisë*). Banorët janë larguar për të siguruar kushte më të mira jetese e mundësi më të mira për punësim, por një pjesë e tyre vazhdon të kthehet në stinën e verës, për të punuar tokat.

Fluksi i largimeve ka qënë shumë i lartë (para 5 vjetësh mendohet të kenë qënë rreth 8000 banorë), por ka rënë së fundmi. Me fillimin e punimeve për ndërtimin e rrugës Qukës-Qafë Plloçë, është vënë re një tendencë e banorëve për t'u rikthyer dhe për të riparuar shtëpitë, sidomos në fshatrat pranë të cilëve do të kalojë kjo rrugë (*Kalivac, Potkozhan, Malinë, Trebinjë, Pevelan*).

Bujqësia, Blegtoria

Aktivitetet kryesore ekonomike në Njësinë Administrative Trebinjë janë **Bujqësia (60%)** dhe **Blegtoria (40%)**. Kultura kryesore është gruri, kryesisht pasi banorët janë shumë të varfër për të blerë bukën, kultivojnë grurin për t'a prodhuar vetë. Infrastruktura bujqësore është tejet e amortizuar dhe e dëmtuar, dhe fshatrat Pleshisht e Trebinjë, që kanë më shumë sipërfaqe tokash bujqësore kanë vështirësi për vaditjen e tyre (*fshatrat e tjerë janë kryesisht malorë*).

Kafshët që mbarështohen janë 1200 gjedhë, 7100 të leshta, 5200 të dhirta dhe 179 derra. Çdo familje ka minimalisht nga një lopë. Në fshatin Dunicë ka një baxho (meqë është në një zonë me relief të thyer dhe banorët merren kryesisht me blegtori).

Ekonomia

Në njësinë Administrative Trebinjë, që është ndoshta edhe njësi më e varfër e Bashkisë Pogradec, janë rreth 28 biznese të vogla, kryesisht shitore, lokale - kafene, një mulli me çekiç dhe një nallban. Biznese të mëdha të regjistruara janë një subjekt me vaska peshku dhe një TV kabllor.

Deri në vitet '90, ka funksionuar një minierë qymyri në Potkozhan, e cila ishte burim punësimi për shumë banorë. Tani miniera është e pashfrytëzuar.

Infrastruktura

Uji i pijshëm

Furnizimi me ujë të pijshëm është problem për fshatrat Trebinjë e Pleshisht, pasi nuk kanë sasi të mjaftueshme uji. Përgjithësisht mungojnë veprat për ujë të pijshëm.



Fig. 6 Pamje e fshatit Pleshisht



Fig. 7 Pamje e minierës të qymyrit në Potkozhan



Figura 7 Rrugë në fshatin Kalivaç

Ujërat e zeza

Banorët zakonisht i bashkojnë tubacionet, dhe i dedhin ujërat e zeza në përrrenjtë më të afërt.

Elektrifikimi

Problemet me elektrifikimin janë të shumta dhe sistemi është i amortizuar. Ndrëçimi rrugor mungon pothuajse tërësisht, pasi nuk ka as kontratë (sidomos fshatrat Hoshtecë, Selcë e Çezmë kanë probleme të mëdha me ndrëçimin). Banorët janë shumë të varfër edhe për të paguar koston e ndrëçimit me energji elektrike, ndaj është e kuptueshme që ngrohja në dimër bëhet me dru zjarri.

Vendgrumbullimi i mbetjeve

Mbetjet grumbullohen në zona malore, por janë sasi të pakonsiderueshme, krahasuar me mbetjet që prodhon qyteti. Përgjithësisht banorët i depozitojnë këto mbetje (kryesisht të natyrës organike) në tokat e tyre apo në përrrenj të thatë.

Transporti

Rrugët e njësisë janë të kalueshme vetëm me mjete të larta, dhe fshatrat nuk janë të arritshëm për shkak të mungesës të infrastrukturës të përshtatshme. Disa rrugë janë të kalueshme me makinë vetëm në stinën e verës.

Shërbime***Arsimi***

Në njësinë administrative Trebinjë mungojnë çerdhet. Kopshtet ka vetëm në 3 fshatra, në Trebinjë, (16 fëmijë / 1 edukatore), në Dunicë (29 fëmijë / 1 edukatore) dhe në Kalivaç (15 fëmijë / 1 edukatore). Shkollat fillore e 9 - vjeçare ndodhen në Trebinjë (48 nxënës / 7 mësues), Dunicë (73 nxënës / 9 mësues), Potkozhan – shkolla e dytë shqipe në Shqipëri (37 nxënës / 5 mësues), Kalivaç (12 nxënës / 2 mësues), Pleshisht (32 nxënës / 5 mësues), Selcë e Sipërme (50 nxënës / 4 mësues), Çezmë e Vogël (29 nxënës / 2 mësues), Hondisht (20 nxënës / 2 mësues), ndërsa në fshatin Llëngë mësimi bëhet me një mësues të jashtëm në një shtëpi private (4 nxënës / 1 mësues).

Shkollë të mesme ka vetëm në fshatin Trebinjë, me 79 nxënës, 4 mësues dhe 2 personel ndihmës.

Shëndetësia

Në 7 fshatra të njësisë administrative ka nga një qendër shëndetësore (*nga të cilat 6 janë funksionale*), dhe një spital. Spitali Qazim Muco Trebinjë është në gjendje mesatarisht të mirë. Fshatit Hondisht i mungon një qendër shëndetësore, dhe është e nevojshme, pasi mbulon dhe fshatin Llëngë.

Njësinë e mbulojnë 2 mjekë dhe 12 infermierë. Në qendrën e njësisë, në Trebinjë ka një qendër shëndetësore, ku është një mjek fiks, ndërsa mjeku tjetër udhëton sipas kërkesave nga infermierët në qendrat e tjera, pra është ambulant.

Vlerat historike, natyrore e kulturore

Kisha dhe manastiri i Shën Marenës në Llëngë

Kisha e Shën Marenës është ndërtuar në vitin 1754. Sipas një mbishkrimi të vjetër në murin veriperëndimor të saj, thuhet se ndërtimi i kishës dhe pikturave murale është bërë me shpenzimet e banorëve, mjeshtrave, esnafëve e klerikëve të fshatit të Llëngës. Në pjesën e brëndshme kisha është e zbukuruar me piktura murale të mjeshtrit Konstandin Shpataraku, dhe ikonostasi i gdhendur me motive floreale, ngjason shumë në aspektin stilistik me kishat e Voskopojës e Vithkuqit.

Festa e Shën Marenës festohet më 30 korrik, e në këtë festë vijnë jo vetëm besimtarë të krishterë por edhe myslimanë, jo vetëm nga fshatrat e Mokrës, por edhe nga Pogradeci, Korça e Elbasani.

Shpella e Shën Marenës

Kanioni i Llëngës

Gurët e Nuses

Urat në Dunicë e Çezmë

Këto ura të vjetra kanë qënë pjesë e rrugës tregtare, segment i “via Egnatia”, që shkonte deri në Voskopojë.

Prognoza e zhvillimit

Zona ka shumë elemente tërheqëse për turistët shqiptarë e të huaj, të natyrës peizazhiste e historike. Ndër problemet më imediate, zgjidhja e të cilëve do të sillte përmirësime të ndjeshme në jetën e banorëve, veçohen:

- Ndërtimi i ujësjellësit që përfshin fshatrat Dunicë, Trebinjë e Pleshisht
- Ndërtimi i rrugës për në Manastirin e Shën Marenës
- Sistemimi dhe rivënia në punë e veprës ujitëse që i shërbente 8 fshatrave të njësisë administrative Trebinjë



Figura 9 Manastiri i Shën Marenës në Llëngë



Figura 9 Kisha e Shën Marenës në Llëngë




Figura 10 Kanioni i Llëngës



Fig. 10 Ura e Golikut

1.2.3 Profili i njësisë administrative Proptisht

Gjeneza – historiku i fshatrave

Territori i njësisë administrative Proptisht përfshin një pjesë të zonës së Mokrës së Poshtme. Mokra e Sipërme me Mokrën e Poshtme kanë disa të përbashkëta por edhe dallime, si në folklor, veshje popullore e në të folur.

Varret monumentale të Selcës, të gdhendura në gur, ndodhen në kodrën e Gradishtës të Selcës, në pjesën perëndimore të fshatit të sotëm Selcë e Poshtme. Në majë të kësaj kodre ka qënë edhe një kështjellë e shek V-IV pK. Sipas disa arkeologëve, ky mund të ketë qënë jo vetëm varri i mbretërve ilirë por edhe vendi i selisë së tyre. Sipas kësaj hipoteze, në këtë zonë mund të ketë qënë Pelioni i Lashtë, që përmendet në luftën midis ilirëve, të udhëhequr nga mbret Bardhyli, me Filipin e Maqedonisë.

Qendër tjetër e banuar që në kohë të hershme, është fshati Rrodokal i Sipërm, emri i të cilit mendohet që vjen nga sllavishtja ‘Rodokral’ – ‘Fismbret’ (në përgjithësi emrat sllavë viheshin si përkthim i emrave të vendeve nga shqipja në sllavisht.) Thuhet që ky ka qënë një fshat i madh, me shumë shtëpi të ndërtuara pranë njëra-tjetrës, aq sa macja ecte çati më çati e kalonte nga kreu i

fshatit deri në fund të tij. Mendohet që epidemia e kolerës ka ndikuar në pakësimin e këtij fshati. Fshati Rodokal i Poshtëm, dikur ka qënë lagje e Rodokalit të Sipërm.

Mendohet që edhe fshati Slabinjë të ketë qënë një vendbanim i hershëm dhe i rëndësishëm. Pranë fshatit ndodhet një urë e vjetër (*degë e rrugës Egnatia, e përmendur edhe më sipër*), e cila vazhdonte në fshatrat Shpellë, Llëngë, Niçë deri në Voskopojë.

Si në fshatra të tjerë të Mokrës të Sipërme, edhe në fshatrat e Mokrës të Poshtme, banesat ndërtoheshin përgjithësisht me mure guri të lidhura me breza druri, ndërsa dyert e dritaret bëheshin me qemerë guri ose me arkitrarë druri. Në trajtimin e elementeve dekorativë e detajeve të konstruksionit, vihet re ndër të tjera edhe një sens i theksuar estetik i mjeshtave muratorë dhe gurgdhëndës të zonës.



Fig. 12 Detaj i punimit të mureve të banesave në fshatin Slabinjë



Fig. 12 Banesa karakteristike të zonës

Demografia

Njësia administrative Proptisht ka **6393 banorë / 1938 familje** (*Burimi: Njësia Administrative Proptisht, 2015*)

Proptishti përbëhet nga 15 fshatra: **Proptisht, Homçan, Kriçkovë, Selcë Poshtë, Homezh, Rodokal i Sipërm, Rodokal i Poshtëm, Zall-Torre, Golik, Vërri, Slatinë, Selishtë, Baribardhë, Somotinë, Slabinjë.**

Popullsia është ndarë në **15 fshatrat** e njësisë si më poshtë (?):

Proptisht	Rodokal i Sipërm	Slatinë
Homçan	Rodokal i Poshtëm	Selishtë
Kriçkovë	Zall-Torre	Baribardhë
Selcë Poshtë	Golik	Somotinë
Homezh	Vërri	Slabinjë

Persona me aftësi të kufizuar: 282, të verbër 33, para/tetraplegjikë 11 / Invalidë pune 120

Lëvizjet demografike

Fluksi i largimeve ka qënë shumë i lartë (*para 5 – 6 vjetësh mendohet të jetë stabilizuar disi gjendja*), por ka rënë së fundmi. Banorët janë larguar për të siguruar kushte më të mira jetese e mundësi më të mira për punësim, por një pjesë e tyre vazhdon të kthehet në stinën e pranverës e të verës, për të punuar tokat.

Ekonomia

Në njësinë Administrative Proptisht janë rreth **43 biznese të vogla**, kryesisht të natyrës të shërbimeve (*shitore, bar –bufe, e ushqimore*), dhe **6 biznese të mëdha** (*2 HEC, 2 Antena televizive, dhe 2 miniera: 1 minierë Hekur-Nike në fshatin Baribardhë, dhe 1 minierë kromi në fshatin Rodokal i Sipërm*). Industria e përpunimit agroushqimor mungon.

Bujqësia, Blegtoria

Aktivitetet kryesore ekonomike në Njësinë Administrative Proptisht janë **Bujqësia (70%)** dhe **Blegtoria (30%)**. Kulturat kryesore që kultivohen janë gruri, misri, tërshëra, fasulet, patate, foragjeret e perimet e ndryshme.

Infrastruktura bujqësore është tejet e amortizuar dhe e dëmtuar. Kanaleve të vjetër vaditës u janë hequr pllakat, ndaj dhe nuk bëhet dot lidhja me rezervuarët. Është mundësia edhe për lidhjen me ujërat që vijnë



Fig. 14 Pamje e HEC-it në afërsi të fshatit Proptisht



Fig. 14 Toka të punuara në fshatin Slabinjë

nga Qafë-Thana, por mungojnë kanalet. Janë bërë disa projekte për sistemimin e këtyre kanaleve, por nuk kanë patur rezultat.

Blegtoria është e zhvilluar më shumë në periferinë malore. Kafshët që mbarështohen janë gjedhët, lopët, të leshtat, delet, të dhirtat, njëthundrakët, shpendët e bletët. Në të gjithë zonën ka vetëm dy baxho.

Infrastruktura

Uji i pijshëm

Burimet natyrore për ujin e pijshëm janë të shumtë, por ujësjellësat janë jashtë përdorimit. Uji i pijshëm nuk paguhet pasi nuk ka matësa e tubacione. Nga ujësjellësat nuk vjen asnjë e ardhur, por vetëm shpenzime për riparime. Fshatrat Rodokal i Sipërm, Rodokal i Poshtëm e Slabinjë kanë vepra shpërndarje, ndërsa fshatrat e tjerë shfrytëzojnë direkt burimet natyrore.

Ujërat e zeza

Fshati Rodokal i Sipërm, duke qënë më i mbledhur territorialisht, ka sistem të mirëfilltë kanalizimesh. Fshatrat e tjerë punojnë me gropa septike, të zgjidhura në mënyrë personale nga banorët, **një pjesë e mbetjeve të të cilave përdoren për pleh.**

Elektrifikimi

Përgjithësisht nuk ka probleme me enegjinë elektrike, apo difekte, për shkak edhe të ndryshimeve klimatike (dimrat nuk janë më aq të acartë sa kanë qënë). Ngrohja bëhet me dru zjarri, por një pjesë shumë e vogël e banorëve i blen ato. Pyjet janë dëmtuar shumë nga prerjet pa kriter (*mund të llogaritet që për çdo familje nevojiten rreth 8m³ dru zjarri në vit, dhe nevoja në rang njësie administrative, për 1900 familje shkon tek 15200 m³ në vit*)

Vendgrumbullimi i mbetjeve

Për mbetjet urbane, janë caktuar disa vendgrumbullime pranë disa prej fshatrave me vendim të këshillit komunal. Në fshatra të tjera është kërkuar vetëasgjësim nga banorët. Kazanët dhe makineritë për mbledhjen e pastrimin e plehrave mungojnë, pasi sistemi rrugor është aq i amortizuar, sa makina e ka të pamundur të vijë.

Transporti

Një pjesë e mirë e rrugëve të njësisë janë të kalueshme vetëm me mjete të larta, dhe disa fshatra nuk janë të arritshëm për shkak të mungesës të infrastrukturës së përshtatshme. Lëvizja bëhet kryesisht me makina private. Ka edhe tri linja kryesore furgonësh, që bëjnë transport midis fshatrave deri në qytezën e Prrenjasit e më pas në Pogradec. Këto linja janë:

Golik - Vërri - Proptisht - Somotinë - Slabinjë - Prrenjas - Pogradec

Homezh - Rodokal i Sipërm - Rodokal i Poshtëm

Homçan - Kriçkovë - Selcë e Poshtme

**Rruga për në fshatin Zalltorre shkon 1 orë me makinë dhe më pas 30 min në këmbë pasi nuk ka rrugë Siguria*

Strukturat e mirëfillta për mbrojtjen nga zjarri, dhe makinat zjarrfikëse mungojnë. Megjithatë, kur ka zjarre futet fshati 'fshatçe' - janë krijuar disa struktura nga kryepleqtë e fshatrave me djemtë që nuk kanë emigruar, të cilat aktivizohen kur ka raste emergjencash.

Policë nuk ka, por është zonë e qetë.

Shërbime

Arsimi

Në njësinë administrative Proptisht mungojnë çerdhet. Kopshte ka vetëm në 9 fshatra (në Homçan, Kriçkovë, Selcë të Poshtme, Somotinë, Selishtë, e Baribardhë nuk ka kopshte).

Në Proptisht ka 13 shkolla fillore dhe 5 shkolla 9 vjeçare. Në fshatrat Homçan, Kriçkovë e Selcë ka pak fëmijë, por fshatrat pranë plotësojnë njëri tjetrin.

Shkolla të mesme ka vetëm 2, në fshatin Proptisht dhe Rodokal i Sipëm.

Shëndetësia

Në 2 nga fshatrat e njësisë administrative, në fshatin Selishtë e Baribardhë, mungon një qendër e kujdesit shëndetësor. Në fshatrat e tjerë qendra shëndetësore përbëhet nga një dhomë ku kryen vizitat, **por është funksionale.**



Fig. 15 Shkollë në fshatin Somotinë (?)



Fig. 18 Rruga për në Proptisht



Fig. 18 Rruga për në fshatin Somotinë



Fig. 18 Rruga për në Slabinjë

Vlerat historike, natyrore e kulturore

- Varret monumentale të Selcës
 - Ura e Golikut (vijim i rrugës Egnatia)
- Ura e Golikut, mbi lumin Shkumbin, është vepër arti e rrugës së vjetër "Via Egnatia", e ndërtuar në shek XVIII dhe klasifikohet si monument kulture i kategorisë së parë. Është urë me dy qemerë në formë gjysmërrethore, midis tyre gjendet një dritare shkarkuese (edhe kjo me qemer gjysmërrethor). Ura është ndërtuar me gurë të gdhendur, ku bie në sy pjesa e poshtme e qemerit e cila ka gurë të mëdhenj dhe të punuar mirë, jo thjesht për estetikë, por edhe për ta bërë strukturën më të fortë.*
- Ura e Terziut (vijim i rrugës Egnatia)
 - Rrapi i Rodokalit (rrap 300 vjeçar)
 - Gurët e nuses (gjeomonument)



Fig. 19 Varret monumentale të Selcës

Proгноza e zhvillimit

Zona ka shumë elemente tërheqëse për turistët shqiptarë e të huaj, të natyrës peizazhiste, arkitektonike e historike.

Ka patur konflikte lidhur me dokumentacionin dhe procesin e regjistrimit të pronave; akti i marrjes të tokës në pronësi u nxor në '91 dhe deri në '98 nuk u bënë regjistrime, ndaj ka probleme me mbivendosjet. Kërkesa për ndërtim, kryesisht banesash janë të shumta (*në tokat e tyre*), megjithatë është ndërtuar edhe pa leje.

Ndër problemet më imediate, zgjidhja e të cilëve do të sillte përmirësime të ndjeshme në jetën e banorëve, veçohen:

- Rikonstrukcioni i kanaleve vaditëse për bujqësinë, investim që do të zgjidhte vaditjen e tokave bujqësore.
- Sistemimi i rrugëve ekzistuese (*disa km. rrugë janë shtruar me kontribut vullnetar nga vetë banorët e zonës*)
- Sistemimi i ujërave të zeza e të bardha brenda fshatrave dhe paisja me matësa për ujin e pijshëm.




Fig. 20 Pamje të fshatit Slabinjë



Fig. 21 Pamje nga rruga për në fshatin Jollë

1.2.4 Profili i njësisë administrative Velçan

Gjeneza – historiku i fshatrave

Velçani është një nga fshatrat e mëdhenj të Mokrës së Poshtme, dhe ndahet në disa lagje. Paria e këtij fshati, historikisht ka dominuar të gjithë zonën e Mokrës

Edhe në këtë zonë ka gjurmë që dëshmojnë për vjetërsinë e zonës, psh. toponimet nga koha e pushtimit romak (me origjinë latine), Bishnicë nga “bosco” (pyll), Laktesh nga latinishtja “*lactum*”, që ka kuptimin “*qumësht*”, Shpellë nga “*speleo*” (shpellë), etj.

Fshatrat më të rinj të zonës përmenden fshatrat Zgallë e Jollë (*të cilët janë sot dhe fshatrat më periferikë*), dhe janë banuar nga të ardhur nga fshatrat e rrethit fqinjë të Gramshit. Kanë qënë fshatarë të varfër, që kanë ardhur të punojnë si bujq në tokat e pronarëve të mëdhenj vendas.



Fig. 22 Banesa karakteristike të zonës

Demografia

Njësia administrative Velçan ka **3725 banorë** (*Burimi: Njësia Administrative Velçan, 2016*) dhe përbëhet nga 9 fshatra: **Velçan, Buzahishtë, Laktesh, Senisht, Bishnicë, Losnik, Shpellë, Jollë, Zgallë**. Fshati më i madh është Velçani me 1800 banorë, dhe fshati më i vogël e më i largët është Zgalla, në vijim të fshatit Jollë.

Popullsia është ndarë në **9 fshatrat** e njësisë si më poshtë:

Velçan 1800 banorë	Senisht 250 banorë	Shpellë 70 banorë
Buzahishtë 500 banorë	Bishnicë 300 banorë	Jollë 70 banorë
Laktesh 600 banorë	Losnik 130 banorë	Zgallë

Në Velçan ka një grup të komunitetit egjiptian, dhe në Jollë ka grup të komunitetit rom.

Persona me aftësi të kufizuar: 90, të verbër 13 (kujdestari verbërie: 2), para/tetraplegjikë 8 (kujdestari: 8), Invalidë pune 67.

Lëvizjet demografike

Ka patur një tendencë për t'u larguar drejt zonave urbane për kushtë më të mira jetese (*deri para 2 vjetësh*), por ky fluks ka rënë, për shkak të mungesës të punësimit. Kjo ka sjellë që një pjesë e tyre të kthehen e të shfrytëzojnë e punojnë tokat e tyre bujqësore. Rreth 20% e popullsisë të kësaj zone jeton jashtë shtetit.

Ekonomia

Në njësinë Administrative Velçan janë rreth **32 biznese të vogla**, kryesisht të natyrës së shërbimeve (*shitore, bar –bufe, e ushqimore*), dhe **1 HEC aktiv** në Bishnicë (dhe 2 të tjerë në ndërtim e sipër) Ka patur edhe një Hotel, por është degraduar dhe është jashtë funksioni. Ka një minierë qymyri që e kap pjesërisht Velçani.

Bujqësia, Blegtoria

Aktivitetet kryesore ekonomike në Njësinë Administrative Velçan janë **Bujqësia (60%)** dhe **Blegtoria (40%)**. **Kulturat kryesore që kultivohen janë gruri, patatet, foragjeret e perimet e ndryshme.**

Infrastruktura bujqësore është tejet e amortizuar dhe e dëmtuar. Kanalet vaditëse për shkak të erozionit janë mbushur me dhe. Për shkak të mospastrimit të tyre, nuk është e mundur të përdoret uji i dy rezervuareve të mëdhenj për vaditje (*kapaciteti max. i rezervuarit më të madh 1000000 m³, kanali i parë i të cilit shkarkonte 5000m³/sek*) dhe rezervuari i dytë ka kapacitet 250.000 m³. Kanali i dytë i rezervuarit në Buzahishtë është sistemuar me kontributin e vetë banorëve.

Kafshët që mbarështohen janë gjedhët, lopët, delet, dhitë, njëthundrakët, shpendët, derrat e bletët. Në të gjithë zonën ka vetëm një baxho në Buzahishtë. Ka edhe ferma në nivel familjar, me rreth 150 krerë bagëti të imët dhe 10 krerë lopë.

Infrastruktura

Uji i pijshëm

Uji i pijshëm vjen nga Bishnica. Nga ky rrjet merr ujë dhe njësia administrative fqinjë, Proptishti, por rrjeti është tejet i amortizuar.



Fig. 23 HEC në Bishnicë



Fig. 25 Kullota në rrugën për në fshatin Bishnicë



Fig. 24 Fshati Bishnicë

Ujërat e zeza

Ujërat e zeza depozitohen në gropa septike, në nivel familjar. Shpesh këto mbetje përdoren nga banorët për plehërimin e tokës bujqësore.

Elektrifikimi

Përgjithësisht fshatrat kanë energji elektrike, por rrjeti është i amortizuar. Disa nga fshatrat furnizohen nga HEC në Bishnicë. Ngrohja bëhet me dru zjarri në 90% të familjeve (nevoja e drurit për ngrohje llogaritet rreth 6 – 10 m sterë në vit për familje) Pyjet janë dëmtuar shumë nga prerjet pa kriter.

Vendgrumbullimi i mbetjeve

Për mbetjet urbane, është caktuar një vendgrumbullim në kufirin mes fshatrave Buzahishtë – Bishnicë por bëhet fjalë për sasi të vogla mbetjesh. Ka patur një fadromë që i punonte, por nuk funksionon më.

Transporti

Një pjesë e mire e fshatrave nuk janë të arritshëm për shkak të mungesës së infrastrukturës të përshtatshme. Rrugë të asfaltuara janë pjesërisht në Buzahishtë dhe Velçan, pjesa tjetër janë rrugë rurale. Ka nga një furgon të licencuar për çdo fshat, që lëviz me orare të përcaktuara. Ka edhe një shoqatë transporti për këtë zonë.

Siguria

Strukturat e mirëfillta për mbrojtjen nga zjarri, dhe makinat zjarrfikëse mungojnë. Ky është një problem i madh, sepse dhe në pyje ka patur shumë zjarre. Ka disa skuadra zjarrfikëse, nga një për çdo fshat, që drejtohen nga kryeplaku, dhe që veprojnë në raste emergjencash.

Rajon policie nuk ka vetem në qytet. Cdo komunë ka patur nga 2 punonjës, dhe një inspektor (që mbulonte Velcanin dhe Proptishtin) dhe vareshin nga Komisariati.

Shërbime

Arsimi

Në njësinë administrative Velçan mungojnë çerdhet. Kopshte ka vetëm në 4 fshatra: në Bishnicë, Velçan, Laktesh e Losnik. Në këto dy të fundit mungojnë edukatoret. Në Velçan ka 5 shkolla 9 vjeçare (në fshatrat Velçan, Buzahishtë, Bishnicë, Laktesh e Senisht) dhe një shkollë të mesme në Velçan.

Shëndetësia

Ka një qendër shëndetësore të madhe në Velçan dhe 5 ambulanca (në Laktesh, Buzahishtë, Bishnicë, Senisht dhe Velçan) Ka patur dhe një spital të përgjithshëm në Bishnicë, i cili sot është jashtë funksioni.

Vlerat historike, natyrore e kulturore

Liqenet e Lukovës

Liqenet e Lukovës janë liqene me origjinë akullnajore dhe ndodhen në lartësi 1871 m nga niveli i detit. Këto liqene ndodhen në afërsi të fshatit Bishnicë (85 km larg nga qyteti i Pogradecit në rrugë automobilistike). Zona është e mbrojtur (Monument natyre i kategorisë së tretë), por ka dëmtime të vegjetacionit nga subjekte që kanë prerë pemët për drurë zjarri.

Gurët e nuses

Gjeomonument, që gjendet në afërsi të fshatit Senisht të Mokrës 100m mbi nivelin e detit; janë gurë deri në 3 m të lartë, me përbërje konglomeratesh me çimentim dhe fortësi jo të njëjtë, të modeluar nga era, që u ka dhënë formën e “Nuses” dhe të “Dhëndrit”.

Guri i Zi (520 - 2072m)

Shkëmbi i qytetit (zonë arkeologjike)

PROGNOZA E ZHVILLIMIT

Zona ka shumë elemente tërheqës për turistët shqiptarë e të huaj, kryesisht të natyrës peizazhistike. Por turizmi pengohet në mënyrë të konsiderueshme nga mungesa e infrastrukturës.

Kërkesa për ndërtime të reja momentalisht mungojnë. Kryesisht vijnë kërkesa për mirëmbajtje e riparime, kur ka dëmtime të banesave ekzistuese. Konfliktet e pronësisë janë të rralla, dhe janë për kufijtë e tokave (adresohen në Zyrën e Pasurive në Pogradec)

Investim i huaj me impakt për zonën është një shkollë në fshatin Bishnicë, e financuar nga një fondacion gjerman (Nehemia), e cila ka ndërtuar dhe një konvikt për fëmijët e fshatrave Shpellë e Jollë, të cilët rrinë gjatë javës në Bishnicë për të ndjekur mësimin, dhe në fundjavë kthehen në shtëpitë e tyre.



Fig. 26 Shkëmbi i qytetit



Fig. 27 Pamje e fshatrave të njësisë administrative Çërravë

1.2.5 Profili i njësisë administrative Çërravë

Gjeneza – historiku i fshatrave

Territori i njësisë administrative Çërravë përfshin një pjesë të fshatrave të zonës së luginës së Çërravës (Çërrava, Nizhaveci, Leshnica), dhe një pjesë të fshatrave të Malit të Thatë (Blacë, Alarup, Bletas).

Dëshmi që në këtë zonë ka patur vendbanime të hershme janë rrënojat e kalasë së Blacës, që ndodhet në kodrën që ndodhet pranë fshatit. Po ashtu, në vitet '90, gjatë gjërimeve për themelet e një ndërtese të re në fshatin Nizhavec, u gjetën gjërmadhat e një kisha të vjetër, të rrënuar e të mbuluar, gjë që dëshmon jo vetëm prezencën e Kishës në vetvete, por edhe të një vendbanimi të hershëm në atë zonë.



Fig. 29 Banorë të fshatit Alarup



Fig. 28 Bujq në fshatin Nizhavec

Demografia

Njësia administrative Çërravë ka **9853 banorë** (*Burimi: Njësia Administrative Çërravë, 2015*) dhe përbëhet nga 10 fshatra: **Çërravë, Lumas, Leshnicë, Grabovicë, Nizhavec, Blacë, Bletas, Alarup, Kodras, Qershizë**. Fshati më i madh është Çërrava me 1902 banorë.

Popullsia është ndarë në **10 fshatrat** e njësisë si më poshtë:

Çërravë 1902 banorë

Nizhavec 561 banorë

Kodras 93 banorë

Lumas 201 banorë

Blacë ___ banorë

Qershizë 884 banorë

Leshnicë 1734 banorë

Bletas 768 banorë

Grabovicë 396 banorë

Alarup 780 banorë

Në Çërravë ka një grup të komunitetit rom (*26 familje, në fshatin Qershizë*).

Persona me aftësi të kufizuar: të paaftë 188 persona (kujdestari paaftësie: 25), të verbër 31 (kujdestari verbërie: 5), para/tetraplegjikë 15 (kujdestari: 15), Invalidë pune 168.

Lëvizjet demografike

Ka patur një tendencë për t'u larguar drejt Greqisë (kryesisht) për kushte më të mira jetese, por ky fluks ka rënë, për shkak të mungesës të mundësive të punësimit në shtetin fqinjë. Prej 7-8 vjetësh vihet re një kthim masiv nga emigracioni familjar në Greqi, dhe një ri-shfrytëzim i tokave të tyre bujqësore. Prej gati 10 vitesh nuk ka patur më as lëvizje ardhëse as nga zona e malësisë së Mokrës.

Ekonomia

Në njësinë Administrative Çërravë janë rreth **83 biznese të vogla**, kryesisht të natyrës së shërbimeve (*tregti pakicë, bar-kafe, TV kabllor, ambulancë e lëvizshme, profesione të lira, 1 sallon bastesh e 1 bilardo*), dhe **15 biznese të mëdha** (*asfaltim/inerte*).

Biznesi që ka më shumë të punësuar është kompania ALB Fruit, i cili merret me mbledhjen dhe paketimin e bimëve mjekësore (*hithra, çaj mali*). Kjo kompani ka 27 punonjës gjatë gjithë vitit, dhe 100-200 punonjës sezonalë, që shtohen në stinën e mbledhjes (*në verë*). Këto prodhime shkojnë në tregun gjerman, por paketimi bëhet në zonë.

Edhe kompanitë e inerteve kanë po ashtu punësim kryesisht sezonal (120 punonjës, në sezonin e aktivitetit të lartë).

2 Minierat që janë në zonë: **miniera e qymyrit të drurit në Alarup** (*e cila furnizonte TEC-in e Korçës dhe Maliqit*), dhe **miniera e qymyrgurit në Petrushë** janë prej kohësh jashtë funksionit.

Bujqësia, Blegtoria

Aktivitetet të tjera të rëndësishme ekonomike në Njësinë Administrative Çërravë janë **Bujqësia dhe Blegtoria**. Veçanërisht në zonën e Çërravës dhe Leshnicës është e zhvilluar pemëtaria e vreshtaria, dhe kulturat më të kultivuara janë: mollët e gështenjat. Mollët kanë vështirësi për t'u shitur pasi nuk ka as treg, as një vendmagazinin frigoriferik të mirëfilltë. Ka vetëm një frigorifer në fshatin Grabovicë, i cili është ndërtuar me investim privat. Magazinimi i frutave bëhet përgjithësisht në shtëpi, dhe prodhuesit presin tregtarët nga qytete të tjera që t'i shesin prodhimet e tyre (*duke pranuar shpesh edhe çmime nën koston e prodhimit*).

Varieteti i rrushit që kultivohet më shumë është i tipit Perlë, pasi edhe shitet më shtrenjtë. Ka edhe punishte për përpunimin e rrushit, por prodhuesit e verës apo rakisë preferojnë rrushin që vjen nga Maqedonia, për shkak të çmimit më të lirë.

Çërrava është e njohur edhe për tregun e gjësë së gjallë për rajonin, ku tregtohen kryesisht bagëti të imta, lopë, etj. (?) Në njësinë administrative Çërravë ka 2 baxho (në fshatin Nishavec), që janë ndërtuar me investim privat, dhe janë në gjendje të mirë.



Fig. 30 Tregu i gjësë së gjallë në Çërravë



Fig. 31 Pamje e fshatit Alarup

Infrastruktura

Uji i pijshëm

Në fshatin Çërravë dhe Qershizë janë bërë shpime me sonda rreth viteve '90, dhe janë bërë puse e depo uji (*fshati Çërravë ka një rrjet të brendshëm*). Në Leshnicë ka problem me depot ujore; fshati Grabovicë e merr ujin me pompë nga burimet, fshatit Petrushë i mungon pompa nga burimi për në depo, Alarup-i ka rrjet të brendshëm që në kohën e komunizmit, në Bletas uji merret nga puset, nëdrsa në Blacë ka nevojë per investim.

Ujërat e zeza

Ujërat e zeza derdhen në lumenj, të cilët më pas shkojnë në liqenin e Ohrit, duke krijuar një problem emergjent mjedisor.

Vendgrumbullimi i mbetjeve

Për mbetjet urbane, janë caktuar tre vendgrumbullime: në Leshnicë, në Petrushë dhe në Çërravë. Ka një makinë që bën mbledhjen e mbetjeve sipas një grafiku. Ka edhe banorë që janë të papërgjegjshëm dhe i hedhin mbetjet në lumenj.

Transporti

Lidhja midis fshatrave bëhet kryesisht me makina e furgona privatë. Ka edhe një linjë me orare të përcaktuara që bën lidhjen e fshatrave me njëri tjetrin e me qytetin e Pogradecit: linja Alarup-Pogradec, e cila kalon nga fshatrat: Alarup –Bletas –Blacë –Grabovicë – Çërravë – Leshnicë – Pogradec. Pjesa e rrugës në segmentet Alarup – Bletas –Blacë është e asfaltuar. Rruga Çërravë - Lumas është e dëmtuar.

Shërbime

Arsimi

Në njësinë administrative Çërravë mungojnë çerdhet. Kopshte ka 2 në Çërravë, dhe nga 1 në fshatrat Leshnicë, Lumas, Pretushë, Grabovicë, Bletas, Alarup dhe Blacë. Shkollat 9 vjeçare (8 shkolla për tërë njësinë) ndodhen në Leshnicë, Lumas, Çërravë, Petrushë, Grabovicë, Bletas, Alarup e Blacë. Kopshtet dhe shkollat 9 vjeçare përgjithësisht ndodhen në të njëjtën godinë. Shkolla të mesme ka në fshatin Çërravë dhe Blacë.

Fshati Nishavec nuk ka shkollë, pasi është jashtë funksionit dhe e amortizuar.

Shëndetësia

Në Çërravë ka gjithsej **11 qendra të kujdesit shëndetësor** (nga një për çdo fshat), dhe 3 doktorë në total (Çërravë, Leshnicë, Lumas, Qershizë – 1 Doktor / Petrushë, Grabovicë, Nishavec – 1 Doktor / Blacë, Alarup, Bletas – 1 Doktor) Në Çërravë është një poliambulancë me 3-4 infermiere dhe 1 doktor, që mbulon dhe Leshnicën, Qershizën dhe Lumasin në ditë të caktuara.

Vlerat historike, natyrore e kulturore

- **Kalaja e Blacës** – Monument kulture i Kategorisë së parë

PROGNOZA E ZHVILLIMIT

Zona ka disa elemente tërheqëse për turistët shqiptarë e të huaj, të natyrës peizazhistike e agro-turistike. Ndër problemet më imediate, zgjidhja e të cilëve do të sillte përmirësime të ndjeshme në zonë e në jetën e banorëve, veçohen:

- Ndërtimi i një sistemi kanalizimesh për fshatrat Leshnicë e Çërravë, ujërat e zeza të të cilave aktualisht derdhen në lumenj që përfundojnë më pas në liqenin e Ohrit.

- Sistemimi i ujit të pijshëm për të gjithë fshatrat e njësisë

- Problem kryesor

Shpyllëzimi masiv dhe shitja e drurit për ngrohje në stinën e dimrit.



Fig. 32 Lin - foto ajrore

1.2.6 Profili i njësisë administrative Udënisht

Gjeneza – historiku i fshatrave

Fshati Lin, nga gjetjet e deritanishme, mendohet të ketë qënë një një vendbanim i lashtë dhe i madh. Mbi kodër janë zbuluar mozaikët e vjetër dhe bazilika bizantine (e ndërtuar rreth shek. VI, në kohën e perandorit Justinian). Zbulimi i një vendbanimi palafit, në afërsi të këtij fshati, është një dëshmi tjetër e hershmërisë së kësaj zone. Tjetër dëshmi e ekzistencës së një qyteti në këtë kodër është edhe emri Zagradje, që në gjuhën sllave ka kuptimin: (za=pas, përtej), (grad= qytet), d.m. th. Vend, apo lagje, pas, përtej, qytetit. Nuk ka të dhëna se si e kur është zhdukur qyteti, por në vendin e Zagradjes janë zbuluar gjetje të ndryshme helenistiko-romake.

Fshati Piskupat, mendohet të mos ketë qënë ku është sot, por në një zonë mbi fshatin e sotëm, që vendasit e quajnë “Katu – plak”, dmth katundi më i vjetër.

Fshatrat Mëmëlisht e Hudënisht, kanë qënë fshatra të mëdhenj e me shtëpitë pranë e pranë, që si fshatra të tjerë të kësaj zone, janë pakësuar nga epidemia e kolerës.



Fig. 33 Rrugicat karakteristike të fshatit Lin

Demografia

Njësia administrative **Hudënisht** ka **7894 banorë** (*Burimi: Njësia Administrative Hudënisht, 2015*) dhe përbëhet nga 6 fshatra: **Mëmëlisht, Çervenakë, Hudënisht, Piskupat, Buqezë, Lin**. Fshati më i madh është Hudënishti me 2712 banorë.

Popullsia është ndarë në **6 fshatrat** e njësisë si më poshtë:

Mëmëlisht 2583 banorë / 837 familje

Piskupat 677 banorë / 198 familje

Çervenakë 372 banorë / 110 familje

Buqezë 292 banorë / 93 familje

Hudënisht 2712 banorë / 868 familje

Lin 1258 banorë / 397 familje

Lëvizjet demografike

Ka patur një tendencë për t'u larguar drejt Tiranës për mundësi më të mëdha punësimi. *Lëvizje drejt qytetit të Pogradecit nuk ka patur, për shkak të distancës të vogël (Lin –Pogradec është 17 km).*

Ekonomia

Në njësinë Administrative Hudënisht janë rreth **30 biznese të mëdha** (*nga 60 që kanë qënë, para prishjes të ndërtimeve buzë liqenit*). Ndër ta veçohen 5 Hotele dhe 6-7 operatorë minierash të liçencuar, ndërsa pjesa tjetër janë biznese familjare (*kryesisht shitore*). Prishja e lokaleve, restoranteve e hoteleve buzë liqenit ka ndikuar ndjeshëm në rënien e punësimit për njësinë administrative *Hudënisht* (*rreth 200 të punësuar e të siguruar, dhe shumë më tepër të tjerë të pa siguruar*) kanë mbetur pa punë.

Veçori për këtë zonë është numri shumë i madh i familjeve në ndihmë ekonomike (*Mëmëlisht – 272 familje, Çervenakë – 33 familje, Hudënisht – 290 familje, Piskupat – 78 familje, Buqezë – 43 familje, Lin – 113 familje*)



Fig. 35 Toka të punuara në krahun lindor të gadishullit të Lin-it

Bujqësia, Blegtoaria

Aktivitetet kryesore ekonomike në Njësinë Administrative Hudënisht janë **Peshkimi** dhe **Bujqësia**. Nga 150 varka të liçencuara për të kryer peshkimin e koranit (*për të gjithë Bashkinë Pogradec*), 100-120 varka i ka Komuna Hudënisht. Ka patur një qendër konservimi, e cila nuk funksionon më. Në Lin ka një rezervat për rritjen e rasatit të koranit, që bën ripopullimin e liqenit me koran.

Tokat bujqësore në Lin, Buqezë, Piskupat e Udënisht (*rreth 5-6 dynym*) nuk kanë kushte të mirëfillta vaditje



Fig. 34 Vreshta në Lin

Infrastruktura

Uji i pijshëm

Në çdo fshat ka ujësjellës, dhe të gjithë janë me vetërrjedhje (*përveç fshatit Lin, ku uji shkon me pompë*). Ujësjellësi i Hudënishtit është me tuba plastike, pjesa tjetër janë jashtë standarteve (*kanë tuba hekuri minierash*). Analizat bëhen shpesh, dhe uji konsiderohet i pijshëm, por nuk është 24 h. Në Hudënisht, depoja është e vogël dhe duhet të zgjerohet.



Fig. 36 Bagëtitë në rrugën kryesore të fshatit Lin

Ujërat e zeza

Projekti për ujërat e zeza është ende i pazbatuar (është mbuluar me kanalizime vetëm zona e qytetit të Pogradecit dhe Buçimas-i). Ujërat e zeza, sidomos në fshatin Lin, derdhen drekt në liqenin e Ohrit, duke krijuar një problem emergjent mjedisor.

Vendgrumbullimi i mbetjeve

Për mbetjet urbane, është caktuar një firmë pastrimi e licencuar, që bën pastrimin 2 herë në javë, mbledh dhe depoziton mbetjet urbane në landfillin e Buçimasit (në afërsi të fshatit Peshkëpi) momentalisht, deri në ndërtimin e landfillit të Maliqit. Ka edhe venddepozitime informale.

Transporti

Lidhja midis fshatrave bëhet kryesisht me makina e furgona privatë. Ka edhe një linjë me orare të papërcaktuara (*nisen kur mbushen me pasagjerë*) që bën lidhjen e fshatrave me njëri tjetrin e me qytetin e Pogradecit: 5-6 furgona me kapacitet mbi 8+1. Pritet të fillojë linja Lin-Pogradec (Pojska Trans). Rrugët midis fshatrave janë problematike, pasi janë të asfaltuara, por u mungon sistemi i kanalizimeve.

Shërbime

Arsimi

Në njësinë administrative Hudënisht mungojnë çerdhet. Kopshtet janë 6 (një në çdo fshat), dhe ka 5 shkolla fillore, të cilat janë të tëra të rikonstruara (përveç shkollës në fshatin Lin). Shkollë të mesme ka vetëm në fshatin Hudënisht.

Shëndetësia

Në Hudënisht ka gjithsej 5 **qendra të kujdesit shëndetësor** (*nga një për çdo fshat*), dhe 3 doktorë në total (në Mëmëlisht, Hudënisht e Lin).

Vlerat historike, natyrore e kulturore

- 70% e vijës bregliqenore
- **Fshati turistik dhe bazilika e Lin-it** – Monument kulture i Kategorisë së parë



Fig. 37 Miniera e hekur – nikelit - Guri i Kuq

1. PROGNOZA E ZHVILLIMIT

Zona ka shumë elemente tërheqëse për turistët shqiptarë e të huaj, kryesisht të natyrës peizazhiste, historike, kulturore e agro-turistike. Por turizmi pengohet në mënyrë të konsiderueshme nga mungesa e infrastrukturës pritëse.

E ardhmja e kësaj njësie, synon drejt zhvillimit të një turizmi të qëndrueshëm, që nënkupton një shfrytëzim më efikas të vijës bregliqenore (*është tentuar dhe zhvillimi i lundrimit, por pa sukses*) dhe aseteve të shumta kulturore. Zgjidhja e disa problemeve imediate, do të jepte një kontribut të rëndësishëm, jo vetëm në përmirësimin e jetës së banorëve të zonës, por edhe në tërheqjen e turistëve të huaj e vendas.



Fig. 38 Mozaiku i Bazilikës së Lin -it

PROBLEME PRIORITARE

- Minierat e vjetra: Guri i kuq (3 km nga Pogradec) dhe miniera e kromit në Pojskë, janë në zona malore, dhe pritat e ndërtuara para 25 vjetësh janë të bllokuara nga inertet dhe nuk funksionojnë më. Një studim mjedisor i bërë rreth viteve 2008-2009 nxjerr një ndotje alarmante për shkak të mbetjeve nga minierat, që ndodhen pranë burimeve ujore.

- Riparimi i ujësjellësve, dhe sistemimi i kanalizimeve të ujërave të zeza (*sidomos në Lin, që është fshat turistik*)

- Sistemimi i këndeve sportive të shkollave



Fig. 39 Rruga kryesore e fshatit Hudënisht



Fig. 40 Parku i Drilonit

1.2.7 Profili i njësisë administrative Buçimas

Gjeneza – historiku i fshatrave

Fshati Tushemisht, në vendin ku është sot, mendohet të jetë populluar jo më shumë se 200 vjet më parë, nga të ardhur prej fshatrave përreth ose nga zona më të largëta. Vendbanimi i vjetër, mendohet të ketë qënë në një vend më të ngritur (*prapa kodrës së Kishës të Shën Pandelimonit*). Vetë pozicionimi i kësaj zone (*rrethuar me pyje, toka pjellore e burime të shumta malore*), dhe zbulimi i mozaikëve bardhezi pranë themeleve të Kishës së sotme të Shën Pandelimonit, të cilët duhet t'i përkasin një kishe bizantine, e mbështesin më tej këtë hipotezë.

Starova ka qënë qendra administrative për tërë trevën e Pogradecit në kohën e Perandorisë Osmane, pra edhe fshati më i madh. Vetë emri “Starovë” nga sllavishtja ka kuptimin “i vjetër” (*fshat i vjetër*).

Në fshatin Vërdovë janë zbuluar tuma (kodërvarre), të cilat dëshmojnë për ekzistencën e një vendbanimi të lashtë (*të mijëvjeçarit të dytë pK*).

Edhe fshati i vjetër Rëmenjë mendohet të ketë qënë në vend tjetër nga fshati i sotëm, por u prish nga fundi i shek XVII, si shumë fshatra të tjerë të kësaj zone për shkak të rënies së epidemisë së kolerës. Fshati i ri duhet të jetë populluar me të ardhur nga fshatrat e tjera.

Ndër fshatrat më të vjetër mendohet të ketë qënë edhe fshati Peshkëpi (*i cili ndodhet mbi Manastirin e Shën Naumit, në zonën e fshatrave të Malit të Thatë*), i cili ka qënë qendër episkopale e kohës. Vetë fjala Peshkëpi ka kuptimin Peshkopatë. Fshati mendohet të ketë qënë shumë i madh (popullsia arrinte në disa mijëra banorë), dhe sipas gojëdhënave fshati i vjetër është djegur nga pushtuesit osmanë, dhe një pjesë e banorëve janë larguar.



Fig. 42 Starovë 1918



Fig. 42 Foto e fshatit Tushemisht (fillim

Demografia

Njësia administrative **Buçimas** ka **21180 banorë** (*Burimi: Njësia Administrative Buçimas, 2015*) dhe përbëhet nga 8 fshatra: Buçimas, Vërdovë, **Rëmenjë**, **Gështenjas**, **Bahçallëk**, **Gurras**, **Tushemisht** dhe **Peshkëpi**. Fshati më i madh është Buçimasi me 7500 banorë.

Popullsia është ndarë në **8 fshatrat** e njësisë si më poshtë:

Buçimas – 7500 banorë / 1500 familje
Vërdovë – 3500 banorë / 850 familje
Rëmenjë – 3000 banorë / 800 familje
Gështenjas – 4000 banorë / 1000 familje
Bahçallëk – 500 banorë / 130 familje
Guras – 2000 banorë / 550 familje
Tushemisht – 480 banorë / 140 familje
Peshkëpi – 200 banorë / 59 familje

Lëvizjet demografike

Tendenca në Buçimas ka qënë ardhëse, më shumë se sa për t'u larguar. Nga viti 1991 -2015 është dyfishuar popullsia, për shkak të ardhjeve të shumta nga zona e malësisë së Mokrës.

Ekonomia

Në njësinë Administrative Buçimas, aktivitetet kryesore ekonomike janë **Bujqësia dhe Blegtoria (70%), të ndryshme (20%) dhe artizanati (10%)**. Baza e ekonomisë ka qënë ndërtimi, por me bllokimin e lejeve janë krijuar vështirësi të shumta. Në njësinë Buçimas (kryesisht në pjesën bregliqenore) ka Hotele dhe restorante, të cilat krijojnë mundësi punësimi për banorët e zonës, dhe të qytetit.

Bujqësia, Blegtoria

Kulturat kryesore që kultivohen në njësinë Buçimas janë drithërat, pemëtaria dhe bimët mjekësore. Kohë më parë është mbjellë edhe sherebelë, por më pas u shkëlq, për shkak të rënies së çmimit në treg. Problem për bujqësinë është edhe mungesa e krahut të punës për shkak të emigracionit të të rinjve. Edhe infrastruktura bujqësore është e amortizuar dhe frigoriferët e mollëve nuk kanë kapacitet (*po ashtu mungon çertifikimi ndërkombëtar për mollët, dhe ato nuk mund të shiten në tregjet jashtë kufijve*).

Infrastruktura

Uji i pijshëm

Ujë të pijshëm ka 24 h në fshatrat e komunës Buçimas (*përveç fshatit Peshkëpi, që funksionon me burime*).

Ujërat e zeza

Rreth 40 % e territorit është e mbuluar me kanalizim për ujrat e zeza (*Tushemishti, Starova dhe njëpjesë e Vërdovës*). Pjesa tjetër kanë gropa septike, por ka edhe njerez që derdhin në lumenj (*Lumi i Vërdovës*), që më pas shkojnë në liqenin e Ohrit.



Fig. 43 Landfilli në afërsi të fshatit Peshkëpi



Fig. 44 Qendra e fshatit Peshkëpi



Fig. 45 Kanalet në fshatin Tushemisht

Vendgrumbullimi i mbetjeve

Pastrimi i komunës bëhet 2 herë në javë për çdo fshat (*me grafik*), dhe mbetjet depozitohen në landfill-in pranë fshatit Peshkëpi. Problem mbetet derdhja e ujërave të zeza dhe hedhja e mbeturinave në lumenj, pasi këta lumenj dalin në Shën Naum. Mendohet qe situata do te zgjidhet përfundimisht me Landfillin e Maliq-it.

Transporti

Fshatrat janë përgjithësisht afër me njëri tjetrin dhe me qytetin e Pogradecit (*përveç fshatit Peshkëpi, distanca e të cilit nga qyteti i Pogradecit shkon 40 min*), dhe lidhja midis tyre bëhet me një linjë furgonësh Pogradec – Tushemisht dhe me makina private.

Shërbime

Arsimi

Në njësinë administrative Buçimas, si edhe në njësitë e tjera, mungojnë çerdhet. Kopshtet publike janë 7 (një në çdo fshat), dhe kopshtet private janë 2 (në Starovë). Shkolla 9-vjeçare janë 8 shkolla (dhe 2 janë private, përsëri në Starovë). Shkolla të mesme ka vetëm 1, që është publike, dhe 2 jopublike. Shkollat jopublike frekuentohen kryesisht nga nxënës që jetojnë në qytetin e Pogradecit. Në Buçimas ka edhe një Universitet jo-publik.

Shëndetësia

Në njësinë administrative Buçimas ka 8 qendra të kujdesit shëndetësor (*nga 1 për çdo fshat*).

Vlerat historike, natyrore e kulturore

Zona ka shumë elemente tërheqëse për turistët shqiptarë e të huaj, kryesisht të natyrës peizazhistike, historike, kulturore e agro-turistike. Ndër elementët kryesorë tërheqës për turistë mund të përmenden:

- **Parku i Drilon-it**
- **Fshati turistik i Tushemishtit**
- **Mozaiku i Tushemishtit**
- **Pjesa bregliqenore**
- **Gatimet tradicionale**



Fig. 46 Sheshi Ollga, Tushemisht

PROGNOZA E ZHVILLIMIT

Ndër problemet më imediate, zgjidhja e të cilëve do të sillte përmirësime të ndjeshme në jetën e banorëve të zonës, e në rritjen e potencialeve turistike, do të veçohen:

- Sistemimi i infrastrukturës bujqësore dhe pastrimi i kanaleve kulluese, bllokimi i të cilëve shkakton përmytje edhe të ndërtesave në periudhën e shirave.
- Shndërrimi i pjesës bregliqenore në një shëtitore/pedonale, me funksion kryesor turizmin
- Vendosja e kazanëve, në mënyrë që hedhja e mbeturinave të bëhet në mënyrë të organizuar (*sistemimi dhe pastrimi edhe i lumit të Vërdovës*)
- Krijimi i mundësive të reja për ngrohje (përvec asaj me ngrohje me dru zjarri), që të mos dëmtohen pyjet përreth
- Krijimi i mundësisë për agropërpunim

1.3 Zhvillimi i territorit të bashkisë Pogradec në vite

Zbulimet e bëra nga gërmimet arkeologjike tregojnë se treva e Pogradecit ka qenë e banuar që në kohët e lashta. Kjo trevë përmendet historikisht për pozitën e favorshme gjeografike, për pasuritë dhe bukuritë e saj. Mendohet se popullsia e ka zanafillën në periudhën e neolitit të hershëm (6000 p.k) e cila dëshmohet me vendbanimet palafite (shtëpi druri të ndërtuara me hunj mbi liqen).

Gjatë periudhave të bakrit dhe bronzit numri i vendbanimeve u rrit së tepërmi. Dëshmitë arkeologjike tregojnë për varre të shumta pranë kishave, të cilat datojnë nga periudha e hekurit, ku edhe emra shqiptarë janë gjetur si: Dasion, Kliti, Genthi etj. Liqeni i Ohrit në atë kohë quhej Lyhnidas (liqeni i dritës) dhe përgjatë tij banonte fis ilir i enkelejdëve.

Sipas historianëve, në këtë trevë u themelua dhe u ngrit një qytet i rëndësishëm jo vetëm për nga ana ekonomike por edhe ajo kulturore. Ky vendbanim mori emrin Enkelena, pikërisht nga fisi i sipërpërmendur. Enkelejtë përmenden për një fis me organizim të rreptë e rigoroz shtetëror dhe ushtarak, si dhe një qytetërim me një kulturë të zhvilluar.

Siç dihet gjerësisht, Iliria pas tri luftërave romake, ra nën sundimin e kësaj të fundit. Megjithatë Enkelena e ruajti zhvillimin e saj falë rrugës ndërkombëtare Egnatia që lidhte Dyrrahun me Kostandinopojën, ku degëzimet përshkronin qytetin dhe Mokrën (sot një fshat në bashkinë e Pogradecit). Më 359, perandoria Romake u nda në dy pjesë, në atë Romake dhe Bizantine. Në këtë të fundit u përfshi dhe Enkelena. Në shekullin e VI filloi pushtimi i rëndë sllav i cili la ndikim edhe në deformimin e emrave. Këtu ndërrohet edhe emir Enkelena në Pogradec (nën kala).

Në fillim të Mesjetës, vendi u quajt Arbëri, mirëpo nuk zgjati shumë dhe u nda në principata. Një ndarje e tillë vijoi deri në pushtimin turk. Porta e Lartë bëri ndarjen e vendit në katër vilajete, ku Pogradeci bënte pjesë në atë të Manastirit, në sanxhakun e Ohrit. Ndarja vazhdoi deri më 1920.

Përgjatë viteve të komunizmit Pogradeci ka qënë një qendër e rëndësishme e turizmit por edhe e industrisë. Ndërtimi i hekurudhës në këtë periudhë përkon me ndërtimin e Minierës së pasurimit të hekur- nikelit në Memelisht të Pogradecit shumë pranë bregut të liqenit.

Në sistemin e shtetit socialist qysh nga viti 1946 Pogradeci ka qënë qendër e Rrethit të Pogradecit dhe në përbërje të qarkut të Korçës. Rrethi i Pogradecit kishte krijuar tashmë, një traditë historike në organizimin administrativ duke pasur në përbërje të tij Fushëgropën e Pogradecit dhe rrethinat e banuara me kufij vendore që i janë përshtatur pozicionimit gjeotopografik dhe relievit duke qënë si nënnyjësi kryesore. Ndërkaq krahina e Mokrës edhe pse me tipare të dallueshme e të ndryshme me ato të fushëgropës së Pogradecit ka qënë, gjithashtu, pjesë tradicionale dhe historike e organizimit të pushtetit vendor.

Organizimi i ri administrativ, ka bërë një ndryshim të ndjeshëm në krahasim nga ai i mëparshëm. Kështu, krijimi i Bashkisë së Pogradecit ka në përbërje të tij një territor më të madh, të diversifikuar dhe me më shumë sfida dhe probleme në të.

2. Dokumentet e planifikimit

2.1 Konventat Ndërkombëtare, Marrëveshjet bilaterale dhe projekte të tjera

Nisur nga konteksti ndërkufitar që ka rajoni ku shtrihet kjo bashki, Qeveria Shqiptare dhe bashkia Pogradec kanë përsipër të respektojnë detyrimet përkatëse në veçanti ndaj Konventës për mbrojtjen e trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore, Konventës së OKB-së për diversitetin biologjik, Konventës për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate ujore (Konventa e Ramsar-it), Konventës për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar (Konventa e Espoo-s), Konventës për akses në informacion, për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe akses në drejtësi për çështjet mjedisore (Konventa e Aarhus-it), Konventës për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe habitatet e tyre (Konventa e Bernës) dhe Konventës për ruajtjen e specieve migratore (Konventa e Bonn-it) ku qeveri është bere pale me nenshkrimin e tyre.


Respektimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të liqenit të Ohrit dhe të pellgut të tij ujëmbledhës”, nënshkruar në Shkup më 17.6.2004, dhe ratifikuar nga Parlamentet e të dy vendeve në Mars të vitit 2005, (Ligji Nr. 4502 datë 10.03.2005). Kjo marrëveshje merr parasysh rëndësinë lokale, rajonale dhe globale të liqenit të Ohrit si një zonë me vlera të jashtëzakonshme mjedisore, ekonomike, shkencore, estetike dhe kulturore, dhe vetëm një marrëveshje ndërkombëtare është thelbësore për ruajtjen e këtyre vlerave për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm pasi ajo garanton një mënyrë menaxhimi që u lejon Palëve të mbrojnë dhe ruajnë liqenin e Ohrit dhe pellgun e tij ujëmbledhës, duke mundësuar në të njëjtën kohë zhvillimin e qëndrueshëm të pellgut ujëmbledhës të liqenit të Ohrit.

Ekziston një projekt i quajtur Projekti “Lake Ohrid Conservation Project” i financuar nga GEF i cili është zbatuar në periudhën 1996-2004 dhe ka pasur si qëllim që përmes një analize komplekse të gjendjes së liqenit të Ohrit, krijimit të strukturave të përbashkëta me palën maqedone si dhe konceptimit të tij si një ekosistem që duhet të menaxhohet pa kufij, të shërbente si katalizator për të inicuar projekte të tjera me qëllimin final mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore të liqenit të Ohrit dhe pellgut ujëmbledhës të tij. Sot janë duke u zbatuar 5 projekte: Projekti për mbështetjen e Parkut të Prespës dhe shpalljen e Rezervës së Biosferës Ohër-Presepë, financim i KFË-së, Projekti për menaxhimin e ujit të pijshëm dhe trajtimin e ujrave të zeza po financim i KFË-së, Projekti për përdorimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore të tre liqeneve ndërkufitare Ohër-Presepë dhe Shkodër, Projekti për menaxhimin të integruar të basenit të Drinit financim i GEF-it, si dhe Projekti për qeverisjen e përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të liqenit të Ohrit dhe pellgut të tij ujëmbledhës financim i BE dhe i zbatuar nga UNESCO. Këto projekte kanë krijuar dhe konsoliduar vizionin e zhvillimit të rajonit duke marrë në konsideratë kontekstin ndërkufitar të tij dhe detyrimet ndaj konventave ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

2.1.1 Plani i menaxhimit të peisazhit të mbrojtur të Pogradecit, 2013

Ky është një draft final i planit të menaxhimit të peisazhit të mbrojtur të Pogradecit i hartuar në vitin 2013 dhe i financuar prej Bashkimit Europian në kuadër të programit IPA 2010 për Shqipërinë. Plani bën një analizim dhe vlerësim aktual të zonës së mbrojtur, bën propozime se si kjo zonë mund të menaxhohet dhe bën një parashikim të planit financiar mbështetur në propozimet e planit të menaxhimit. Lidhur me objektivat e planit të menaxhimit mund të thuhet se synohet përforcimi i ruajtjes së peisazhit të mbrojtur, ruajtja dhe konservimi i habitatit, zhvillimi i përdorimeve rekreative dhe turistike, zhvillimi i qëndrueshëm i agrikulturës dhe aktiviteteteve social ekonomike si dhe promovimi i kërkimit shkencor dhe edukimit.

Figura 11. Harta e zonimit të propozuar të peisazhit të mbrojtur të Pogradecit



Peisazhi i mbrojtur i Pogradecit bazuar në zonimin e propozuar të këtij plani ndahet në katër zona:

“Zona bërthamë” - e cila është një zonë e kushtuar e rritjes së peshkut, këto zona janë caktuar në bregun e liqenit, Lin dhe Tushemisht. Këtu nuk lejohet gjuetia e peshkut si dhe veprime të tjera në dëm të habitatit. Në këtë zonë duhet të ruhet bimësia në mënyrë që të ndodhë i gjithë procesi natyror.

“ **Zona e përdorimit të qëndrueshëm**” - një zonë e cila përbëhet nga pyje të cilat janë kryesisht në degradim si dhe liqeni i Ohrit (ngjyra jeshile në hartën sipër). Në këto zona lejohet peshkimi nga peshkatarë të liçencuar, përdorimi i drurëve për dru zjarri nga operatorë të liçencuar, zona plazhi, prodhimi i lajthive dhe gështenjave etj.

“**Zona e përdorimit tradicional**”- kjo zonë përkon me zonat urbane, tokat bujqësore dhe vreshta të zonës së peisazhit. Në këtë zonë duhet të shmanget keqmenaxhimi i tokës dhe ujit si dhe shmangia e përdorimit të pesticideve. Bazuar në këtë plan këto zona janë të kufizuara përsa i përket urbanizimit dhe ndërtimit të infrastrukturave kryesore. Kjo zonë përfshin dhe pjesë të zonave ekonomike.

“**Zonat rekreative**” – lidhen me hapësirën e aktiviteteve turistike përgjatë vijës liqenore. Lidhur me këtë zonë Plani i menaxhimit propozon një plan zhvillimi për bregun e liqenit për të minimizuar derdhjet e ujrave të zeza në liqen.

2.2. Strategjitë dhe Programet në nivel ndërkombëtar

Strategjia 2020 e Evropës Jug-Lindore – Punësimi dhe prosperiteti në një këndvështrim Evropian (BE/ Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal)

Ky dokument është hartuar në vitin 2011, si përgjigje ndaj kërkesës së qeverive të vendeve të Ballkanit Perëndimor, nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal në bashkëpunim me qeveritë e vendeve të këtij rajoni, për përgatitjen e një dokumenti në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me konkurrencën rajonale dhe strategjitë e rritjes. Ky dokument fokusohet në pesë shtylla të modelit të ri zhvillimor: **Rritje e Integruar** – me fokus Tregjet Rajonale, ekonominë e orientuar drejt eksportit dhe investimeve të huaja, etj.

Rritje e Zgjuar – me fokus rritjen e konkurrueshmërisë Rajonale, udhëheqjen nga njohuria dhe novacioni dhe bazuar në kapitalin njerëzor, teknologjitë moderne të komunikimit dhe industritë kreative. **Rritje e Qëndrueshme** – me fokus në infrastrukturën dhe energjinë e qëndrueshme, në përdorimin me efikasitet dhe ndjeshmëri të burimeve, sidomos atyre natyrore. **Rritje Gjithëpërfshirëse** – me fokus avancimin përtej një shoqërie përjashtuese drejt një situate ku të gjithë përfitojnë nga zhvillimi në mënyrë të drejtë. **Qeverisje në funksion të rritjes** - me fokus qeverisjen transparente, funksionale dhe efikase

Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Shqipëri – Greqi 2014 – 2020

Programi Interreg II IPA i Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri – Greqi 2014 – 2020 është rezultat i një procesi të programimit të udhëhequr nga "Komiteti i Përbashkët i Programimit", i themeluar për përgatitjen e programit Interreg II IPA për bashkëpunimin ndërkufitar. Strategjia e këtij programi është: "Për gjetjen e ekuilibrit mes zhvillimit të qëndrueshëm rajonal dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkufitar midis popullsisë dhe rajoneve, institucioneve vendore, në përputhje me BE-në dhe politikat kombëtare, me qëllim adresimin e sfidave të përbashkëta nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta"

Prioritetet e programit në bazë të Aneksit III të rregullores IPA II (BE) Nr 231/2014, përfshijnë: Promovimi i transportit të qëndrueshëm, informacionit dhe komunikimit (IC) rrjete dhe shërbime dhe investime në ujë, mbeturinave dhe energjisë sistemeve dhe pajisjeve ndërkufitare. Mbrojtja e mjedisit dhe promovimin e ndryshimeve klimatike përshtatjen & zbutjen, parandalimin e rrezikut dhe menaxhimit. Vlerësimin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Rritja e

konkurrencës në mjedisin e biznesit dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, tregtisë dhe investimeve.

Zonat përfituese ndërkufitare shtrihen nga Deti Jon në liqenet e Prespës, dhe përfshinë: Rajonet e Grevenës, Kosturit, Follorinës, Arta, Thesprotia, Janinë, Prevezë, Zakynthos, Kerkyra, Kefallinia dhe Lefkada në Greqi dhe rajonet e Vlorës, Qarku i Gjirokastrës, Qarku i Korçës përfshirë këtu edhe Bashkinë Pogradec dhe Qarku i Beratit në Shqipëri.

Programe të tjera ndërkufitare janë: Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Shqipëri – Maqedoni 2014 – 2020, Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Shqipëri – ADRIION 2014 – 2020, Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Shqipëri – Mediteranien 2014 – 2020

Bazuar në draft Planin e Përgjithshëm Kombëtar i hartuar nga AKPT dhe MZHU disa nga direktivat kryesore të cilat rrjedhin për PPV-në e Bashkisë Pogradec janë:

RAJONALIZIMI - Një nga kërkesat që plotëson Plani i Përgjithshëm Kombëtar është krijimi i bazave për zhvillim rajonal.

Tre janë tipet e Rajoneve të përcaktuara nga PPK:


- RAJONE NDËRKUFITARE
- RAJONE EKONOMIKE KOMBËTARE
- RAJONE TË SPECIALIZUARA

RAJONET NDËRKUFITARE burojnë drejtpërdrejt nga Programet IPA Crossborder (Vetëm për periudhën 2014-2020) Shqipëria do të sigurojë një mbështetje financiare prej 75 milion eurosh.)

Shqipëri – Greqi (Fondi IPA 42.312.029€) përfshin: *Rajonin Korçë – Selanik, Rajonin Gjirokastrë – Janinë, Rajonin Sarandë – Korfuz*

RAJONI KORÇË - SELANIK, ka bashkëpunim ekonomik, potencial për zhvillimin dhe nxitjen e bashkëpunimit në sektorin e turizmit, bujqësisë dhe të energjitikës.

Figura 12. Rajonet ndërkufitare (Burimi: PPK, 2015)



RAJONET EKONOMIKE KOMBËTARE: aktualisht si një rajon i tillë i mirëfilltë performon vetëm rajoni ekonomik Tiranë Durrës, por Plani Kombëtar deri në 2030 mundëson fuqizimin edhe të 6 rajoneve të tjera me rëndësi kombëtare. Plani kombëtar e sheh Pogradecin si pjesë e një rajoni ekonomik të rëndësishëm atë të Pogradec - Korçë me avantazhe të larta për lidhje me rajonin Durrës-Tiranë duke formuar një zinxhir të rajoneve ekonomike.


Profili këtij rajoni: Tregëti (shkëmbim & përpunim) – Energji – Turizëm – Bujqësi

Zhvillimet Strategjike:

3. Korça, qendër primare, turistike, bujqësore por edhe energjitike.

4. Pogradeci qendër e specializuar, turizëm liqenor, natyror -bujqësi.

Figura 13. Sistemi infrastrukturor (Burimi: PPK, 2015)



SISTEMI INFRASTRUKTUROR

Objektivi: Integrimi hapësinor, rritja e aksesueshmërise së vendit dhe shpërndarje e balancuar e flukseve.

Politikat: Organizimi i territorit në sistemin e hierarkizimit të qendrave urbane dhe zhvillimi i korridoreve të integruara të flukseve të infrastrukturës.

TRANSPORTI

Objektivi: Multimodal dhe miqësor ndaj ambjentit konkurrues

Politika: Krijimi dhe konsolidimi i një sistemi të integruar multimodal mbarë Kombëtar, rritje dhe konsolidim i pikave të aksesit dhe të lidhjes së territorit.

Në sistemin e infrastrukturës së transportit për bashkinë e Pogradecit, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

1. Dhjetë Stacione Intermodale Ndërkombëtare në Tiranë, Durrës, Lezhë, Shkodër, Kukës, Pogradec, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, të cilat do të përmbushin nevojat ndërkombëtare dhe tranzitore të lëvizjes dhe shkëmbimit të modaliteve të transportit me vendet e tjera .

2. Integrimi i mëtejshëm dhe lidhjen e rrjetit tonë hekurudhor (Stacioni i fundit Pogradec) me rrjetin hekurudhor të Maqedonisë

3. Fuqizimin e linjës hekurudhore si pjese e multimodalitetit te korridorit viii

4. Rivlerësimin e aksit ekzistues Lin - Pogradec sipas konceptit të Rrugeve Green¹ duke e rehabilituar dhe përshtatur në ato segmente të cilat kalojnë pranë ose përmes zonave të mbrojtura .

Për transportin ajror PPK sugjeron ish fushat aeroportuale në Shkodër dhe **Korçë** propozohen të ruhen të lira nga ndërtimet për të vlerësuar mundësinë në një të ardhme për zhvillimin e transportit ajror.

ENERGJIA

Objektivi: Zhvillimi i një rrjeti eficient energjistik

Politika: Diversifikimi drejt energjise së rinovueshme

Në sistemin e infrastrukturës energjitike, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

4 Korridore energjetike: TAP – IAP – **WBR** – Kosovë do të mundësojnë integrimin e sistemit energjistik të Shqipërisë në infrastrukturën energjitike të Ballkanit Perëndimor dhe Europës. Shqipëria përbën një korridor të rëndësishëm që lidh Greqinë me vendet e Bashkimit European dhe Kroacinë. Ky korridor siguron një mundësi për lidhje energjetike nëndetare mes Shqipërisë dhe Italisë, një nga ekonomitë më të mëdha të Bashkimit European;

2.4. Analiza e planeve dhe instrumenteve në nivel vendor

Ne rastin e territorit administrativ të Bashkisë Pogradec, nuk kemi të bejmë me një analizë të thelluar të sistemeve të planifikimit, planeve rregullative, sektoriale etj, pasi zhvillimi i qytetit dhe i njësive administrative perreth tij, është prirur kryesisht nga një zhvillim i kufizuar, pjesërisht i udhëhequr nga studime urbanistike pjesore dhe pjesërisht i karakterizuar nga zhvillime të karakterit informal, karakteristike kjo e zhvillimeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në dy dekadat e fundit.

Figura 14 Foto të Pogradecit të vitit 1979



Plani rregullues i qytetit të Pogradecit i vitit 1979

Në vitet 1979 është miratuar nga Komiteti Ekzekutiv i rrethit të Pogradecit një projekt ide e planit rregullues të qytetit të Pogradecit. Projekt ideja sugjeron që t'i qëndrohet strikt qasjes së zonimit të propozuar në këtë dokument. Plani i vitit 1979 është me shumë rëndësi, pasi sistemi rrugor dhe forma urbane e strukturave është trashëguar në ditët e sotme nga plani i këtij viti. Janë shtuar edhe rrugë të reja, dhe ka patur ndryshime pas viteve 90.

Studimi urbanistik Pjesor i Bregut të Liqenit 2002

Ky plan, për brezin e liqenit përcakton disa elemente kyçe, të tilla si përcaktimi si zonë në ruajtje e zonës të banimit me ndërtime 2-3 kate, dhe ruajtja e karakteristikave arkitektonike të saj, përcaktimin e një këndi lojrash për fëmijë, rikonstruksionin e objekteve të degraduara dhe rikthimi i tyre me funksion turistik (Oktapodi, godina e Turizmit të vjeter, etj).

Projekti i mbrojtjes së liqenit të Ohrit, kanalizimi i ujrave te zeza dhe furnizimi me ujë të pijshëm të qytetit Pogradec

Detyra e projektimit për studimin urbanistik të qendrës së qytetit dhe vija kufizuese e saj 2003

Qëllimi i kësaj detyre projektimi është realizimi i një studimi urbanistik pjesor që ruan e zhvillon zonën e qendrës së qytetit si qendër biznesi, sociale kulturore e historike të qytetit. Ky studim urban ka si objektiv krijimin e një qendre atraktive për qytetarët e turistë e huaj dhe vendas, sigurimin e trashëgimisë kulturore e vlerave historike, ruajtjen e traditës të ndërtimit, dhe në tërësi rigjallërimin e qendrës dhe krijimin e kushteve që të bëhet atraktive e në të të kalojnë kohën të lirë të gjitha grupmoshat.

Plani i përgjithshëm rregullues i Pogradecit 2009

Qëllimi kryesor i këtij plani është të shërbejë si direktive për të ndihmuar banorët e qytetit të realizojnë qëllimet e tyre për qytetin e së ardhmes. Elemente të planit, si përdorimi i tokës, transporti, shërbimet publike, infrastruktura inxhinierike, trajtimi hapësinor i qytetit dhe zbatimi janë konceptuar si mjete për të arritur këtë objekt. Ndër objektivat kryesore të këtij plani janë: ruajtja dhe rritja e cilesisë të njësive ekzistuese të banimit, krijimi i mundësive për të ndërtuar banesa të reja brenda disa prej njësive ekzistuese të banimit, realizimi i brezave tranzitore midis territoreve të punës dhe zonave të banimit ose atyre turistike, ruajtjen, ristrukturimin, përmirësimin dhe krijimin e parqeve dhe shërbimeve rekreative për t'i shërbyer atyre që banojnë, punojnë apo pushojnë në qytet, krijimi dhe theksimi i imazhit vizual, pamjes dhe identitetit urban e arkitektonik të qytetit, ruajtja e hapësirave të lira brenda qytetit nga rritja e vazhdueshme e presionit për ndërtim. etj.

Shpallja e qendrës historike të qytetit të Pogradecit dhe miratimi i rregullores për administrimin e saj (Vendim Nr.544 datë 18.06.2015)¹

Përcaktimi i kufirit të zonës së mbrojtur të objektit “Kalaja e Pogradecit”, monument Kulture i kategorisë së parë

Territori administrativ i Bashkisë Pogradec, është zhvilluar nëpërmjet një skanimi sipërfaqësor të kërkesave për zhvillim, duke i trajtuar këto kërkesa në terma pjesore dhe të pandërlidhura nga një strategji e çfarëdollojshme territoriale. Kjo situatë ka ndikuar në një zhvillim kaotik të territorit urban në zonat e urbanizuara. Ndërsa në territoret suburbane dhe rurale, situata është ndryshe. Në këto zona, zhvillimet janë kryesisht informale, të cilat kanë ndikuar në shtimin e zonave të urbanizuara dhe demtimin e tokave bujqësore, duke tjetërsuar përdorimin e tyre dhe dëmtuar perspektivën e investimeve të gjera në zonat e prekura nga zhvillimi informal. Si rrjedhojë e këtyre ndërtimeve, territore të reja të urbanizuara janë krijuar në fshatrat e njësive administrative Buçimas e Udënisht (*kryesisht në Tushemisht, Buçimas, Udënisht e Mëmëlisht*), ndërsa zgjerimi i territorit të urbanizuar dhe densifikimi i atij ekzistues ka ndodhur në Lin.


¹ Detyrimet që rrjedhin nga ky vendim janë marrë në konsideratë për përcaktimin e njësive strukturore

2.4.1 Plani Rregullues i bashkisë Pogradec

Në vitin 2003 është hartuar Detyra e Projektimit të Planit Rregullues të qytetit të Pogradecit i cili përfshinte kufijtë territorialë të qytetit brenda vijës së verdhë. Nga ky plan vlen të veçojmë propozimet në skemën e zonimit funksional, skemë e cila mund të orjentojë edhe zhvillimin e territorit sot pavarësisht ndryshimeve të ndodhura në të përgjatë këtyre viteve. Plani në fjalë propozon shtrirjen e zonave të banimit në lindje dhe juglindje të qytetit ekzistues i ndjekur nga një rrjet rrugor kuadratik. Ndërkohë zona ekonomike sipas këtij plani duhej të shtrihej në ish zonën industriale, në rrugën drejt Korçës, dhe në rrugën e Rëmënjit. Zona e pushimit referuar propozimeve të këtij plani do të shtrihej në zonën e bregut të liqenit, përgjatë gjithë gjatësisë së tij^{vii}.

2.5 Analiza e elementëve përjashtues

Në hartën e analizës së elementëve përjashtues janë evidentuar si layer-a zonat e urbanizuara, rrugët lidhëse nëpërmjet tyre si dhe ndërtesat. Nga ana tjetër janë evidentuar edhe elementët përjashtues, elemente të cilat ndikojnë në planifikimin e territorit nëpërmjet kufizimeve që ato mbartin. Në këtë mënyrë janë evidentuar elementë të tillë infrastrukturorë të cilët janë të vështirë për t'u kaluar, si



elementë përjashtues janë quajtur edhe zonat e kontaminuara. Kjo për vetë faktin se ndërhyrjet në këto zona do të jenë të vështira, do të krkojnë kohë dhe burime të shumta financiare për t'u kryer. Por jo vetëm kjo por edhe fakti se këto zona kufizojnë zhvillime të tjera urbane apo turistike të mundshme në perspektivë. Si elemente përjashtues janë evidentuar gjithashtu edhe zona të cilat janë të vështira për t'u aksesuar. Në fakt edhe ky element lidhet me infrastrukturën pasi një arsye që këto zona janë të paaksesueshme është mungesa e infrastrukturës rrugore. Këto janë elemente të cilat duhen marrë në konsideratë gjatë propozimeve të mëtejshme në mënyrë që të meren masa për zbutjen e kufizimeve të tyre.

Monumentet Hidrike

- Burimi i Drilonit (5).
Në zonë ndodhen edhe disa ndërtesa të rëndësishme historike kulturore, ku përfshihet:
- Rrënojat e Kishës Paleokristiane në Lin. Gjatë gërmimeve janë gjetur mozaikë nga shekujt IV dhe V. Ky është një Monument Kulturor i Shqipërisë.
- Rrënojat e Kishës Bizantine në Lin. Ky është një Monument Kulturor i Shqipërisë.
- Kalaja e Pogradecit.

Konkluzione dhe rekomandime

- Mbikqyrjen dhe menaxhimin e Zonës Së Mbrojtur Të Peisazhit të Teritorit Tokësor/Ujor të Pogradecit-së në mënyrë profesionale dhe efektive.
- Përfshirjen e të gjithë aktorëve lokalë në një proces të qëndrueshëm e gjithëpërfshirës për të kontribuar në menaxhimin e burimeve të peisazhit të mbrojtur dhe në ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet ruajtjes së natyrës dhe zhvillimin e aktiviteteve njerëzore.
- Marrjen parasysh të bashkëpunimit ndërkufitar në planifikimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zonës së mbrojtur.
- Rivitalizmin e potencialeve natyrore

3. Veçoritë Fizike dhe Mjedisore

3.1 Topografia dhe Relievi

Figura 15. Relievi i Bashkisë Pogradec



Bashkia e Pogradecit shtrihet në vijën bregore në jug të liqenit të Ohrit, i vendosur përgjatë kodrave në formën e një teatri, shkallaret e të cilit zbresin drejt liqenit. Ka një pozicion fushor në lartësinë 694 m mbi nivelin e detit. Në veriperëndim, Pogradeci zotërohet me pamje e vëzhgim të relievit prej një kodre me lartësi rreth 800 m, ku ka qenë edhe një qendër banimi e hershme e Dasaretisë (Enkelana). Në juglindje vijon me fushën e Starovës, pas së cilës vijnë sistemi kodrinor rrethues jugor, për gjithë rrethinën e tij. Sistemi rrugor është paralel me vijën kryesore bregore ku veçohen dy prej tyre: njëra si shëtitore e qendrës, ndërkaj tjetra është përvijim i rrugës që lidh qytetin me Shën Naumin, e përpara tij me qendrën turistike të Drilonit.

Gjeohapësira e bashkisë Pogradec përbëhet nga disa elementë të relievit si: Fushëgropa e Pogradecit, Krahina e Mokrës, Malësia e Gorës, Kurrizi malor: Maja e Beshenikut - Qafë Thanë, Gjeohapësira kodrinoro- malore : Dardhas- Alarup dhe qyteti i Pogradecit.

3.1.1. Fushëgropa e Pogradecit

Fushëgropa e Pogradecit zë në sipërfaqe prej 15.7 km². Syprina liqenore zë një sipërfaqe prej 109 km². Ajo ka formën e një trapezi me bazë të vogël në veri : 2,9 km dhe në Jug 7,4 km (*Këndi veriperëndimor i Pogradecit deri në Tushemisht*). Lartësia e syprinës ujore të liqenit është 694

metër mbi nivelin e detit. Niveli lartësor i fushës fillon nga një “0” relative dhe deri në fillimin kodrinoro-malor shkon në lartësinë ku fillon hipja e relievit për në Qafë Pllaçë. Në këtë kufi kodrinor lartësia është 820 metër.

3.1.2. Hapësira liqenore

Liqeni i Ohrit është liqeni më i thellë tektonik i Ballkanit (liqeni i 7-të më i thellë në Europë), dhe mbulon në total një sipërfaqe prej rreth 358.2km², prej së cilës 109 km² i përkasin Shqipërisë. Liqeni ndodhet në një lartësi 695 m mbi nivelin e detit.

Vija bregliqenore e liqenit të Ohrit është e gjatë 87.5km, prej nga 56 km i përkasin Maqedonisë dhe 31.5 km Shqipërisë, dhe gjerësia e tij maksimale arrin 30 km, ndërsa gjerësia varion nga 11.2 dheri në 14.5 km. Thellësia më e madhe e tij është 289 metra^{viii}.

I krijuar rreth 2 milion vjet më parë nga mbushja me ujë e gropës tektonike, Liqeni i Ohrit është i dyti për nga madhësia në Shqipëri pas atij të Shkodrës.

3.1.3. Krahina e Mokrës

Mokra ka tipare të veçanta, të relievit gjeohapsinor, të shtrirjes, historisë dhe kulturës. Është një nga krahinat më të hershme të banuara. Përfshin 47 fshatra të cilat shtrihen në Mokrën e Sipërme dhe Mokrën e Poshtme e mbështjellë e tëra në faqet malore që bjenë nga kreshti malor i cili fillon nga mali Valamares, Qafa e Panjës e deri tek Guri i Kamjes. Mokra përfshin në vete tre njësi administrative vendore: **Proptisht, Trebinjë dhe Velçan**. Ka një sipërfaqe prej 376 km².

Lumi i Dunshës takohet me Shkumbinin në veri të fshatit Çezma e Vogël, në lartësinë 533.9 metër. Përroi i Homçanit që bashkohet me përroin e Selcës së Sipërme, zbret nga lartësitë 1344 metër. Në lumin e Slabinjës zbret lumi dhe lugina e Dunshës që përfshin ujrat që vijnë nga faja e Trebinjës, Povelan, Potkozhan, Kalivaç dhe përroi që rrjedh nga Guri i Bardhë dhe Dunica prej një relievi që ngrihet gjer në qafën e Panjës e Guri i Kamjes. Përroi dhe lugina e Homçanit (*lartësia 912 metër*) mbledh ujrat që zbresin nga maja e Korijes (*1343 metër*). Në verilindje të Mokrës është lugina e Homezhit (*750 metër*) me ujra që zbresin në harkun kreshtor të majës së Fushës së madhe (*1429 metër*), maja e Shullërit të Kaprit (*1343 metër*), maja e Ahishtes së Gegës (*1513 metër*) me përrenj që zbresin nga lartësitë në jug të Çervenakës. Kufiri perëndimor i Krahinës së Mokrës fundon në gjeohapësirën midis fshatrave Stravaj (*e Librazhdit*) dhe Senisht (*e njësisë administrative të Velçanit*). Vija përmblyllëse në jugperëndim të Mokrës është kreshti malor që zë fill nga maja e Lenijes, Qafa e Mushkës (*1825 metër*). Guri i Kamjes (*1461 metër*) është jo vetëm një monument natyre në kreshtin fundor të krahinës së Mokrës, por pika dhe këndi juglindor ndarës midis tre nënkrahinave: Ujëmbledhësit dhe Fushëgropës së Pogradecit në Lindje, të Malësisë së Gorës (*fshatrave të Bashkisë së Maliqit në Jug si dhe vetë Krahinës së Mokrës*).

3.1.4. Kurrizi malor: Maja e Beshenikut - Guri i Kuq - Qafë-Thanë

Ka një sipërfaqe prej 89 km². Kreshti ndarës në lindje të malësisë së Mokrës, që lidhet me masivin dhe kurrizin malor përfshin lartësinë 1411 metër (*maja e Beshenikut në lindje të fshatit Kalivaç*) vijon me kurrizorin drejt majës së Shullërit (*1226 metër*). Kreshti ndarës vijon me një platformë të thyer drejt majës së Fushës së Madhe (*1429 metër*) në lindje të fshatit Homezh (*njësia administrative e Proptishtit*). Në veri merr drejtim përka majës së Fushës së Moçalit, majës së Fushës së Madhe, majës së Shullërit të Kaprit (*1343.3 metër*) maja e Ahishtes së Gegës (*1513.5 metër*). Ky kresht ndan dy njësitë e Bashkisë së Pogradecit: Mokrën me fushëgropën e Pogradecit.

Si relief ka drejtimin veri-jug. Lartësitë kurrizore janë të përafërta me pritje uljeje gjer në Qafë – Tanë : 940 metër. Lartësia më e madhe është në majën e Ahishtës së Gegës (1513 metër)

Lugina dhe përrenj zbresin nga lartësitë drejt lindjes, si përroi i Varreve, që zbret në jug të fshatit Memëlisht (*i njësisë së Udënishtit*) përroi i Torbilit, përroi i fushës së Moçalit.

3.1.5. Gjeohapësira ujëmbledhëse lindore Guri i Kamjes - Kalivaç - në kufijtë e Fushëgropës së Pogradecit

Ka një sipërfaqe prej 32 km². Është një formë e faqes malore me ujëmbledhje dhe rrjedhje në drejtim të lindjes. Në veri kufizon nga qafa e Kalivaçit (*maja e Beshenikut, 1411 metër*) me rënie në rrjedhje të përroit të Kishës që zbret në periferinë jugperëndimore të Pogradecit. Ndërkaq kufizimi perëndimor vijon në jug deri tek Guri i Kamjes (1425 metër) që është edhe një monument natyror. Duke filluar që nga veriu prej kreshtit malor dhe faqeve përkatëse rrjedhin: përroi i Kishës, që zbret në këndin jugperëndimor të Pogradecit, përroi i Vërdovës, Përroi i Rrëmenjit dhe përroi i Gështenjasit.

3.1.6. Malësia e Gorës Jugore

Ka një sipërfaqe prej 18 km². Është veriu i krahinës së Gorës, që mbështetet dhe kufizohet më Malësinë e Mokrës. Kjo gjeohapësirë ka në përfshirje të saj fshatrat Niçë, Stërkanj, Osnat, Lekas, Dërdushë (*të njësisë së Dardhasit*). Si relief përfshin luginat dhe ujrata që rrjedhin në jug nga kreshti malor i krahinës së Mokrës, nga kurrizi i Mesmalit (*bashkia e Maliqit*) dhe ujrata dhe luginat që zbresin nga qafa e Panjës deri tek Guri i Kamjes, për në Osnat. Luginat dhe përrenjtë përkatës vijnë në Stërkanj (*i njësisë administrative të Dardhasit*), që është edhe fshati këndor e fundor i Bashkisë së Pogradecit

3.1.7. Gjeohapësira: Dardhas – Çërravë - Alarup


Ka një sipërfaqe prej 97 km². Kjo gjeohapësirë është plotësim i relievit kodrinoro-malor të pjesës jugore të Bashkisë së Pogradecit. Ajo kufizhet nga perëndimi me malësinë e Mokrës dhe të Gorës, në Jug me Bashkinë e Maliqit, në veri me hapësirën e fushëgropës së Pogradecit, në Lindje nga kufiri shtetëror me Maqedoninë. Në perëndim fshatrat kufitarë me Gorën janë Prenisht (1100 metër) që i përket njësisë administrative të Dardhasit, Grunjas (920 metër), Osnat, që përfshihen në njësinë e Dardhasit. Në këtë gjeohapësirë përfshihen 13 fshatra në dy njësi administrative vendore: Dardhas, Stropckë, Leshnicë, Çërravë, Qershizë, Grabovicë, Pretushë, Nizhavec, Blacë, Bletas, Lumas, Alarup, Peshkëpi. Kufizimi lindor është kufiri shtetëror me Maqedoninë duke përfshirë Peshkëpinë dhe Alaraupin. Në Bletas fillon relief intensiv ngjithës për në Malin e Thatë. Në jugperëndim shtrihet Blaca (*lartësia 1017 metër*), Nizhavec (*lartësia 955 metër*), Pretushë (*lartësia 986 metër*), Veliternë (*lartësia 820 metër*) deri në kufi me Grunjasin (*lartësia 1009 metër*).

3.2. Klima

KLIMA NË RAJONIN E POGRADECIT

Pozicioni gjeografik, mbizotërimi i kodrave dhe maleve bën që territori i bashkisë së Pogradecit të futet në zonën ku dimri është i ftohtë dhe vera e freskët. Rreshjet e pakta bien në formë bore.

Figura 16. Harta e zonave klimatike



Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia

Klima e rajonit në të cilin bashkia Pogradec gjendet është tipike kontinentale, me verë të nxehtë e të thatë dhe dimër të ftohtë dhe me reshje jo të shumta.

Tabela 1. Karakteristikat kryesore të klimës në rajonin e Pogradecit

<i>Nr</i>	<i>KARAKTERISTIKA</i>	<i>TIPI</i>
1	Tipet kryesore të klimës	Mesdhetare kontinentale para malore
2	Vendodhja e stacionit më të afërt metereologjik	Pogradec
3	Rreshjet mesatare vjetore	760 mm
4	Muaji me rreshjet më të dendura	Dhjetori
5	Muaji me rreshje dëbore më të mëdha	Janari

6	Fillimi dhe fundi i shirave të vjeshtës (<i>p.sh herët në shtator, mesi i tetorit, fundi i tetorit</i>)	15 Shtator - 30 Nëntor
7	Fillimi dhe mbarimi i rreshjeve në pranverë	15 Mars - 30 Prill
8	Fillimi dhe përfundimi i rreshjeve të dëborës	5 Dhjetor - 15 Mars
9	Muaji i shkrirjes së plotë të dëbores	Fillim muaji Maj
10	Fillimi dhe përfundimi i periudhës së thatë	Korrik - Shtator
11	Data e ngricës së parë	Pas 10 Nëntorit
12	Data e ngricës së fundit	10 ditëshi i parë Prillit
13	Temperatura minimale mesatare afatgjatë, muaji dhe zgjatja	Temp.mes.vjetore 6-12°C Temp.min.vjetore (-10°C) (-15°C)
14	Muajt e tokës së ngrirë (<i>lartësi 50 cm</i>)	Janar-Shkurt deri 20 cm thellësi

Burimi: *Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia*

Temperatura maksimale gjatë verës variojnë 36-38 gradë, temperatura mesatare mujore luhet nga 20 gradë deri në 24 gradë. Gjatë dimrit bien dhe reshje dëbore, ku në rajonin tonë e përreth trashësia shkon në mbi 0.5m, ndërsa në veri në lartësi të mëdha trashësia shkon deri në mbi 1m. Gjatë vitit në zonën tonë reshjet janë të shumta dhe sasia e tyre mesatare shkon nga 900-1300 mm, dhe më shumë reshje bien në muajin nëntor dhe dhjetor të vitit. Dëbora fillon të bjerë që në fundin e muajit Nëntor dhe vazhdon në mënyrë jo të qëndrueshme deri në muajin Shkurt. Ky territor, pothuajse gjatë gjithë vitit, por veçanërisht në periudhën fundi i vjeshtës-fillimi i pranverës rrihet nga erëra të ftohta. Klima e territorit tokësor/ujor të Pogradecit është e tipit kontinental lokal, me një temperaturë mesatare vjetore prej 11.4°C. Temperaturat mesatare mujore arrijnë rreth afërsisht 21.2 gradë në Korrik dhe Gusht, ku maksimumi arrin në gusht me 34.4 gradë. Temperatura mesatare më e ulët është gjatë Janarit, rreth 1.5 °C, me një minimum prej -17.2°C.

PARAMETRAT KLIMATERIK

Era

Era më e shpeshtë është ajo që fryn nga veriu, sidomos në vjeshtë dhe dimër. Erërat që fryjnë nga jugu dhe juglindja dominojnë gjatë pranverës dhe verës. Erërat e juglindjes dhe lindjes janë të konsiderueshme.


Periudhat e qeta dhe me erë ndryshojnë gjatë ditës, veçanërisht në verë: mëngjeset karakterizohen nga luhetjet mes erërave që fryjnë nga veriu dhe periudhave të qeta. Kushtet e motit ndryshojnë mjaft pasditeve, kur qetësia prishet nga erërat e jugut dhe juglindjes. Shpejtësia mesatare e erës në rajonin e Ohrit është relativisht e ulët, 3.4 m/sek.

Era percaktohet si levizje horizontale e ajrit, ndërsa lëvizja vertikale quhet rrymë ajri. Karakteristikat kryesore të erës janë drejtimi dhe shpejtësia e erës. Drejtimi i erës është kahu nga fryn era dhe merr emrin e tij sipas një prej 16 pikave të horizontit. Lulina e lumit shërben si një drejtues për rrymat ajrore dhe po të gjykojmë nga të dhënat e stacionit meteorologjik të Elbasanit drejtimi dominues, në të gjithë stinët, janë VL (20% të rasteve) dhe JP (10.4% të rasteve). Rrymat ajrore janë një ndër faktorët kryesorë të formimit të klimës. Në territorin në studim, drejtimi i erës gjatë vitit është i ndryshueshëm. Shpejtësitë e erës në territorin në studim janë në vartësi të periudhës së vitit. Vlerat më të mëdha të shpejtësisë së erës vrotohen në stinën e dimrit. Shpejtësitë maksimale të erës me periudhë përsëritje një herë në 50, 20, 10 vjet janë respektivisht 30-33m/s, 28-30m/s, dhe 24-27m/s (sipas Kushteve teknike Hidrometeorologjike).

Temperatura

Regjimi termik paraqet uniformitet të kënaqshëm. Vleftat e temperaturës mesatare vjetore përgjithësisht luhaten rreth 13.0°C . Temperatura mesatare e janarit lëkundet në rreth 2.9°C . Në figurë paraqitet shpërndarja e temperaturës mesatare gjatë vitit

Figura 17. Shpërndarja e temperaturës mesatare gjatë vitit



Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia

Ecuria ditore e temperaturës së ajrit, në çdo stinë dhe muaj të vitit, shprehet nga një valë pothuajse sinusoidale, që karakterizohet nga një maksimum në orët e para të pasdites. Dukuria e uljes së temperaturës minimale deri në vlera negative është përgjithësisht veçori e muajve të dimrit. Por të tilla mund të vrotohen pjesërisht edhe gjatë marsit e tetorit. Me 5 janar 1980 në Prenjas është regjistruar temperatura minimale -19.0°C .

Regjimi termik i ajrit dhe i tokës duhen parë në kompleks. Dihet se temperatura e ajrit dhe e

tokës në të njëjtin moment nuk janë të njëjlojta. Ajri nuk ngrohet drejtpërdrejt nën veprimin e rrezeve të diellit, por nga nxehtësia që lëshon toka. Në tërësi ecuria vjetore e temperaturës mesatare të shtresës sipërfaqësore të tokës (0 – 20 cm thellësi) është e ngjashme me atë të ajrit. Vlerat më të larta vrojtohen në muajt e verës, ndërsa ato më të ulëta në muajt e dimrit. Në ecurinë e temperaturave të tokës vërehen dy momente kryesore:

- a) periudha kur temperatura mesatare rritet me rritjen e thellësisë
- b) periudha kur kjo temperaturë ulet me rritjen e thellësisë.

Tendenca e rritjes së vlerave mesatare të temperaturës së tokës nga sipërfaqja në drejtim të thellësisë duket, përgjithësisht, nga fundi i muajit shtator. Dukuria e uljes së vlerave mesatare të temperaturës së tokës nga sipërfaqja në thellësi, është veçori e muajve të gjysmës së ngrohtë të vitit minimum rreth kohës së lindjes së diellit.

Reshjet atmosferike

Reshjet janë një prej faktorëve kryesorë që influencojnë regjimin klimaterik të zonës. Reshjet e shiut variojnë gjatë vitit dhe luajnë një rol të rëndësishëm në balancën e ujit të liqenit dhe pellgut të tij ujëmbledhës. Niveli më i lartë i reshjeve normalisht shënohet në Nëntor-Janar dhe në pranverën e vonë, zakonisht në maj. Reshjet arrijnë nivelin më të ulët gjatë Korrikut dhe Gushtit. Reshjet mesatare të shiut në vit në basenin e liqenit shkojnë afërsisht 759 mm. Termi *reshje*, i përdorur në hidrologji, përfshin të gjitha format e ujit që vijnë nga atmosfera në tokë. Format kryesore të reshjeve janë: shiu, bora, breshëri, vesa etj. Reshjet atmosferike janë nga elementët më të rëndësishëm të motit dhe të klimës. Faktorët kryesorë që kushtëzojnë sasinë, intensitetin, shpërndarjen vjetore, stinore e mujore të reshjeve, në zonën në studim janë: pozicioni gjeografik dhe veçoritë e relievit. Është e qartë se për një pellg, përgjithësisht, reshjet janë faktori kryesor i regjimit hidrologjik, sepse ato janë vetë edhe materiali kryesor që krijon rrjedhjen në hapësirë dhe kohë. Një karakteristikë e përgjithshme e shpërndarjes së reshjeve në pellgun e Shkumbinit është se lartësia e tyre rritet nga Perëndimi në Lindje deri në pellgjet e degëve Gostime e Rapun (inklusiv) dhe pastaj zbret nga Veriu në Jug. Reshjet atmosferike janë nga elementet më të rëndësishëm të motit dhe të klimës.

Tabela 2. Reshjet vjetore (në mm)

Stacioni	Periudha e perseritjes (vjet)					Max (mm)	Min (mm)	Mesatarja (mm)
	500	100	50	20	10			
Pogradec	1472	1296	1214	1099	1005	1209	351	763

Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia

Në territorin në studim, gjatë vitit bien mesatarisht 1424 mm në Stravaj dhe 763 mm në Pogradec.

Tabela 3. Vitet me reshje maksimale dhe minimale dhe raporti ndërmjet tyre.

	Reshjet me te medha		Reshjet me te pakta		Raporti ndermjet reshjeve me te medha e me te pakta.
	Sasia mm	Viti	Sasia mm	Viti	
Pogradec	1209	1947	351	1953	3.44

Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia

Shpërndarja e reshjeve brenda vitit në territorin në studim është tipike mesdhetare, me reshje të shumta gjatë gjysmës së ftohtë të vitit dhe reshje të pakta gjatë gjysmës së ngrohtë me thatësi që mund të zgjatë disa muaj. Ndarja e vitit në dy gjysma viti është bërë duke ndjekur kriterin pluviometrik të muajve. Si gjysmë e ftohtë e vitit është marrë inkluziv periudha *tetor...mars* ndërsa ajo e ngrohtë periudha *prill...shtator*.

Nga analiza e reshjeve të dy periudhave vihet re se reshjet e gjysmës së ftohtë të vitit janë më të mëdha se ato të gjysmës së ngrohtë, gjë që tregon karakterin mesdhetar të shpërndarjes së reshjeve në territorin në studim.

Po të shohim ecurinë e sasisë së reshjeve sipas renditjes kronologjike të muajve, do të vemë re se kjo ecuri paraqet afërsisht trajtat e një kurbe paraboloidi me origjinë të vendosur në muajt me më pak reshje dhe me krahë në të dy drejtimet që ndjekin rritjen graduale të reshjeve sipas radhës së muajve Muajt me më shumë reshje janë Nëntori, Dhjetori e Janari, por reshjet më të shumta vrojtohen në muajin Nëntor. Muaji me më pak reshje është Korriku. Nga sasia e reshjeve mbizotëron stina e dimrit, megjithëse vjeshta në disa raste barazohet me të.

Tabela 4. Lartësia e reshjeve vjetore me periudhë të ndryshme përsëritje

STACIONI	Periudha e përsëritjes ne vjet			
	2	20	50	100
Pogradec	7	1099	1214	1296

Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia

Dëbora

Në Shqipëri reshjet në forme bore bien kryesisht në muajt e dimrit dhe përfshijnë më tepër zonat malore të vendit sidomos ato që shtrihen në brendi të territorit. Mesatarja e lartësive maksimale të dëborës, për territorin në studim, është nga 15 deri 30 cm. Vlera mesatare e dendësisë së borës merret 0.13 gr/cm^3 . Mesatarja e lartësive maksimale të borës ndryshon me ndryshimin e lartësisë së vendit, mbi nivelin e detit sipas kësaj ligjësie (*shiko Kushtet Meteorologjike të Projektimit*):

ku:

$$Y = 2.3(H/100) + 3.7$$

Y – mesatarja e lartësive maksimale ne cm, H - lartësia e vendit mbi nivelin e detit në m.

P.sh. për lartësinë 800 m mbi nivelin e detit, mesatarja e lartësive është 22.1 cm. Për zonën në studim (në lartësinë 800 m) vlera e pritshme për periudhën e përsëritjes një herë në 50 vjet është $22.1 \times 3.4 = 75$ cm. Ndryshimet klimatike nuk kanë më nevojë të paraqiten si një fenomen global që mund të ndikojë tek ekosistemet, si dhe tek sektorë të rëndësishëm të bujqësisë. Ndryshimet klimatike janë tashmë një kërcënim i njohur që, për t'u trajtuar siç duhet, duhet të merren në konsideratë në mënyrë të integruara, si pjesë e sfidave më të mëdha të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel global. Ndryshimet klimatike pritet që të rrisin frekuencën dhe madhësinë e ngjarjeve ekstreme si dëmet e shkaktuara nga përmytjet, thatësira, zjarret nëpër pyje, valë të nxehti dhe rreziqe të tjera klimatike. Pritet gjithashtu që të shkaktojnë reduktim të drithërave dhe të ujit.

Ndryshimet e shpejta dhe/ose të ashpra klimatike mund të kenë një ndikim të madh në inventarin biotik të liqenit. Për më tepër, eutrofikimi i Liqenit të Pogradecit pritet të përforcohet dukshëm nga ngrohja globale. Ndryshimet e temperaturës, anomalitë në reshje dhe shpeshtësia e rritur e ngjarjeve ekstreme mund të çojë në degradimin e burimeve ujore dhe mund të shkaktojë pasoja ekstreme në ekosistem. Ndryshimet në mesataren e reshjeve mund të ndikojnë ekosistemet, biodiversitetin, prodhimin e ushqimit, burimet ujore të disponueshme dhe rrjedhën e lumenjve. Ndryshimi klimatik ndikon biodiversitetin dhe modifikon kushtet rrethore: temperaturat mesatare dhe disponueshmërinë e ujit. Flora dhe fauna duhet t'i përshtaten kushteve të ndryshuara në mënyrë që struktura e ekosistemit të mund të ndryshojë. Mund të shfaqen specie të reja të huaja në këtë zonë dhe ta kolonizojnë duke shkaktuar zhdukjen e specieve të tjera dhe duke ndikuar negativisht në biodiversitetin vendor si dhe në bujqësi e në shëndetin e bimëve.

Liqeni i Ohrit - Stacioni Lin


Stacioni ndodhet në pjesën veriperëndimore të liqenit. Ekspeditat për marrjen e mostrave është realizuar në sezona të ndryshme vetëm në sipërfaqe të ujit. Temperatura e ujit ndryshon sipas sezonit dhe varion nga 9.9°C në 21°C . Liqeni i Ohrit është liqen i thellë dhe uji nuk qarkullon brenda vitit, si pasojë temperatura në kollonën e ujit ndryshon nga sipërfaqja në thellësi. Vlerat më të larta të përmbajtjes së BOD_5 janë në verë dhe në pranverë $1.02\text{-}1.67$ mg/l O_2 që tregon për rritje të aktivitetit biologjik, kurse vlera më e ulët në tetor 0.48 mg/l O_2 . Gjithsesi janë më të ulta se vlera limite < 3 dhe ujrato vlerësohen të cilësisë oligotrofike. Vlerat e nitrateve janë të ulta në dimër dhe pranverë dhe në vlera mbi normën e lejuar $1.14\text{-}1.8$ mg N/l në verë dhe vjeshtë.

VLERËSIMI I NDRYSHIMIT DHE ADAPTIMIT

Qëllimi i vlerësimit N & A përfshin si modelimin klimatik dhe vlerësimin e integruar të ndikimeve të ndryshimeve klimatike në sektorët kryesorë në zonat bregdetare të Shqipërisë. Këta sektorë kyç janë bujqësia, shëndetësia, burimet ujore, fatkeqësitë natyrore, turizmi, dhe biodiversiteti.

Skenarët e ndryshimit të klimës

Skenarët e Ndryshimeve klimatike për temperaturë, reshje, do të thotë presion i nivelit të detit dhe rritja e nivelit të detit janë zhvilluar duke përdorur modelin MAGICC / SCENGEN (v. 5, 3, v 2).

Figura 18. Harta e temperaturës në thellësi 100 metra në tokë

Shpërndarja territoriale e temperaturave në 100 m thellësi

Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia

Ndryshimet e parashikuara në regjimin e temperaturës

Për shkak të ndryshimit të mundshëm të temperaturës, Zona bregdetare shqiptare ka gjasa të bëhet më e ngrohtë. Të gjithë skenarët tregojnë një rritje të mundshme në temperatura vjetore që lidhen me 1990 për të gjitha horizontet kohore. Veçanërisht:

- A1F1MI parashikon rritjen mesatare më të lartë pas 2014, me një rrotje të mundshme deri në 4.8 në 2100 (skenari më i lartë/max),
- A1BAIM parashikon një rritje mesatare prej 1.7°C me 2050 dhe 3.2°C (skenari mesatar), dhe
- B1IMA parashikon rritjen më të vogël pas 2040 (skenari më i ulët/min).

Ndryshimet e parashikuara në regjimin e reshjeve

Të gjitha skenarët tregojnë një rënie të reshjeve vjetore në lidhje me 1990 për të gjitha horizontet kohore. Duke përgjithësuar rezultatet e tyre rezulton se reshjet vjetore kanë mundësi të ulen deri në -8,5% (nga -56,0 deri në 47,4%) në 2050; deri në -18,1% (nga -89,7% deri 94,0%) në 2100

Disa ndikime të përgjithshme

Si rezultat i ndryshimi të temperaturës dhe regjimit të reshjeve, janë parashikuar ndikimet e mëposhtme:

- Rritja e temperaturave minimale ditore më shumë se ato maksimale ka të ngjarë të ndodhë në të gjitha zonat e tokës
- Thatësira të shpeshta të gjata dhe me rrezik të madh zjarri janë të mundshme.
- Numri i ditëve me temperaturë mbi 35°C është parashikuar të rritet mesatarisht 10 ditë në vit deri 2100. Si pasojë e kësaj , numri i valëve të nxehta dhe i ditëve me temperaturë të ftohtë janë parashikuar gjithashtu të rriten.
- Ditët e freskëta dhe valët e ftohta janë shumë të mundshme të zvogëlohen. Dimërat e ngrohtë do të reduktojnë kërkesën e energjisë për ngrohje.
- Një rritje e numrit të ditëve me shira të rrëmbyeshëm që shkaktojnë përmytje deri në 2100.
- Temperaturat e rritura të pranverës do të rrisin temperaturën e tokës, të mbjellat e verës në zonat e përshtatshme do të zgjasin periudhën e rritjes. Zgjatja e periudhës së rritjes është parashikuar të rritet me 26 ditë krahasuar me 1990.
- Si rezultat i reduktimit të reshjeve totale vjetore, zonat bregdetare mund të përjetojnë një rënie të përgjithshme. Kërkesa për ujë mund të rritet, veçanërisht në verë.
- Deri në vitin 2100 kushtet që do të jenë më të mira për turistët do të zgjerohen. Në verë kushtet do të ndryshojnë nga idealia në të shkëlqyeshme.

NGJARJE TË PAZAKONTA KLIMATIKE

Ndër dukuritë e pazakonta klimatike bëjnë pjesë edhe ato që lidhen me regjimin e reshjeve. Shqipëria, si vend me klimë tipike mesdhetare, karakterizohet nga një regjim i çrregullt i reshjeve nga pikëpamja e shpërndarjes vjetore. Kjo shpërndarje karakterizohet nga një maksimum në muajt e dimrit (30-40% e reshjeve vjetore) dhe një minimum në muajt e verës (10%). Çrregullsia e reshjeve vihet re edhe në shpërndarjen e tyre gjeografike. Kështu, në shkallë lokale herë pas here ndodhin ngjarje jo të zakonata, si reshjet intensive brenda 24 orëve të shoqëruara në disa raste me përmytje apo mungesa e theksuar e reshjeve që sjell thatësira të zgjatura.


Si vite skajore në Shqipëri janë përcaktuar vitet hidrologjike 1949, 1954, 1957 e 1985 si vite ujëpakët dhe 1963, 1970, 1978 e 1986 si vite ujëshumë. Ndër ata ujëpakët, më i thati paraqitet viti 1949. Në krahasim me mesataren shumëvjeçare, në këtë vit sasia e reshjeve kanë qenë 1.6 herë më pak se norma. Gjatë këtij viti, thatësira ka qenë më e theksuar në Shqipërinë juglindore, si në Voskopojë, Korçë, Leskovik, etj. I dyti për nga thatësira është viti 1953-1954, me 1.4 herë më pak reshje se mesatarja shumëvjeçare. Viti me reshje më të shumta ka qenë viti 1963, me 1.6 herë më shumë reshje se mesatarja shumëvjeçare në shkallë vendi dhe veçanërisht në zonën jugore me 2 herë më shumë se mesatarja. Rajoni i studiuar karakterizohet nga një sasi tepër e vogël reshjesh, rreth 700 mm/vit. Në vitet e ardhshme (sipas UNEP, 1994) pritet që deri në vitin 2100, si rezultat

i ngrohjes globale, të ndodhë një ndryshim i temperaturës mesatare vjetore me $0,7-2,5^{\circ}\text{C}$, pra luhajte e, gjë e cila do të pasqyrohet edhe në ciklin hidrologjik. Gjatë dimrit pritet që rritja e temperaturës të ndjekë ecurinë vjetore, ndërsa sasia e reshjeve do të zvogëlohet deri me 5%. Gjatë pranverës temperaturat mesatare që ndryshojnë mes $13,8$ dhe $15,7^{\circ}\text{C}$ mendohet të ndryshojë në $15,2^{\circ}\text{C}$ dhe $18,5^{\circ}\text{C}$, ndërsa sasia e reshjeve do të rritet me 0,18%. Gjatë verës temperaturat mesatare do të luhaten nga $23,2^{\circ}\text{C}$ në $24,7^{\circ}\text{C}$, ndërsa sasia e reshjeve do të zvogëlohet me 60%. Gjatë vjeshtës ndryshimi i temperaturës pritet të jetë më i madh se ai vjetor, për shkak të verës së zgjatur, ndërkohë që sasia e reshjeve pritet të rritet me 53%.

Këto ndryshime të klimës do të ndikojnë edhe në rezervat ujore duke shkaktuar:


- Zvogëlim të rrjedhjes së ujërave sipërfaqësorë gjatë thatësirës së verës, veçanërisht në zonat jugore të Shqipërisë me 2% deri në 2030 dhe 5% deri në 2100;
- Keqësim të problemeve të ujit, veçanërisht atij të pijshëm, si gjatë stinës së verës për shkak të pakësimit të reshjeve, ashtu edhe gjatë vjeshtës për shkak të rritjes së turbullirës së ujit;
- Rritje e evapotranspiracionit për shkak të rritjes së temperaturës duke sjellë dhe zvogëlim të sasisë totale të ujit;

Figura 19. Harta e diellëzimit të Shqipërisë



Burimi: *Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia*

Figura 20. Shpërndarja territoriale e sasisë vjetore të orëve me diell



Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia

4. Mjedisi dhe ekosistemet

4.1 Habitati dhe Biodiversiteti

HABITATET UJORE

Liqeni është një nga rezervatet biologjike më të pasura dhe më të çmuara të Europës. Ai shkëlqen si një sistem unikal pasi karakterizohet nga një biodiversitet me shumë specie endemike të florës dhe faunës. Në liqen rriten rreth 17 lloje peshqish, nga të cilët 10 janë endemike ndërsa 7 të tjerët me

vlera komerciale. Familja Salmonidae, e përfaqësuar nga Korani me katër racat e tij, e mbyll ciklin biologjik brenda liqenit.

FLORA

Vegjetacioni higrofil

Shoqërimet bimore kryesore të këtij vegjetacioni u përkasin klasave *Alno-Populetea* ((Verrinjeve dhe Plepishteve) dhe *Salicetea purpurea* (Shelgjeve) *Salix purpurea* etj. Përbërësit kryesore të pyjeve (aluvionale) të zallishteve të lumit të Shkumbinit dhe degëve të tij janë jane formacione drunore të rrapishteve (*Plantanus orientalis*, Rrapi), *Juglans regia*-Arra, *Alnus glutinosa*-Verriri I zi.

Nje formacion tjetër drunor është me Frasherin, *Fraxinus angustifolia*, *Quercus robur*, *Ulmus minor*, vidhi në kompleks me *Populus alba*, *Populus nigra*, *Salix Alba* në toka aluvionale të lumit Shkumbin.

Pyjet dhe shkorretat mesdhetare

Brezi i pyjeve dhe shkorretave mesdhetare përfaqëson formacionin bazë dhe me përhapjen më të madhe. Shoqërimi i *Quercetum cocciferii* formon formacionin shkurror të dominuar nga pralli. Shoqërimi i *Arbuto-Ericetum*, i maresë me shqopen, është formacioni bimor me i përhapur në këtë luginë. Formacione të pyjeve të *Quercus frainetto* e *Quercus cerris* si dhe stadeve të degradimit të tyre (*Carpinus orientalis*, *Ostrya carpinifolia*) takohen në një pjesë të konsiderueshme, derine 1200 m lartësi mbi nivelin e detit. Pylli natyror dominohet kryesisht nga *Quercus cerris*, i shoqëruar nga *Quercus pubescens* apo *Quercus frainetto*.

Tipet e grumbujve më të përhapura dhe që janë formacione bazë dhe shtrihen në ekonomitë pyjore të bashkisë Pogradec janë:

-Pyjet me geshtenjë –*Castanea sativa* dhe geshtenje me dushqe

Figura 21. Pyll Gështenje, Gështenjas



Pyje geshtenje –Geshtenjas

-Pyje me qarr dhe pyje qarri me dushqe të tjerë ,pyje qarri me shkozë

Figura 22. Pyll lisi - Velçan



Pyje lisi - velcan

-Pyje me bunge

-Pyje shpardhi me dushqe të tjerë

Pyje me pishë të zezë

-Pyje ahudhe pyje ahu me bredh të bardhë

-Pyje me bredh të bardhë



Pyjet e bredhit (Abies alba) Bishnice-Uji i ftohte

-Pyjet dominohen nga pikëpamja fitosociologjike dhe i përkasin rendit *quercetalia pubescentis* dhe bashkëshoqerimeve të aleancës Quercion frainetto-cerris dhe Ostrio- Carpinino orientalis. Llojet me predominus janë pyjet me qarr (Quercus cerris), pyjet e ahut (Fagus silvatica) të shoqëruara me Shpardin e Qarrin.

FAUNA

Amfibet dhe reptilet (herpetofauna)

Herpetofauna e zonës gëzon një pasuri llojore të rëndësise mesatare.

Llojet më të zakonshme të amfibeve përfshijnë *Bombina variegata* dhe *Rana balcanica*. Midis reptileve vlen të përmendet prania e *Natrix natrix*, *Elaphe quatrolineata*, *Malpolon monspensulanum*, *Testudo hermanni* etj. Të gjithë amfibët e pranishëm në zonë vlerësohen si të kërcënuar në kontekstin kombëtar. Vetëm *Rana balcanica* i përket kategorisë Vulnerabel. Statusi i llojeve të tjera i takon kategorisë Rrezik i Ulët. Pothuajse të gjithë reptilet e rajonit futen në listën e kuqe të vendit. Pjesa më e madhe i takon kategorisë Rrezik i Ulët, dy lloje (*Elaphe quatrolineata*, *Elaphe situla*) cilësohen si të Përkeqësuar (Vulnerabël). Lidhur me reptilët mund të thuhet se vihen re rreth 15 lloje reptilësh në zonë të cilat kanë statuse të ndryshme.

Shpendët

Në zonë janë të pranishëm rreth 39 lloje shpendësh. Nga llojet e shpendeve të pranishëm në zonë 22 prej tyre janë të rrezikuar në shkallë kombëtare. Prej këtyre 17 lloje i përkasin kategorive të larta të rrezikimit. Gjithashtu vlen të theksohet se në territorin e bashkisë Pogradec gjenden edhe shpendë të tillë si Gjeli i egër ((*Tetrao urogallus*).

Gjitarët

Në zonë numërohen rreth 20 gjitarë nga të cilët 6 janë të rrezikuar në shkallë kombëtare. Prej këtyre 3 lloje bien në kategoritë e larta të rrezikimit (CR,EN,VU).Nga mishngrënësit takohen dhelpra (*Vulpes vulpes*), baldosa (*Meles meles*), dhe nuselalja (*Mustela nivalis*). Në mjediset ujore të zonës takohet rrallë edhe lundërza (*Lutra lutra*). Pyjet dhe mjediset ujore të zonës janë zona me rëndësi të vecantë për lakuriqet e natës (lloje të gjinive *Rhinolophus*, *Myotis*, dhe *Pipistrellus*) të cilët i vizitojnë ato për ushqim dhe pirje uji^{ix}.

Tabela 5. Gjitarët

Speciet	Emri shqip	Statusi kombëtar i ruajtjes
<i>Erinaceus concolor</i>	Iriqi	
<i>Talpa sp.</i>	Urithi	
<i>Crocidura sp.</i>	Hundegjati	
<i>Rhinolophus ferrum-equinum</i>	Lakuriqnate hundpatkua i madh	LRcd
<i>Rhinolophus blasii</i>	Lakuriqnate hundpatkua i Blasius-it	LRnt
<i>Rhinolophus euryale</i>	Lakuriqnate hundpatkua i	VU
	Mesdheut	
<i>Myotis myotis</i>	Lakuriqnate veshmiu i madh	
<i>Myotis blythi</i>	Lakuriqnate veshmiu i vogël	
<i>Pipistrellus pipistrellus</i>	Pipistrelli i zakonshëm	
<i>Pipistrellus savii</i>	Pipistrelli i Savi-it	
<i>Pipistrellus kuhli</i>	Pipistrelli i Kuhl-it	
<i>Lepus capensis</i>	Lepuri	
<i>Microtus epiroticus</i>	Miu i Ondrias-it	
<i>Microtus thomasi</i>	Miu i Thomasit	LRnt

<i>Apodemus sylvaticus</i>	Miu i pyllit	
<i>Mus spicilegus</i>	Miu i maqedonise	
<i>Vulpes vulpes</i>	Dhelpra	
<i>Lutra lutra</i>	Lutra, lunderza	VU
<i>Meles meles</i>	Baldosa	EN
<i>Mustela nivalis</i>	Nuse lalja	
<i>Ursus arctos</i>	Ariu I Murrme	
<i>Canis lupus</i>	Ujku	

(**Burimi:** Agjensia Kombëtare e Mjedisit)

Fauna në habitatet tokësore

Tokat kullosore, arat dhe arat e braktisura që të shndërruara në toka barishtore në afërsi të vendbanimeve dhe fshatrave, sigurojnë mbajtje të një numri të lartë specimesh zogjsh, më së shumti zogjve të vegjël (Rendi: *Passeriformes/Harabelorët*). Në dimër, fushat e hapura përdoren nga tufa trishtilash shoqëruar nga harabela të tjerë të vegjël. Në verë, fushat e hapura sigurojnë terrene shumëzimi për Shkurtën - *Coturnix coturnix*. Gardhet dhe pemët e ndryshme frutore në vendet e hapura vizitohen nga Gushëkuqi - *Erithacus rubecula*, Cerla e zakonshme - *Miliaria calandra*, Harabeli - *Passer domesticus*, Cerri - *Troglodytes troglodytes*, lauresha (*Alaudidae*) dhe shumë lloje trishtilash.

Zonat shkurre sigurojnë një habitat të rëndësishëm dimërimi për shumë lloje zogjsh, të cilët shumëzohen në lartësi më të larta dhe lëvizin poshtë në zonat shkurre për t'iu larguar motit të keq. Zogjtë tipikë janë Bilbilthi kokëzi - *Sylviaatricapilla*, Bilbili kokëzi gushëbardhë - *Sylvia melanocephala*, Cerla - *Emberiza spp*, Bilbili i kënetave - *Cettia cetti*, etj.

Lakuriqët e natës përfaqësohen kryesisht nga *Myotis nattereri*, *Nyctalus leisleri*, *Rhinolophus ferruequinum*, *R. blasii*. Gjitarë të tjerë dhe më shumë të përhapur në zonën e mbrojtur të liqenit të Pogradecit janë shqarhi (*Martes foina*), vjedulla (*Meles meles*), nuse-lala (*Mustela nivalis*), dhelpra e kuqe (*Vulpes vulpes*), ketri i kuq (*Sciurus vulgaris*), lepuri (*Lepus europeus*), iriqi (*Erinacues concolor*), gjeri (*Glis glis*), gjumashi i lathjisë (*Muscardinus avellanarius*), minjtë e drurit/arave (*Apodemus flavicollis*, *A. sylvaticus*, *A. mystacinus*), hundëgjatës (*Crocidura sp*), urithi (*Talpa stankovici*) dhe miu i fushës (*Microtus sp*).

Peisazhi i Mbrojtur Tokësor/Ujor i Pogradecit shërben si bio - korridor për gjitarët e mëdhenj midis zonës qendrore Rajcë-Shebenik-Jabllanicë dhe Guri i Nikës-Holtë-Lukovë, në Shqipëri. Amfibët dhe zvarranikët janë të zakonshëm në zonën e mbrojtur. Llojet kryesore më të përhapur që mund të vëzhgohen kryesisht në zonën e liqenit të Pogradecit janë: *Triturus cristatus*, *T. vulgaris*, *Salamandra salamandra*, *Bombina variegata*, *Rana balcanica*, *Rana dalmatina*, *Rana graeca*, *Bufo viridis*, *Hyla arborea*, *Emys orbicularis* dhe *Natrix natrix*.

Habitati i liqenit

Liqeni i Pogradecit ka një bimësi të pasur prej 125 bimësh ujore. Llojet më të zakonshme janë *Phragmites australis*, *Potamogeton spp.*, *Chara spp.*, *Ceratophyllum spp.*, *Myriophyllum spp.*


Gjashtë zonat e njëpasnjëshme të bimësisë përcaktohen në vijim: Zona 1: *Chara spp.*, Zona2: *Potamogeton spp.*, Zona 3: Zona e kallamishteve - *Phragmites australis*, Zona 4: llojet me gjethe pluskuese, Zona 5: Zona Palustrine dhe Zona: *Charatea*.

Fauna bentike e liqenit të Pogradecit përmban një dendësi dhe shumëllojshmëri të lartë specimesh. Në zonë gjenden lloje arkaike, endemike e të rralla dhe liqeni është i famshëm për këtë. Sfungjeri i rrumbullakët *Ochridospongia rotunda* gjendet vetëm në liqenin e Pogradecit dhe është një lloj endemik e i rrallë. Grupi më i përhapur dhe më i madh në numër janë Gastropodet (kërmijtë), dhe shumica e tyre në liqen janë lloje endemike. Niveli i lartë i endemizmit përfaqësohet gjithashtu nga taksonë të tjerë, të tillë si *Tricladida*, *Oligochaeta*, *Hirudinea*, *Ostracoda*, *Amphipoda* dhe *Isopoda*.

Fito dhe zoo-planktoni, mikroalgat, janë tregues biologjikë shumë të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në regjimin/cilësinë e ujit. Fitoplanktoni përfaqësohet më shumë nga *Cyclotella ocellata*, *Achnanthes minutissima*, *Achnanthes biasolettiana*, *Fragilaria capucina*, etj

Pogradeci përfaqëson një përqindje të lartë (60%) të llojeve të peshqve endemikë. Në liqen gjenden 21 lloje natyror peshqish, 11 prej të cilëve shfrytëzohen për qëllime tregtie. Dy salmonidet, korani - *Salmo letnica* dhe belushka - *Salmothymus ohridanus*, janë deri më tani llojet më të rëndësishme në peshkim pasuar nga gjuhëza (*Alburnus alburnus*), krapë (*Cyprinus carpio*), ngjala (*Anguilla anguilla*) dhe gurneci (*Rutilus rubilio ohridanus*). Gjatë viteve të fundit, në liqen janë hedhur lloje peshqish jo natyror si ylber (*Oncorhynchus mykiss*), barkuleci (*Gambusia affinis*) apo sharoku laraman (*Lepomis gibbosus*). Këto lloje nuk janë të afta të riprodhohen në mënyrë natyrore dhe tani konsiderohen si të zhdukura.

Figura 23. Pylli i Gështenjës



Burimi: E.Keci

Figura 24. Habitati i Kallamishteve




Figura 25. Pyll Ahu cungishte (*Fagus silvatica*)



Figura 26. Tokë bujqësore



Figura 27. Pyll pishe e zezë (majtas) dhe pyll dushku (djathtas)

Burimi: foto nga M.Christensen

4.2 Territori toka dhe nëntoka

Klasifikimi i tokave sipas brezave

Elementët kryesorë që diktojnë cilësinë e një tokë e që lidhen drejtpërsëdrejti me rendimentin e cilësisë së tokave janë: përbërja mekanike, trashësia e horizontit humusor, përmbajtja e humusit, shkalla e pH dhe përmbajtja e fosforit. Ndryshimi i rendimentit të bimës nën ndikimin e trashësisë së horizontit humusor lëviz nga 20-30%. Rreth 90% e sipërfaqes pyjore përbëhet nga toka të kafejta dhe 100% nga toka të murme pyjore malore. Thellësia është mesatarisht e thellë deri në të thella, por takohen edhe toka të cekta vecanërisht në shkurret me bush dhe vendet ku vegjeton bulgri. Konsistenca është mesatarisht e ngjeshura deri e ngjeshur me reaksion përgjithësisht neutrale. Në bazë të lartësisë mbi nivelin e detit dhe të pjesëmarrjes së shkëmbinjve nga pikëpamja gjeolitologjike, struktura dhe tekstura e tokës produktive e tipit “soil” klasifikohet në:

Brezi i tokave të kafenjta malore. Këto toka shtrihen në pjesët më të ulëta të maleve, nganjëherë fillojnë nga 300m mbi nivelin e detit dhe shfaqen në lartësi deri në 1000-1300m mbi nivelin e detit, shtrihen si në brezin e shkurreve ashtu edhe të dushkut. Ato, zakonisht vendosen në pjesën e mesit të luginës së Shkumbinit

Brezi i tokave të murrme pyjore, shtrihet në brezin e ahut dhe të pishës, në pjesën e mesit dhe të sipërme të luginave lumore, duke zënë lartësinë nga 800-1500 m mbi nivelin e detit.

Brezi i tokave livadhore malore që rrisin dhe zhvillojnë brezin bimor të kullotave alpine, zakonisht vendosen mbi 1500-1700m dhe ndodhet nën ndikimin e një klime të ftohtë dhe të ashpër malore, të brezit të ahut, karakteristike e zonës fitoklimatike fagetum (ahut) në zona e ftohtë dhe kullotave apine, 1500-1750m.

Toka pyjore kafe - Zona jonë më së shumti përfaqësohet nga toka pyjore kafe, të cilat janë formuar sidomos nga magma ultra-alkaline TIC e shkëmbinj sedimentarë. Në bazë të strukturës kimike, tokat e zakonshme të tokave kafe pyjore kanë reagim neutral me tendencë aciditeti (pH 5,8-6,0), shkallë të lartë të ngopjes me alkaline (90-95%), përmbajtje të lartë të humusit, azotit (humus 12 - 14%, azotit 1,08-0,48) e kalium. Tokat pyjore kafe përmbajnë më pak fosfor krahasuar me elementët e tjerë. Tokat pyjore kafe të pangopura alkaline janë formuar nga formacionet rërore dhe argjilore. Ato kanë karakteristika të përbashkëta me tokat e zakonshme pyjore, por ndryshojnë prej tyre nga aciditeti, nga shkalla më e ulët e ngopjes me alkaline (20-25%) dhe nga përmbajtja në sasi më të vogël të humusit (6-7 %) dhe azotit (0.35 %).


Tokat e murrme pyjore (kafe-malore) Në shkëmbinj të magmatikë dhe ultra-alkalinë të rajonit tonë, janë formuar tokat ngjyrë kafe apo të zeza të Mesdheut. Në fillimet e para morfologjike, ata janë dalluar për ngjyrën e zezë, për strukturën e rëndë mekanike dhe strukturën e thyer. Ato kanë fryrje dhe tkurrje të lartë, ndërsa kanë edhe filtrim të ulët. Një tjetër karakteristikë dalluese e këtyre tokave, është përmbajtja e lartë e magnezit, në kompleksitetin e thithjen koloidale (20-25 mek/100 gr. Tokës).

Ndërtimi Gjeologjik

Në ndërtimin gjeologjik të rajonit Pogradec, marrin pjesë të tre llojet shkëmbore, sedimentarë, magmatikë dhe metamorfikë, të formuara në kohë e hapësira të ndryshme. Në kuadrin e zhvillimit dhe ndërtimit gjeologjik, pjesën më të madhe, gati 80% të sipërfaqes, të territorit të Qarkut të Korçës, e zë zona gjeologo-tektonike e facialo-strukturale e Mirditës, që nga pikëpamja e zhvillimit gjeologjik, trashëgon të gjitha karakteristikat e saj. Këto zona kontaktojnë midis tyre, me kontakte tektonike mbihipëse e mbulesorë. Në ndërtimin gjeologjik, veçohen një shumëllojshmëri e madhe shkëmbinjsh, me mosha të ndryshme formimi, duke filluar nga ato më të vjetër Silurian-Devonian, e deri në depozitimet e formimet Kuaternare të sotme (Holocen).

Magmatizmi

Formacionet magmatike janë me prejardhje mantelore në mënyrë intruzive dhe efuzive. Këto formacione kanë përhapje të madhe në teritorin e bashkisë Pogradec dhe për pjesën më të madhe



të këtij teritori ato përbëjnë bazamentin e tij, mbi të cilët pastaj vendosen formacionet e tjera gjeologjike sedimentare.

Zona Mirdita

Në territorin e bashkisë Pogradec ajo ka një përhapje mbizotëruese duke zënë mbi 95% të sipërfaqes të këtij teritori. Kjo superzonë ka ndërtim gjeomorfologjik e strukturor grabenor me vendosje në të dy anët e saj (P e L) të ofioliteve.

Shkëmbinjtë metamorfikë (μJ_2)

Në këta shkëmbinj futen shkëmbinjtë metamorfikë subofiolitikë dhe serpentinitet. Në pjesën J të masivit të Shebenik-Pogradecit takohen në trajtën e një shiriti me gjerësi 200-500m duke filluar nga Piskupati me vazhdim fragmentar në Kotodesh, Rrajcë Skënderbej e me tutje në drejtimin VVP.

Depozitimet liqenore (të plazhit) të Holocenit (lqQ_4h)


Janë depozitime bregliqenore që shtrihen gjatë gjithë bregut të Liqenit të Pogradecit dhe gjerësia e tyre shkon nga disa m në bregun abraziv deri në dhjetra m (150m në plazhin Pogradec-Tushemisht) në bregun kumulativ. Depozitimet liqenore që shtrihen për gjatë bregut abraziv të liqenit përfaqësohen nga argjilat, argjilat zhavorrore, rërat, zhuret e deri tek materiali copëzor. Gjerësia e tyre varion nga 0-20 m, trashësia shkon nga 10-ra cm në rreth 30m në pjesët qendrore të fushëzave.

Shtresat dhe përbërja e tyre

Zonat e mësipërme tektonike kontaktojnë midis tyre, me kontakte tektonike mbihipëse e mbulesore, por ato që ndikojnë më tepër në truall mbajtjen për shërbime civile janë depozitimet e kuaternarit si këto më poshtë.

Depozitimet Kuaternare (Q)

Figura 28. Hartë gjeologjike në shkallë 1: 200,000



Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Në hartën gjeologjike, dallohen nga ngjyra e verdhë në bezhë. Janë formime tipike liqenore. Nga anarfolgjike, këto depozitime përfaqësojnë zona kodrinore. Nga pikëpamja e përbërje litologjike ato përfaqësohen nga ndërthurje pakosh konglomeratesh, kongloranorësh me çimentim shumë të dobët deri të shkriçet (zhuro zhavorore) me ndryshime faciale si në trashësi dhe në shtrirje me kalime në kongloranorë të shkriçet, si dhe nivele argjilash e suargjilash apo argjilorërash. Trashësia e këtyre depozitimeve arrin 40-50 m.

Tektonika

Në kuadrin krahinor marrin pjesë, tre zona të ndryshme gjeologo-tektonike e facialo- strukturale, të cilat janë pjesë përbërëse e gjeologjisë së Shqipërisë. Ato janë: 1-zona e Mirditës, 2-zona e Krasta-Cukalit dhe 3-zona e Krujës (Grup autoresh 1999; Aliaj 1987; Tagari etj. 1993). Përhapjen më të madhe e ka zona Mirdita, që karakterizohet nga një zhvillim i fuqishëm i magmatizmit ofiolitik, si dhe i sedimenteve të fuqishme terrigjene, që mbushin ultësirat ndërmallore të territorit të këtij rajoni.

FORMACIONET LITOLOGJIKE, INKUADRIMI GJEOLGJIK I TYRE

Të përgjithshme

Në territorin e bashkisë Pogradec, gjejnë përhapje shkëmbinj dhe dhera me litologji të ndryshme, të moshave nga Triasiku e deri në Kuarternar. Këto shkëmbinj dhe dhera i përkasin zonave tektoniko- faciale të “Mirditës”, “Krasta-Cukalit” dhe Kruja. Për qëllime gjeologo-inxhinierike, në kemi bërë një rivlerësim dhe rigrupim të kufijve moshore litostratigrafike, kriteri vlerësues i së cilit ka qënë evidentimi i përbërjeve litologjike me veti të përafërta gjeoteknike dhe sjellje afërsisht të njëjtë ndaj strukturave inxhinierike. Në territorin e bashkisë, në sipërfaqe shfaqen shkëmbinj rrënjësorë si dhe dhera të Kuarternarit të tipit mbulesor. Shkëmbinjtë ndahen në tre grupe:

- 1- Shkëmbinj të fortë
- 2- Shkëmbinj mesatare
- 3- Shkëmbinj të butë


Kushtet geomorfologjike

Për lehtësi vlerësimi të gjithë territorin e Bashkisë e kemi ndarë në 3 njësi kryesore morfologjike: Njësia morfologjike fushore, Njësia morfologjike kodrinore, Njësia morfologjike malore

1-Njësia morfologjike fushore

Gropa e Pogradecit, zë pjesën jugore e jugperëndimore të gropës së Ohrit. Përfshin fushën e Buçimasit dhe rripin bregliqenor perëndimor, që në veri, në fushën e Linit, dhe shkon deri në kufirin shtetëror. Rrjeti hidrografik përbëhet nga disa përrenj të vegjël që derdhen në liqenin e Ohrit dhe nga burimet e shumta karstike të Drilonit, Tushemishtit, Linit, Jabllanicës. Kjo njësi përmban shumicën e ndërtimeve të kryera në rang Bashkie. Në të gjenden qytetet i Pogradecit, si dhe një shumicë e madhe qëndrash të banuara turistike si Tushemishti, Buçimasi, Piskupati, Lini. Po ashtu në të janë ndërtuar rrugët kryesore dhe hekurudhat. Në vetvete kjo është njësia më perspektivë për zhvillimin e ndërtimeve në të ardhmen.

Figura 29. Harta Gjeologo-Inxhinierike Pogradeç



Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

2 –Njësia morfologjike kodrinore zhvillohet në rrethinat e zonës fushore dhe qendër të territorit të Bashkisë, në luginën e lumit Shkumbin, në zonën e Mokrës etj. Në vartësi të strukturave gjeologjike ku ato gjenden, shfaqen edhe forma relievi tipike, si p.sh. relievet kodrinore të strukturave monoklinale dhe relievet kodrinore të strukturave të rrudhosura. Shpatet e kodrave e kodrinave të kësaj njësie morfologjike, kanë pjerrësi nga 5 deri në 35⁰ dhe drejtime rënie të ndryshueshme. Në të shumtën e rasteve këto kodra janë të mbjella me pemë frutore, por nuk përjashtohen rastet edhe kur ato përmbajnë pyjet natyrale. Është pikërisht kjo njësi morfologjike e prekur së tepërmi nga erozioni dhe fenomene shpati të tipit rrëshqitje të dherave dhe të Shkëmbinjve. Në lidhje me ndërtime, kjo njësi morfologjike është tepër e lakmueshme, sepse ato janë ballkone natyrore me pamje piktoreske si në drejtim të fushave dhe qëndrave të banuara kryesore të Bashkisë.


3-Njësia morfologjike malore zë pjesën qëndërlindore dhe perëndimore të territorit të Bashkisë. Ajo gjen përhapje që nga shpatet malore të Malit të Thatë, në pjesën lindore dhe në malësinë e Velçanit, në perëndim të territorit të bashkisë. Kuotat e kësaj njësie variojnë nga 1000 deri në 2288 m.n.d., e cila gjendet në majën “Pllaja e Pusit” të malit Thatë dhe që përfaqëson kuotën më të lartë të Bashkisë Pogradec. Format morfologjike të kësaj njësie varen shumë nga përbërja litologjike e shkëmbinjve rrënjësorë dhe në përgjithësi janë të dy llojeve: forma morfologjike të përcaktuara nga shkëputjet tektonike dhe format morfologjike karstike.

Zonimi i territorit mbi bazën e kushteve gjeologo – inxhinierike

Për ndërtimin e hartës së zonimit të territorit për përshtatshmërinë ndërtuese që kanë trojet në të, janë marë në konsideratë 3 kritere:

- Kriteri litologo-gjeologo-inxhinierik
- Kriteri i ekspozimit ndaj rrezikut gjeologjik
- Kriteri morfologjik

Figura 30. Harta e Zonimit Pogradec



Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Kriteri litologo-gjeologo- inxhinierik ka qënë kriter bazë mbi të cilin është ndarë territori në zona që karakterizohen nga një farë shkalle homogjeniteti i kushteve ndërtuese të trojeve që gjenden në to. Me këtë kihet parasysh kryesisht vetitë fiziko- mekanike (*granulometria, peshat specifike, volumore dhe të skeletit, poroziteti, rezistenca, koeficientet e deformimit, përjrimi, çarshmeria, etj*), vetitë ujore (*ujëmbajtja, ujëdhënia, përshkushmëria, konsistenca, etj*) dhe shkalla e ndryshimeve që ndodhin në trojet e ndërtimit nga prezenca e ujrave. Duke u bazuar në këtë kriter, territori ndahet në 5 zona (Konomi, N. 1998, 2002):

- I. Zona e përhapjes së Shkëmbinjve të fortë, në hartë paraqitet me vija horizontale.
- II. Zona e përhapjes së Shkëmbinjve mesatarë, në hartë paraqitet me vija vertikale.
- III. Zona e përhapjes së Shkëmbinjve të dobët, në hartë paraqitet me kombinim të vijave horizontale dhe atyre vertikale.
- IV. Zona e përhapjes së dherave pa kohezion, në hartë paraqitet me vija të pjerrëta majtas.
- V. Zona e përhapjes së dherave me kohezion, në hartë paraqitet me vija të pjerrëta djathtas. Kriteri i ekspozimit ndaj rrezikut gjeologjik mund të jetë i lidhur me kriterin morfologjik, dhe lidhja e tyre është organike dhe e pandashme, ose mund të mos jetë i lidhur me të. Duke patur parasysh lidhjen ose jo të elementeve të rrezikut gjeologjik me kriterin morfologjik, elementët e rrezikut gjeologjik i kemi ndarë në dy grupe:

1) Rrezikun që vjen nga aktiviteti tektonik në rajonin e studimit, gjë që reflektohet me sasinë dhe intensitetin e tërmeteve që ndodhin në territor, pavarësisht nga kushtet gjeologo-inxhinierike të trojeve të ndërtimit. Bazuar në këtë kriter territori është ndarë në 2 nënzona:

- Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet VII ballë
- Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet VIII ballë

Në hartën e zonimit këto zona paraqiten të ndara me vija blu dhe me numra me ngjyrë blu. Për realizimin e kësaj ndarjeje janë marrë të dhënat e Hartës Sizmike të Shqipërisë me shkallë 1:250

2) Rrezikun që vjen nga fenomenet gjeodinamike të shpateve. Është gama tjetër e fenomeneve të rrezikut gjeologjik të marra në konsideratë, të cilat lidhen ngushtësisht me ndarjet e sektorëve me bazë kriterin morfologjik. Duke patur parasysh edhe shkallën e hartës 1:50 000, dhe për pasojë edhe detajimet që mundëson kjo shkallë, territori është ndarë në tre sektorë, pavarësisht ndarjes në zona dhe nënzona të përshkruara më lart. Këta sektorë janë:

a - Sektori pa zhvillim të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili përputhet me njësinë fushore. Në hartë ky sektor paraqitet me ngjyrë jeshile. Pjerrësia e trojeve të këtij sektori nuk i kalon 2⁰. Këtu futet zona fushore pranë liqenit të Pogradeci (fusha e Buçimasit), si dhe disa sektorë të vegjël në

kufirin jugor të Bashkisë. Në këtë sektor, me përjashtim të brigjeve të shtretërve aktuale të lumenjve dhe përrenjve, nuk priten as në të ardhmen zhvillime të elementeve të rrezikut gjeologjik. Për këtë arsye ai konsiderohet si një sektor i qetë dhe jo kërcënues ndaj ndërtimeve që kryhen në të. Studimet gjeologo – inxhinierike që kryhen për ndërtimet e këtij sektori, duhet të jenë të thjeshta dhe të marin në konsideratë vlerësimin e parametrave gjeoteknikë të shtresave të tokës.

b - Sektori me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili i përket njësisë kodrinore dhe malore, por që në të nuk gjejnë përhapje të madhe fenomenet e rrezikut gjeologjik. Në hartë ky sektor paraqitet me ngjyrë të verdhë, duke zënë pjesën më të madhe të territorit të Bashkisë. Ndërtimet që bëhen në këtë sektor për momentin janë të pa cënuara, por që në të ardhmen, si rezultat i prishjes së ekuilibrit të shpatit, apo avancimit të zonave nën erozion, pjesë të këtij sektori mund të klasifikohen si sektori me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik. Studimet gjeologo- inxhinierike që kryhen për ndërtimet e këtij sektori, përveç vlerësimit të parametrave gjeoteknikë të shtresave të tokës, duhet të japi të dhëna të plota për fenomenet e rrezikut gjeologjik që mund t'i kërcënojë këto ndërtime, si dhe të rekomandojë edhe masat mbrojtëse përkatëse, me qëllim eliminimin apo mosaktivizimin e fenomeneve të rrezikut.

c - Sektori me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili i përket njësisë kodrinore dhe malore, por që në të gjejnë përhapje të madhe fenomenet e rrezikut gjeologjik. Në hartë ky sektor paraqitet me ngjyrë të kuqe. Në hartë, pjesë e këtij sektori, janë konturuar sipërfaqet e rrëshqitjeve të ndodhura e të njohura deri tani, zonat e shembjeve (subsidence) në fushat minerare të shfrytëzuara, si dhe sipërfaqet e zonave nën erozion. Duke patur parasysh dinamikën e shpateve, ky sektor tenton të rritet dhe të fitojë sipërfaqe të reja nga sektori b (*Sektori me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, me ngjyrë të verdhë*). Në këta sektorë parimi i përgjithshëm është se nuk duhet të ndërtohet, por nëse është e nevojshme, atëherë studimi gjeologo – inxhinierik duhet të jetë shumë i thelluar, ku të jepen të dhëna për atë çka ka ndodhur dhe të llogariten mirë efikasiteti i masave mbrojtëse që mund të rekomandohen.

Veprimtarite Sizmike dhe veçoritë e tërmeteve

Nga pikëpamja tektonike kemi të bëjmë me zonë tektono-strukturore Gropa e Pogradecit. Rajoni në studim preket nga forcat tektonike orogjenike. Shkëputjet tektonike janë shumë aktive, dhe në relief shprehen me kontraste të theksuara. Pasojë e tyre janë dhe lëvizjet e shpeshta sizmike, që trondisin zonën. Si pjesë përbërëse e një strukture neogenike në zhvillim, zona në studim preket nga forcat tektonike orogjenike dhe sidomos nga ato neotektonike. Epiqendrat e tërmeteve përqëndrohen kryesisht gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive.


AKTIVITETI SIZMIK

Të dhënat historike për aktivitetin sizmik, janë relativisht të mangëta. Rajoni është prekur nga tërmete historike me intensitet deri në 8 ballë (MSK-64) dhe gjatë shekullit të kaluar, nga tërmete me magnitudë 5.3 deri 5.6. Nisur nga kërkesat e kohës, janë ndërtuar edhe harta të shpejtimeve

maksimale reference të trojeve. E tillë është edhe harta e paraqitur më poshtë, e përpiluar në vitin 2003 në kuadër të projektit “Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri” – PNUD.

Nisur nga aktiviteti sizmik historik, ndërtimi gjeologjik si dhe nga studimet e lartpërmendura, mund të thuhet se rajoni ndodhet në një zonë aktive nga pikëpamja sizmike.


Figura 31. Harta Sizmike



Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

4.3 Burimet Ujore


Figura 32. Hidrografia




Burimi: IDRA, 2015

Në bashkinë e Pogradecit ka përhapjen e akuiferëve të llojeve të ndryshme. Sipërfaqen më të madhe në shkallë Bashkie e zënë akuiferët poro-çarje me ujëmbajtje mesatare deri të ulët të cilët shtrihen në dy krahët e lumit Shkumbin dhe zënë rreth 46% të gjithë sipërfaqes së tij. Akuiferi karbonatik karstik zënë rreth 18 % të gjithë sipërfaqes së tij. Ato ndërtojnë pjesët më të larta malore si mali i Thatë etj. Akuiferët karbonatikë karstikë përmbajnë resurse ujore nënëtokësore shumë të mëdha dhe kryesorët për furnizimin me ujë të territorit të bashkisë. Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor, kanë përfajje shumë të vogël dhe të kufizuar në bashkinë e Pogradecit dhe shtrihen në zonat fushore pranë liqenit. Ky akuifer zënë rreth 5% të territorit të bashkisë dhe shtrihet në zonën Buçimas-Pogradec dhe nuk paraqesin interes për furnizim me ujë. Akuiferi jo pak i rëndësishem është edhe akuiferi me porozitet çarjeve me ujëmbajtje mesatare deri të ulët. Ky akuifer zënë një sipërfaqe rreth 12% të territorit të bashkisë dhe shtrihet në pjesën perendimore të liqenit të Ohrit. Në figurën më poshtë jepen sipërfaqet e tipeve të ndryshme të akuiferëve për bashkinë e Pogradecit.

Figura 33. Sipërfaqet e akuiferëve sipas llojeve



Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
Figura 34. Akuiferët



Burimi: Shërbimi Gjeologjik shqiptar

Ndër akuiferët më të rëndësishëm mund të përmendim: Akuiferi karstik Mali i Thatë, Gorë – Mokër, burimi i Tushemishtit dhe Akuiferi karstik Çervenakë dhe Qafë-Thanës

Burimi i Tushemishtit shërben për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit të Pogradecit. Nga burimet karstike furnizohen gjithashtu, fshatrat Çërravë, Buçimas, Lin e shumë të tjerë. Nga akuiferët e tjerë furnizohen me ujë disa fshatra të vegjël si dhe familjarë në mënyrë private. Në këto akuiferë janë kryer edhe një numër i konsiderueshëm shpimesh që shfrytëzohen nga persona privatë. Sasitë e tyre nuk janë të evidentuara. Resurset ujore shfrytëzohen gjerësisht dhe në bujqësi për vaditje.

Vlerësimi i resurseve ujore për akuiferët është mbështetur në resurset dinamike të cilat i kemi vlerësuar në bazë të burimeve që ato drenojnë në sipërfaqe për akuiferët me çarje, çarje-karst dhe poro-çarje. Në tabelën vijuese Nr.III.2 po japim resurset dinamike të ujërave nëntokësore në akuiferët kryesorë të bashkisë Pogradec dhe përdorimin e tyre. Resurset dinamike të UN dhe përdorimi i tyre për furnizim me ujë të pijshëm.

Tabela 6. Akuiferet e Pogradecit

Akuiferi	Resurset dinamike të UN, m ³ /s	Shfrytëzimi i UN, m ³ /s	Përdorimi
Akuiferi i poroz i Pogradec	0.05	0.02	Për ujë komunal
Akuiferi poro-çarje i Gorë-Mokër	0.07	0.07	Furnizim me ujë të pijshëm
Akuiferi çarjesh	0.1	0.1	Furnizim me ujë të pijshëm
Akuiferi karstik i Mali i Thatë-Rakickë	3.15	0.5	Furnizim me ujë të pijshëm
Jo akuifere	0.07	0.05	Furnizim me ujë të pijshëm
Shuma	3.44	0.74	

Figura 35. Volorekë, zona e drenimit dhe Zaveri, Prespa e Madhe



Ujërat sipërfaqësore

Lumenjtë

Arteriet lumore kryesore, të bashkisë Pogradec janë: 1-Lumi i Shkumbinit që buron nga malësitë e Vallamarës dhe përshkon krahinën e Mokrës me të cilin në teritorin e bashkisë Pogradec bashkohen lumi i Llëngës, i Bishnicës, i Dushës, i Radicinës dhe dhjetra përrenj me burime në të dyja anët e luginës së tij; 2- Lumi i Çërravës; 3- Lumi i Drilonit; 4- Lumi i Rëmenjit; 5- Lumi i Vërdovës; 6- Lumi i Qytetit dhe 7- Lumi Tërhanit.

Liqenet

Në teritorin e bashkisë Pogradec liqenet, kanë vlera të veçanta nga lloji dhe origjina e tyre. Liqenet që ndodhen në këtë teritor janë^x: Liqeni i Ohrit (Pogradecit), Liqeni i Madh, Liqeni i Lukovës, Liqeni i Llëngës, Liqenet e Gur Topit.

Liqeni i Ohrit është formuar në periudhën e Pliocenit, me moshë 2-4 milionë vjeçare, duke u futur ndër katër liqenet me të vjetër të botës. Vendoset në lartësinë 695m mbi nivelin e detit me thellësinë mesatare 145m dhe atë maksimale që arrin 289m. Furnizimi kryesor me ujë i liqenit bëhet nëpërmjet rrugëve nëntokësore nga liqeni i Prespës, i vendosur 157m me lart, që dalin pranë bregut Shën Naum-Drilon me prurje të përgjithshme 15m³/sek. Rreth 26% e ujrave vijnë në liqen nga lumenjtë e përrenjtë që derdhen në të.

Në vitin 1999, me një vendim të Këshillit të Ministrave, pellgu ujëmbledhës i Liqenit të Pogradecit merr statusin e zonës së mbrojtur. Në liqen, rriten 40 specie të rralla, ndër më të njohurat dhe ekonomkisht më të rëndësishmet është peshku i pastër i llojit *Salmo letnica*(Korani) dhe *Salmothimus ohridanus* (Belushka). Nentor 1979 pjesa maqedone e liqenit te Ohrit eshte shpallur trashegimi natyrore boterore, (CC-79/CONF.003 /13 Paris, 30 November 1979), dhe ne Shtator te vitit 1980 qyteti i Ohrit dhe pjesa maqedone e basenit te tij jane shpalluar trashegimi kulturore boterore, (CC-80/CONF.016/10 Paris, 29 September 1980), nga UNESCO.

Liqenet e Lukovës - Liqenet e Lukovës gjenden në shpatin lindor të Malit të Gurit të Topit, në afërsi të fshatit Bishnicë të ish Komunës Velçan të Bashkisë së Pogradecit, rreth 80 km nga qyteti i Pogradecit, në lartësitë 1700m dhe 2027m mbi nivelin e detit. Janë dy liqene akullnajorë (Liqeni i Vogël dhe Liqeni i Madh).

4.4 Pasurite Minerale MINERALET METALORE


Boksitet

Boksitet në bashkinë Pogradec vendosen në gropat karstike të krijuara nga qarkullimi i ujerave sipërfaqësore në kohëra të gjata gjeologjike dhe me pas të mbushura me mineral boksiti. Ndër objektet kryesore përmendim:

Objekti Krasta e Blacës - Mineralizimi boksitik është i tipit hekuror dhe mbush gropat karstike të gëlqerorëve të Triasit, vargmali i malit të thatë nga Çërrava deri në afërsi të Pojanit të Korçës. Përmbajtja e Al_2O_3 shkon nga 22-24% dhe FeO shkon në 23,21%. SiO_2 - luhatet deri 27.5%.

Objekti Saselishtë - Mineralizimi boksitik është i tipit hekuror dhe mbush gropat karstike të gëlqerorëve të kretakut. Përmbajtja e Al_2O_3 shkon nga 43.06% dhe Fe_2O_3 shkon në 23,68%. SiO_2 - luhatet deri 9.73%. Morfologjia e trupave është linzore, dardhore sipas morfologjisë së gropës karstike. Në përgjithësi dominon ajo linzore. Boksitet janë lëndë e parë për prodhimin e aluminit, kur moduli Al_2O_3/SiO_2 shkon nga 3-4%.

Figura 36. Harta e burimeve metalore



Minerali Bakër

Në bashkinë e Pogradecit kemi vetëm shfaqjen sulfurore të bakrit në objektin “Guri i Topit” qëndodhet në kufi me bashkinë e Gramshit. Këto sulfure janë të tipit kuarc-pirit dhe përgjithësisht vendosen në afërsi të kontaktit të shkëmbinjve ultrabazikë me ato vullkanogjene.

Vendburimet e Hekur-Nikelit

Vendburimet e hekur-Nikelit në bashkinë Pogradec i përkasin tipit lateritik të ngelura në vend ose pak të transportuara. Një pjesë e mirë e këtyre vendburimeve kanë qenë në shfrytëzim deri në vitet 1990. Në mënyrë të shkurtuar po përshkruajmë vendburimet si më poshtë:

Vendburimi Guri i Kuq

I përket bashkisë së Pogradecit dhe është vendburimi kryesor në këtë rajon. Në bazë të analizave të kryera rezulton se përqindja e Ni luhartet nga 0.97-1% dhe FeO=48.7%. Mosha mineralizimit është para kretakut. Rezervat në gjendje janë: Q = 53.077.063 ton.

Vendburimi Guri i Përgjegjur - I përket bashkisë të Pogradecit. Rezervat në gjendje janë: Q = 1 401 754 ton.

Vendburimi Çervenakë - I përket bashkisë të Pogradecit. Në bazë të analizave të kryera rezulton se përqindja e Ni luhartet nga 0.95% dhe FeO = 44.5%. Mosha mineralizimit është para kretakut. Rezervat në gjendje janë: Q = 5 108 981 ton.

Vendburimi Gradishtë - Në baze të analizave të kryera rezulton se përqindja e Ni luhartet në 0.69% dhe FeO=45.7%. Mosha mineralizimit është para kretakut. Rezervat në gjendje janë: Q = 245 000 ton.

Vendburimi Rodokal - I përket bashkisë të Pogradecit Korja e prishjes ka një zhvillim normal si në sipërfaqe dhe në thellësi. Në bazë të analizave të kryera rezulton se përqindja e Ni luhartet në 1.07% dhe FeO-45-50%. Mosha mineralizimit është para kretakut. Rezervat në gjendje janë: Q=714 066 ton.

Vendburimi Debrovë - Vendburimi është i tipit të ridepozituar dhe vendoset mbi një bazament karbonatik Rezervat në gjendje janë: Q = 3 850 000 ton.

Konkluzione

Rezervat e Fe-Ni në bashkinë e Pogradecit janë të konsiderueshme, të shfrytëzuara dhe të përdorura deri në vitet 1992 për nevoja të kombinatit metalurgjik Elbasan. Tani shfrytëzohen vetëm 3% e tyre me karrierë pasi çmimi i tregut është i ulët dhe nuk lejon shfrytëzimin nga nëntoka.

Minerali i kromit

Vendburimi Pojskë - Është vendburimi më i madh në bashkinë Pogradec. Vendburim me rezerva të konsiderueshme për shfrytëzim, nuk jep ndikime në mjedis gjatë shfrytëzimit pasi punimet kryhen nga nëntoka. Sot ai shfrytëzohet nga subjekt privat.

Objekti Mëmlisht 4 - Është objekt pranë fshatit Mëmlisht të bashkisë Pogradec. Vendburimi është zbuluar në vitet 1980-1987 dhe vënë në shfrytëzim pas viteve 1996. Gjendja aktuale: Në aktivitet shfrytëzimi nga subjekt privat.

Objekti Pojska Perëndimore - Është një objekt pranë Pojskës të bashkisë Pogradec. Vendburimi është zbuluar në vitet 1980-1987 dhe nuk është vënë në shfrytëzim.

Objekti Gjordukë - Është një objekt në afërsi të Çervenakës të bashkisë së Pogradecit. Vendburimi është zbuluar në vitet 1980 dhe nuk është vënë në shfrytëzim pas viteve 1990. Rezerva të zbuluara deri në 14.7 mijë ton. Të mbetura pas shfrytëzimit 5 mijë ton (C_1 -2000: C_2 -3000) me përmbajtje mesatare të $Cr_2O_3=33\%$.

Objekti Bregu i Pishës - Është një objekt në afërsi të Vendburimit të Pojskës të bashkisë së Pogradecit. Rezerva të zbuluara deri në 10.4 mijë ton. Të mbetura pas shfrytëzimit 9 mijë ton (C_1 - 7000: C_2 -2000) me përmbajtje mesatare të Cr_2O_3 - 43%.

Objekti Hija e Zezë - Është objekt në afërsi të Vendburimit të Pojskës, bashkisë Pogradec. Objekti është zbuluar në vitet 1996-1998 dhe është vënë në shfrytëzim pas viteve 2005. Rezerva të zbuluara deri në 4.7 mijë ton. Të mbetura pas shfrytëzimit 4 mijë ton (C_1 -3000: C_2 -1000) me përmbajtje mesatare të Cr_2O_3 - 42%.

Objekti Guri i Pëllumbit - Është objekt në afërsi të fshatit Rodokal të bashkisë së Pogradecit. Objekti është zbuluar në vitet 1980-1985 dhe është vënë në shfrytëzim pas viteve 2005. Vendburim me krom të pasur që duhet kërkuar në drejtim të JL, sipas planit të zhytjes

Objekti Masha e Kolnekut - Është objekt në afërsi të fshatit Rodokal të bashkisë së Pogradecit. Objekti është zbuluar në vitet 1980-1985 dhe nuk është vënë në shfrytëzim. E lidhur me rrugë auto. Vendburim me krom të varfër që duhet kërkuar në drejtim të JL, sipas planit të zhytjes.

Objekti Bregu i Tollovicës - Është objekt në afërsi të fshatit Rodokal të bashkisë së Pogradecit. Objekti është zbuluar në vitet 1980-1985 dhe nuk është vënë në shfrytëzim. E lidhur me rrugë auto. Vendburim me krom të varfër që duhet kërkuar në drejtim të JL, sipas planit të zhytjes. (Dhima, K., etj. Viti 1998).

Objekti Çervenaka Perëndimore - Është objekt në afërsi të Minierës së Fe-Ni Çervanakë të bashkisë Pogradec. Objekti është zbuluar në vitet 1980-1985 dhe nuk është vënë në shfrytëzim pas viteve 90.

Objekti Çervenaka - Është objekt në afërsi të Minierës së Fe-Ni Çervanakë të bashkisë Pogradec. Objekti është zbuluar në vitet 1980-1985. Vendburim me krom të varfër që duhet kërkuar sipas zhvillimit të duniteve.

MINERALET JOMETALORË (MINERALET DHE SHKËMBINJTË INDUSTRIALË)

Argjilat

Argjilat në bashkinë e Pogradecit kanë një përhapje të konsiderueshme. I përkasin tipit lagunor, lagunore-ndërmallore si dhe liqenor-detar.

Vendburimi i argjilave Alarup - Ndodhet në Bashkinë e Pogradecit në afërsi të fshatit Alarup nga ku ka marre emrin dhe vendburimi. Janë disa dalje të cilat janë emërtuar Alarupi-1; Alarupi-2; Alarupi-3; Alarupi-4. Argjilat kanë trashësi të konsiderueshme, ngjyre gri në të kuqërremtë nga prania e hekurit.

Vendburimi i argjilave Zdërvaskë

Ndodhet në rajonin e Pogradecit në afërsi të fshatit Zdërvaskë nga ku marrë emrin dhe vendburimi. Argjilat janë të tipit lagunor me larmi ngjyrash nga prania e hekurit, trashësi të konsiderueshme. Përbërja kimike e tyre është: $\text{SiO}_2=57\%$; $\text{Al}_2\text{O}_3=23,89\%$; $\text{Fe}_2\text{O}_3= 3.6\%$; $\text{CaO}=2,0$. Rezervat mbi 100 mijë ton.

Kuarci dhe rërat kuarcore

Zajet kuarcore Çërravë- Peshkëpi - Natyra e zajeve është konglomeratike, ku brenda konglomerateve takohen mjaft zaje me kuarc të pasur. Rezervat janë mbi 2 milion ton në gjithë zonën Çërravë- Peshkëpi. Perspektiva për të ardhmen: Zajet e kuarcit kur janë të cilësisë mbi 96 janë përdorur në industrinë e porcelanit. (Kadilli, B., etj. Viti 1976).

Rërat kuarcore Alarup-Peshkëpi - Vendndodhja administrative: Bashkia Pogradec. Fshati Alarup-Peshkëpi. Depozitime tipike aluviale të kuaternarit të vendosura në gropat ndërmallore. Burimi i ushqimit vjen nga masivi i Vardarit.

Gëlqerorët

Gëlqerorët zënë sipërfaqe të konsiderueshme në bashkinë e Pogradecit. Një pjesë e mirë e tyre janë studiuar për tu përdorur si material ndërtimi dhe një pjesë për veti dekorative. Mun të përmenden këtu Vendburimi Gurras, zona e Tushemishtit dhe vendburimin Gradishtë - Saselishtë

Gurët dekorativë

Gëlqerorët zënë sipërfaqe të konsiderueshme në bashkinë e Pogradecit. Një pjesë e mirë e tyre janë studiuar për tu përdorur si material ndërtimi dhe një pjesë për veti dekorative. Ndër to mund të përmendim vendburimin e Linit i cili ndodhet 1 km larg fshatit Lin. Gurët e këtij vendburimi janë gëlqerorë të mermerizuar. Vendburimi ka rezerva të konsiderueshme mbi $700,000 \text{ m}^3$ dhe perspektiva është e hapur për rëndësinë që kanë për përdorim në fushën e ndërtimit.

LËNDËT E PARA ENERGJETIKE

Qymyret - Qymyrbajtja e bashkisë së Pogradecit, lidhet me depozitimet molasike të ultësirave të mbivendosura mbi zonat e brendshme dhe ato të jashtme si dhe janë të moshave të ndyrshme.

Në rajonin e bashkisë Pogradec bëjnë pjesë disa vendburime të rëndësishme të qymyrit të cilat një pjesë e mirë e tyre janë shfrytëzuar pjesërisht duke plotësuar nevojat ekonomike të kohës Mund të përmendim këtu: Vendburimi i qymyreve Velçan (i Mokrës), vendburimi Dardhas – Vërdovë, vendburimi Grunjas, Malinë, Potkozhan, Qafëpanjë – Llëngë.

Vendburimi i qymyreve Petrushë-Leshnicë-Stropckë është një nga vendburimet më të rëndësishëm në bashki. Vendburimi ndodhet rreth 14 km larg qytetit të Pogradecit, afër fshatit Leshnicë. Duke qenë se është punuar edhe më parë me punime shfrytëzimi në minierën e Petrushës infrastruktura është e ngritur, me rrugë të asfaltuar (nacionale), ujë, energji elektrike, ndërtesa definitive tullë, etj. çka lejon fillimet e punës pa shumë shpenzime paraprake.

Nafta dhe gazi

Mbi studjshmërinë dhe rëndësinë e kërkimit për gaz në territorin e bashkisë Pogradec Territori i bashkisë Pogradec është shumë pak i studjuar në drejtim të kërkimit për naftë dhe gaz.

4.5 Pyjet


Figura 37. Harta e shpërndarjes së pyjeve në rajonin e Pogradecit



Burimi: Bashkia Pogradec dhe IDRA, 2016

Një vlerë të jashtëzakonshme pyjet kanë në pasurimin e ajrit me oksigjen duke kryer funksionin e mushkërive të jetës në tokë nëpërmjet procesit të absorbimit të gazit karbonik dhe çlirimit të oksigjenit. Ato shërbejnë si ambient çlodhës dhe qetësues për njeriun. Pyjet janë streha dhe ushqim për pjesën më të madhe të faunës. Prodhimi drusor zë një vend të rëndësishëm në aktivitetin ekonomik të njeriut si lëndë djegëse dhe prodhim të lëndës drusore për industrinë, por shfrytëzimi i tyre duhet të jetë racional. Po t'i referohemi të dhënave statistikore të inventarit kombëtar të pyjeve në letër, fondi pyjor dhe kullësor zë sot rreth 62% të sipërfaqes së Shqipërisë (1.5 mln ha pyje dhe 480 mijë ha kullota, (sipas inventarit me të fundit, 2004), nga të cilat 36% janë pyje, 18% kullota dhe 8% sipërfaqe me bimësi pyjore, djerr e inproduktive, dhe nëse do të ishin vërtetë të tilla në sipërfaqe dhe vëllim do të përbënin një pasuri të madhe kombëtare në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit, sidomos atij rural.


Figura 38. Harta e pyjeve dhe kullotave te komunes Proptisht



Burimi: Bashkia Pogradec

Gjatë tranzicionit u pre në mënyrë të parestaurueshme dhe 100 mijë ha, ku nuk u kursyen dhe drurët e mbjellë anës rrugëve auto-nacionale e sekondare në rreth 150km linear, ku ende s'janë ripyllëzuar dhe janë një dëshmi e vandalizmës sonë. Dhe u degraduan mijëra ha të tjerë apo u kthyen në shkurre e toka djerrë, shumica e të cilave janë ende të parestauruara. Janë dëmtuar rëndë dhe janë në gjendje të shkatërruar zonat që janë biokorridore të rëndësisë ndërkombëtare si masivi PK-Lurë, Dajt-Bizë-Martanesh, Bozdovec, Gërmenj-Shelegur, riviera bredgdetare dhe u pre në shumica e kurorave të qyteteve. Efektiviteti i dhënies së pyjeve njesive administrative. Në këtë gjendje, mbasi Qeveria me justifikimin se s'mund t'i qeverisë dot pyjet me miratim të KM pas v. 2005 gjeti "zgjidhjen" në formën më të papërshtatëshme dhe ju dhanë 50% (750,000ha) e pyjeve dhe kullotave komunave pa administratën teknike-menaxhuese.

Figura 39. Harta e gjendjes ekzistuese e njësisë administrative Buçimas



Burimi: Bashkia Pogradec

Por, pa administratën menaxhuese, këto pyje janë sot *res nullius* (pronë e askujt), të parregjistruara nga komunat dhe “të bëra dalje” nga shteti, dhe kur në shumicën e komunave të vendit nuk janë ndarë përfundimisht kufijtë administrativ dhe ka mbivendosje të sipërfaqeve dhe këto pyje kanë mbetur ende tparregjistruar prej tyre dhe kjo u bë që në fillim e pamenduar dhe në kushtet kur komunat tona kanë mungesën e kapaciteteve të tyre njerëzore dhe financiare. Dhe këto pyje sot janë në mëshirë të fatit pa administratë mbarështuese lokale dhe 50% e zjarreve kanë qenë në këto pyje.

Pyjet dhe vlerat e tjera të lidhura me të në shifra

- sipërfaqja e rrethit:
- 101,130 ha fondi pyjor
- 82,530ha fondi kullësor
- 3,009ha sip. Bujqësore
- 8,720 ha të tjera
- 6,901 ha monumente të natyrës,
- drurë të veçuar është
- 18 copë
- rrëshirë
- 10.000 ton blegtori
- 2,861krerë bimë mjekësore
- 150ton bimë eterovajor

Pyjet dhe kullotat, pasuria në shkatërrim e njësisive administrative të bashkisë Pogradec

Shfrytëzimi i kullotave bëhet në mënyrë individuale dhe janë kryesisht verore. Gjendja e tyre paraqitet e mirë. Këto kullota kanë pejzazhe të përshtatshme për zhvillimin e turizmit malor. Administrimi i pyjeve komunale bëhet nga zyra e shërbimeve pyjore në komunë. Aktualisht ekziston edhe një plan mbarështimi, i cili planifikon politikat dhe punimet për administrimin e pyjeve për një periudhë 10 vjeçare. Mbledhja e produkteve pyjore bëhet në mënyrë vetjake nga banorët pasi mungojnë pikat e grumbullimit në territorin tonë. Deri më tani nuk ka dëmtime serioze në pyllin komunal. Ndërsa, rënie zjarri ka pasur vetëm në vitin 2007. Gjendja e menaxhimit të pyjeve dhe turizmi në rajonin e Korçës paraqitet në zhvillim e sipër. Përveç bukurisë natyrore e larmisë së florës që kanë kullotat, ato shërbejnë si burim ushqimi për blegtorinë. Shpesh herë mbështetur nga tradita, bëhet djegia e kullotave me qëllim përmirësimin e tyre. Kjo metodë është e gabuar, pasi nga djegia e tyre jo vetëm që nuk bëhet përmirësimi i tyre, por dëmtohet flora ekzistuese dhe vitin pasardhës, sipërfaqja e djegur dominohet nga bimët e dëmshme të kullotave. Gjithashtu, djegia e kullotave përbën rrezik për djegien e pyjeve, duke qënë se janë ngjitur njëri me tjetrin, pasi në kushte të disfavorshme zjarri depërton edhe në sipërfaqet pyjore. Djegia e kullotave krijon kushte të favorshme për shfaqjen e erozionit, veçanërisht në sipërfaqet e pjerrëta nga reshjet e rrëmbyeshme të vjeshtë

Strukturat shtetërore për mbrojtjen edhe administrimin e pyjeve

Ne Shqipëri prej vitit 1990 dhe deri në vitin 2005 pyjet ishin nën administrimin e autoritetit të Ministrisë së Bujqësisë e Ushqimit duke u perfaqësuar me një organigramë me 57 punonjës në nivelin e Drejtorisë së Përgjithshme të pyjeve dhe kullotave dhe institutit të kërkimeve pyjore, kullosore me 37 punonjës. Në vitin 2006 këto dy organizma u shpërbenë duke krijuar një drejtori teknike të re me 11 punonjës në autoritetin e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave. Në nivel lokal u mbajt strukturat me 36 drejtori të shërbimit pyjor të shpërndara në nivel rrethi. Në këtë periudhë drejtoritë e shërbimit pyjor kanë të gjitha funksionet që lidhen me menaxhimin e pyjeve, policinë pyjore ekstensionin dhe zonat e mbrojtura. Drejtoritë ishin të organizuara në sektorë e zona pyjore, specialistët kishin detyra funksionale të konkretizuara në zona pyjore për menaxhimin e mbrojtjen e tyre.

Drejtoritë e shërbimit pyjor në rrethe ishin përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve e kullotave në juridiksion të rrethit. Këto drejtori ishin të organizuara në sektore të veçantë si:

- Sektori i Administrimit Menaxhimit e shërbimi Këshillimor
- Sektori i Policisë Pyjore
- Sektori i Zonave të Mbrojtura
- Sektori i Finances dhe Marketingut

Organizimi teritorial bazohet në sektorët pyjore dhe zonat pyjore sipas madhësisë së sipërfaqes pyjore dhe kullosore. Funksionet menaxhuese në rreth bazohen në tre nivele:

- Institucioni i Drejtorit-policia pyjore
- Sektori i Menaxhimit dhe Sektorët pyjore dhe Sektorët pyjore 27 veta.

Funksionet kontrolluese realizoheshin nëpërmjet drejtorit dhe sektorit të policisë pyjore nëpër zona pyjore. Pra inspektorët e zonave kanë funksion të dyfishtë menaxhues, kontrollues e mbrojtës.

Ne çdo nivel të strukturave të shërbimit pyjor për të punësuarit nuk kanë patur sistem vlerësimi mbi performancën e tyre.

Numri i të punësuarve në administratën e pyjeve (1990 – 2010)

Nr.	Emërtimi	Viti 1990	Viti 2000	Viti 2005	2010
1	Specialistë të menaxhimit të pyjeve	583	353	313	210
2	Polici pyjore +Zm	897	897	650	635
3	Specialistë të tjerë	225	100	80	72
4	Punonjës shkencorë	21	18	12	11
5	Specialistë në komuna	0	0	0	100


Në Sektorin e Menaxhimit numri i punonjësve është zvogëluar në masën 64%, ndërsa në sektorin e policisë e Zm-zvogëluar në 29%. Shërbimet mbështetëse janë zvogëluar në 68%. Në përgjithësi numri i punonjësve në pyje është ulur në masën 46%.

Sot janë punësuar në administratën e pyjeve pranë Ministerisë së mjedisit rreth 600 punonjës, ku policia pyjore është ndarë më vete quhet “Inspektoriati i Pyjeve” dhe zonat e mbrojtura dhe pjesa e administrimit dhe menaxhimit të pyjeve e kullotave i është transferuar bashkive. Në këtë moment këto shërbime janë inactive duke mos patur asnjë efektivitet në punën e tyre.

Vlerësimi i sipërfaqes së fondit pyjor

Vlerësimi i sipërfaqes së fondit pyjor dhe kullor deri tani është i disponueshëm në qarqe dhe deri në nivelin e rrethit. Sipërfaqja e fondit pyjor duke ju referuar inventarit të pyjeve të vitit 2014 i zhvilluar në sistemin Gis, mbulon rreth 52% të sipërfaqes totale të Shqipërisë, brenda së cilës ndodhen pyjet dhe sipërfaqja e klasifikuar si toka pyjore etj.

Figura 40. Grafiku i shpërndarjes së fondit pyjor në % në Shqipëri.



Sipas të dhënave të Drejtorisë së Bujqësisë e ushqimit në Qarkun e Korçës, shpërndarja e territorit sipas kategorisë së përdorimit është më poshtë:

Emertimi	Sip. Totale ha	Sipërfaqja e kultivuar		Sipërfaqja pyjore		Kullota		Te tjera	
		ha	%	ha	%	ha	%	ha	%
Pogradeci	71541	17506	26	29581	40	6600	9	17854	25

Karshi sipërfaqes totale të bashkisë Pogradec, pyjet dhe kullotat zenë 50.5% të sipërfaqes.

Figura 41. Sipërfaqja e bashkisë Pogradec e ndarë sipas kategorive të përdorimit të teritorit





Figura 42. Shpërndarja e sipërfaqeve pyjore dhe kullordore sipas NjA



Ndarja e sipërfaqes pyjore dhe kullorore sipas kategorise se perdorimit te teritorit, qeverisjes dhe njesive te qeverisjes vendore(sipas transferimit te fundit te pyjeve dhe kullotave bashkise Pogradec).

Figura 43. Ndarja e sipërfaqeve pyjore dhe kullorore sipas kategorisë

Njesia	Pyje+	Qeverisja e pyjeve	Inpr-			
--------	-------	--------------------	-------	--	--	--

N r	Qeverisj e vendore	Kullo ta etj. ha	Pyje ha	Trungishte (Pyje larte) ha	Cungishte (Pyje ulet) ha	Shkurre ha	Kullo ta ha	dukti ve ha	Dje rra ha	Siperfaqe me bimesi pyjore ha	Ujore ha
1	Proptisht	4146	3607	41	3514	52	410	129	-	-	-
2	Velçan	7085	6101	4026	2063	12	944	28	-	-	11
3	Trebinje	7798	6407	3064	3088	255	1175	214	2	-	-
4	Dardhas	3894	3466	998	2468	-	360	48	8	12	-
Shuma:		22923	19581	8129	11133	319	2890	419	10	12	11

Pyjet dhe kullotat e bashkise duke i referuar siperfaqes së bashkisë mbulojne 32% të siperfaqes.

Figura 44. Shperndarja e sipërfaqes sipas kategorise se perdorimit te teritorit





Figura 45. Ndarja e pyjëvë sipas trajtimit



Tendencat e sipërfaqeve pyjore

Duke analizuar sensin evolutiv të llojeve pyjore të dy dekadave vihet re nje zvogëlim të siperfaqeve të llojeve halore në 3.3% dhe përhapjen e pyjeve të përzjera në 4% me dominancë llojet fletore. Ndërkohë tkurrja e sipërfaqes së pyjeve halore gjatë kësaj periudhe argumentohet me praktikat e keqmenaxhuara gjatë ndërhyrjes me teknika trajtimi dhe prerje të lejuara të gabuara pa kontroll si dhe dëmtimet e shkaktuara nga zjarret në vitet 2000-2010 e në vazhdim.

Nga vitet 1990-2015 zonat pyjore me lende drusore janë pakësuar ose pothuajse nuk ka. Gjatë viteve të fundit çdovit është humbur rreth 1.5% e siperfaqes pyjore kjo për furnizimin e popullsisë me dru

zjarri. Kjo ka rdhur si rezultat i dëmtimeve nga prerjet pa leje, zjarret si dhe ndryshimin e statusit të funksionit të pyjeve nga prodhues në funksion mbrojtës, rekreativ etj.

Shpërndarja e materialit drusor sipas ekonomive pyjore


Rritja e vëllimit dhe prodhimit të pyjeve

Vlerësimi i vëllimit të materialit drusor në rritje, të klasifikuar sipas formave menaxhuese, përberjes së llojeve pyjore dhe masës së disponibilitetit të tyre për furnizimin me produkte pyjore, është pika më themelore e informacionit për zbatimin e vlerësimin e teknikave të menaxhimit të qëndrueshmërisë të pyjeve.


Tabela 7. Shpërndarja e vëllimit të materialit drusor sipas ekonomive, bashkia Pogradec - 2014

Nr.	Ekonomia pyjore	Pjesa ekonomike	Lende+ dru zjarri m3	Ndare ne:			Dru zjarri m3	
				Trashe m3	Mesme m3	Holle m3		
1	Bishnice	Bishnice	74085	1554	12068	47533	12930	
		Talle	79291	3956	16870	38116	20349	
		U. Ftohte	184552	19633	55660	77380	31879	
		Shuma:	337928	25143	84598	163029	65158	
2	Alarup		0	10388	0	0	10388	
3	Dardhas-Pret.		0	10607	0	0	10607	
4	Derdushe		0	15271	295	280	14125	
5	Dunice-Çezme		0	38759	0	0	37509	
6	G. Pogradecit		0	20055	0	0	20055	
7	G. k.Lin		0	29369	0	0	18239	
8	G. Nikes		0	205130	17660	39464	52579	
9	Moker 1		0	114286	0	0	113389	
10	Moker 2		0	66645	0	0	66075	
11	Q. Panje		0	19609	0	0	16748	
Totali i rrethit:			0	868047	43098	124342	275735	424872

Tabela 8. Shpërndarja e vëllimeve drusore sipas ekonomive pyjore në m3



SHPERNDARJE E VOLUMEVE DRUSORE SIPAS EKONOMIVE PYJORE NE m3



Drutë e zjarrit

Nje nga prodhimet kryesore te pyllit pervec lendes se rumbullaket jane dhe drute e zjarrit qe perdoren nga popullata per ngrohje. Drutë e zjarrit vijne nga shfrytezimi i lëndës së punimit rreth 10-15%, nga ngastrat e veçanta per dru zjarri dhe si rezultat i përmirësimeve, rehabilitimit të sipërfaqeve të degraduara, rrallimet e pastrimet e pyjeve të rinj si në trungishte e cungishte. Drutë e zjarrit që vijnë si rezultat i shfrytëzimit të lëndës drusore qe sot nuk I lejon ligji I moratoriumit, kurse ngastra te vecanta per dru zjarri ne bashkinë Pogradec nuk ka, per kete arsye nga 11367m³ dru zjarri qe i nevojitet sot popullates plotesohen vetëm 37000m³ ose 30% e sasisë (duke llogaritur prerjen 3-4 me shume se rritja vjetore e pyjeve si dhe perdorimi i fashinave ne zonat qe kane pyje ne afersi dhe diferenca është 75330 m³ dru zjarri më pak per vitin 2016. Kjo diferencë do të rritet në qoftese nuk merren masa për zëvendësimin e drurëve të zjarrit me alternativa të tjera ose lënda drusore të importohet nga jashtë vendit.

Territori dhe gjendja vegetative e pyjeve dhe kullotave

Referuar vëzhgimit ne terren, gjate marrjes se te dhenave per secilen n/ngaster, konstatohet se gjendja e tyre nuk eshte e mire, per shkak te krasitjes per gjith, kullotjes pa kriter dhe mbi te gjitha per shkak te prerjes mbi mundesine vjetore te shfrytezimit. Fenomeni me negativ eshte prerja e majave te drureve, per te menguar rritjen e tyre ne lartesi dhe per te lehtesuar krasitjen e tyre. Në shumë ngastra, janë bërë prerje rrah për prodhim dru zjarri, por që nuk janë mbrojtur nga kullotja. Po ashtu janë bërë edhe punime ricungimi në pyjet e dushkut, por që nuk i është arritur qëllimit për të cilin janë kryer, sepse edhe ato nuk jane mbrojtur nga kullotja. Nje pjese e pyjeve trungishte, si te te llojit ah ashtu ndhe te llojit lis, jane te degraduar, sepse jane perdorur per krasitje. Per këto arsye, sot ka shumë sipërfaqe pyjore të degraduara, si ne pyjet trungishte dhe ne cungishte. Ne nivel fshati shperndarja e fondit pyjor e kullosor jepet ne pasqyren 1.

Tab. – 5 Funkzionet aktuale të fondit pyjor Burimi: Bashkia Pogradec

Funksioni aktual	Sipërfaqja	
	(ha)	(%)
Prodhues	2,025.8	80.3
Mbrojtës	329.9	13.1
Mbrojtës me mundësi prodhimi	166.1	6.6
Totali	2,521.8	100.0

Tab. – 6 Funkzionet e synuar të fondit pyjor - Burimi: Bashkia Pogradec

Funksioni i synuar	Sipërfaqja	
	(ha)	(%)
Prodhues	2025.8	80.3
Mbrojtës	104.1	4.1
Mbrojtës me mundësi prodhimi	391.9	15.6
Totali	2521.8	100.0

Prodhimet pyjore që përdoren zakonisht

Nder prodhimet pyjore që përdoren në mënyrë të përditshme nga banorët e fshatrave të kësaj komune janë drutë e zjarrit. Prodhime të tjera janë lënda e ndërtimit dhe gjethi për blegtorinë, përdorimi i të cilave nuk është gjithëvjetor. Për të krahasuar nevojat e banorëve për prodhime pyjore, dru zjarri dhe lëndë ndërtimi, është llogaritur mundësia vjetore e shfrytëzimit, për të gjithë sipërfaqen e pyjeve që i kalojnë komunës, por edhe për secilin fshat. Në total mundësia vjetore e shfrytëzimit të drutëve të zjarrit rezultoi 2.818 m³ dhe e lëndës së punimit 3.712 m³.

Drutë e zjarrit

Drutë e zjarrit përdoren kryesisht për gatim, ngrohje dhe larje. Ato sigurohen nga pyjet komunale dhe shtetërore. Nevojat mesatare për një familje llogariten në 10 m³/vit ose rreth 17 mst/vit.

Pyjet trungishte përbejnë 29 % të fondit total të pyjeve dhe 25 % e mundësive të shfrytëzimit të drutëve të zjarrit do të sigurohet nga këta pyje, ndërsa nga pyjet cungishte, që zënë rreth 79 % të sipërfaqes, do të sigurohen rreth 75 % e nevojave. Nevojat për dru zjarri të atyre fshatrave që nuk plotësohen nga pyjet e tyre do të marrin nga pyjet shtetëror ose nga fshatrat e tjera. Referuar mundësive vjetore të shfrytëzimit për secilin fshat, konsatohet se të gjithë fshatrat nuk i plotësojnë nevojat me dru zjarri nga pyjet komunale, por duhet të marrin edhe nga pyjet shtetërore, një sasi prej 4.255 m³. Për sa u përket lëndëve të tjera energjitike, në këto komune nuk disponohen të dhëna për përdorimin e burimeve të tjera energjitike.

Lënda e ndërtimit

Mundësia vjetore e shfrytëzimit të lëndës së punimit është 3.736 m³. Lënda e ndërtimit përdoret për ndërtimin dhe riparimin e shtëpive, stallave etj. Mesatarisht janë llogaritur rreth 1,0 m³ lëndë ndërtimi për çdo familje në vit. Nevojat përgjithësisht plotësohen nga pyjet komunale.

Figura 46. Pamje nga sipërfaqet e kullotave të Pogradecit



Plotësimi i nevojave me bazë ushqimore për blegtorinë

Për plotësimin e nevojave të blegtorisë me bazë ushqimore, përveç kulturave të ndryshme bujqësore, banorët e fshatrave të kësaj komune përdorin kullotat dhe pyjet komunale e shtetërore. Kryesisht kjo bazë ushqimore përbehet nga bari dhe gjethi.

Përveç kullotjes në periudhën e vegetacionit, pyjet, si ato të llojit lis ashtu dhe të llojit ah, tradicionalisht janë përdorur për të siguruar bazën ushqimore të blegtorisë, për periudhën e dimrit. Për këto banorët e fshatrave bëjnë krasitjen e drutëve. Gjate periudhës së tranzicionit ky proces është kryer i pa kontrolluar, duke degraduar pyjet, për shkak të krasitjes

shume te madhe dhe mbi te gjitha per shkak te prerjes se majave te dureve, per te penguar rritjen ne lartesi dhe per te lehtësuar ngjitjen e njerezve, deri afer majes, ku ndodhen deget. Sipas te dhenave te grumbulluara gjate takimeve, rezulton se nevojat per baze ushqimore per blegtorine, jane sipas vlerave te pasqyres se meposhteme dhe sigurohe si nga pyjet komunale ashtu dhe ata shtetore.

Plani i menaxhimit te pyjeve dhe kullotave, ne vartesi te gjendjes aktuale te seciles ngaster pyjore, ka parashikuar edhe krasitjen e degeve te drureve. Ne pasqyren ne vijim jepen ngastrat e planifikuara per krasitjen e degeve.

Probleme të kullotjes

Komuna Velçan ka marre ne pronesi gjithsej 440 ha kullota, nga te cilat 286 ha kullota neto dhe 154 ha kullota me drure e shkurre. Gjendja e tyre nuk eshte shume e mire per shkak te mbikullotjes dhe mungeses se investimeve per permiresimin e tyre. Per kete arsye koeficienti i ngrenshmerise, varion nga 75% deri ne 85%. Keto kullota sherbejne mesatarisht per 123 dite kullotje ne vit. Meqenese kerkesat per kullotje jane te medha, blegtoria kullotet edhe ne pyjet komunale e shtetore, nga te cilet gjithashtu sigurohet edhe baza ushqimore, per periudhen e dimrit. Krasitja e pyjeve per gjeth, ka shkaktuar degradimin e drureve, duke ulur ndjeshem rritjen e tyre.

Per sa i perket kullotjes ne pyje, gjate planifikimit te ngastrave ku ajo ka mundesi te kryhet, u morr ne konsuiderate gjendja e tyre aktuale, me synim shmangien e rrezikut te demtimit nga kullotja si dhe lloji i bagetive.

Konkrestisht kullotja e dhise eshte palnifikuar dhe rekomandohet ne ngastrat ku:

- druret dhe filizeria kane lartesi mbi 2 m;
- jane kryer punime perimresuese te pastrimit, ne vitin e dyte pas kryerjes se tyre, meqenese ka mbirje te llastareve te rinj, pa te ardhmen, qe konsumojne lende ushqyese ne dem te fidave kryesore;
- mosha e grumbujve duhet te jete mbi 6 vjeçare dhe kuroredendesi nen 0,7, pa perjashtuar edhe ato mbi kete nivel.

Kullotja e deleve rekomandohet ne ngastrat ku:

- druret dhe filizet kane lartesine mbi 1,5 m;
- kuroredendesia e grumbullit te jete nen 0,6, sepse bimesia, per shkak te dritesimit te tyre, rezulton e bolleshme.

Kullotja nuk duhet te lejohet ne ngastrat e ricinguara, per nje periudhe 5 vjeçare, ku jane kryer pyllzime dhe per dhente ne periudhen me lageshti shume te madhe, per te mos mundesuar krijimin e rrekeve te ujit gjate kalimit te tyre, pasi dihet se ato kalojne njera pas tjetres. Per secilin fshat jane planifikuar ngastrat pyjore ku rekomandohet kullotja e blegtorise. MJEDISI EKOLOGJIK

Vegjetacioni dhe biodiversiteti

Karakteristikat kryesore te kesaj zone per sa i perket relievit eshte ekzistenca e nje rrjeti te dendur hidrografik, me peroska e perrenj, kulme e shpate me kundrejtime te ndryshme ku dominon kundrejtimi lindor dhe ai verior. Kjo gje ka sjelle krijimin e shume habitateve dhe mikrohabiteteve te larmishme natyrore, me nje biodiversitet shume te pasur. Kuota me e ulet mbi nivelin e detit eshte pika e bashkimit te perroit te Llokfishtit (kufi Slabinjen) me lumin shkumbin, me 550m, ndersa kuota me e larte eshte maja e Qysakut me 1726m. Pjerresia e terrenit varion nga pjerresia 10-15% deri ne gremina, si Shkemb i Losnikut, Shkemb i Qytetit, Maja e Strehave, Guri i Kuq etj. Por pjerresia mesatare varion nga 30-40%

Tipet aktuale të pyjeve dhe potenciali natyror

Pershkrimi i pyllit si pjese e planit te mbareshtimitdhe i kullotes eshte bere per cdo ngaster te dhene ne perdorim. Pyjet ne pjesen me te madhe jane larg fshatit ku jane vene ne perdorim individual dhe te perbashket. Sic kemi permendur dhe me súper, siperfaqe e fondit pyjor dhe kullosor te komunes eshte 2919 ha nga te cilat pyje gjithesej 2453.2 ha te cilat perbejne nje volum total prej 121654.5m³ e cila eshte e ndare ne lende punimi 64877m³ dhe dru zjarri 56777m³.

Tipet e grumbullit pyjor

Formacionet me te perhapura dhe qe jane formacione baze dhe shtrihen ne ekonomite pyjore të bashkisë Pogradec janë:

- 1-Formacioni i ahishteve (*Fagus silvatica*) me *Abies Boriss regia*-(Bredhi maqedonise) në gëlqerore.
- 2-Formacioni pyjor i ahut (*Fagus silvatica*) me *Abies alba*(Bredhin e Bardhe) në shkëmbij gëlqerorë.
- 3-Formacioni pyjor *Quercus petrea* me *Carpinus betulus*, Qarri(*Quercus cerris*) me mellezen (*Ostria carpinifolia*)
- 4-Formacioni pyjor i Geshtenjes (*Castanea sativa*) me *Quercus petrea* në shkëmbij silicore.
- 5-Formacioni pyjor *Pinus nigra* (Pisha e zeze) me *Abies alba* (B. e bardhe) me *Fagus silvatica* (Ahun) ne gelqerorë.
- 6-Formacionet bimore te pyjeve të *quercus frainetto* e *quercus cerris* si dhe perzjerja e tyre me shkurret si *Carpinus betulus*,*Ostria carpinifolia*,takohen në pjesën më të madhe të pyjeve nga lartesia 600-1200mmbi nivelin e detit.
- 7-Pyjet dominohen nga pikpamja fitosociologjike dhe i përkasin rendit *quercetalia pubescentis* dhe bashkëshoqerimeve të aleances *Quercion frainetto-cerris* dhe *Ostrio-Carpinino orientalis*.Llojet me predominus janë pyjet me qarr (*Quercus cerris*), pyjet e ahut (*Fagus silvatica*) të shoqëruara me shpardhin e Qarrin.

Pyjet e bashkisë Pogradec kanë një potencial prodhues jo te paket neqofte se do të merren masa për ërmirësimin e pyjeve të lisit që përbëjnë rreth 12000 ha dhe janë nje resurset e pashtereshme per prodhimin e druve te zjarrit. Sipas kadastrës së vitit 2014 pyjet kane një prodhimtari prej 868047 mije m³ lëndë punimi dhe dru zjarri, ku kjo e fundit ze 50% e volumit drusor që është tregues për një zhvillim jo normal të pyjeve.

Origjina e pyllit dhe natyraliteti

Nga siperfaqja totale e pyjeve prej 2,453 ha, 785.6 ha ose 26.3 %, jane pyje me origjine farore, pra pyje trungishte, ndersa 1736,2 ha ose 58.1 % jane pyje me origjine lastarore, pra pyje cungishte. Per sa i perket natyralitetit, 1205.6 ha ose 47.8 % jane pyje natyrore dhe 1316.2 ha ose 52.2 % jane gjysem-natyrore.

Pyjet që qeverisen si trungishte ku bejnë pjesë pyjet e lartë të ahut dhe pyjet me pishë të zezë kane origjine farore,në një siperfaqe prej 8130 ha,kurse pyjet e ulet cungishtet e lisit dhe nje pjesë të ahut që ndodhet ne afersi të fshatrave duke prere disa here kane shkuar ne nje regression negativ me origjine llastarore. Këto pyje kanë një prodhimtari më të ulët dhe një jetëgjatësi më të shkurter krahasuar me trungishtet me origjinë farore.

Natyraliteti

Shkalla e natyralitetit të pyjeve tregon intensitetin dhe historinë e nderhyrjeve njerëzore, intensitetet e ndryshme të shfrytëzimit të zonave pyjore të cilat karakterizohen jo vetëm nga pjesa e mbetur e grumbujve pyjore në vendndodhjen por dhe në ndryshimin e strukturave dhe komuniteteve të ndryshme të specieve brenda tyre. Shkalla e natyralitetit e përkrahur është klasifikuar në tre kategori:

-Zona pyjore të pa shqetësuara nga njeriu (natyrale)

-Zona pyjore gjysëm natyrale (të shqetësuara nga njeriu me ndërhyrjet e tija)

-Plantacione

Për gjendjen që kanë sot pyjet tanë, përfshihen në klasifikimin e dytë pyje gjysëm natyrore, ku faktori njeri ka ndikuar negativisht ose pozitivisht në këto sipërfaqe pyjore.

Tab. – 12 Natyraliteti i fondit pyjor

Natyraliteti	Sipërfaqja	
	(ha)	(%)
Natyror	1205.6	47.8
Gjysëm-natyror	1316.2	52.2
Totali	2521.8	100.0

Burimi: Bashkia Pogradec

Biotopet e veçantë

Biotopet janë sipërfaqe të vecanta që kanë një sipërfaqe më të vogël se 1ha, ku kanë lloje drunore të rrallë (**shoqërimi pyjorë të rralla**) në formë njollash ku inventarizohen veçmas ose kur janë më shumë se 1 ha përshkruhen si ngastra të veçanta: Në pyje tona kemi në ekonominë pyjore Bishnice, pjesa ekonomike uji i ftohtë me llojin *ilex aquifolium* (ilqja) ngastra nr 36a si dhe plepishnja në Bishnice (*Populus tremula*) ngastra 7a dhe 18a.

Llojet e rrezikuara

Duke parë shtrirjen gjeografike të kësaj komune, krijohen kushte të favorshme për rritje e disa kafsheve dhe shpendesh të egra. Disa lloje që takohen janë: Lepuri i eger, ujku, ariu dhe rralle, derri i eger, cakalli, lunderza, derri i eger. Rëndësi e veçantë duhet të tregohet për mbrojtjen e këtyre kafsheve.

Rezervat gjenetike

Janë sipërfaqe pyjore ngastra ose nënngastra të cilat ruhen dhe trajtohen për prodhimin e farave pyjore të cilat do të mbillen në fidanishtet pyjore për gjeneratat e reja.

Në bashkinë Pogradec, kemi dy sipërfaqe, ngastra 2b-Pjesa ekonomike Bishnice pjesa ekonomike Uji i ftohtë lloji Ah dhe në ekonominë pyjore Guri I Nikës ngastra 7a lloji Ah.

Ruajtja dhe përdorimi i burimeve gjenetike pyjore, janë çështjet thelbësore për të përshpejtuar përshtatjen gjenetike të druveve dhe popullatave të tyre në mjedise të reja, për të ruajtur kapacitetin adaptiv të tyre dhe evolucionin e mëtejshëm të pyjeve.

Per të ardhmen menaxhimi i pyjeve do të favorizojë evolucionin nëpërmjet seleksionimit natyror duke inkurajuar kështu zhvillimin e kombinimeve të reja gjenotipike, gjithashtu do të ndimoje dhe në ruajtjen e potencialit evolutiv të grumbullit pyjor natyror.

Fauna dhe gjuetia

Shtirja gjeografike e teritorit të bashkisë së Pogradecit ka krijuar kushte për rritjen e zhvillimin e shume kafshëve dhe shpendeve të egra si: Lepuri I eger, Ariu, Ujku, Dhelpra, Baldosa, Derri i eger, Kaprolli, Dhia e egër, dhe shpendë si Thelleza e malit, e fushës, Qukapiku, etj.

Ne kete periudhe, pra në periudhën e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Pogradec, aktiviteti I gjuetisë nuk zhvillohet sepse eshte i ndaluar nga Ligji për Moratoriumin e gjuetise.

Prodhimet drusore dhe cilësia

Pyjet e vendosur per rreth fshtave te komunes Velçan ne nje pjese te tyre jane trajtuar me prerje nga ana e sherbimit pyjor, por gjithashtu ata jane perdorur prej dekadash nga ana e komuniteteve per nevojat e tyre. Kryesisht prej tyre jane marre drute e zjarrit, lenda e ndertimit dhe gjethi per blegtorine. Aktualisht gjendja e tyre nuk paraqitet e mire, sepse prerjet nuk jane bere sipas kriterave teknike. Pyjet trugishte prej lisi jane krasitur ne vijimesi per gjeth, duke i degraduar ata. Prej tyre jane marre edhe drute e zjarrit dhe lenda e ndertimit. Po ashtu edhe pyjet cungishte jane prere qofte per dru zjarri, lende dhe gjeth. Mbi te gjitha ne kete komune verehet nje fenomen jo i mire, ai i prerjes se majave te druveve, duke mos u dhene atyre mundesi rritje. Ky veprim behet me qellim qe te lehtesohet hipja ne dru per krasitjen e degeve. Pervec ketyre prodhimeve, nga keta pyje jane prodhuar edhe hunj, thupra, bishta veglash etj. Pergjithesisht lenda drusore, qofte ajo e llojit ah po ashtu dhe ajo e llojit lis, nuk kane cilesi te mire, per shkak te krasitjeve te shumta dhe prerjes se majave dhe per pasoje trugjet jane deformuar dhe jane me nyje te shumte.

Clesia e grumbullit ka të beje me % që ze lënda e punimit në llojet drusore dhe shprehet në tre kritere:

-E ulet- Lënda epunimit ze deri në 40% të vëllimit per haloret dhe 25% për fletorët

-Mesatare- Lënda e punimit zë 40-60% për haloret dhe 25-50% per fletorët

-Lartë-Lënda e punimit zë mbi 60% për haloret dhe 50% për fletorët

Duke qenë se pyjet jane te shfrytezuar dhe sot kemi pyje me moshet të re pyjet e bashkisë Pogradec bëjnë pjesë në kriterin e parë të ulët.

Për rritjen e cilësisë së grumbullit pyjor, përmiresimi i pyjeve të lisit (cungishteve) si dhe nderhyrja në pyjet e rinj të Ahut me moshë 20-60 vjet është një nga detyrat më të rëndësishme të administrimit dhe menaxhimit të pyjeve, ku për një periudhe 10 vjeëare të arrihet në kriterin mesatar të cilësisë së grumbujve, pra për të rritur raportin e lëndës së punimit karshi drusë së zjarrit.

Prodhimet pyjore jo drusore, bimët mjeksore, gështenjat, arrat, lajthitë etj.

Ne pyjet dhe kullotat e rajonit, nxirren edhe prodhime te tjera jo drusore, te tilla si bime mjeksore, fruta, fara, bar etj. Nder me kryesoret jane, dellinja e zeze dhe e kuqe, murrizi, etj. Sikurse per lenden drusore edhe per keto prodhime nuk eshte treguar kujdesi i duhur, ne drejtim te zbatimit të

rregullave teknike për vjeljen dhe grumbullimin e tyre, gje që deri para disa vitesh, kishte përkeqësuar gjendjen e tyre. Arrat dhe geshtenjat janë prodhime që sigurohen nga druret e veçantë ose grumbuj të vegjel druresh, përrreth shtepive, tokave tëbukës ose në pyll. Bashkia e Pogradecit është e pasur me bimë mjekësore dhe etero vajore dhe keto zene rreth 40% të sipërfaqes pyjore e kullimore. Llojet më kryesore janë Trendafili i eger, Murrizet, Sherebela, çaji i malit, njëmijë fleteshi, balsami, rignonet e ndryshme, dëllinje e zezë, e kuqe molla e egër, mëllagat e ndryshme, qumeshorët, salepet etj. që kanë një vlere të madhe. Studime konkrete deri tani nuk ka, por po behen përllogaritje në bazë të njësive administrative, ekonomive pyjore dhe fshatrave, ku vlerësimi dhe vjelja e prodhimeve jo drusore në pyll do të ndikojë pozitivisht në rritjen e të ardhurave për komunitetin.

Rritja në vëllim dhe prodhimitaria e pyjeve

Vëllimi i materialit drusor, vetem në pyjet e Velcanit, vlerësohet në 124.681 m³ lende në këmbë, nga e cila 65.367 m³ lende punimi dhe 59.314 m³ dru zjarri. Pyjet trungishte kanë vëllimin pak më të vogël, të barabartë me 59.126 m³ lende në këmbë, pyjet cungishte 65.555 m³ në këmbë. Rritja aktuale vijuese varion në funksion të moshës dhe klases së lartësisë. Konkretisht hasen rritje vijuese 0,6 m³/ha/vit deri 5,1 m³/ha/vit. Sikurse rritja vijuese, rritja mesatare gjithashtu është në vartësi të parametrave të drureve, numrit të tyre për ha dhe moshës së grumbullit. Nisur nga fakti që u përmend edhe më lart, pra gjendja përgjithësisht jo e mirë, grumbujt kanë rritje mesatare që vijojnë nga 0,2 m³/ha deri në 6,4 m³/ha në vit.

Prodhimet drusore, mundësia vjetore e shfrytëzimit

Në kuadrin e menaxhimit të pyjeve në përgjithësi do të parashikohen vetem nderhyrje silvikulturore duke qenë se pyjet janë në moshe të re dhe me keto nderhyrje do të përmirësohet gjendja e tyre. Nderhyrjet do të jenë prerjet sanitare, rrallimet si dhe nxitja e ripërtritjes dhe përmirësimit të gjendjes aktuale të pyjeve cungishtet në përmirësimin dhe mbrojtjen e tyre.

Funksionet kryesore

Siç është theksuar dhe më sipër, pyjet e komunes Velçan kanë funksion prodhues, mbrojtës dhe mbrojtës me funksion prodhues. Edhe pyjet me funksion prodhues kryejnë funksionet e tyre natyrore, për mbrojtjen e tokës, përmirësimin e klimes, regjimit hidrik etj.

Menaxhimi i rreziqeve (Ulja e rreziqeve)

Pyjet janë të ekspozuar kundrejt rreziqeve që janë prerjet dhe kullotja pa kriter, zjarret, demtuesit dhe semundjet e ndryshme. Menaxhimi dhe ulja e tyre do të jete i mundur nepermjet zbatimit të masave të parashikuara nga plani i mbareshtrimit, për sa u përket prerjeve, mbrojtjes nga mbikullotja, ndalimit të kullotjes për peridha të caktuara, pas kryerjes së punimeve ripërteritese ose pyllëzimeve artificiale, etj. Për sa u përket demtuesve dhe semundjeve, luftimi i tyre do të behet në funksion të situatave konkrete. Faktori kryesor për uljen e rreziqeve dhe menaxhimin sa më të mirë të tyre do të jete bashkëpunimi midis strukturave të shërbimit pyjor, me rolin e keshillimor, komuniteteve dhe shoqatës së përdoruesve të pyjeve dhe kullotave.

Llojet e kërcënuara

Identifikimi I shkallës së kërcënimit për llojet e caktuara të bimëve, kafeshëve, kërpudhave ka një rëndësi globale dhe përcaktimi I masave të menaxhimit, mbrojtja e tyre ka filluesen tek ruajtja e

habitateve. Habitatet e pyjeve të rrezikuara, disa nga këto janë tipike dhe të veçanta për vendin tonë si tipet e pyjeve dushk-frashër, pyjet e bredhit, pyjet e ahut, pyjet e pishës.

Habitate teper të rrezikuara- Habitatet e geshtenjës, pishës, bredhit

Habitate të perkeqësuar- Habitati I pyjeve me panje mali

Habitate më pak të rrezikuara- Dushk me ilqe, pyjeve me shkozë.

Funksioni i pyjeve- Kryesisht pyjet i ndajmë në pyje me funksion prodhimi, pyje me funksion mbrojtës dhe funksion ndermjetës pyje mbrojtës –prodhues. Siperfaqja e pyjeve kryesisht kanë funksion prodhues ku vetëm 10-12% e siperfaqes është me funksion mbrojtës dhe mbrojtës –prodhues. Në këto siperfaqe përfshihen siperfaqet pyjore në basenet e liqeneve malore, rezervuarve, pjerrësitë e medha si në shkëmbin e Llenges, liqenet e Lukoves, Pyjet e Pishës se zeze në basenin e Liqenit të Pogradecit etj.

Sistemi i menaxhimit te pyjeve- Pyjet menaxhohen ose qeverisen ne tre forma:

-Pyje trungishte, behet fjale per pyjet e larte te ahut, qe kane nje prodhimtari te larte tematerialit drusor dhe kane origjine farore, keta pyje zene nje siperfaqe prej 8100 ha sot jane pyje te rinj me nje zhvillim te mire vegjetativ. Pyje cungishte-Kryesisht jane pyjet e lisit dhe te geshtenjës me nje siperfaqe prej 11133ha qe kane nje prodhimtari te ulet dhe jane me origjine llastarore.

Figura 47. Cungishte Ahu



Figura 48. Pyll Lisi në Velçan

Shkurret jane pyjet me lloje si shkoza, bushi, melleza, lajthite cilat kane nje siperfaqe prej 319 ha qe prodhojne dru zjarri të një sasi të vogël. Ne bashkinë Pogradec ekonomite pyjore jane te mbuluara me plane menaxhimi por ju ka kaluar afti I perdorimit te tyre dhe te dhenat qe jane sot per te kryher nje menaxhim te qendrushem te pyjeve nuk jane te sakta ,prandaj eshte e domozdoshme riberja e tyre ne nje afat sa me te shkurter.

Tipet e pyllit

Per sa u perket tipeve te pyllit, masat e parashikuara synojne ndryshimin e tyre. Ndryshimi do te konsistoje ne rritjen e siperfaqes se pyjeve trugishte ndaj atyre cungishte, pasi ne ngastra te veçanta eshte parashikuar kthimi i cungishteve ne trugishte, qe do ta rrite me tej perqindjen e tyre. Po ashtu siperfaqja e trugishteve parashikohet te rritet, per shkak te pyllzimeve qe do te kryhen ne siperfaqet me bimesi pyjore dhe ato djerre.

Tipi i kullotave

Tipet e kullotave qe gjenden në bashkinë Pogradec janë: Kullota Alpine Ballkanike me Sesleria comosa, Festuca riloensis, Corvex curvua etj. Nga siperfaqja totale e kullotave ne nje Komune te caktuar si ajo e Velcanit , prej 439,8 ha, 285.7 jane kullota neto (me bar), ndersa 154,1 ha jane kullota me drure e shkurre. Te gjitha jane kullota verore. Ne keto kullota predominon mbulesa barishtore graminace, qe zene nga 45 % deri ne 80 5 te llojeve barishtore. Leguminozet variojne ne kufijte 20-30 % ndersa llojet e tjere nga 15 % deri ne 30 %.

Përdoruesit e kullotave dhe periudha e vitit kur ato përdoren

Kullotat jane ne perdorim te perbashket, sipas fshtrove. Periudha e perdorimit te tyre shtrihet nga fundi i muajit maj deri ne muajin tetor, pergjithesisht nje periudhe pothuajse 5-6 mujore.

Gjendja e tyre

mund te konsiderohet jo e mire, sepse ato jane te mbikulltura, perdoret per nje periudhe mbi 6 mujore, kane munguar punimet per permiresimin e tyre, etj. Përcaktimi i biomasës. Ne llogaritjen e prodhimtarise per çdo ngaster jane perdorur si te dhenat nga plani i vjeter i mbareshtimit te kullotave

ashtu dhe eksperiencia e fshatareve per sasisne e barit te prodhuar me kositje, ne pjese te ndryshme te kullotes

Po ashtu u morr ne konsiderate edhe pervoja e disa barinjve me eksperience per prodhimtarine e çdo ngastre. Mbi kete baze u be perlllogaritja e prodhimtarise se biomases, e cila eshte e ndryshme per ngastra te ndryshem. Ne pasyren e meposhteme jepen te dhena per parcelat e secilit fshat, nga ku rezulton se prodhimtaria arrin nga 8 kv/ha deri ne 45 kv/ha, me nje mesatare prej rreth 20 kv/ha.

I-Zonat e mbrojtura-

Pejsazh I mbrojtur tokesor-ujor I Pogradecit kat e v-te

Sip. Totale-27323 ha

a-Pyje,shkurre,toke me bimesi pyjore 9120ha

b-Kullota +livadhe -2180 ha

c-Bujqesore ,pemetore,vreshta e tj-3975 ha

d-Ujore -11000ha

e-Jo prodhuese- 168 ha

f- Troje- 880ha

II-Ekonomia pyjore Guri I Nikes sipërfaqia 2200 ha

-Zone e mbrojtur e burimeve te menaxhuara.

Përfundime:

Tregusit e mësiperm na afrojnë një prespektivë të plotë të resurseve pyjore, kullosore dhe eshte një burim i vlefshëm informacioni për politikat pyjore kombëtare dhe lokale e programeve pyjore që janë zbatuar.Shtrirja dhe ne vençanti ndryshimet në sipërfaqet në fondin pyjor e kullosor në vlerësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve për një vendimmarrje të proceseve politike dhe ekonomike.

Në analizat e bera kohët e fundit sipërfaqia e pyjeve është zvogeluar në masën 1.2-1.3% kjo ulje është konstatuar me shumë në 10vjeçarin, kurse ne pyjet tona kjo ulje është 0.5-0.6%.

Duke ju referuar elementëve të përbërjes së fondit pyjor dhe dimensionet e disponueshmërisë se pyjeve, si pjese per prodhimin e lendes drusore, aq e domozdoshme per plotesimin e nevojave te shoqerise ne kete moment rezulton se:

- Janë zvogëluar resurset pyjore si dhe perfitimet e komunitetit qe nxirren prej tyre.

-Pmvaresisht se sipërfaqia uk ka ndonje zvogëlim te madh, ajo ka humbur treguesit cilesore ,ku një pjesë e sipërfaqes pyjore eshte qeverisur si trungishte, nga nderhyrjet e gabuara jane kthyer ne cungishte, ne pyje me vlere cilesore te ulet dhe trungishtet me material drusor ne sipërfaqe me bimesi pyjore ose sipërfaqe me filizeri ahu me moshe te re, pra jane humbur treguesit sasiore.

-Ajo qe ka ndryshuar me shume eshte se sipërfaqia e pyjeve me funksion kryesor prodhimin e lendes drusore e cila llogaritej gati 60%, tamni indentifikohet me nje zhvillim qe nuk vihet re, por ne fakt keto zhvillime janë ne kahe te kundërt.

Shperndarja e vellimit te materialit drusor e cila sot nuk eshte uniforme ne raport me klasat e moshave dhe kategorive diametrike te drureve, perberjes morfollogjike te llojeve te drureve, krijon nje problem per menaxhimin e qendrueshëm ,multifunksional e afatgjate të pyjeve.

-Ulja e prodhimitarise se pyjeve ndikon drejtperdrejt ne zvogelimin e sasise se materialit drusor ne dispozicion per furnizimin me lendë drusore në nivel local dhe kombëtar.

4.6 Ajri

1.1 BURIMET E NDOTJES SË AJRIT

Ka shumë burime të ndojes së ajrit në Shqipëri; sektorët kryesorë kontribues janë ai i transportit, industria, bujqësia, përdorimi shtëpiak i produkteve si dhe ngrohja.

Të gjithë këto sektorë çlirojnë një shumëllojshmëri ndotësash si dioksid squfuri, okside të azotit, nga druri (PM10), bujqësia (NH₃, PM10), dhe industria (VOC, NOX, PM10. Dhjetëra mijëra produkte të tjera kimike përdoren nga njeriu në aktivitetin industrial dhe në jetën e përditshme. Hidrokarburet, aromatikët, polinuklearët (PAH) si (etileni, acetileni, tolueni, xilleni) metalet e rënda, pesticidet dhe herbicidet, poliklorodifenili (PCB), tretësira organike dhe metale në formë gjurmësh, përfaqësojnë faktorë të ndotjes lokale që vijnë nga burime të ndryshme.

Metalet e rëndë


Plumbi është një metal i rëndë, që ndodhet në përbërjen e kores së tokës. Përqendrimet natyrore të plumbit janë të ulët, por shfrytëzimi i plumbit nga njeriu ka rritur nivelet e përmbajtjes së këtij ndotësi në atmosferë. Burimi kryesor i plumbit në ajrin urban është djegia e benzinës me plumb nga motorët e automjeteve.

Vlerësimi i situatës nga pluhurat (pm10, pm2.5)

Grimcat e pluhurit (PM) janë një përzjerje e aerosoleve (të ngurta ose të lëngëta) që përfshin një diapason të gjerë në madhësi dhe kompozime kimike. PM10, PM2.5 i referohet grimcave me diametër 10 dhe 2.5 micrometer ose më të vogël, dhe emetohet direkt në atmosferë si grimca primare ose formohet si rezultat i emisioneve të SO₂, Nox, NH₃ dhe NMVOC PM emetohen nga shumë burime antropogjenike si djegia e lëndës djegëse, ndërtimet, pluhuri natyral pezull, kripa e detit etj.

PM2.5 nuk është monitoruar nga sistemet e institucioneve publike, por kemi nxjerrë disa të dhëna të mesatarizuara prej vetëmonitorimeve të bizneseve për këtë rajon mbështetur në listën e dhënës informative prej Drejtorisë Mjedisore të Qarkut Korçë.

Figura 49. Vlerat vjetore për PM10



Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Niveli i lartë i PM10

PM10 – ose “particulate matter” është lëndë e grimcuar e imët, me diametër grimcash më të vogël se 10μ (mikron, ose të mijtat e milimetrit). Niveli i kuq i PM10 tregon vlerën e lartë që i kalon $80\mu\text{g}/\text{m}^3$.

Ky nivel i lartë i përqendrimit të PM10 mund të shpjegohet me arsye të ndryshme, si:


- numri i lartë i automjeteve në një qendër të caktuar;
- lëvizja apo përdorimi i automjeteve me naftë, e pak me benzinë apo gaz;
- prania shumë e ulët e rrugëve ekologjike
- sasia shumë e ulët e gjelbërimit $\text{m}^2/\text{banorë}$ dhe struktura e bimësisë e papërshtatshme për thithjen e pluhurave;
- relievi i papërshtatshëm, i rrethuar nga male e kodra ku ajri qarkullon me vështirësi;
- aktivitetet industriale brenda qytetit;
- qarkullimit të automjeteve të vjetra ose me emetime gazrash, etj.
- mos përdorimi i energjinë alternative në banesa, si panele diellore, mulli ere, gjeotermi, peleta, etj.

PM2.5 – ose “particulate matter” është lëndë e grimcuar e imët, me diametër grimcash më të vogël se 2.5μ (mikron, ose të mijtat e milimetrit). Niveli i kuq i PM2.5 tregon vlerën e lartë që i kalon $35\mu\text{g}/\text{m}^3$. Ky nivel i lartë i përqendrimit të PM2.5 mund të shpjegohet për të njëjtat arsye si më sipër.

Vlerësimi i situatës nga SO₂ (dioksid sqfuri)

SO₂ është formuar nga oksidimi i sqfurit dhe kryesisht nga djegia e lëndës djegëse me përmbajtje sqfuri. Sektori i prodhimit të energjisë elektrike është burimi kryesor i SO₂. SO₂ është një ndotës që shkakton probleme serioze në shëndetin e popullatës. Në grafikun e mëposhtëm janë dhënë vlerat mesatare vjetore të SO₂ në qytetet kryesore të vendit tonë. Siç vihet re dhe nga grafiku vlerat e monitoruara në Pogradec të SO₂ janë të ulta. Po ti referohemi vlerave ditore dhe orare të monitoruara vërejmë se nivelet e tyre janë më të ulta në krahasim me standartin orar dhe ditor të BE-së.

Figura 50. Vlerat mesatare të SO₂



Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Përmbajtja më e ulët e sqfurit në karburant


Për shkak se emetimet e SO₂ janë direkt proporcionale me përmbajtjen e sqfurit të karburantit të djegur, kjo do të krijojë zvogëlime të menjëhershme. Për shembull, të zvogëlosh nivelin e sqfurit të naftës së përdorur nga automjetet, nga mesatarja aktuale rreth 2.7 në 0.5% do të zvogëlojë emetimet e SO₂ nga këto mjete në rreth 80%. Duke pakësuar përmbajtjen e sqfurit në karburant do të zvogëlojë gjithashtu formacionin e sulfatit dhe si pasojë emetimet e PM. Gjithashtu, pakësimet e mëdha në përmbajtjen e sqfurit në karburant do të lejojnë zvogëlime shtesë në NO_x dhe PM duke përdorur mekanizmat e sigurt pas trajtimit që nuk punojnë me efekt në prani të lartë të koncentrateve të sqfurit.

Vlerësimi i situatës për NO₂ (Dioksid azoti)

NO₂ është një ndotës që emetohet në atmosferë si rezultat i djegies së lëndës djegëse nga proceset industriale dhe sektori i transportit rrugor. NO₂ është i lidhur me efekte të padëshiruara në shëndet, ky mund të dëmtojë mëlçinë, mushkëritë, shpretkën dhe gjakun. Ashtu si SO₂ dhe NO₂ ndikon në formimin e shiut acid dhe në eutrofikimin e tokës dhe ujit. Për NO₂ burimi kryesor i ndotjes është shkarkimi i automjeteve dhe siç vihet re nga grafiku nivelet më të larta janë monitoruar në stacionet e instaluar pranë rrugëve me trafik të rënduar. ***Nga stacionet e instaluar tregohet se ka një nivel të lartë¹¹ të NO₂.*** Ky nivel i lartë mund të shpjegohet me arsye të ndryshme, si:


- mungesa e rrugëve ekologjike (bicikleta) mungesa e gjelbërimit m²/banorë dhe struktura e bimësisë për thithjen e pluhurave;
- aktivitete industriale brenda qytetit;
- mos përdorim te energjive alternative në banesat, si panele diellore, mulli ere, gjeotermi, peleta, etj.

Figura 51. Vlerat mesatare vjetore për NO₂



Burimi: Agjencia Kombetare Mjedisit

Figura 52. Vlerat në kufi për NO2 dhe NOx



Burimi: Agjencia Kombetare Mjedisit


Tabela 9. Të dhënat mesatare të cilësisë së ajrit

	Pogradeci	Standarti i BE
PM10	39	40
PM2.5	23	25
SO2	5	
O3	42	
CO	0.9	
NO2	10	40

Burimi: Monitoruar nga AKM


- Pogradeci paraqet përqendrime relativisht të ulta krahasuar me qytete të tjera të
- Përqëndrimet e ozonit paraqiten në vlera të ngjashme me qytetet e tjera.
- Pogradeci përqëndrimet me te larta te ozonit i ka pranë DSHP-se

Figura 53. Përdorimet e vlerave të NOx




Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Figura 54. Përqëndrimet e vlerave të O₃



Burimi: Agjencia Kombetare Mjedisit


Figura 55. Vlera vjetore të O₃



Burimi: Agjencia Kombetare Mjedisit

Përsa i përket O₃, në të gjitha pikat e monitoruara përqëndrimi është relativisht konstant. Në Pogradec përqëndrimet më të larta të ozonit i ka pranë DSHP-së, ndërsa vlerat e NO₂ ndodhen në nivele të ulta.

Figura 56. Vlerat mesatare të O₃ për periudhën Nëntor-Dhjetor



Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Vlerësimi i situatës nga CO (monoksidi i karbonit)

Monoksidi i Karbonit (CO) emetohet në atmosferë për shkak të djegies jo të plotë të lëndës djegëse. Burimet kryesor të shkarkimit të CO në ajër janë transporti rrugor, biznesi, shtëpitë dhe industria. Monoksidi i Karbonit (CO) është një ndotës që në nivele të larta mund të shkaktojë probleme në zemër dhe të dëmtojë sistemin nervor. Ndërsa në stacionin e Pogradecit niveli i lartë i CO është për shkak të përdorimit të druve të zjarrit si lëndë djegëse për ngrohjen e banesave.

4.7 Mbetjet

GJENDJA E TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE NË BASHKINË E POGRADECIT

Problemi kryesor në Pogradec është mungesa e kompanive të kualifikuara për grumbullimin edhe riciklimin e mbeturinave prej kartoni e plastike, dhe transportimi i tyre drejt pikave të riciklimit në qytete të tjera është i pamundur për shkak të kostos të lartë. Mbetjet trajtohen nga subjekte private, të cilat nga pikat e grumbullimit i transportojnë në venddepozitim dhe përcaktuar.

Venddepozitimi ku trajtohen mbetjet ndodhet në vendin e quajtur Përroi i Shtogut, në territorin e Njësisë administrative Buçimas, në distancë 13 km nga qyteti i Pogradecit Ky venddepozitim ka shërbyer dhe shërben si i tillë deri në ndërtimin dhe vënien në përdorim të landfillit rajonal të Maliq-it. Në këtë venddepozitim të përbashkët depozitohen mbeturinat shtëpiake e inerte të qytetit Pogradec, Njësisë Administrative Buçimas dhe Njësisë Administrative Hudënisht. Këto mbetje grumbullohen pa ndonjë trajtim, dhe megjithëse janë të përqëndruara, sjellin ndotjen e mjedisit, (ajrit, ujërave dhe tokave), sidomos nga mungesa e seleksionimit sipas tipeve të mbetjeve urbane dhe industriale. Venddepozitimi, është jashtë kritereve dhe kushteve teknike të përcaktuara nga pikëpamja gjeologo-inxhinierike, dhe rjedhja e ujërave nga venddepozita krijon ndotje për ujërat sipërfaqësore dhe për tokat bujqësore.

Sasia e mbetjeve shtëpiake gjatë vitit 2015 për Bashkinë Pogradec ka qënë si më poshtë:

Qyteti i Pogradecit 10.990 ton / vit (*gjenerimi i mbetjeve 1kg/person në ditë*)

Nj. A. Çërravë 2592 ton /vit (*gjenerimi i mbetjeve 0.6 kg/person në ditë*)

Nj. A. Hudënisht 1900 ton /vit (*gjenerimi i mbetjeve 0.6 kg/person në ditë*)

Nj. A. Buçimas 3600 ton /vit (*gjenerimi i mbetjeve 0.6 kg/person në ditë*)

Nj. A. Dardhas 288 ton /vit (*gjenerimi i mbetjeve 0.6 kg/person në ditë*)

Për Nj. A. Proptisht, Trebinjë e Velçan – nuk administrohen të dhëna

Mbetjet inerte dhe vend depozitat e tyre

Nga fluksi i ndërtimeve krijohen mbetje inerte të shumta, të cilat në të shumtën e rasteve hidhen në anët e rrugëve, në shpatet e përrenjve apo lumenjve e afër mbetjeve urbane (shpesh të përziera me to). Mbetjet e inerteve, nën ndikimin e agjentëve atmosferik, erërave dhe reshjeve, sjellin ndotje të tokës, ajrit, ujërave dhe ambientit përreth. Sasia e mbetjeve inerte gjatë vitit 2015 për qytetin e Pogradecit ka qënë 700 ton (*për sasinë e mbetjeve inerte për 2015 për njësitë administrative nuk ka të dhëna të sakta*).

Mbetjet urbane në territorin e ish - komunave

Largimi i mbetjeve urbane nga disa rrugë kryesore bëhet një herë në javë me anë të një kamionçini, por pa patur mjetet e nevojshme për menaxhimin e duhur të tyre. Aktualisht, situata është akoma dhe më e rëndë, sepse ky shërbim, prej rreth një viti mungon krejtësisht dhe koshat për depozitim dhe këtyre mbetjeve nuk ekzistojnë në asnjë rrugë të fshatrave që përbëjnë këto ish-komuna. Kjo situatë është paradoksale, përderisa rajoni në fjalë ka nën funksionin e vet edhe shërbimin e pastrimit të mbetjeve urbane përcaktuar në Ligjin Nr. 8652 datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” (i ndryshuar). Çdo ditë e më tepër këto mbetje urbane përbëjnë një shqetësim të vazhdueshëm për banorët e këtyre zonave, të cilët e

perceptojnë kërcënimin real që po iu ushtrohet. Gjithashtu, një mjedis i papërshtatshëm është krijuar edhe për zhvillimin e bizneseve lokale ekzistues apo të rinj. Nga këqyrjet tona në terren, konstatuam që në çdo anë të rrugëve, në kanalet kullues dhe në kanalet vaditës gjenden grumbuj mbeturinash, të cilat hidhen kryesisht nga familjarët dhe bizneset private që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këto njesi administartive. Kjo situatë ishte edhe më alarmante gjatë rrugës nacionale, madje dhe në rrugët e rrëpirat brenda e midis lagjeve të fshatrave. Ajo çfarë e përkeqëson edhe më tepër situatën është mungesa e ndërgjegjësimit publik lidhur me mbrojtjen e mjedisit, ashtu si dhe një mungesë e përgjithshme e dëshirës qytetare për të kërkuar të drejtat e tyre mjedisore pranë autoriteteve përgjegjëse.

Konkluzione

Mungesa e menaxhimit të Trajtimit të Integruar të Mbetjeve Urbane ka shkaktuar një shpërndarje të pakontrolluar të plehrave, të cilat shkaktojnë ndotje të mëdha që lidhen me tokën, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, ajrin dhe erën (aromat). Shihet i nevojshëm një plan menaxhimi për mbeturinat. Sistemimi i Mbetjeve Bashkiake është kryer dhe vazhdon të kryhet, në mënyrë primitive. Aktualisht nuk bëhet asnjë lloj ndarje dhe trajtimi.

4.8 Problemet mjedisore të tokës, ujit dhe ajrit

4.8.1 TË PËRGJITHSHME

Bashkia e Pogradecit disponon një gamë mineralesh si: krom, hekur- nikel, nikel-silikat, qymyr guri, argjila, kuarcite, gurë dekorativ, gurë gëlqeror, ranor, konglomerate, inerte lumi etj, shfrytëzimi i të cilave, krahas rëndësisë ekonomike sjell edhe impakte negative në ndotjen e mjedisit.


Përveç shfrytëzimit me punime nëntokësore apo në qiell të hapur, (me karriera), të këtyre mineraleve, burime ndotjesh janë edhe stoqet e mineralit apo të sterileve të tyre, sidomos fabrikat e pasurimit të hekur-nikelit, të kromit etj, me dambat e tyre përkatëse. Këto paraqesin rrezik potencial për mjedisin. Jonet e metaleve të rëndë që vazhdimisht kalojnë në tretje, sjellin rrisqe serioze në bimësinë dhe gjallesat që jetojnë në ambjente tokësore dhe ujore të ndotura nga këto jone. *Punimet minerare të mbyllura dhe ato aktive, shfrytëzimet sipërfaqësore (karrierat) dhe stoqet e tyre të sterileve dhe të mineraleve*

Në Bashkinë e Pogradecit përpara dhe gjatë viteve ‘90, industria minerare ka qënë ndër degët e zhvilluara por mbyllja e minierave ka lënë pas mjaft stoqe mineralesh, sterilesh si dhe mbetjesh teknologjike, të cilat duke qënë në qiell të hapur dhe në relieve kodrinore, kanë dhënë mjaft efekte negative në sektorët përreth, deri edhe me pasoja për njerëzit, florën dhe faunën e rajonit (Mema, I., etj., (2010); Shushku, B., etj., (2013); Haklaj, I., etj., 2014). Konkretisht për këtë Bashki probleme gjeomjedisore sjellin kryesisht minierat dhe karrierat e kromit, të hekur-nikelit, të materialeve të ndërtimit, inertet lumore etj, (me stoqet e sterileve të tyre), si në: Guri i Kuq etj.

Nga veprimtaria e agjentëve atmosferik, këto stoqe dhe damba sjellin pasoja në ekosisteme, pra janë të predispozuar për të krijuar ndotje të theksuara në toka, ujëra, dhe bëhet shumë pak për rehabilitimin e ambjenteve të ndotura. Ka damba që janë rehabilituar dhe mbuluar me bimësi spontane, (A.K. e Mjedisit, 2014). Po kështu edhe karrierat e shumta që janë aktivizuar për prodhimin e materialeve të ndërtimit, si dhe shfrytëzimi intensiv dhe i pa kontrolluar i inerteve në shtretërit e lumenjëve, sjellin ndotje sjellin ndotje të theksuara në mjedisin ku veprojnë.

Nga aktiviteti minerar i këtyre punimeve shkaktohen: *Transformime gjeomekanike dhe ndotja e ujërave dhe e tokave* si nga:

- a. Gërmimet sipërfaqësore;
- b. Shembjet, rrëshqitjet, vidhisjet;
- c. Depozitimet (stoqet) e sterileve etj

Figura 57. Diagrama e lejeve të shfrytëzimit

Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Figura 58. Pamje e impianit të thyerjes së kuarçit; "Mademi", Peshkëpi, lumi i Çërravës

Aktiviteti minerar privat, në rrethin e Pogradecit ka filluar në vitin 2001 dhe janë dhënë rreth 30 leje minerare. Këto leje shfrytëzimi kanë një shpërndarje jouniforme dhe pikërisht janë: 7 për shfrytëzimin e mineralit të kromit, 13 për shfrytëzimin e mineralit të Fe-Ni dhe nikel silikat, 2 për shfrytëzim kuarçi dhe 7 për shfrytëzimin e gurit gëlqeror, ku pothuajse të gjithë kanë montuar impiante të thyerje-fraksionimit të gurit gëlqeror që prodhohet si dhe disa pika shfrytëzimi për inerte lumore.

Natyrisht që këto punime për shfrytëzimin e këtyre mineraleve të mësipërme, sjellin ndotje kryesisht në ajër me pluhurat e tyre, por edhe në ujëra dhe në toka, me sterilet e shumta që prodhohen. Përgjithësisht indikatorët më kryesorë të cilësisë së ajrit janë LNP, PM10, PM2,5, PM1, (në $\mu\text{g}/\text{m}^3$). Përveç këtyre ndotësve kryesorë, që ndikojnë në cilësinë e ajrit, janë edhe kimikatet, materialet biologjike, që shkaktojnë shqetësime ose dëmtime tek njerëzit dhe organizmat e tjerë, duke ndikuar negativisht në mjedisin natyror.

Punimet minerare të shfrytëzimit, në përgjithësi kryhen jashtë rregullave dhe kriterëve të caktuara, pra rrjedhimisht sjellin prishje të ekuilibrave natyrorë si: - nga ana *morfologjike*, ku sipërmarrësit nuk i rehabilitojnë, pra nuk i mbyllin gërmadhat (karrierat), grykat e puseve, hyrjet e galerive, (duke sjellë rrezik për njerëzit dhe kafshët), dëmtojnë bimësinë, kullotat dhe tokat bujqësore). Shpesh ka dalja të hinkave në sipërfaqe nga shembja e punimeve nëntokesore. - nga *ndotjet e ajrit, të ujërave dhe të tokave*, kryesisht me pluhurat e madhësive të ndryshme, deri PM10, PM2,5, PM1, që rrjedhin nga plasjet e minave, nga thyerjet dhe fraksionimet për prodhimin e inerteve të ndërtimit, nga transportimi i tyre etj; nga plasjet eksplozive, nga makinat e transportit, motorrët e makinerive etj; nga largimi

nëpërmes agjentëve atmosferik, nga këto stoqe karrierash, të favorizuara nga vet pozicioni kodrinor me reliev të thyer, që lehtësojnë transportimin e tyre drejt kuotave më të ulta, në toka, në përrenj, lumenj, liqene dhe dete, (Goskollli, E., etj., (2003); Shushku, B., etj.,2013).

Figura 59. Miniera e Kromit Hija e zezë




Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Implantet e shfrytëzimit të Inerteve Lumore

Edhe në Bashkinë e Pogradecit kemi raste të këtij lloj aktiviteti, si në lumin Shkumbin, ku nga shfrytëzimi intensiv dhe pa kriter, jashtë çdo kontrolli, sjellin pasoja në shtratin e lumit dhe për rrjedhojë edhe në ekuilibrin natyror të tij, duke sjellur edhe ndryshime në ekosistemin gjeokimik, në vijimsinë e lumit. Kjo veprimtari përveç këtyre që thamë, sjell edhe ndotje të theksuar të ujërave të vet

lumenjëve, nga përzierjet dhe turbullirat që krijohen në vet materialin lumor (fraksionimin dhe larjen e tij), nga shembjet përkatëse, nga vajrat dhe mbetjet që rrjedhin prej impianteve dhe makinerive të transportit etj. Të gjitha këto sjellin rrisqe negative si për faunën e këtyre lumenjëve, ashtu edhe të ujërave nëntokësore që furnizohen nga këta akujfer të përherhëm.

Figura 60. Harta gjeomjedisore, Pogradec**Fabrika e pasurimit dhe damba e saj**

Materiali i dambave është ndotës serioz edhe për faktin se kemi të bëjmë me material të bluar, deri në pudër (0,074mm), gjë që rrit në mënyrë të ndjeshme sipërfaqen aktive të tyre me agjentët atmosferik, pra bëhet i favorshëm dhe i gatshëm për tu futur në reaksione kimike. Edhe mbetjet teknologjike të fabrikave të pasurimit janë një burim ndotjeje. Por përveç shkarkimeve industriale që thamë më sipër, në ndotjen e ujërave rol kryesor luajnë edhe shkarkimet e lëngëta urbane, bujqësore, blegtorale etj, të cilat në mënyrë progresive ndikojnë në uljen e cilësisë së ujërave të lumenjve, liqeneve dhe të krejt mjedisit.

Figura 61. Ish Fabrika e pasurimit të Fe-Ni dhe stoqe minerali

Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Fabrikat e Tullave

Fabrikat e tullave kanë patur aktivitet të madh për vite të tëra dhe vazhdojnë të kenë kudo në vendin tonë. Këto fabrika janë burim ndotje si nga aktiviteti i tyre por edhe nga karrierat e argjilave që shfrytëzohen për lëndë të parë për prodhimin e tullave. Këto në përgjithësi janë të ngritura afër zonave të populluara, duke sjellë gjithnjë shqetësime dhe dëmtime të ambientit rrethues, me pluhura dhe ndotje të ujërave dhe të tokave, me çlirimin e gazrave nga lëndët djegëse që përdorin si si dhe shqetësime të tjera të përditëshme nga transporti i argjilës, i tullave të prodhuara etj.

Industria Ndërtimore

Industria Ndërtimore, që nga hapja e gropave të bazamenteve të pallateve, transportimi i këtyre dherave, ku pothuajse nuk zbatohen as normat elementare për mbrojtjen e mjedisit, duke dëmtuar rrugët si dhe hedhja ku të munden e këtij materiali. Po kështu edhe pluhurat e shumta që vijnë nga inertet që përdoren në fabrikat e betonit, të cilat ndodhen brenda ose shumë afër qendrave të banimit. Probleme kryesore në ndotjen urbane sjellin pluhurat dhe materialet inerte të prishjes së ndërtimeve të vjetra ose të atyre të ndërtuara pa leje. Përmbajtja e grimcave totale (LNP) dhe atyre të respirueshme (PM10, PM2.5, PM1), në atmosferën urbane të këtyre qyteteve nuk është sinjifikative, ku në përgjithësi është brenda normave të lejuara të Standartit Shqiptar¹².

Industria kimike dhe Mekanike

Uzinat dhe fabrikat e ndryshme, megjithëse e kanë mbyllur aktivitetin e tyre me vite, ekzistojnë ende pasojat e ndotjeve në shkallë të ndryshme, nga mbetjet e tyre kimike dhe teknologjike. Në Bashkinë e Pogradecit, siç thamë, ka qenë e zhvilluar një industri e përbërë kryesisht nga miniera dhe pak fabrika, si dhe mund të përmendim edhe uzinat mekanike, parqet e automjeteve me ofiçinat, me torneritë dhe repartet e ndryshme mekanike të tyre, nëpër ndërmarrje, ferma bujqësore, etj. Këto fabrika, ndërmarrje e reparte, me veprimtarinë e tyre shumë vjeçare dhe me një teknologji të vjetruar dhe me prodhime mbetjesh jo të pakta, por edhe me preparatet kimike që përdorin, padyshim kanë sjellë dhe shumë prej tyre vazhdojnë të sjellin ndotje të ambientit me mbetjet e tyre, (si ndotje të ajrit, të ujërave dhe të tokave), aty ku ndodhen dhe me gjërë, duke patur parasyshtë mos marrjen e masave për shmangjen e tyre, për eliminimin e të cilave kërkohet disiplinë dhe kontroll i vazhdueshëm nga ARM e kësaj Bashkie¹³.

Karburantet

Pikat e furnizimit të automjeteve me karburant, siç dihet janë të shpërndara gjithandej, deri në zemër të qyteteve. Për Pogradecin është për tu theksuar se që nga fshati Lin deri në Tushemisht janë ndërtuar një numër i madh karburantesh, (mbi 20 të tillë). Po kështu, vetëm në Qytetin e Pogradecit, që nga hyrja deri afër rrugës për në Tushemisht janë 6 pika karburanti. Këto karburante përveç ndotjeve që sjellin, si në ajër, në rrugët dhe ambientet përreth tyre, me avujt dhe praninë fizike të produkteve të hidrokarbureve, si naftë, benzinë, vajra etj.,

‘Varrezat’ e Automjeteve

Vatra ndotjeje janë edhe ‘varrezat’ e automjeteve që gjenden të shpërndara në shumë pika të hapsirave të bashkive të vendit, të cilat prodhojnë ndotje të përditëshme si në ujrën dhe në tokat përreth. Ato përmbajnë sasi të konsiderueshme substancash me shkallë të lartë ndotjeje, përfshirë naftën, vajrat, tretës dhe produkte të tjera petrokimike. Konkretisht një varrezë makinash është pranë fshatit Mëmëlisht; tre të tilla janë pranë fshatit Hudenisht; një është në afërsi të fshatit Pllloçë, rrugës për në Qytetin e Korçës.

Figura 62. "Varreza" automjetesh




Në Pogradec (Guri i Kuq) - Monitorimi i ndotjes së tokave pranë kësaj miniere është kryer përgjatë rrugës nacionale Pogradec-Tiranë në 3 pika, e para 500m larg objektit, e dyta në distancën rreth 1 km nga e para dhe pika e tretë, në largësi rreth 1.5 km nga e dyta. Mostrat janë marrë në thellësi 0-30 cm dhe vlerësohen për përmbajtjen totale të Ni, Cr, Co, Pb, Cu, Mn, Zn. Analizat e kryera tregojnë se, tokat e zonës kanë tendencë drejt bazicitetit, ku pH në pika të ndryshme lëviz nga 7.5-8.7. Edhe në këto toka, përveç bakrit dhe zinkut, që gjenden në tokë në intervale normale, elementët e tyre gjenden në vlera të larta dhe që i kalojnë shumë limitet e lejuar nga BE. Nga një vështrim i vlerave të matura për

metalet, të cilat konsiderohen me përmbajtje toksike pohojmë se, nikeli gjendet pa shumë ndryshim midis pikave të monitorimit, deri në 40 herë më tepër se limiti i lejuar nga BE, kromi deri në 20 herë më tepër, kobalti deri në 6 herë dhe plumbi deri në 2 herë. Gjithashtu nivele mjaft të larta vërehen edhe për manganin, i cili luhetet nga 1086-1396 µg/kg. Pra përmbajtja e metaleve të rënde në tokat pranë këtyre minierave në vlera kaq të larta është me pasoja në kultivimin e bimëve në këtë zonë, aq më tepër që konsiderohet zonë turistike. Prandaj studime të mëtejshme, që do të saktësojnë transferimin e ndotjes edhe në hallkat e tjera të zinxhirit ushqimor do të jenë me mjaft interes.

Nga përpunimi i të dhënave, pothuajse në të gjitha pikat e monitorimit, përgjithësisht gjejmë korrelacione të forta ndërmjet reaksionit të tokës dhe përqendrimit të metaleve të analizuara, si dhe nëpërmjet vetë metaleve. Në të ardhmen kërkohen që, të thellohet studimet për të përcaktuar, si burimet e përqendrimeve të larta të këtyre metaleve të rënda në këto toka, ashtu edhe format e tretshme të këtyre metaleve.

HotSpotet

Të ashtuquajturat "Pika të nxehta" ose "Hot Spote", krijohen nga mbetjet e rrezikshme, (MbRr), të cilat kanë karakteristika kimike e fizike toksike, gërryese, kancerogjene dhe që sjellin efekte të dëmshme. minierat dhe proceset minerare; - mbetjet e naftës dhe mbetje të tjera të hidrokarbureve; Siç e kemi thënë më sipër, konkretisht për Bashkinë e Pogradecit si "Pika të nxehta" ose "Hot Spote", janë cilësuar: **Damba e minierës së Fe-Ni Guri i Kuq në Pogradec**, me sipërfaqe rreth 3 ha. **Fabrika e përpunimit të Fe-Ni e Gurit të Kuq Pogradec**, me damben e saj në breg të këtij Liqeni, me rreth 100 000 m³ sterile. **Damba e përherëshme mbi fshatin Hudenisht**¹⁴, me rreth 300 000 ton material (kokrrizor dhe shllamor), e cila sjell ndotje në Liqen, në biodiversitetin e tij, sidomos në faunën si përshembull zhdukja e Karavidhes, specie e rrallë e liqenit, e ngjashme me karkalecin e detit¹⁵.

Figura 63. Hotspotet në bashkinë Pogradec

Burimi: Vlerësimi Mjedisor dhe Rehabilitimi I ‘Hot Spoteve’ Shqiptare, 2012

Ndotja e ujit të pijshëm

Në rajonin në studim, në adresë të sigurimit të shëndetit publik, mjaft e rëndësishme është cilësia e ujit të pijshëm. Por, ky ujë nuk shfaq probleme higjieno-sanitare, sepse kemi:

- Furnizimi me orar të pakufizuar, duke siguruar presion konstant të ujit;
- Jo Amortizim të rrjetit ujësjellës;
- Ndërhyrjet nuk janë pa kriter në tubacionet e ujësjellësve;

Por nga ana tjetër mund të shfaq së shpejti problem sanitarë për shkak se:

- kemi ruajtje të dobët të brezave të mbrojtjes sanitare të vendburimeve ujore për shkak të ngritjes mbi to të ndërtesave apo mbjelljes së tokës fare pranë burimit, duke përdorur edhe shumë kimikate;
- klorinimi më shumë seç duhet i ujit;

Ndotja në ujërat Liqenore

Lëndët ushqyese (*fosfori dhe azoti*) të pranishëm në ujrat e përrenjve dhe në ujrat e përdorura shtëpiake favorizojnë rritjen e algave dhe të bimëve ujore, gjë që përshpejton eutrofizimin e liqenit. Në verë, këto alga dhe bimë ujore, shkaktojnë degradimin e karakteristikave kimike dhe fizike të ujit: turbiditetin, treguesin e ngjyrës, shijen dhe ngjyrën. Madje, respektimi i algave dhe i bimëve

ujore modifikon vazhdimisht përmbajtjen në ujë të oksigjenit të tretur. Gjithashtu algat e vdekura depozitohen në fundin e liqenit, gjë që çon në zmadhimin e shtresës së llumit.

Presionet mbi akuiferët

Presionet mbi akuiferët e rajonit Pogradec janë përqëndruar në:

- Kërkesën më të madhe për burimet ujore (bujqësia dhe turizmi) në periudhën e thatë (qershor-shtator), kur disponibiliteti i burimeve të ujërave nëtokësore është më i ulëti;
- Rritjen e vazhdueshme e të pa pakontrolluar të një numri të madh shpimesh privatë për furnizim me ujë pijshëm dhe industri;
- Shfrytëzimi pa kriter i shumë shpimeve të vjetër e të rinj të kryer në akuiferë me presion;
- Ritmet e larta të urbanizimit në zonën fushore, sidomos në dy dekadat e fundit.

Në zonën ku ka pasur aktivitet minerar, sidomos ato toka që ndodhen pranë dhe në kontakt me Liqenin, përmes analizave të elementeve Ni, Cu, Cr, Pb rezulton, se përmbajtja e këtyre elementëve në tokë janë më tepër sesa është norma e lejuar dhe vlerësohen si toksike. Monitorimet dhe vlerësimet e kryera për ndotjen e tokës rreth objekteve industriale dhe minierave kanë arritur në përfundimin se¹⁶:

- Intensiteti i ndotjes varet nga origjina e metaleve në tokë. Zonat industriale në periferi të ndikimit të ndotjes mund të veprojnë në rajonet përreth deri 4 km, por autorët e ndryshëm identifikojnë një zgjatje të ndikimit të saj deri në 8 km.
- Të gjitha zonat e monitoruara janë të ndotura nga dy ose më shumë metale. Kjo mund të jetë rezultat i sfondit gjeologjik ose aktivitetit të njeriut, ose një kombinimi të tyre.
- Tokat pranë zonës industriale ku zhvillohet aktiviteti i industrisë minerare karakterizohen nga përqëndrim shumë i lartë i nikelit.

Në përgjithësi në të gjitha fushat e përfshira në studim, metalet e rënda të përqëndruara janë tepër të larta, në krahasim me vlerat e regjistruara që konsiderohen toksike, ose dhe me normat e lejuara nga BE-ja dhe vendet e tjera. Nga procese monitorimi të kryera më parë është evidentuar një nivel i lartë i përmbajtjes së përgjithshme të metaleve të rënda në të gjitha tokat përreth objekteve minerare. Gjithsesi, ende ka nevojë për studime të mëtejshme monitorimi.

Konkluzione:

Nga evidentimet rezulton se bashkia Pogradec ka një pozicion gjeografik tepër të favorshëm duke pasur parasysh shtrirjen pranë koridoreve kombëtare lidhëse si dhe pozicionim pranë pasurive natyrore të shumta.

Zhvillimi I territorit të bashkisë Pogradec është ndjekur kryesisht nga një mënyrë spontane zhvillimi dhe e pabazuar në dokumente planifikimi. Por ekzistojnë strategji, direktiva dhe plane menaxhimi të shumta lidhur me peisazhin natyror të mbrojtur të Liqenit të Ohrit.

Zona e peisazhit të mbrojtur të Pogradecit përfshin në të një larmishmëri të madhe të habitateve ujore, florës,faunës dhe sipërfaqeve ujore.

Ekzistojnë potenciale natyore të pashfrytzuar siç janë liqenet e Lukovës të cilat po rrezikohen ndjeshëm nga veprimtaritë njerëzore shkatërruese (ndërtimi, përdorimi për vaditje)

Pavarësisht planeve të menaxhimit dhe direktivave për mbrojtjen e peisazhit të mbrojtur të Liqenit të Pogradecit, kjo zonë rrezikohet seriozisht nga mbetjet ndustriale, derdhjet e ujrave të zeza dhe aktivitete të tjera njerëzore.

4.9. Fenomenet e Rrezikut Gjeologjik

RREZIQET NGA LËKUNDJET E TOKËS

Risku sizmik

Në bazë të hartës sizmotektonike të Shqipërisë, (Sh. Aliaj, 1988) rajoni në fjalë bën pjesë në zonën sizmogjene Shkodër-Mat-Librazhd-Korcë me aktivitet sizmik deri në 8 ballë ose me magnitudë 5.5 deri në 6.0. Në kuadrin rajonal, linja sizmogjene Shkodër - Peja është një prej epiqendrave më të forta të tërmeteve, që përshkojnë këtë segment.

Tërmetet - Në hartën e elementeve të rrezikut të bashkisë, janë hedhur vatrat e tërmeteve kryesore, të cilat mund të jenë brenda territorit të qarkut, ose në afërsi të tij, por që ka ndikuar në territorin e bashkisë Pogradec. Këto tërmete janë klasifikuar si historike (tërmete të rëna që nga lashtësia deri në vitin 1900) dhe tërmete të matur instrumentalisht (tërmete të rëna nga viti 1900 deri sot). Në këtë zonë janë gjeneruar tërmete të forta, si me 18 Shkurt 1911 në liqenin e Ohrit me $M(\text{magnitudo}) = 6.7$ shkallë rihter dhe intensitet $I_0=9$ ballë, më 28 Janar 1931 $M=5.8$ shkallë rihter dhe $I_0= 8-9$ ballë, tërmet tjetër është regjistruar me 26 Maj 1960 me $M=6.4$ shkallë rihter dhe $I_0=8-9$ ballë në Korçë. Me 18 Janar 1958 është regjistruar tërmeti me $M= 4.7$ shkallë rihter dhe $I_0=6-7$ ballë. Më 12 Qershor 1995 me $M=3.0$ dhe thellësi 10 km (Koçiaj, S. 1976; Muço, B. 1996).

Duke patur parasysh lidhjen ose jo të elementeve të rrezikut gjeologjik me kriterin morfologjik, elementet e rrezikut gjeologjik i kemi ndarë në dy grupe:

1) Rrezikun që vjen nga aktiviteti tektonik në rajonin e studimit, gjë që reflektohet me sasinë dhe intensitetin e tërmeteve që ndodhin në territor, pavarësisht nga kushtet gjeologo-inxhinierike të trojeve të ndërtimit. Bazuar në këtë kriter territori është ndarë në 4 nenzona:

- Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet VI ballë
- Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet VII ballë
- Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet VIII ballë
- Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet IX ballë




Fig. –2 Harta e Rrezikut Gjeologjik, Pogradec (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

2) Rrezikun që vjen nga fenomenet gjeodinamike të shpateve. Është gama tjetër e fenomeneve të rrezikut gjeologjik të mara në konsiderate, të cilat lidhen ngushtësisht me ndarjet e sektoreve me bazë kriterin morfologjik.

a. Sektori pa zhvillim të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili përputhet me njësinë fushore. Në hartë, ky sektor paraqitet me ngjyrë jeshile. Pjerrësia e trojeve të këtij sektori nuk i kalon 2° . Këtu futet fusha e Bucimasit, Pogradecit. Në këtë sektor, me përjashtim të brigjeve të shtreterve aktuale të lumenjve dhe përrenjve, nuk priten as në të ardhmen zhvillime të elementeve të rrezikut gjeologjik. Për këtë arsye, ai konsiderohet si një sektor i qetë dhe jo kërcenues ndaj ndërtimeve që kryhen në të.

b. Sektori me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili i përket njësisë kodrinore dhe malore, por që në të nuk gjejnë përhapje të madhe fenomenet e rrezikut gjeologjik. Në hartë ky sektor paraqitet me ngjyrë të verdhë, duke zënë pjesën më të madhe të territorit të bashkisë. Ndërtimet që bëhen në këtë sektor për momentin janë të pa cenuara, por që në të ardhmen, si rezultat i prishjes së ekuilibrit të shpatit, apo avancimit të zonave nën erozion, pjesë të këtij sektori mund të klasifikohen si sektori me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik.

c. Sektori me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili i përket njësisë kodrinore dhe malore, por që në të gjejnë përhapje të madhe fenomenet e rrezikut gjeologjik. Në hartë ky sektor paraqitet me ngjyrë të kuqe. Në hartë, pjesë e këtij sektori, janë konturuar sipërfaqet e rrëshqitjeve të ndodhura e të njohura deri tani, zonat e shëmbjeve (subsidence) në fushat minerare të shfrytëzuara, si dhe sipërfaqet e zonave nën erozion. Duke patur

parasysh dinamiken e shpateve, ky sektor tenton të rritet dhe të fitojë sipërfaqe të reja nga sektori

Rreziqet nga tektonikat dhe neoteknikat aktive

Nga pikëpamja tektonike, kemi të bëjmë njëherësh me disa zona tektonike të mëdha, që përbëjnë element të madh strukturor në Albanide. Si pjesë përbërëse e saj, rajoni në studim preket nga forcat tektonike orogjenike. Shkëputjet tektonike janë shume aktive dhe në reliev shprehen me kontraste të theksuara. Pasojë e tyre janë dhe levizjet, megjithëse jo të shpeshta sizmike, që trondisin zonën. Si pjesë përbërëse e një strukture neogenike në zhvillim, zona në studim është e prekur nga forcat tektonike orogjenike. Shkëputja tektonike vepron në kuadrin e regjimit aktiv ngjeshës, në kohët e sotme Holocenike paraqitet me ritme më të ulta të aktivitetit. Theksojme se, shkëputja nga thellësia dhe në vetvete shpreh njëherësh dhe aktivitetin sizmik të rajonit.

Risqe nga lëkundjet e tjera të tokës

Duke u bazuar në ballafaqimin sizmotektonik të mësipërm rezulton se zona e shkëputjeve sizmogjene ka gjeneruar në të kaluarën dhe mund të gjenerojë edhe në të ardhmen tërmete me potencial sizmik të pritshëm $M_{max}=6.0-6.9$.

- Zona në studim ndodhet jo larg nga thyerjet tektonike, që mund të gjenerojnë lëkundje të tokës në formën e tërmeteve;
- Zona në studim ndodhet pranë rezervuarëve e liqeneve ujorë, që mund të shkaktojë lëkundje të tokës;
- Zonat në studim përgjithsisht ndodhen në, mbi dhe pranë tokave të mbushura me dhera të hedhura, që mund të shkaktojë lëkundje të tokës;
- Zonat në studim ndodhen edhe mbi formacione me shkëmbinj magmatik, ku nuk është e mundur të shkarkojnë ujëra nëntokësorë, dhe bëjnë që të mos shkaktohen lëkundje të tokës;

Megjithatë, parimi më i mirë për një investitor është të ndërtojë një godinë të mirë edhe pranë qendrës së tërmeteve sesa një godinë të dobët larg tij.


Risku i lëngëzimit të truallit

Procesi i lëngëzimit të truallit ndodh, si në rastet kur formacioni përbëhet ose ndërtohet prej ranorëve ose rërave, dhe në rastet kur ai përbëhet prej argjilave, të cilat në rastet e tërmeteve ose të lëkundjeve të tokës për shkaqet e sipërmendura bëhen shkak për lëvizje të reja subsidente ose lëvizje të tokës në formë rrjedhjeje. Shpesh këto procese lidhen me mungesën e një migrimi anësor të ujërave, duke bërë që të ushtrohet presion për të dalë lart, duke lëngëzuar në këtë mënyrë rërat. Tërmeti i ndihmon akoma më shumë këto procese. Lëngëzimi i argjilave ndodh, kur zëvendësohen porët me ujëra të kripura me ujëra të ëmbla, kur struktura argjilore dobësohet shumë dhe gjatë tërmeteve ose vibrimeve transformohet në masë viskoze, që rrjedh në drejtimin poshtë. Në rastin tonë përqasen raste nga këto probabilitete, duke i dhënë vlera pozitive ndikimeve prej këtyre parametrave. Megjithatë, investitori duhet të jetë i kujdesshëm në këqyrjen dhe marrjen e masave pararendëse, si në vlerësimin e ngjarjeve të vogla sizmike, çlirimin e gazit radon, ndryshimi i nivelit të ujërave nëntokësorë, sjelljen dhe reagimin e kafshëve, fryrjen e pjerrësive, fryrjen e sipërfaqeve etj.

5. Përdorimi i Tokës dhe Infrastruktura

5.1 Sistemet në territorin e bashkisë Pogradec

Figura 64. Sistemet territoriale bashkia Pogradec



Burimi: Corine, AKPT, përpunoi IDRA, 2016

Burimi i materialeve të përdorura për të gjeneruar hartat e përdorimit të tokës, janë materialet e marra AKPT, ASIG, dhe materialet nga *Corine*², të mundësuar nga AKPT në fillim të projektit, të cilat në vijim janë pasuruar e përditësuar nga grupi punës pranë IDRA gjatë vizitave të shpeshta në terren e konsultimeve me specialistët në Bashkinë Pogradec dhe Njësitë Administrative.

Në territorin e Bashkisë Pogradec, për shkak edhe të diversitetit të relievit, vihet re një mbizotërim i dukshëm i sistemit natyror (63 %), i cili ndahet në pyje, toka me vegjetacion të ulët e kullota. Sistemi bujqësor (18 %), i dyti në sipërfaqe ndërthurret shpesh me Sistemin Ujqor (15.5%) e me atë Urban (2.5%), gjë që vihet re sidomos në zonën Pogradec-Buçimas. Sistemi infrastrukturor zë rreth 1% të sipërfaqes territoriale të përgjithshme të Bashkisë Pogradec.

SISTEMI NATYROR

² Programi Corine është një nismë e ndërmarrë në vitin 1985 nga Bashkimi Europian. Corine nënkupton "Coordination of Information on the Environment" (Koordinim i informacionit për mjedisin) dhe është një program prototip, i cili përfshin një inventar të përdorimit të tokës, të ndarë në 44 klasa, që prezantohet si prodhim hartografik në shkallë 1:100 000 dhe është operacionale për pjesën më të madhe të Europës.

Sistemi natyror zë pjesën më të madhe të territorit administrativ të Bashkisë Pogradec me një shtrirje në rreth 74% të të gjithë sipërfaqes. Ky sistem ka në përbërje të tij një sferë të gjerë zonash të mbrojtura, me një larmishëmi të veçantë në shkallë rajoni, nga të cilat më të spikaturat janë zona bregliqenore me një sipërfaqe prej 27323 dhe monumentet e ndryshme të natyrës.

Zhvillimi i zonave të ndryshme të këtij sistemi do të bëhet në përputhje me direktivat dhe objektivat strategjike të këtij plani si dhe të planeve të menaxhimit të mjedisit natyror në vijim.

Objektivat strategjike për këtë sistem përmbajnë:

- Rritjen e zonave të gjelbra dhe përcaktimin e detyrimit për ripyllëzimin e zonave të çpyllëzuara, për të frenuar degradimin e mëtejshëm të territorit dhe frenuar erozionin.
- Rigjenerimin e parqeve periferike
- Zhvillimin e zonave bujqësore dhe përcaktimin e zonave të agro-turizmit
- Krijimin e parqeve bujqësore të frutave
- Rivitalizimin e monumenteve natyrore dhe ngritjen e politikave të zhvillimit ekonomik në funksion të stimulimit të ruajtjes dhe promovimit të tyre.
- Rizhvillimin e ekosistemeve dhe ruajtjen dhe rigjenerimin e biodiversitetit në zonat natyrore.
- Përcaktimi i politikave të qarta në funksion të trajtimit të zonave me rrezik natyror.
- Përcaktimin e qartë të përdorimit të tokës sipas nënkategorive pjesë përbërëse të sistemit natyror.

SISTEMI BUJQËSOR

Sistemi bujqësor zë një pjesë të konsiderueshme të territorit administrativ, rreth 21% të sipërfaqes administrative të Bashkisë Pogradec.

Nënkategoritë e përdorimit të tokës pjesë përbërëse të këtij sistemi përfshijnë drufrutorët dhe tokat bujqësore, të cilat formëzojnë dhe një nga dy shtyllat kryesore ekonomike për më tepër se gjysmën e popullsisë rurale të Bashkisë Pogradec.

Nga analiza e territorit u vërejt një mbivendosje e zonave urbane dhe tokave bujqësore të cilat u trajtuan me kujdes duke përkufizuar me skrupulozitet risaktësimin e tyre duke përkufizuar zonat e reja bujqësore në ndërveprim me territoret e tjera, pjesë të sistemeve të ndryshme territoriale.

Objektivat strategjike për këtë sistem përmbajnë:

- Zhvillimin e zonave bujqësore dhe përcaktimin e zonave të agro-turizmit
- Krijimin e parqeve bujqësore të frutave
- Rikualifikimin dhe rizhvillimin e infrastruktures në funksion të sistemit bujqësor, kanalet vaditëse dhe sistemeve të kullimit të ujërave, si një ndërhyrje me përparësi për rikualifikimin e ekonomisë të ndërlidhur me këtë sistem.
- Kategorizimi i zonave bujqësore sipas informacionit dhe hierarkisë në bazë të tipit të prodhimit dhe shkallës së rëndësisë në treg dhe planin e investimeve

SISTEMI UJOR

Sistemi ujqor ze 109km² nga sipërfaqja totale ë territorit administrativ të Bashkisë Pogradec, ku liqeni ka rolin më të rëndësishëm të lidhur me ekonominë lokale në shumë dimensione.

Objektivat strategjike për këtë sistem përmbajnë:

- Zhvillimin e sistemeve të trajtimit të ujërave të zeza, në mënyrë që të ulet ndotja në ujërat e liqenit.
- Ndaljen e shkarkimit të mbeturinave në lumenj dhe përrenj
- Krijimin e infrastrukturës ndihmëse në trajtimin dhe sistemimin e ujërave malor për frenimin e përmytjeve të zonave urbane dhe tokave bujqësore
- Zhvillimin e pikave pejsazhike dhe udhetimit pedonal apo çiklistik në pjesën bregliqenore.

SISTEMI URBAN

Sistemi urban zë një rreth 4% të të gjithë territorit administrativ të Bashkisë Pogradec, me përqëndrimin më të madh të tij në pjesën bregliqenore, ku në ndryshim me bashkitë e pjesës të bregut perëndimor të Republikës të Shqipërisë, vetëm rreth 40% e popullsisë shtrihet në zonat urbane dhe rreth 60% në zonat rurale.

Në këtë drejtim, zhvillimi urban i zonave rurale e ka ndryshuar pak karakterin e tij sipas vendbanimeve të trashëguara ndër vite, ndërsa në zonat urbane është tjetërsuar kryesisht nëpërmjet zhvillimit në lartësi në pjesën bregliqenore të qytetit të Pogradecit dhe banesave individuale informale në pjesët e tjera të territorit suburban.

Në procesin e analizës së territorit janë evidentuar dhe përkufizuar zonat urbane duke sintetizuar formëzimin e tyre në trajta të qarta grupimesh duke stimuluar prioritizimin e infrastrukturës së munguar në zhvillimin urban të shpërhapjes në zonat e reja urbane apo sub-urbane dhe rihvillimin e infrastrukturës të munguar apo degraduar në ato ekzistuese.

Popullsia e territorit administrativ të Bashkisë Pogradec, ndonëse ka pësuar rritje të pakta në zonat urbane në këto vite, ka pësuar rënie, qoftë për shkak të emigracionit dhe levizjeve të brëndshme demografike ashtu dhe për shkak të fronteve të pakta të punës. Kjo rënie parashikohet të vazhdojë dhe për 10 vjeçarin e ardhshëm, gjë e cila ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë me politikat e rihvillimit ekonomik të kësaj bashkie.

Shërbimet janë vlerësuar dhe ndonëse ka nevojë për rihvillim të shërbimeve të shëndetësisë dhe sigurisë, është evidentuar një shtrirje e mirë e shërbimit arsimor në territor e cila kërkon kryesisht programe administrimi për përshtatjen e shërbimit konform kërkesave bashkëkohore.

Objektivat kryesore strategjike për këtë sistem përmbajnë:

- Trajtimin e rigjenerimit ekonomik nëpërmjet përcaktimit të politikave ekonomike të përshtatshme për situatën aktuale të Bashkisë Pogradec
- Rihvillim të sistemit urban dhe ristrukturim të strukturës ekzistuese me vlera historike dhe kulturore për zonën

- Ristrukturim dhe rikualifikim të sipërfaqes urbane të kompaktësuar në zonat rurale
- Përmirësim i cilësisë të jetës në strukturën urbane me anë të ndërhyrjeve në infrastrukturë inxhinierike dhe atë të shërbimeve
- Përmirësim i cilësisë të jetës në strukturat urbane nëpërmjet zhvillimit të politikave konkrete në mbështetje të zhvillimit cilësor konform kërkesave bashkëkohore, stimulimit të zhvillimit të ekonomisë dhe turizmit
- Rritje të standarteve në shërbime
- Krijimin e parqeve të reja urbane në funksion të aktiviteteve rekreative dhe kulturore të ndërlidhura me mjedisin natyror dhe ekologjik
- Identifikimin dhe përcaktimin e politikave të zhvillimit të qendrave lokale dhe poleve komunitare
- Përcaktimin e kriterëve bazë për mënyrat e ndërhyrjes në territor
- Evidentimin e planeve konkrete të prioritizimit të ndërhyrjeve në infrastrukturë dhe strukturën ekzistuese nëpërmjet identifikimit të projekteve konkrete
- Ngritjen e sistemit të të dhënave në sferën shumëdimensionale të planifikimit të shërbimeve e cila lejon përditësim të vazhdueshëm dhe rritjen e kapaciteteve logjistike në administratë publike në funksion të këtij shërbimi.

SISTEMI INFRASTRUKTUROR


Sistemi infrastrukturor zë një pjesë të pakonsiderueshme të territorit në kontekst territorial, por shumë të rëndësishëm në kontekst administrativ.

Territori i bashkisë Pogradec përbëhet nga disa akse të rëndësishme rrugore kombëtare, si: rruga nacionale Tiranë – Korçë një aks i rëndësishëm që lidh kryeqytetin me rajonin juglindor, e cila shtrihet përgjatë vijës liqenore dhe shërben për transportimin e pasagjerëve dhe mallrave. Një aks tjetër i rëndësishëm është ai “Qukës – Qafë Plloçë” i cili tashmë ka filluar të ndërtohet dhe që do të bëjë një lidhje më efikase të kryeqytetit me Bashkinë e Pogradecit dhe Korçës.


SISTEMI NATYROR



SISTEMI BUJQËSOR



SISTEMI UJOR



SISTEMI URBAN




SISTEMI INFRASTRUKTUROR



5.2 Përdorimi i tokës në bashkinë Pogradec

Figura 65. Përdorimi i tokës bashkia Pogradec



Burimi: Corine, AKPT, Përpunoi IDRA

Figura 66. Përdorimi i tokës në qytetin e Pogradecit

Tokë natyrore	44321 ha
Ujëra	10918 ha
Bujqësi	12350 ha
Toke bujqesore ne zone urbane	220 ha
Infrastrukturë	367 ha
Banim	1850 ha
Industri edhe ekonomi	100 ha
Arsim - Shëndetësi	11 ha
Institucione	6 ha
<i>Gjithesëj (sip tokësore dhe ujore e bashkisë)</i>	70300 ha




Tabela 10. Përdorimi i tokës i shprehur në përqindje


Analiza e përdorimit të tokës është hartuar në bazë të kërkesave ligjore të Ligjit të Planifikimit 107/2014 dhe VKM 671 “Rregullorja e Planifikimit të Territorit”. Analiza e përdorimit të tokës është trajtuar sipas kategorive dhe nënkategorive bazë të përdorimit të tokës ndërsa hartëzimi i materialit është kryer në sajë të të dhënave të mara nga Corine, nëpërmjet AKPT dhe azhurnimit të materialit nga vizitat në terren dhe analizimit me ekspertët e grupit. Pjesa më e madhe e territorit të bashkisë përbëhet nga kategoria e përdorimit natyror dhe dhe atij bujqësor si dhe banim. Në hartën e përdorimit të tokës janë evidentuar kategori përdorimi si hekurdha, infrastruktura rrugore, ujëra, varreza, arsim, industri dhe ekonomi, institucione, shëndetësi si dhe zona mirerare. Vihet re një përhapje më e madhe e kategorive të arsimit dhe institucioneve në zonën urbane të qytetit të Pogradecit.

5.3 Infrastruktura rrugore

Në këtë seksion do të shqyrtohet sistemi i infrastrukturave rrugore në tërësi, duke marrë në konsideratë klasifikimin e rrjetit rrugor, analizimin e gjendjes ekzistuese, shtrirjen, llojin e transportit, lidhjet infrastrukturore etj.

Aktualisht bashkia Pogradec është një nyje e rëndësishme në rrjetin kombëtar dhe ndërkombëtar të transportit si pjesë e Koridorit VIII , Rrugës Egnatia dhe Transportit Ujor Ndërkufitar në Liqenin e Ohrit . Si pjesë e korridorit VIII ai bën pjesë në aksin hekurudhor dhe rrugor Durres- Vlorë – Rrogozhin-Elbasan-Prenjas-Pogradec.

Figura 67. Infrastruktura kombëtare



Territori i bashkisë Pogradec përbëhet nga disa akse të rëndësishme rrugore kombëtare të cilat e ndihmojnë atë për t'u lidhur me rajonet e tjera fqinje. Në bashkinë Pogradec shtrihet rruga nacionale Tiranë – Korçë një aks i rëndësishëm që lidh kryeqytetin me me rajonin juglindor. Kjo rrugë në territorin e bashkisë shtrihet përgjatë vijës liqenore në periferi si dhe futet në brendësi të qytetit. Ky është një aks i rëndësishëm për transportimin e pasagjerëve dhe mallrave.

Një aks tjetër i rëndësishëm është ai “Qukës – Qafë Plloçë” i cili tashmë ka filluar të ndërtohet dhe që do të bëjë një lidhje më efektive të kryeqytetit me Bashkinë e Pogradecit dhe Korçës.

Gjithashtu vlen të përmendet edhe linja hekurudhore Elbasan – Prrenjas - Pogradec e cila pavarësisht se sot është jashtë funksionit është një potencial i madh për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të territorit të bashkisë.

Mënyrat e transportit në bashki dhe linjat

Viti	Motomjet e	Automjet e	Autobu s	ATP	Kamjon	ATV	APV	Rimorki o	Mak Bujq	Mak Tek	Kamping	MR V	Total
2011 ¹⁷	103	3097	88	479	324	24	84	94	5	15	0	0	4313
2012	98	2705	68	404	223	19	74	90	3	13	0	0	3711
2013	94	2547	66	382	242	18	72	86	3	13	0	0	3823
2014	97	2584	61	372	239	19	59	76	3	13	0	0	3523
2015	143	4784	91	554	282	32	90	108	5	15	0	0	6104

Mënyrat e transportit që përdoren aktualisht sipas kategorizimit të bazuar në KRR në Bashkinë Pogradec janë: lëvizja në këmbë, lëvizja me mjete (autovetura) private, lëvizje e kufizuar me bicikleteqë, mungon shërbimi public qytetas, i cili është konsideruar nga Bashkia si “**jo efektiv**”, përdoren aktualisht transporti me autobus ndërmjet qytetit të Pogradecit dhe ishkomunave dhe transpordi me autobus ndërqytetas. Ekzistojnë dy linja kryesore ajo e rrjetit të linjave të transportit publik dhe linjat ndërqytetase.

a. Linjat ndërqytetëse

- Linja “Pogradec – Tiranë – Pogradec”. Ka **4 orare** dhe punojnë **7 mjete** me nr. total 120 vende.
- Linja “Pogradec – Durrës – Pogradec”. Ka vetem **1 orar** dhe punon **1 mjet** me 13 vende.
- Linja “Pogradec – Korçë – Pogradec”. Ka **6 orare** dhe punojnë **13 mjete** me nr. total 212 vende.
- Linja “Pogradec – Prrenjas – Pogradec”. Ka **6 orare** dhe punojnë **4 mjete** me 48 vende.

b. Linjat Rrethqytetëse

- Linja “Alarup-Bletas – Blacë – Pogradec”. Ka **5 orare** dhe punon **1 mjet** me 56 vende.
- Linja “Dardhas – Pogradec – Dardhas”. Ka **4 orare** dhe punon **1 mjet** me 14 vende.
- Linja “Nizhavec – Pretushë – Çërravë – Pogradec – Çërravë – Pretushë – Nizhavec“. Ka **19 orare** dhe punojnë **4 mjete** me 56 vende.
- Linja “Pogradec – Lin – Pogradec”. Kjo linjë ka **13 orare** dhe punojnë **5 mjete** me nr.total 82 vende.
- Linja “Rëmenj – Pogradec – Remenj”. Ka **18 orare** dhe punojnë **3 mjete** me nr.total 32 vende.
- Linja “Velcan – Pogradec – Velçan”. Ka **6 orare** dhe punojnë **6 mjete** me nr. total 86 vende.
- Linja “Proptisht – Pogradec – Proptisht”. Punojnë **9 mjete** me një orar me nr. total 135 vende.
- Linja “Tushemisht – Pogradec – Tushemisht”. Ka **8 orare** dhe punojnë **2 mjete** me nr total 35 vende.

Mjete nga linja të tjera që vijnë në Qytetin e Pogradecit

- Tiranë – Pogradec. Punojnë **4 mjete** me një orar me **80 vende** në total. (bileta me çmim 450 lekë)
- Durrës – Pogradec. Punon **1 mjet** me një orar me mbi **30 vende**. (bileta me çmim 150 lekë)
- Prrenjas – Pogradec. Punon **1 mjet** me **15 vende** dhe me 4 orare. (bileta me çmim 100 lekë)

Stacionet e grumbullimit sipas tipeve të mjeteve

1. Të gjitha mjetet tip autobus grumbullohen tek sheshi i autobusave (Axsensia). Autobusët janë të linjave ndërqytetese dhe rrethqytetëse.
2. Mjetet tip Furgona 8+1 taksi kanë tre stacione parkimi. Një stacion në fillim të rrugës “Gani Butka” dhe dy stacione tek rruga Kajo Karafili.
3. Mjetet taksi 4+1 kanë 2 stacione qëndrimi. Një stacion në krye të rrugës “Rinia” dhe një stacion perballë sheshit të autobusave.

Verifikimi i cilësisë të infrastrukturës rrugore

Nga analiza përgjithësuese mund të nxjerrim disa tregues domethënës për rrjetin rrugor të Qytetit të Pogradecit duke ju referuar dhe hartave të emërtimit të rrugëve, skemës të qarkullimit ,apo dhe hartës të klasifikimit të rrjetit rrugor¹⁸ .

Figura 68. Tregues mbi rrjetin rrugor

Kartela NR	Emërtimi i Rrugës	Gjatesia m	Gjerësia	Struktura	Trotuare ml	Tabela	Parkime
1	RESHIT ÇOLLAKU 1	844	10.4	pllaka bet	D 608 M 830	E13 T11, S14 T 2	D 72 M 67
2	RESHIT ÇOLLAKU 2	382	7.2	pllaka bet	D 345 M 332	E22 T16 S 12	D 50 M 39
3	Taulantet	550	8	pllaka bet	M 510(210 pllaka300 natyrale))	0	0
4	"Mulla Suli"	340	8	Asp i dem	M 270 (natyrale)	0	0
5	Drimone	650	8	Asp i dem	M 451ml natyrale	0	0
6	14 Marsi	400	8	Asp i dem	D182(32 pllake ,150 natyrale) M247(62beton,26pllaka,189nat	0	0
7	Motrat Qiria	730	8	Asp i dem	D123(76pll demtuar, 47 naty) M220(33pll,55,pll dem,32 naty)	S S2	0
8	"Kajo Karafili"	1054	9.5	Asp i dem	D 440 ml M 598	E20 ,T14 , S 26,T 5	0
9	Gani Butka	403	9.2	Asphalt	D 337 ml M 393	E10 ,T8 ,S 5 ,T 2	D 53 Majtas 0
10	RRUGA e Korçes	692	9	Asphalt	D 440 ml M 598	E25 ,T18 , S 4 T 4	D24

Ashtu si edhe evidentohet në tabelën e mësipërme duket qartë se pjesa më e madhe e rrugëve të paraqitura në kartelë janë të pajisura me trotuar¹⁹ ndërsa cilësia e rrugëve varjon nga rrugë të shtruara me asfalt deri në rrugë të pashtruara.

Tipologjia e rrugëve

Rrjeti rrugor përfaqëson pjesën me vitale dhe me delikate të një zone urbane, duke e konsideruar si një organizëm të gjallë që është vazhdimisht i “ushqyer” me njerez , mallra , energji , informacion . Rrjeti urban rrugor është i ndarë në tre kategori rrugeshe: primare(te përshejtimit), sekondare (rrjedhese) dhe të treta (te lagjeve dhe lokale)

Rruget Primare Jane rruget me funksione hyrese dhe dalese nga qyteti dhe ne sherbim te Transportit te kembimit ndermjet territorit urban dhe ekstra urban, si dhe te Transportit transit perkundrejt zonave urbane. Ne kategorinë e rrugeve primare Urbane perfshihen:

Autostradat Urbane – Seksionet e te cilave i kemi rekomanduar per ndertimin e By-Paseve te qytetit te Pogradecit ;

Rruget primare rrjedhese –fukcioni i te cilave eshte garantimi i fluiditetit te zhvendosjes ë kembimit te automjeteve edhe rrjetit të qarkullimit brenda qytetit. Ato lejojnë një nivel të lartë të sherbimit të zhvendosjes ne distanca me te medha brenda rrjetit urban. Ne kete kategori rrugesh bejne pjese rruget e shpejta urbane, rruget me shpejtesi te kufizuar urbane, itineraret e rezervuara te mjeteve publike te krijuara ne korsite e rrugeve te rezervuara dhe nga rruge me korsit te rezervuara.


Rruget Sekondare ose **Rruget e lokale** jane rruge urbane me kapacitet te mesem dhe te larte, me funksionet e meposhteme:

- mbledhjen/shperndarjen e trafikut ndermjet rrugeve primare dhe linjat me kapacitet te ulet te rrjetit
- nen -lidhjet me njesite bashkiake te qytetit

Rruget e lokale me funksion lidhes ndermjet lagjeve fqinje (cvendosje ne distanca minimale, gjithmone brenda qytetit) ose per zonat urbane me dimensione me te medha, ndermjet pikave ekstreme te lagjeve. Ne kete kategori hyjne, rruget e destinuara per sherbimet kryesore urbane te lagjeve.

Rruget e treta jane rruget urbane me kapacitet te ulet me hyrje lokale per ne njesite administrative

Figura 69. Sistemi rrugor, Bashkia Pogradec



Burimi: AKPT, përpunoi IDRA, 2016

Linja hekurdhore

Linja hekurdhore në bashkinë Pogradec sot është jashtë funksionit por ashtu si edhe u përmend edhe më sipër përbën një potencial të madh për zhvillimin ekonomik të bashkisë. Lidhur me këtë sot ekzistojnë disa nisma strategjike dhe zhvillimore. Një prej tyre është ajo e planifikimit të studimit të fizibilitetit²⁰ për lidhjen e hekurudhës së Shqipërisë me Maqedoninë nëpërmjet linjës hekurdhore Lin – Strugë²¹.

Ne kuadrin e programit të Qeverisë për periudhën 2003-2005 për paraprirjen e zhvillimit të transportit, në vecanti duke i kushtuar vëmendje për rigjallërimin e hekurudhës dhe të mundësive të zgjerimit të saj, për vitin 2003 në matricën e temave studimore dhe të projekteve për transportin. Qeveria ka përfshirë dhe planifikuar kryerjen e Studimit të fizibilitetit për lidhjen e hekurudhës të Shqipërisë me Maqedoninë.

Vlerësimi i nevojës së transportit hekurdhore dhe i zhvillimeve të tij, në kuadrin e përgjithshëm të transportit ka rëndësi, në çdo sistem ekonomik-shoqëror për impaktet pozitive të zhvillimit të vendit dhe të plotësimit të nevojave të grupeve të ndryshme shoqërore të popullsisë. Si, në vendet e Europës Perëndimore, ashtu edhe në Europën Lindore, por edhe në vendet e Rajonit të Ballkanit, kujdesi për hekurudhën dhe mbështetjen e saj ka qenë realisht më i lartë dhe i mbrojtur nga fenomenet negative të vërejtura në vendin tonë, gjatë periudhës së tranzicionit.

Vlerat e arritura dhe të njohura, si dhe cilësitë e transportit hekurdhor, si transport i shpejtë masiv, i sigurtë, më i lirë, komodo, i pastër nga pikpamje ekologjike, plotikat e Komunitetit Europian që

mbeshtesin zhvillimin dhe modernizimin e hekurudhave, si edhe ekzistenca e nje infrastrukture hekurudhore, mjeteve hekurudhore dhe nje baze materilo-teknike relativisht jo e paket nevoiten, mbi bazen e studimeve te gjinden mundesi dhe tregje te transporti te brendeshem dhe lidhje me jashte per shfrytezimin me parametra te larte tekniko-shfrytezonjes dhe te rritjes se eficenses se transportit, nepermejt haromonizimeve te tij.

Me zhvillimet ekonomike ne vitet e fundit,ne kuader te bashkepunimit ekonomik dhe te tregtise se lire ne vendet e rajonit te Ballkanit,te zhvillimeve integrues ne kuader te Paktit te Stabilitetit dhe SECI-it, transportet me hekurudhe per e nga Maqedonia,si dhe mundesine ekzistuese tranzite e hekurudhes shqiptare per ne detin Adriatik merr nje prioritet te rendesishem dhe perben nje faktor determinues per t'u studjuar eperiste ekonomike dhe shoqerore te kesaj lidhje.

Lidhja e hekurudhes shqiptare me territorin maqedones,per te bere te mundur pritjen dhe nisjen e mallrave nga territori i Maqedonise ka rendesi dy fishe.

Se pari, zhvillon mundesite e hekurudhes per nje shtet te dyte,duke hapur dritaren per levizjen e mallreve midis dy vendeve ne kuader te marreveshje te tregtise se lire dhe shfrytezimin e hapsireve tranzite ne distance dhe me kosto me te ulet.

Se dyti, paraprin zhvillimit te hekurudhes ,ne kuader te detyrave te lidhjes se se te gjithë gjatesise se linjes hekurudhore te Korridorit e 8-te, per lidhjen me hekurudhe te portit te Durresit me portin Burgas dhe Varna..

Studimi parashikon te realizoje transportin hekurudhore me rrjetin ekzistues te linjes hekurudhore per segmentin nga Port i Durresi deri ne Lin, me linjat e dyte eksituese ne stacione hekurudhore gjate gjithe linjes, si edhe duke shfrytezuat rrjetin ekzistues te linjave ne Portin Detar te Durresit.

Studimi i fizibilitetit do te perqendrohet ne leverdishmerin e varainteve te ndryshem qe do te ndertohen per te realizuar lidhjen ne pjesen shqiptare deri ne kufi dhe me shtrirje deri ne pjesen e pales maqedones.

Studimi do te analizoje e do te marre ne konsiderate edhe mundesine e perdorimit te hekurudhes shqiptare per levizjen e mallrave nga Maqedonia per ne Malin e Zi.

Analiza, shqyrtimi dhe integrimi i ketyre tre elementeve, fillimisht ne transportin hekurudhore te mallrave dhe ne perspective edhe ne transportin e udhetareve, duke pare peshen specifike dhe impaktin e pergjithshem ne hekurudhe,si edhe ne konteksin e e ndikimit dhe te raporteve apo perpjestimeve te deges se transportit me zhvillimet makro-ekonomike te vendit.

Mundesite e rritjes se trafikut per e nga maqedonia, mund te te shqyrtohet edhe impakti i levzjes se tranave, ne funksion te teknologjive te shfrytezimit hekurudhore nepermjet marrjes e lenies se vagoneve ne disa vagona te rendesihem.

Studimi i fizibilitetit te lidhjes se hekurudhes Shqiperi - Maqedoni do te synoje te arrije objektivat kryesore, ne lidhje me:

- ❖ Mundesite e infrastruktures te rrjetit ekzistues te linjes hekurudhore, te nderlidhjes,te sinjalizimit dhe te stacioneve per segmentin Durres-Lin per te realizuar levizjen e trenave

- sipas trafikut te mundeshem qe krijohet nga lidhja e saj me territorin e maqedonise(duke formuar nje kompleks porti i lagur-porti i thate)
- ❖ Te identifikoje dhe te vlersoje varaintet dhe nenvaraintet e linjave per ndertimin e rid dhe realizimin e lidhjes se linjes ekzistuese deri ne kufi (dhe deri ne stacionin e Struges),sipas kuotave te pranueshme dhe qe i paraprijne perspektives.
 - ❖ Te analizoje dhe te vlersoje infrastrukturen e linjes se rrjetit hekurudhore se bashku me stacionet hekurudhore nga Porti i Duresit deri ne Stacionin e Linit, se bashku me nderlidhjen dhe sinjalizimin, si dhe te identifikohen nevojat e nderhyrjen me emergjente.
 - ❖ Te vlersoje veprimtarine e transportueseve ne funksion te mbulimi te shpenzimeve per investimin e ndertimit te lidhjes deri ne kufi,ne Qaf-Thane,sipas varianteve dhe te operimeit .
 - ❖ Te percaktoje trafikun dhe kerkesat ne perspective per lvizjen e mallrave ne perspektive dhe strukturen e tyre.
 - ❖ Te analizoje mjetet hekurudhore te nevojeshme per perballimin e trafikut ne studim, si edhe mundesite e perfhsirjes se mjeteve hekurudhore sipas inventarit dhe gjendjes teknike disponuese.
 - ❖ Te percaktoje hapsirat dhe mundesine per zhvillimin e transportin intermodal.
 - ❖ Te nxirren e perllogaritet treguesit e fizibilitetit ekonomik te liddjes dhe te ndikit te lidhjes ne permiresimin e parametrat ekonomike-financiare ne transportin hekurudhor.
 - ❖ Te percaktoje planin e veprimit dhe rruget per te realizuar perfundimet e studimit.
 - ❖ Te shqyrtoje impaktin hekurudhes ne transportin shqiptare dhe refleksionin e tij ne zhvillimet makro-ekonomike dhe sociale te vendit.




Studimi i fizibilitetit te lidhjes se hekurudhes shqiptare me maqedonine do te beje analiza dhe disa çeshtje qe lidhen me anen teknike dhe operacionale ne kushtet e nevojës se kryerjes se investimeve kapitale te lidhjes dhe te ndonje pjese emergjente, me qellim arrije ne normalitet e kushtezuar te rrjetit hekurudhore perkates per kryerjen e transportit

nderkombetarsi edhe te shprehi vemdjen per te ardhmen qe te operoje sipas standarteve me te avancuara dhe me moderne Nderkombetare dhe Europiane per rendimentin, sigurine, seriozitetin, performancen dhe vjeljen e te ardhurave.


PLANIMETRIA E HEKURUDHES SHQIPERI - MAQEDONI


ALTERNATIVA I, VARIANTI BAZE DHE ALTERNATIVA II, VARIANTI I



PLANIMETRIA E HEKURUDHES SHQIPERI - MAQEDONI

ALTERNATIVA I, VARIANTI BAZE DHE ALTERNATIVA II, VARIANTI II





Nr	Emertimi i Punimeve	Njesia	Alternativa e I	Alternativa e dyte		
				Varianti me dalje tuneli	Varianti 160 m thelesi	Varianti i 230m thelesi
1	Gjatesia e linjes	Km	3.60	1.65	1.68	1.75
	Nga kjo:					
a	Linja kryesore	Km	2.76	1.65	1.68	1.75
b	Linja te dyta	Km	0.84	-	-	-
2	Tunel	Km	-	-	0.20	0.40
3	Trase	Km	2.76	1.65	1.48	1.35
	Nga kjo					
a	Ne liqen	Km	-	0.70	0.40	-
4	Vepra arti	Cope	14	4	6	7
5	Punime dheu e shkambi	M ³	90.000	140.000	110.000	70.000
6	Linja telefonike kablllore	Km	2.76	12.15	12.15	12.15
7	Kosto	Milion €	5.2	5.786	5.45	6.4

Lidhja hekurudhore mes Shqiperise dhe Maqedonise (Struge) ne kete material eshte trajtuar me dy alternativa me variantet perkatese, te cilat jane si me poshte:

1. Lidhja nga Stacioni Lin.
2. Lidhja direkte nga tuneli i Qafe Thanës.

Te dyja alternativat do te trajtohen jo thjesht si lidhje me stacionin e perpunimit (Portit te Thate) Struge por si pjese perberese e korridorit te VIII hekurudhor.


Te dyja alternativat me variantet e tyre perkatese pavaresisht nga gjurma e ndertimit te tyre, pika e takimit ne kufirin me Maqedonine do te jete e njejte.

Por duke marre parasysh kohen e gjate qe nga koha e kryerjes te ketij studimi (2003) dhe ndryshimet e ndodhura gjate ketyre viteve ne Rajonin e Ballkani (referuar Raporteve te pervitshme Shumvjecare SEETO 2004 – 2015) ky studim duhet te perditesohet nga MIT dhe IST

Seksioni Lin – Pogradec Rendesia e ketij seksioni varet ne progresin e lidhjes te rrjetit hekurudhor Shqiptar me rrjetin hekurudhor Grek me ane te rruges Pogradec – Korçe – Follorine, e cila nuk ekziston . Ne rast se kjo rruge nuk do te shkoje ne Korce, atehere eshte e nevojshme te oshtirjra e rruges me 5 km nga stacioni ekzistues Pogradec ne qytetin e Pogradecit; riorganizohet si vijon:

- rritet shpejtesia në 80 km për orë;
- elektrifikohen linja .

Durrës – Lin, Pogradec (Kufiri me Maqedonin) Ky segment ka një potencial të madh për efekt të lidhjes qe mund të vendos me Maqedonin. Duke kaluar nëpërmjet zonës industrial në Elbasan, ky segment përfundon aktualisht ne Lin (Pogradec), 2.7 km nga kufiri Maqedonin . Kosto e përgjithëshme për këtë segment vlersohet 150 Milion Euro Në këtë zonë mund të ngrihet një “Interport” I cili mund të përpunoj mallra që vijnë me transport hekurudhor për tu shpërndarë në Shqipërin juglindore , në Maqedoni dhe në Greqi



Po keshtu detyrimisht duhet te mbeshtetemi ne SEETO 2015 per projektet e rrjetit rrugor te korridorit VIII ,Investimet në Rrjetin e pergjithshëm të transportit SEETO nëTotal kanë qënë parashikuar €9.3 billion që nga viti 2004

- 5.1 billion euro jane disbursuar ne periudhen 2004–2012;
Investimet ne SEETO jane shperndare per perjudhen 2004–2012 si me poshte :

- 84% ne sektorin rrugor;
- 7.3% (€ 370 million) ne sektorin hekurudhor .
- Jane lidhur marveshje per te financuar dhe 4.2 billion € , per perjudhen ne vazhdim nga te cilat
- 82% e investimeve do te shkojne ne sektorin rrugor
- 16% do te shkojne ne sektorin hekurudhor

Lidhja nëpërmjet ujit

Figura 70. Liqeni i Ohrit



Bashkia Pogradec ka mundësi për zhvillimin e linjave të transportit ujor nëpërmjet liqenit të Ohrit si për qëllime turistike ashtu dhe për shërbime transporti për territorin që laget nga ujrat e liqenit ashtu dhe për zonën ndërkufitare Bashkia Pogradec. Megjithatë sot moli i qytetit nuk e ofron këtë shërbim dhe ka nevojë për rikonstrukcion.

Linja Ujore Ohër - Strugë - Pogradec është miratuar në parim nga kërret e bashkive vite më parë, por pavarësisht kësaj, burokracitë e ndryshme qeveritare bënë që projekti në fjalë të zvarritej dhe të mbetej për një kohë të gjatë vetëm në letër.

Analiza dhe vlersimi i kapaciteteve egzistuese te qarkullimit

Duke ju referuar shkallës aktuale të motorizimit (numrit të automjeteve për 1000 banorë), treguesve të kërkesës për mobilitet urban të motorizuar kundrejt përmasave të shtrirjes dhe forms dhe përmasave të qytetit , shpërndarjes të vëndeve të punimit, çerdheve, kopshteve dhe shkollave kapacitetet qarkulluese të qytetit²² nuk përbëjnë problem, ndërkohë që duhet të shikohet me kujdes problem i parkimeve, sidomos në periudhën e sezonit turistik dhe fundjavës, por edhe gjatë gjithë vitit. Nga ana tjetër në territorin e bashkisë nuk ekziston një sistem i transportit publik. Prandaj është e nevojshme të rivlerësohet edhe njëherë sistemi i transportit publik edhe ai i parkimeve publike.

5.4 Rrjetet inxhinierike të Infrastrukturës

5.4.1 Të dhëna mbi infrastrukturën e rrjetit elektrik

Lidhja e përdoruesve të energjise elektrike të qytetit të Pogradecit në anën e tensionit 110 kV me sistemin elektroenergjetik të Shqipërisë realizohet me nënstationin elektrik me tension 110 kV, në të cilin ka dy transformatorë dhe pjesërisht me nënstationin elektrik të Gurit të Kuq.

Nënstationi 110/10 kV i Pogradecit është i lidhur me linjën elektro-transmetuese (me tension 110kV) Elbasan-Korçë, pra me ushqim të njëanshem, d.m.th. vetëm nga Elbasani.

Në “nyjen” transformuese me tension 110/10 kV në nënstationin elektrik të qytetit ekzistojnë dy transformatorë me tension 110/10 kV, me fuqi 10 000 kVA dhe 5 600 kVA. Aktualisht ata janë të ngarkuar rreth fuqisë nominale të tyre, duke u paraqitur si pengesë në mundësinë e furnizimit me energji elektrike të përdoruesve, për periudhën afatshkurter e veçanërisht afatmesëm të zhvillimit të qytetit.

Duhet theksuar që nënstationi elektrik i Gurit të Kuq ndodhet larg qendrës së qytetit dhe sot ky nënstation e ka humbur funksionin e vet²³. Rrjeti shpërndarës i tensionit të mesëm të Pogradecit është 10 kV. Në këtë rrjet shpërndarës (10 kV) nuk është arritur furnizimi i dyanshëm në të gjitha kabinat, d.m.th. nuk është arritur që çdo kabinë, në rast nevojë (difekt, punime rimonti, etj) të ketë mundësi furnizimi nga dy fidera të tensionit 10 kV, që dalin nga dy seksionet e ndryshme të zbarave me tension 10 kV të nënstationit elektrik të Pogradecit. Rrjeti ekzistues i T.M., i ndërtuar që nga viti 1968 është me linja ajrore dhe kabllore. Seksionet e linjave në rrjetin shpërndarës të T.M. nuk lejojnë në rast nevojë rezervim të plotë të furnizimit me energji elektrike të përdoruesve ekzistues reciprokisht nga dy fidera të ndryshëm, sepse në rrjetin kabllor seksionet e përcjellsave janë Cu 35, 25mm² dhe Al me 50 mm².

5.4.2 Të dhëna mbi rrjetin e ujesjellesit

Burimi i furnizimit me ujë

Pogradeci furnizohet me ujë nga burimi Kabash me debit të pakët dhe kryesisht nga burimet e Tushemishtit. Burimi ka një debit 150 l / sek. dhe ushqen me ujë, përveç qytetit të Pogradecit edhe fshatrat Vërdovë dhe Tushemisht. Uji kalon në një depo me kapacitet 2000 m³. Stacioni i pompimit, për shkak të vjetërsisë dhe amortizimit të tij është në gjendje të keqe dhe ka nevojë për zëvendësim. Për furnizimin me ujë të qytetit, mungon një studim i mirëfillte hidrogeologjik. Skema e furnizimit përfshin 6 rezervuare, me kapacitet total të depozitimit 3 920 m³, që përbën 1/3 e kërkesës mesatare ditore. Rezervuaret janë me kushte mesatare pune, tre nga të cilët rrjedhin dhe kanë nevojë për zëvendësim të veshjes mbrojtëse. Edhe instalimet hidraulike, veçanërisht saraçineskat, kanë rrjedhje. Rrjeti shpërndarës përbëhet nga tubacione me dimensione dhe materiale të ndryshme. Ka tuba çeliku, gize, xingato deri në plastike. Një pjesë e tubacioneve të gjendjes ekzistuese kanë nevojë të zëvendësohen ose përforcohen.


5.4.3 Të dhëna mbi rrjetin e kanalizimit të ujrave të zeza

Bashkia e Pogradecit për trajtimin e ujërave të zeza, është mbështetur me projekte nga Qeveria Gjermane. Ujërat e zeza të këtij Qyteti janë të sistemuara dhe e kanë Impjantin përkatës të perpunimit të tyre. Ato mblidhen në kolektor që në hyrje të qytetit, pranë buzës së Liqenit deri në afërsi të 1 Majit (stacionit të pompimit). Rreth 3 km larg ndodhet impianti I perpunimit, në Guras-Zagraçan, i cili përfundon pranë fshatit Vërdovë dhe linja tjetër është ajo Tushemisht- Drilon, e cila lidhet me impiantin në Guras. Megjithatë vlen të përmendet se territoret e ish- komunave nuk i kanë të sistemuara kanalizimet e ujërave të zeza dhe nuk janë pjesë e sistemit të Impajntit të Pastrimit. Këtu bëjnë pjesë territoret e ish- komunave të zonës së Mokrës por edhe njësia administrative e Hudënishtit e cila ka dalje të drejtpërdrejtë në liqenin e Ohrit.

5.5. Analiza e periferialitetit

Analiza e periferialitetit përmban në thelb të saj analizimin e zonave më periferike të territorit të bashkisë Pogradec. Kjo analizë shërben për të parë se cilat zona në territorin e bashkisë Pogradec janë më pak të shërbyera, pra cilave iu ofrohen më pak shërbime publike, cilat zona kanë probleme të tjera sociale etj. Elementët bazë që analizohen në këtë seksion janë largësia nga qendrat e territorit urban, largësia nga zonat ekonomike, lidhja me rrjetin rrugor, furnizimi me infrastrukturë, niveli i kriminalitetit, probleme të ndryshme sociale, plotësimi me funksione sipas kategorive bazë të përdorimeve të tokës. Në këtë seksion më të përkohës fokusimi është dhënë aspekteve fizike të lidhjes me infrastrukturë ndërkohë që elementë të tjerë socialë janë trajtuar në seksionin zhvillimi social dhe ekonomik.

Figura 71. Shpërndarja e dëndësisë demografike në njësitë administrative të Bashkisë Pogradec



Paraprakisht mund të themi se vetë qyteti i Pogradecit si poli kryesor i zhvillimit të Bashkisë Pogradec është një qytet me përmasa të vogla (gjatësi jo më shumë se 3.5 km dhe gjërësi më pak se 1.5 km) që favorizon lëvizjen në këmbë ose me bicikleta, si dhe zona e Bucimasit si zonë me një dëndësi më të lartë të dëndësisë demografike dhe në afërsi të vetë qytetit dhe me një shtrirje të konsiderueshme në bregun e liqenit është e favorshme për shtrirjen e rrugëve të këmbësorve dhe të

Tabela 11. Periferialiteti (infrastruktura)

bicikletave ,nga të cilat nuk mund të përjashtohen dhe njesit administrative të Hudenishtit dhe Ceravës të cilat na nxisin për të promovuar dhe transportin public urban ne gjithë këtë teritor që përmëndëm më sipër.

Nj. Admin.	Qyteti/Fshati	Distanca nga Qendra e Nj.A.			Distanca nga Bashkia		
		hapësirë (km)	kohë (orë) (minuta)		hapësirë (km)	kohë (orë) (minuta)	
		-		-	-		
Pogradec							
Buçimas							
	Buçimas	0	0	0	2.5	0	5
	Bahçallëk	3	0	5	5	0	10
	Gështënjas	3.3	0	10	4.8	0	15
	Gurras	3.7	0	12	6.5	0	15
	Peshkëpi	12	0	20	14.8	0	40
	Remenj	2.6	0	7	3.3	0	10
	Tushemisht	4.6	0	10	6.1	0	12
	Vërdovë	2.5	0	10	1.4	0	7
Çërravë							
	Çërravë	0	0	0	11	0	15
	Alarup	9.9	0	10	20.3	0	30
	Blacë	7.6	0	10	17.1	0	25
	Bletas	10.3	0	15	19.2	0	30
	Grabovicë	2.9	0	5	12.2	0	20
	Kodras	6	0	10	17	0	25
	Leshnicë	2.5	0	5	9.1	0	10
	Lumas	2.1	0	10	13	0	25
	Nizhavec	7.1	0	15	18	0	30
	Pretushë	5.8	0	7	14.9	0	20
	Qershizë	11.1	0	2	23.9	0	15
Dardhas							
	Dardhas	0	0	0	12.6	0	25
	Derdushë	15.2	0	25	25.1	0	50
	Grunjas	18.5	0	45	23.8	1	10
	Lekas	14.2	0	25	27	0	50
	Nicë	20.9	0	45	29.7	1	10
	Osnat	16.3	0	30	25.9	0	55
	Preisht	10.2	0	25	21.4	0	50
	Stërkanj	23.4	0	35	32	1	0
	Stropckë	3.5	0	8	10.4	0	35
Proptisht							
	Proptisht	0	0	0	42.8	1	30
	Baribardhë	9.3	0	30	45.3	1	45
	Golik	7	0	15	36.2	1	15
	Homçan	8.5	0	30	48.6	1	40
	Homezh	17.6	1	0	44.7	1	40

Kriçkovë	3.3	0	10	43.3	1	25
Rodokal Poshtë	10.4	0	40	38.2	1	15
Rodokal Sipër	13.5	0	45	40.2	1	25
Selcë e Poshtme	5.5	0	20	41.5	1	30
Selishtë	11.3	0	40	46.9	1	40
Slabinjë	5.4	0	15	48.1	1	45
Slatinë	7.3	0	30	43.6	1	35
Somotinë	1.8	0	5	44.4	1	35
Vërri	2.8	0	5	40	1	20
Zalltore	12.3	0	35	42.7	1	30
Trebinjë						
Trebinjë	0	0	0	20.3	1	30
Çezmë e Madhe	7.6	0	45	26	2	20
Çezmë e Vogël	8.5	0	50	26.7	2	30
Dunicë	7.8	0	40	19.9	1	20
Guri i Bardhë	8.2	0	50	21.5	1	30
Hondisht	11.8	1	0	30	2	0
Hoshtecë	6.2	0	50	27.3	2	30
Kalivaç	4.5	0	20	16.4	1	0
Llëngë	17.8	1	30	20.4	1	30
Malinë	2	0	10	19.2	1	20
Pevelan	1.8	0	5	20.1	1	25
Pleshisht	2.8	0	20	23.3	2	0
Potgozhan	2.7	0	15	17.7	1	10
Selcë e Sipërme	6.9	1	0	28.1	2	40
Zemcë	6	0	30	26.3	2	0
Udenisht						
Udenisht	0	0	0	7.6	0	10
Buqez	10.5	0	10	17.1	0	20
Çervenakë	9	0	25	11	0	35
Lin	13	0	10	20	0	20
Memlisht	3.9	0	7	4.3	0	7
Piskupat	9.4	0	7	15.8	0	15
Velçan						
Velçan	0	0	0	54.1	3	0
Bishnicë	9.8	0	30	60.9	3	30
Buzahishtë	3.5	0	20	53.6	3	20
Jollë	17.7	1	45	60.5	4	30
Laktesh	5.8	0	25	48.6	2	10
Losnik	3.5	0	20	53.8	2	30
Senishtë	8.9	1	30	63.2	4	0
Shpellë	14.9	0	45	65.2	3	45

Në tabelen e mësipërmë jepen treguesit e dipendencës për të gjithë njësit administrative të Bashkisë të Re Pogradec ,nga ku rezulton se distance në kohë nga qendra varion nga 5 min. në 60 minuta . Në seksionin e mëposhtëm është trajtuar çdo njësi administrative për të analizuar më në detaj

periferialitetin e fshatrave të njësive administrative me qendrën e njësisë. Kështu janë analizuar lidhjet infrastrukturore që këto fshatra kanë me çdo qendër njësie si dhe nga qendra e Bashkisë Pogradec (qyteti), duke evidentuar në këtë mënyrë kohën e arritjes në qendër si dhe gjatësitë e rrugës në km.

Njësia administrative Dardhas

Figura 72. Harta e periferialitetit për NjA Dardhas




Tabela 12. Distancat për Nj.A Dardhas

Qyteti/Fshati	Distanca nga Qendra e Nj.A.			Distanca nga Bashkia		
	hapësirë (km)	kohë (orë) (minuta)		hapësirë (km)	kohë (orë) (minuta)	
Dardhas	0	0	0	12.6	0	25
Derdushë	15.2	0	25	25.1	0	50
Grunjas	18.5	0	45	23.8	1	10
Lekas	14.2	0	25	27	0	50
Nicë	20.9	0	45	29.7	1	10
Osnat	16.3	0	30	25.9	0	55
Prenisht	10.2	0	25	21.4	0	50
Stërkanj	23.4	0	35	32	1	0
Stropckë	3.5	0	8	10.4	0	35

Figura 74. Rrugët fshati Stropckë**Figura 73. Rruga për në fshatin Stropckë**

Njësia administrative e Dardhës është e lidhur mirë për nga ana infrastrukturore me fshatrat përbërës të saj. Duket se distanca më e largët nga qendra e njësisë është ajo me fshatin Niçë, vetëm 20 km. Gjithsesi evidentohet se gjendja cilësore e rrugëve është e mirë vetëm në rrugët kryesore ndërsa pjesët e tjera janë të pasfaltuara. Për shembull është vënë re se nga vizitat në terren rezulton se rruga nga fshati Stropckë deri tek Guri i Kamjes është e pashtuar dhe ka nevojë për kryerjen e investimeve. Kësaj duhet t'i vihet fokus i veçantë për aq kohë sa Guri i Kamjes është një pikë atraktive turistike për zonën.

Njësia administrative Trebinjë

Njësia administrative Trebinjë është një nga njësitë me problemet më të mëdha për sa i përket lidhjeve infrastrukturore. Investimet në ish – komunën Trebinjë kanë qënë të pakta dhe sot gjendemi para një situatë ku rruga kryesore lidhëse Pogradec – Vërdovë – Trebinjë është në gjendje të degraduar si dhe rrugët e tjera lidhëse me fshatrat e tjerë të njësisë janë po aq në gjendje të degraduar. Kjo shpjegon dhe kohën e madhe që duhet për të arritur në qendrën e kësaj njësie dhe fshatrat e tjerë. Kështu për të shkuar nga qyteti i Pogradecit drejt fshatit Trebinjë duhet 1 orë ndonëse distanca është vetëm 20 km ndërsa për të shkuar në fshatin Cezmë e Madhe nevojitet 2 orë ndonëse fshati është vetëm 6 km larg fshatit Trebinjë.




Fig. 47 Rruga për në fshatin Kalivaç

Figura 75. Lidhjet infrastrukturore për NjA Trebinjë

Nj. Admin.	Qyteti/Fshati	Distanca nga Qendra e Nj.A.			Distanca nga Bashkia		
		hapësirë (km)	kohë		hapësirë (km)	kohë	
		(km)	(orë)	(minuta)	(km)	(orë)	(minuta)
Trebinjë							
	Trebinjë	0	0	0	20.3	1	30
	Çezmë e Madhe	7.6	0	45	26	2	20
	Çezmë e Vogël	8.5	0	50	26.7	2	30
	Dunicë	7.8	0	40	19.9	1	20
	Guri i Bardhë	8.2	0	50	21.5	1	30
	Hondisht	11.8	1	0	30	2	0
	Hoshtecë	6.2	0	50	27.3	2	30
	Kalivaç	4.5	0	20	16.4	1	0
	Llëngë	17.8	1	30	20.4	1	30
	Malinë	2	0	10	19.2	1	20
	Pevelan	1.8	0	5	20.1	1	25
	Pleshisht	2.8	0	20	23.3	2	0
	Potgozhan	2.7	0	15	17.7	1	10
	Selcë e Sipërme	6.9	1	0	28.1	2	40
	Zemcë	6	0	30	26.3	2	0

Tabela. Distanca nga NjA Trebinjë dhe Bashkia

Njësia administrative Proptisht

Njësia administrative Proptisht është një nga njësitë administrative malore e cila ka probleme arritshmërie dhe aksesit megjithatë jo në nivelin e NjA Trebinjë. Ndonëse fshatrat kryesorë janë dy herë më larg (në kilometra), referuar qendrës së bashkisë Pogradec ato aksesohen vetëm për 1 orë e 30 min. Në këtë nivel arritshmërie janë edhe fshatrat e tjerë përbërës të njësisë.

Tabela 13. Distancat NjA dhe bashkia Pogradec

Nj. Admin.	Qyteti/Fshati	Distanca nga Qendra e Nj.A.			Distanca nga Bashkia		
		hapësirë (km)	kohë (orë) (minuta)		hapësirë (km)	kohë (orë) (minuta)	
Proptisht	Proptisht	0	0	0	42.8	1	30
	Baribardhë	9.3	0	30	45.3	1	45
	Golik	7	0	15	36.2	1	15
	Homçan	8.5	0	30	48.6	1	40
	Homezh	17.6	1	0	44.7	1	40
	Kriçkovë	3.3	0	10	43.3	1	25
	Rodokal Poshtë	10.4	0	40	38.2	1	15
	Rodokal Sipër	13.5	0	45	40.2	1	25
	Selcë e Poshtme	5.5	0	20	41.5	1	30
	Selishtë	11.3	0	40	46.9	1	40
	Slabinjë	5.4	0	15	48.1	1	45
	Slatinë	7.3	0	30	43.6	1	35
	Somotinë	1.8	0	5	44.4	1	35
	Vërrri	2.8	0	5	40	1	20
	Zalltore*	12.3	0	35	42.7	1	30

Figura. 48 Harta e periferialitetit për njësinë administrative Proptisht




Figura 76. Harta e periferialitetit për njësinë administrative Velçan




Fig. 51 Rruga hyrëse në fshatin Velçan



Fig. 51 Rrugë në fshatin Velçan




Fig. 51 Qendra shëndetësore në Velçan

NjA Velçan është një nga njësitë administrative më të skajshme të bashkisë Pogradec dhe për pasojë përmban edhe probleme arritshmërie. Për të shkuar nga qendra e bashkisë Pogradec drejt Velçanit dhe fshatrave përreth nevojitet minimalisht tre orë pavarësisht se distanca është vetëm 54 km. Ndërsa për të shkuar në Senisht nevojiten 4 orë për të përshkuar 63 km ndërkohë për të shkuar drejt fshatit Jollë nevojiten rreth 4 orë e gjysëm.

Tabela 14. Distancat për NjA Velçan

Nj. Admin.	Qyteti/Fshati	Distanca nga Qendra e Nj.A.			Distanca nga Bashkia		
		hapësirë (km)	kohë (orë) (minuta)		hapësirë (km)	kohë (orë) (minuta)	
Velçan							
	Velçan	0	0	0	54.1	3	0
	Bishnicë	9.8	0	30	60.9	3	30
	Buzahishtë	3.5	0	20	53.6	3	20
	Jollë	17.7	1	45	60.5	4	30
	Laktesh	5.8	0	25	48.6	2	10
	Losnik	3.5	0	20	53.8	2	30
	Senishtë	8.9	1	30	63.2	4	0
	Shpellë	14.9	0	45	65.2	3	45

Figura 77. Periferialeteti Cërravë




Njësia administrative Cërravë është një nga njësitë administrative me lidhjen më të mirë rrugore të bashkisë Pogradec. Kjo për vetë faktin se gjashtë nga nëntë fshatra të njësisë shtrihen përgjatë rrugës nacionale Pogradec – Korçë. Por edhe fshatrat e tjerë që gjenden larg saj siç janë Blaca, Bletasi dhe Alarupi kanë një lidhje të mirë me rrugën kryesore dhe pjesën qendrore të njësisë. Fshati më i largët referuar qendrës së bashkisë Pogradec është fshati Qershizë me vetëm 24 km.

Nj. Admin.	Qyteti/Fshati	Distanca nga Qendra e Nj.A.		Distanca nga Bashkia	
		hapësirë (km)	kohë (minuta)	hapësirë (km)	kohë (minuta)
Cërravë					
	Cërravë	0	0	11	15
	Alarup	9.9	10	20.3	30
	Blacë	7.6	10	17.1	25
	Bletas	10.3	15	19.2	30
	Grabovicë	2.9	5	12.2	20
	Kodras	6	10	17	25
	Leshnicë	2.5	5	9.1	10
	Lumas	2.1	10	13	25
	Nizhavec	7.1	15	18	30
	Pretushë	5.8	7	14.9	20
	Qershizë	11.1	2	23.9	15

Tabela 15. Distancat për NjA Cërravë

Njësia administrative Udënisht

Figura 78. Harta e periferialitetit Udënisht



Njësia Udënisht është një njësi e cila ka një lidhje shumë të mirë me qendrën e bashkisë Pogradec dhe gjendet shumë pranë rrugës nacionale Tiranë - Pogradec. Rrugët lidhëse janë kryesisht në gjenje të mirë por megjithatë Nj.A Udënisht pothuajse nuk ka asnjë lidhje komunikimi me Nj.A Udënisht dhe Trebinjë ndonëse gjenden në kufi të saj. Udënishti mund të lidhet me këto njësi nëpërmjet Nj.A Buçimas dhe rrugës së Katjelit në bashkinë Prenjas.

Tabela 16. Distancat për Nj.A Udënisht

Nj. Admin.	Qyteti/Fshati	Distanca nga Qendra e Nj.A.		Distanca nga Bashkia	
		hapësirë (km)	kohë (minuta)	hapësirë (km)	kohë (minuta)
Udënisht					
	Udënisht	0	0	7.6	10
	Buqez	10.5	10	17.1	20
	Çervenakë	9	25	11	35
	Lin	13	10	20	20
	Memlisht	3.9	7	4.3	7
	Piskupat	9.4	7	15.8	15

Njësia administrative Buçimas

Figura 79. Distancat për Nj.A Buçimas




Tabela 17. Periferialiteti Buçimas

Nj. Admin.	Qyteti/Fshati	Distanca nga Qendra e Nj.A.		Distanca nga Bashkia	
		hapësirë (km)	kohë (minuta)	hapësirë (km)	kohë (minuta)
Buçimas					
	Buçimas	0	0	2.5	5
	Bahçallëk	3	5	5	10
	Gështënjas	3.3	10	4.8	15
	Gurras	3.7	12	6.5	15
	Peshkëpi	12	20	14.8	40
	Remenj	2.6	7	3.3	10
	Tushemisht	4.6	10	6.1	12
	Vërdovë	2.5	10	1.4	7

Njësia administrative Buçimas ka një lidhje shumë të mirë me qendrën e bashkisë, por edhe rrugët nacionale, por megjithatë mbart edhe probleme të tjera. Fshati Peshkëpi është fshati më pak i arritshëm në kohë pasi ndonëse ai gjendet vetëm 15 km nga qendra e bashkisë ai mund të arrihet për 40 minuta. Kjo për faktin se infrastruktura rrugore është e degraduar dhe ka nevojë për investime. Edhe rrugë të tjera si ajo drejt Vërdovës kanë nevojë për ndërhyrje pasi kufizojnë lidhjen e shpejtë me qendrën.

5.6 Analiza e tipologjisë hapësinore


TIPOLOGJI KRYESORE TË STRUKTURAVE URBANE

Gjatë studimit të zonave urbane në territorin administrativ të Bashkise Pogradec, u vu re një përdorim i tipologjive të ndryshme urbane të zhvilluara përgjatë të gjitha zonave të banimit, ku kryesisht tipologjitë e strukturave shumëfamiljare ishin të vendosura në qytetin e Pogradecit, aty ku dhe gjendet shumëllojshmëria më e madhe e tipologjive të strukturave urbane, me ndonjë përjashtim në Tushemisht dhe Lin.

Ndërsa në zonat urbane të rajonit, gjendet një tipologji strukturash kryesisht e formuar me struktura banimi të tipit një-familjare, të lidhura dhe të veçuara.

Një përmbledhje e strukturave urbane tipike të vërejtura gjatë skanimit të territorit është evidentuar në vijim:

Banesa të tipit një-familjare, të lidhura, të grupuara në rresht pjesërisht:



Banesa të tipit një-familjare, të veçuara:



Banesa shumë familjare, lineare, të vendosura në linjë me rrugën kryesore:



Banesa shumë familjare, lineare të vendosura përpendikular me rrugën kryesore:



Banesa shumë familjare, lineare të vendosura me kënd me rrugën kryesore:



Banesa shumë familjare, e tipit kullë:



Banesa shumë familjare, e tipit kullë, me terraca:



Banesa shumë familjare, të tipit bllok i mbyllur:



Megjithatë, në masë, procesi i zhvillimit apo rizhvillimit të hapësires urbane është i formuar nga një proces mbushje urbane e cila në formë dhe përmbajtje ka rezultuar në një trajtë zhvillimi të pa kornizuar nga principet formale të planifikimit dhe projektimit.

Territori administrativ i Bashkisë Pogradec është një territor i cili në pjesën urbane të qytetit të Pogradecit përbëhet nga sipërfaqe komplekse sistemesh hapësinore, karakteristike kjo e të gjitha qyteteve të urbanizuara Shqiptare.

Nje tipologji hapësinore është një tërësi karakteristikash të unifikuara për një grup elementesh apo strukturash. Kështu, një grup ndërtesash të tipit kullë, me lartësi 5-8 kate, përbëjnë një tipologji.

Gjithashtu, një grup fshatrash të shtrirë linearisht në lidhje me një rrugë kryesore formojnë një tipologji. Edhe një zonë me rrjet rrugor kuadratik përbën një tipologji të caktuar.

Pra për përcaktimin e një tipologjie urbane ka një sërë kriteresh të cilat angazhohen për të përfituar një përfundim vlerësimi në lidhje me tipologjinë specifike urbane e cila merret në shqyrtim. Në rastin e qytetit të Pogradecit, është ndjekur kriteri i njëtrajtshmërisë të llojit të volumit të strukturave, së bashku me mënyren e vendosjes së tyre në territor.

Qyteti i Pogradecit si shumë qytete të tjera Shqiptare, kanë probleme të definicionit të një tipologjie të pastër homogjene, hapësinore, si pasojë e ndërtimeve informale në njërën anë, dhe të ndërtimeve formale por pa strategji konkrete planifikimi në anën tjetër.

Për rrjedhojë grupimet në vijim do të japin vetëm një vlerësim tipologjik të mënyres së grupimit të strukturave urbane të cilat formesojnë një tipologji e cila mbizotëron në zonën specifike të marre në shqyrtim, për ta evidentuar si tipologji hapësinore në hapësirën territoriale këtë fragment.

Zona e evidentuar në figurën në vijim, përkufizohet si një tipologji hapësinore e formuluar nga objekte lineare banimi, shumëfamiljare, të larta.

Figura 80. Objekte lineare banimi




Zona e evidentuar në figurën në vijim, përkufizohet si një tipologji hapësinore e formuluar nga objekte individuale banimi, njëfamiljare, të ulëta:

Figura 81. Objekte individuale banimi



Zona e evidentuar në figurën në vijim, përkufizohet si një tipologji hapësinore e formuluar nga struktura me përdorim të përzier, banimi dhe shërbime:

Figura 82. Banim dhe shërbime



Zona e evidentuar në figurën në vijim, përkufizohet si një tipologji hapësinore e formuluar nga struktura me densitet të ulët, të tipit informal:

Figura 83. Struktura me densitet të ulët informal



Zona e evidentuar në figurën në vijim, përkufizohet si një tipologji hapësinore e formuluar nga struktura që formulojnë një zonë ekonomike, e përbërë nga magazina dhe punishte:

Figura 84. Zonë ekonomike



Zona e evidentuar në figurën në vijim, përkufizohet si një tipologji hapësinore e formuluar zona bujqësore me zhvillim të shpërhapur, kryesisht informal:

Figura 85. Zhvillim i shpërhapur informal




Zona e evidentuar në figurën në vijim, përkufizohet si një tipologji hapësinore e zonë industriale:


Figura 86. Zonë industriale




Keto ishin tipologjitë kryesore hapësinore të ndodhura pranë territoreve të urbanizuara, të cilat në karakteristika përkufizojnë disa tipologji hapësirash të cilat janë përgjithësisht në proces formimi.




Përqindja e banesave të ndërtuara **përpara vitit 1960**




Përqindja e banesave të ndërtuara **në periudhën 1961-1980**



Përqindja e banesave të ndërtuara **në periudhën 1981-1990**



Përqindja e banesave të ndërtuara **në periudhën 2001-2005**



Përqindja e banesave të ndërtuara **në periudhën 2006-2011**

Legjenda

- | | |
|--|---|
| 0 - 5 | Lum |
| 6 - 10 | Rrugë |
| 11 - 15 | Det / Liqen |
| 16 - 20 | Aglomerati 2011 |
| 21 - 25 | Kufiri Administrativ |
| 26 - 30 | Relievi |
| 31 - 100 | |

Burimi: INSTITUTI I STATISTIKAVE,
Censuri i Popullësisë dhe Banesave 2011

5.7 Analiza e cilësisë së strukturave dhe territoreve

Kjo është një analizë e cila ka për qëllim analizimin e strukturave të territorit për të marrë masa për ndërhyrjet e rehabilitimit fizik, rigjenerimit, rihvillimit apo programe të tjera që do të ndërmeren gjatë propozimeve të planit.

Për të përcaktuar gjendjen fizike të këtyre objekteve janë përdorur hartat e vjetra ushtarake të bashkisë Pogradec dhe territoreve të ish- komunave, hartat e zhvillimit në vite të bashkisë, analiza e tipologjisë, të dhëna të tjera nga bashkia si dhe analizimi i strukturave në terren nëpërmjet vizitave në territorin e bashkisë.

Zonat/objektet/ strukturat do të ndahen në mënyrë të përgjithshme sipas klasifikimit: në gjendje shumë të mirë, gjendje e mirë, gjendje e degraduar, shumë e ndotur, e ndotur, e shtruar, e pashtuar, në rrezik përmbajtje, rrezik tërmeti etj. Të gjitha kategorizimet do të bëhen në varësi të gjendjes aktuale dhe llojit të strukturës.

Analizimi i hapësirave publike në bashkinë Pogradec

Në territorin e bashkisë Pogradec gjenden një tërësi hapësirash publike të tipologjive të ndryshme dhe të dimesioneve të ndryshme gjithashtu. Një nga hapësirat publike më të rëndësishme në qytetin e Pogradecit është shëtitorja 1 Maji e cila sot është në gjendje të mirë dhe e mirëmbajtur, por megjithatë në vazhdim mund të ketë nevojë për ndërhyrje rehabilituese për të shtuar elementë dizajni, çlodhëse, korsi biçikletash apo mjedise parkimi. Megjithatë problematika shfaqen në hapësirën publike të Oktapodit si dhe në hapësirën publike pas Hotel 1 Majit. Hapësira publike e Oktapodit është komplet e degraduar, duke përmendur këtu objektin e Oktapodit, Turizmin e vjetër si dhe banesa individuale në gjendje jo të mirë. E gjithë kjo zonë ka nevojë për ndërhyrje rehabilituese, për të përmirësuar hapësirën publike, për t'a lidhur atë me pjesën tjetër të shëtitores përgjatë liqenit dhe për ta kthyer atë në një hapësirë në funksion të zhvillimit të turizmit liqenor dhe turistik. Probleme hasen edhe në hapësirën publike pas 1 Majit dhe veçanërisht në hapësirën përballë godinave qeveritare. Kjo hapësirë ka nevojë për ndërhyrje pasi sot ajo konsiston vetëm në një hapësirë e mbjellë me bar dhe e rrethuar nga disa banesa 1 katëshe banimi.

Figura 87. Zona e Oktapodit Pogradec



Hapësirat publike si hapësira përpara bashkisë, apo bulevardi pranë saj apo hapësira e shatervanit përballë “Llakmanëve” janë në gjendje të mirë dhe janë hapësira publike të suksesshme. Megjithatë nga vizitat në terren është evidentuar një problem i cili lidhet me mungesën e hapësirave publike në lagjet e banimit, mungesën e trajtimit të tyre apo zaptimi i tyre nga ndërtimet. Këto hapësira publike pothuajse mungojnë ose kur janë kthehen në hapësira parkimi nga banorët.

Figura 88. Hapësira publike Pogradec

Në lidhje me hapësirat publike në njësitë e tjera administrative, vlen të thuhet se NjA Buçimas (fshati Tushemisht) dhe NjA Lin (fshati Lin) janë të vetmet fshatra në të cilat mund të identifikohen hapësira publike në formën e shesheve apo qendrave urbane. Këto janë investime të kryera në kohët e fundit dhe përbëjnë një destinacion turistik për vizitorët në këto zona. Në njësitë e tjera mund të flitet vetëm

për hapësira publike në formën e fushave të sportit të shkollave apo shesheve pranë godinave të njësive administrative.

Figura 89. Qendër Tushemisht

Figura 90. Hapësira publike Pogradec

Cilësia e strukturave dhe territoreve në bashkinë Pogradec

Lidhur me cilësinë e territoreve në bashkinë e Pogradecit vlen të analizohen territoret e pikave të nxehta mjedisore, zonat e depozitimit të mbetjeve si dhe zonat e ish fabrikave të industrisë minerale. Lidhur me këto duhet të theksohet se zona e Gurit të Kuq ka nevojë për ndërhyrje emergjente për ndotjen që këto territore mbartin si dhe efektin që ka në mjedis, liqenin e Ohrit dhe turizmin liqenor. Gjithashtu duhet të rehabilitohen hapësirat e depozitimit të mbetjeve në Peshkëpi dhe zonat e tjera të njësive vendore. Në vëmendje duhet të jenë dhe zonat ku është zhvilluar industria minerale para viteve 1990, si ajo e Alarupit apo e Cervenakës.

Territore të tjera të cilat kanë nevojë për ndërhyrje pasi ndodhen në gjendje të degraduar janë shtretërit e lumenjve dhe zonat e gjelbërta përreth tyre. Zonat përgjatë lumit të Vërdovës kanë problem të shumta në lidhje me përmytjet për vetë faktin se shtrati I lumit të Vërdovës është i mbushur nga inertet në vite si dhe është ndërtuar, dhe është shpyllëzuar. Këto territore kanë nevojë për ndërhyrje emergjente. Në zonë nuk duket të ketë problem me zonat të cilat janë prekur apo kanë tendencën të preken nga tërmete të fuqishme.

Figura 91. Zona në përmbytje, Vërdovë



Figura 92. Guri i Kuq, Pogradec



Lidhur me cilësinë e strukturave në bashkinë Pogradec vlen të thuhet se objektet e ndërtuara para viteve 1980 (shiko hartën e mëposhtme) në përgjithësi kanë nevojë për ndërhyrje për përmirësimin e cilësisë fizike të tyre. Kjo është e nevojshme si në zonat e banuara në qytetin e Pogradecit ashtu edhe në zonat e banimit të njëjësive të tjera administrative.

Figura 93. Banesa të ndërtuara në vitet 1961 - 1980




Figura 94. Banesa të ndërtuara para viteve 1960






Figura 95. Banesa 2006 - 2011



Megjithatë duhet thënë se viti i ndërtimit të banesave nuk është detyrimisht një faktor final tregues pasi ka rezultuar se edhe banesat e ndërtuara në vitet 2006 – 2011 kanë probleme me cilësinë e tyre sidomos në rastet kur banesat janë ndërtuar në mënyrë informale dhe pa u bazuar në normativat përkatëse.

5.8 Analiza e mënyrës së përdorimit të pronave publike

Figura 96. Analiza e pronësisë mbi tokën



Burimi: ASIG, përpunoi IDRA

Analiza e përdorimit të pronave ka si bazë informacioni të saj, materialet nga geoportali ASIG si dhe është përpunuar nga grupi teknik.

Vihet re se një pjesë e konsiderueshme e pronave në bashkinë e Pogradecit janë prona publike dhe përkohë kryesisht me zonat natyrore të sistemit natyror. Ato janë vendosur kryesisht në zonat malore të bashkisë Pogradec dhe përbëjnë një potencial të madh për zhvillimin ekonomik. Prezencë më e madhe e tokave shtetërore evidentohet në njësitë administrative Trebinjë, Velçan dhe Proptisht. Zonat me pronësi private janë pozicionuar në qendër të njësive aty ku edhe vendbanimet dhe tokat bujqësore të banorëve gjenden. Shtrirjen më të madhe të tokave private e kanë NjA Pogradec, Udënisht, Buçimas dhe Cërravë. Këto janë njësi ku relievi është fushor dhe ka përqëndrim më të madh të tokave dhe ndërtimeve private. Gjithashtu janë evidentuar edhe zonat me pronësi private në njësitë e tjera ndërsa pjesa tjetër e territorit është i pambuluar me informacion.

Pronat publike në bashkinë e Pogradecit gjenden në trajtën e pyjeve publike, në formën e objekteve të tjera fizike si shkolla, kopshte, çerdhe, spitale, objekte ushtarake, fetare, kulturore, sociale, varreza publike, hapësira publike etj. Megjithatë lidhur me këtë, në rastin e bashkisë Pogradec ekziston një problem pasi mungon inventarizimi dhe kalimi në pronësi të institucionit të bashkisë I pronave publike. Ky fakt ashtu si dhe është trajtuar në seksionin e zhvillimit social dhe ekonomik përbën një

problem madhor për aq kohë sa bashkia nuk ka të drejtë të përdorur këto prona si pronë të institucionit për t'i shitur, transformuar apo për t'i vendosur si garanci bankarë në raste tërheqjeje huaje, apo për vënien e pronave të paluajtshme në dispozicion të zhvillimit të turizmit.

5.9 Analiza e marrëdhënieve të pronësisë mbi tokën, përfshirë konfliktet dhe situatat e informalitetit

Situatat e informalitetit, si në gjithë Shqipërinë janë prezente edhe në bashkinë e Pogradecit. Ndërtimet e zhvilluara në mënyrë informale janë kryer kryesisht pas viteve 1990, ndërsa përhapja më e madhe e banesave/zonave informale në bashkinë e Pogradecit është kryer deri në vitet 2006. Por sigurisht edhe në periudhën 2006 -2014 (vit ky kur u pezulluan ndërtimet sipas vendimit të KKT) ka pasur një zhvillim të ndërtimeve informale në territor, pavarësisht se kjo ka qënë në nivele më të ulta se në periudhën e mëparshme.

Fenomeni i ndërtimit të zonave informale në bashkinë e Pogradecit nuk ka asnjë ndryshim nga fenomeni i përgjithshëm i ndodhur në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Banorë të fshatrave të zonës së Mokrës, të fshatrave të Korçës apo banorë të qytetit për një jetesë më të mirë, u vendosën në zona të pandërtuara në periferitë e qytetit ekzistues të Pogradecit. Tokat në të cilat ndërtuan u blenë tek pronarët përkatës, u zaptuan ose u privatizuan. Ka nga ata ndërtues të cilët ndërtuan në tokat e tyre por gjithsesi në mënyrë informale. Këto zona ku kjo popullsi e ardhur nga zona të tjera janë kryesisht të pa pajisura me infrastrukturë publike, zona në të cilat mungojnë rrugët, shkollat, ndriçimi urban madje edhe kanalizimet e ujit të pijshëm dhe ujrave të zeza.

Në përcaktimin e qeverisë, zonë informale do të konsiderohet territori me sipërfaqe mbi 2 hektarë, i zënë nga ndërtime informale, procesi i legalizimit të të cilave nuk u nënshtrohet kushteve të instrumenteve të planifikimit të territorit. “Drejtoritë në varësi të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), për propozimin e zonës informale, orientohen nga: evidentimi faktik i ndërtimeve informale në territorin përkatës; vija kufizuese administrative e njësisë të qeverisjes vendore; morfologjia dhe kushtet e relievit; gjendja e pronësisë dhe cilësitë juridike të territorit”, përcakton qeveria.


Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/ Ndërtimeve Informale, në nivel qarku mund të thuhet se Qarku i Korçës nuk është një nga qarqet më dominuese përsa i përket nivelit të ndërtimit të zonave informale, ashtu si mund të jetë Durrësi, Tirana apo Vlora por megjithatë ka prezencë të këtyre zonave dhe kjo është e evidentueshme në qytetet e Korçës, Pogradecit si dhe njësitë administrative: Libonik, Voskop, Udënisht dhe Buçimas.

Lidhur me zonat informale të bashkisë Pogradec gjenden dy vendime të evidencës së zonave informale një vendim i vitit 2007/2008 i miratuar nga K.RR.T.R.SH dhe një vendim tjetër i evidencës së zonave informale në vitin 2015 nga K.K.T²⁴.

Për sa i përket evidencës së bërë në vitet 2007/2008 në bashkinë Pogradec janë shpallur tre zona informale, ku dy prej tyre gjenden në njësinë administrative Buçimas (Buçimas, Vërdovë, Rëmënjë dhe rruga e Tushemishtit) dhe një në njësinë administrative Udënisht (zona Pole). Si sipërfaqe totalë për dy zonat në njësinë administrative Buçimas është 98 dhe 28 ha ndërsa në Nja Udënisht është 15 ha. Të treja zonat sëbashku përbëjnë një sipërfaqe totale prej 141,90 ha. Numri i banorëve që jeton në këto zona informale është 2094 banorë ndërsa numri total i objekteve të deklaruara është 562 nga 842 objekte të gjendura në këtë zona.

Referuar të dhënave që vijnë nga evidentimi i zonave informale të miratuara në K.K.T sipas Qarkut Korçe - vendim nr. 2 date 30.12.2015, bashkia e Pogradecit përbëhet nga 9 zona informale. Dy prej këtyre zonave gjenden në NjA Pogradec dhe shtatë të tjera në NjA Buçimas. Sipërfaqja totale e zonave informale është 126.9 ha. Ndërsa si numër total i deklarimeve është 1042 të tilla. Kryesisht objektet e deklaruara varrojnë nga 1 deri në 4 kate dhe kryesisht janë ndërtuar për qëllime banimi por nuk mungojnë edhe rastet e ndërtimit të objekteve informale për qëllime ekonomike.

Figura 97. Zonat informale të miratuara Qarku Korçë






Figura 98. Harta e zonave informale

LEGJENDA

	VIJE KUFIZUESE INFORMALE EKZISTUESE
	VIJE KUFIZUESE INFORMALE E PROPOZUAR
	VIJE KUFIZUESE ADMINISTRATIVE
	KUFI I ZONES KADASTRALE
	KUFI TERRITORI /OBJEKTI ME CILESURI JURIDIKE
	AKS KOMBETAR

TREGUESIT PËR ZONEN INFORMALE

BASHKIA POGRADEC

ZONA INFORMALE NJ.A POGRADEC

- SIPERFAQJA INFORMALE : 105.12 HA
- NUMRI TOTAL I VETDEKLARIMEVE: 284

ZONA INFORMALE NJ.A BUCIMAS

- SIPERFAQJA INFORMALE : 214.27 HA
- NUMRI TOTAL I VETDEKLARIMEVE: 758

Në bashkinë Pogradec dhe konkretisht në njësinë administrative të Pogradecit, zona informale është zhvilluar mbi unazën e qytetit, lagje si ajo e Kalasë dhe e “Përroit të Caprazit”²⁵. Kjo zonë informale është vendosur në kodrat e qytetit në një terren të pjerrët në të cilën mungonin plotësisht infrastrukturën publike. Sot në këto zona janë kryer investime të pakëta dhe kryesisht lidhur me investime ujësjellës – kanalizime, ndërsa hasen probleme të mëdha me infrastrukturën rrugore, shërbimin e pastimit, ndriçimin etj.

Lidhur me tipologjinë e ndërtimeve në këto zona mund të thuhet se ato janë tip banesa private deri në 3 -4 kate dhe në të shumtën e rasteve janë ndërtuar pa u bazuar në një projekt teknik por nga vetë banorët duke bërë që cilësia e ndërtimit të tyre të mos jetë shumë e mirë.

Figura 99. Zona informale Pogradec



Figura 100. Infrastruktura e zonave informale



Figura 101. Zona informale Pogradec




Një zonë tjetër informale në qytet është ajo që shtrihet pranë zonës industriale deri tek Varrezat e dëshmorëve. Kjo zonë për nga tipologjia është pothuajse e njëjtë me zonën e parë por nga ana e sigurimit të infrastrukturës publike është më tepër e plotësuar si dhe ka arritshmëri më mirë me rrugët kryesore.

Zonat informale të Buçimasit dhe Udënishtit kanë karakter më rural, janë zona ku shërbimet publike janë në mungesë dhe janë shtrirë kryesisht në toka të cilat më herët kanë pasur funksion bujqësor. Këto zona kryesisht janë ndërtuar me vila individuale të cilat shërbejnë për banim por edhe për qëllime akomodimi turistësh dhe qëllime ekonomike.

Evidentimi i zonave informale i cituar edhe më sipër është bërë jo vetëm me qëllimin e evidentimit faktit të këtyre zonave por edhe se ky evidentim do të shërbente si bazë për legalizimin e këtyre zonave. Lidhur me këtë pronarët e banesave informale i referohen ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Legalizimi i zonave informale është duke u kryer ende për gjithë zonat informale në Shqipëri dhe bashkinë Pogradec.

5.10 Analiza e elementëve të rëndësishëm territorialë

Figura 102. Elementët e rëndësishëm territorialë



Burimi: IDRA, 2016

Si elementë të rëndësishëm territorialë të cilët ndikojnë në zhvillimin e territorit si dhe e identifikojnë atë janë evidentuar një tërësi pikash artificiale dhe natyrore që gjenden në territorin e bashkisë Pogradec. Kështu përmendin Liqenin e Ohrit, një element i fortë i cili ka kufizuar dhe orjentuar zhvillimin e territorit të bashkisë Pogradec në vite duke bërë që vendbanimet dhe zhvillimet ekonomike fillimisht të shtrihen pranë tij. Elementë të tjerë territorformues janë lumenjtë dhe përrrenjtë e shumtë të gjendur në territor si për shembull Lumi i Cërravës, Lumi i Vërdovës, Lumi i qytetit, Lumi Shkumbin etj. Vendbanime të shumta janë ndërtuar rreth këtyre lumenjve. Banorët që në kohët e hershme i kanë parë lumenjtë si elementë pranë të cilëve duhet të zhvillojnë jetesën dhe veprimtaritë e tyre ekonomike. Kurora e kodrave të Pogradecit është një tjetër element i cili kufizon kodra të cilat në një farë mënyre e kanë kufizuar shtrirjen e qytetit në vite pavarësisht vendbanimeve të mëvonshme të ndërtuara në to.

Elementë të tjerë natyrorë territor formues janë fushat bujqësore të Buçimasit dhe Cërravës të cilat impaktojnë shumë territorin e bashkisë. Tendanca e banorëve për t'u vendosur në këto fusha ka qënë e hershme dhe është përforcuar edhe vitet e fundit. Përqëndrimi i vendbanimeve pranë këtij elementi të fortë natyror lidhet edhe me faktin e të pozicionuarit pranë liqenit të Pogradecit, qytetit të Pogradecit dhe Tushemishtit.

Pyjet gjithashtu janë elementë të fortë natyrorë territorformues për bashkinë e Pogradecit ato shtrihen kryesisht në zonat malore të zonës së Mokrës dhe përbëjnë një pasuri të madhe natyrore për bashkinë. Shumë vendbanime të ish- komunave janë krijuar rreth këtyre pyjeve dhe zonave natyrore.

Si një element tjetër territorformues është evidentuar edhe Via Egnatia e cila shtrihet shumë pranë bashkisë dhe ka patur një impakt të madh në zhvillimin e zonës së Mokrës, madje janë ndërtuar edhe infrastruktura ndihmëse (si ura e Golikut) në funksion të lidhjes me këtë rrugë. Elementë të rëndësishëm territorialë janë edhe zonat e vendbanimeve të hershme si në Tushemisht, Lin, Dardhas, Trebinjë, Proptisht etj. Zonat minerare janë elementë të tjerë territorialë të cilët kanë impaktin e tyre pozitiv ose negativ në territor. Përmëdim këtu zonat minerare të Alarupit, Gurit të Kuq dhe zona të tjera në Mokër.

6. Zhvillimi Social dhe Ekonomik

6.1 Demografia

Analiza demografike është baza mbi të cilën mbështeten të gjitha elementet planifikuese të planit të përgjithshëm vendor. Duke pasur parasysh të gjitha zhvillimet demografike, lëvizjet e mëdha migratore të 20-25 viteve të fundit, është shumë e rëndësishme një analizë e thelluar në këtë aspekt.

Se pari, duhet theksuar se momentalisht në Shqipëri ka dy lloje burimesh që përdoren në lidhje me shifrat e popullsisë:

1. Të dhënat e popullsisë sipas Gjendjes Civile
2. Të dhënat e popullsisë sipas Censurit të vitit 2011

Pavarësisht se të dhënat e INSTAT për popullsinë, bëjnë vlerësim të popullsisë vetëm mbi bazën e Censurit (lexo Censuseve), të dhënat e Gjendjes Civile në fakt janë të dhënat që konsiderohet zyrtarisht për shpërndarjen e Transfertes së Pakushtëzuar nga Qeveria Qendrore në Bashki. Pra nga njëra anë kemi institucionin zyrtar të statistikave kombëtare (INSTAT) që raporton një popullsi prej **2 894 475** (2014) ndërkohë që një institucion tjetër zyrtar si Ministria e Financave, kur bën alokimin e transfertes së pakushtëzuar përdor një të dhënë tjetër të popullsisë sipas regjistrit të gjendjes civile i cili qëndron në shifrat e një popullsie totale prej **4 329 326** banorësh (2014), një diferencë prej rreth 1,4 milion banorësh në nivel kombëtar.

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhënat e regjistrit të Gjendjes Civile për çdo njësi administrative të bashkisë së Pogradecit.

Tabela 18. Të dhënat mbi popullsinë, Gjendja Civile

BASHKIA	Popullsia	% ndaj totalit	Nr. Familje	Gjinia		Grupmoshat		
				Meshkuj	Femra	0-14 vjec	15 -64 vjec	>65 vjec
Pogradec	36,842	41%	12,367	18,453	18,389	5,560	27,391	3,891
Bucimas	17,792	20%	5,259	9,140	8,652	3,397	12,635	1,751
Cerrave	9,201	10%	2,924	4,797	4,404	1,676	6,518	1,007
Udenisht	10,920	12%	3,547	5,629	5,291	2,128	7,758	1,013
Proptisht	6,106	7%	1,941	3,208	2,898	1,276	4,254	537
Trebinje	3,355	4%	1,178	1,762	1,593	520	2,419	416
Velcan	2,716	3%	917	1,422	1,294	528	1,922	266
Dardhas	3,794	4%	1,283	1,952	1,842	653	2,747	373
Total	90,726		29,416	46,363	44,363	15,738	65,644	9,254
				51%	49%	17%	72%	10%
Urbane	41%							
Rurale	59%							

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Janar 2016

Qyteti i Pogradecit, sipas Gjendjes Civile ka 36 842 banorë, ose rreth 41% të popullsisë totale të Bashkisë. Njësia me popullsinë më të madhe pas qytetit të Pogradecit është Njësia Administrative - Buçimas me 17 792 banorë, ose 20% e totalit të bashkisë. Njësitë më të vogla të Bashkisë, për nga popullsia, janë Dardhas (3794 banorë – 4%), Trebinja (3 355 banorë - 4%) dhe Velçani (2 716 banorë – 3%).

Nga pikpamja e shtrirjes territoriale dhe formësimit urban, njësitë administrative të Buçimasit dhe të Udenishtit kanë një lidhje me “organike” midis tyre duke krijuar një territor të përbashkët, afër njëri-tjetrit, dhe të lidhur nga bregliqeni. Këto 3 njësi përbëjnë edhe 73% të popullsisë të të gjithë bashkisë duke formuar kështu piken e “gravitetit” demografik të bashkisë së re të Pogradecit. Njësite “malore” të bashkisë, Dardhas, Trebinjë, Velçan dhe Proptisht, përbëjnë 18% të popullsisë së bashkisë.

Rreth 17% e popullsisë, sipas Gjendjes Civile, është e moshës 0-14 vjec, që nënkupton moshën e fëmijëve, më së shumti në arsim të detyrueshëm (e rëndësishme sidomos për planifikimin e arsimit parauniversitar). Rreth 72% e popullsisë është në moshën 15-64 vjeç që nënkupton moshën aktive për punë dhe 10% e popullsisë është në moshën 65 vjeç e lart, që nënkupton moshën ekonomikisht jo-aktive.

Figura 103. Diferenca e Popullsisë




Tabela 19. Krahasimi GJC vs. Census 2011

Njesia	Krahasimi GJC vs. Census 2011		
	GJC 2016	Census 2011	Diferenca
Pogradec	36,842	20,848	-15,994
Bucimas	17,792	15,687	-2,105
Cerrave	9,201	7,009	-2,192
Udenisht	10,920	5,990	-4,930
Proptisht	6,106	4,785	-1,321
Trebinje	3,355	2,481	-874
Dardhas	3,794	2,182	-1,612
Verlcan	2,716	2,548	-168
Total	90,726	61,530	-29,196

Nga të dhënat që gjeneron Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC), duket se mundësia e vetme që ka Gjendja Civile për të nxjerrë numrin e popullsisë mbi bazën e njësisë më të vogël administrative nuk është fshati apo lagja, pasi kjo gjë nuk reflektohet saktë në regjistër, por është Qendra e Votimit. Ky kategorizim është i saktë në nivel Njësia Administrative (Ish –Komunë) por nuk të jep informacion në nivel fshati. Momentalisht kjo është mundësia më e mirë pasi sipas


DPGJC, vetëm sistemi i adresave, i cili po zbatohet tani mund të sjellë mundësinë për të gjeneruar të dhëna në nivel fshati apo lagje²⁶.

Ndërsa kemi konsideruar deri tani shifrat e dhëna nga Regjistri i Gjendjes Civile është për t'u vënë re diferenca që ekziston midis këtij numri dhe atij që ka vlerësuar Censusi i vitit 2011 për Bashkinë e Pogradecit. Numri i raportuar nga Censusi 2011 për Bashkinë e Pogradecit është rreth 32% më i ulët se numri që raporton Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për vitin 2016 (shiko grafikun). Kjo diferencë vjen kryesisht si pasojë e migrimit (të jashtëm e te brendshëm), pra personave/familjeve që janë larguar dhe jetojnë diku tjetër por që figurojnë ende në regjistrat e gjendjes civile në ato zona.

Nje diferencë e tillë është e konsiderueshme dhe mund të ndikojë në përlllogaritjet e ndryshme të planit të përgjithshëm vendor.

Krahasimi i dy burimeve nxjerr edhe një problem tjetër përse i përket strukturës moshore të popullsisë. Ndërkohe që të dhënat e Gjendjes Civile nxjerrin në pah një strukturë moshore solide përse i përket segmentit ekonomikisht aktiv (15-64 vjec) me 72% të popullsisë totale, Censusi 2011 rezulton me një ulje të peshës së këtij segmenti duke e çuar në nivelin e 68% të popullsisë totale të bashkisë. Hipoteza që mund të ngrihet në këtë rast është se pikërisht kjo moshë ekonomikisht aktive mund të jetë ajo që ka qënë pjesë e lëvizjeve migratore me shumë se segmentet e tjera moshore.

Figura 104. Grupet moshore



Burimi: Census dhe Gjendja Civile


Një analizë e kujdesshme e diferencave midis shifrave të Censurit 2011 dhe raportimeve të regjistratit të Gjendjes Civile, edhe në nivel Njesie Administrative nxjerr në pah edhe disa tregues të tjerë. Sipas tabelës së mëposhtme që paraqet të dy burimet e shifrave të popullsisë, duket se diferencat më të mëdha janë në 3 njësi administrative:

- 1- Qyteti i Pogradecit i cili sipas Censurit të 2011 ka 20848 banorë ndërkohë që sipas Gjendjes Civile supozohet të ketë 36842 banorë. Kjo diferencë nga Censusi me 15994 persona, është pothuajse 43% më pak se sa numri i deklaruar në Gjendjen Civile, një shifër kjo e konsiderueshme për nivelet e planifikimit.
- 2- Njesia Administrative e Udënishtit e cila sipas Gjendjes Civile duhet të ketë një popullsi prej rreth 11000 banorësh ndërkohë që sipas Censurit të 2011 ka rezultuar pothuajse 45% më pak me 4785 banorë.
- 3- Njesia Administrative e Dardhasit, e cila sipas Gjendjes Civile duhet të ketë popullsi prej 3794 banorësh, ndërkohë që sipas Censurit ka rreth 42% më pak (2182 banorë).

Duket se këto tre njësi janë prekur më së shumti nga levizjet migratore, ndërkohe që sipas të dhënave, Buçimasi është nga ato njësi që edhe ka pritur të ardhur nga njësi të tjera duke zbutur kështu diferencën midis të ikurve dhe të ardhurve në atë njësi.

Popullsia në Bashkinë e Pogradecit anon nga pesha e asaj rurale me 59% kundrejt asaj urbane me 41%. Ky është një raport i kundërt me treguesin në nivel kombëtar ku 57% e popullsisë konsiderohet Urbane dhe 43% Rurale (Burimi: INSTAT).

Figura 105. Urbane vs Rurale



Një raport i tillë i popullsisë kushtëzon edhe mënyrën dhe nivelin e investimeve të ndryshme të Bashkisë për të ofruar shërbime publike të aksesueshme në territor, duke e vënë Bashkinë në veshitësi me të mëdha për investime infrastrukturore.

Madhësia mesatare e familjes, sipas regjistrit të Gjendjes Civile është **3.1 persona**. Ndërkohë INSTAT në Censusin e vet ka përdorur konceptin e Njësive Ekonomike Familjare (NJEF). Sipas INSTAT një Njësi Ekonomike Familjare i referohet “një personi ose një grupi personash të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët”. Si rrjedhojë një Njësi Ekonomike Familjare mund të përfshijë edhe dy “familje” të cilat sipas regjistrit civil janë të ndara por që jetojnë bashkë (dy kurora psh.). Pikërisht për këtë arsye, madhësia mesatare e NJEF sipas Censurit del më e madhe duke shkuar në 3.9 persona për NJEF. Ky dallim është i rëndësishëm për Bashkinë, pasi në të vërtetë, ndarja formale që bëjnë familje të ndryshme të cilat jetojnë bashkë në një banesë ndodh për arsye që lidhen drejtpërdrejt me përfitime sociale të ndryshme (*Ndihma Ekonomike, pagesa paaftësie, bursa shkollore etj*).

Pavarësisht që për nevojat e bashkisë është e domosdoshme që të dihet popullsia reale rezidente (banuese), për efekt të përlogaritjeve të ndryshme të planit të përgjithshëm vendor, sugjerohet që shifra e popullsisë e raportuar nga gjendja civile të jetë baza. Kjo është shifra zyrtare që raportohet dhe mbi bazën e së cilës bashkia duhet të përlogarisë nivelin e e volumeve të shërbimeve publike të ndryshme. Gjithsesi, për efekt të vlerësimeve specifike, Bashkia duhet të bëjë analizë ad-hoc ku duhet të marrë parasysh faktin e popullsisë rezidente (e dalë nga vlerësimet e Censurit 2011).

Figura 106. Raportet e Varësisë

	Gjithsej	0-14 vjec	15-64 vjec	65+ vjec
Bashkia Pogradec - Gj.C 2016	90,726	15,738	65,644	9,254
Bashkia Pogradec - Census 2011	61,530	13,063	41,772	6,695
Struktura në %				

Bashkia Pogradec - Gj.C 2016	100	17%	72%	10%
Bashkia Pogradec - Census 2011	100	21%	68%	11%
Shqiperi - GJC 2016	100	18%	69%	13%
Shqiperi - Census 2011	100	20%	68%	12%

Burimi: Census 2011

Struktura moshore e popullsisë është e rëndësishme për të vlerësuar raportet e varësisë së atyre segmenteve që me gjasa janë të varura ekonomikisht (fëmijë + të moshuar) dhe që janë “konsumatore neto” ndaj atyre që janë me gjasa ekonomikisht aktiv, (Prodhues Neto). Ndryshimet në këtë raport janë të domosdoshme për të parë së çfarë politikash mbështetese janë të nevojshme nga pikpamja sociale dhe ekonomike. Një nivel i lartë varësie nënkupton që popullsia aktive dhe ekonomia në përgjithësi përballen me një barrë të madhe për të mbështetur dhe ofruar shërbime sociale tek moshat e reja dhe moshat e vjetra.

Te dhënat e përpunuara për Bashkinë e Pogradecit tregojnë që treguesi i varesisë për këtë bashki është në nivele më të mira se treguesi për Shqipërinë në total, nëse do të nisemi nga të dhënat e Gjendjes Civile. Sipas këtyre të dhënave treguesit i Varësisë së Përgjithshme për Pogradecin është 38%, që do të thotë se për çdo 100 persona ekonomikisht aktive janë për t'u mbështetur 38 persona ekonomikisht jo-aktive (fëmijë dhe të moshuar). Ky tregues për Shqipërinë është 47%. Në terma konkrete kjo do të thotë se, sipas gjendjes civile, kjo Bashki ka një popullsi aktive me peshë të madhe duke krijuar një potencial të madh njerëzor për zhvillimin ekonomik. Kjo popullsi e ka moshën aktive, dhe nëse ekzistojnë mundësitë për punësim mund të bëhet një aset i rëndësishëm ekonomik.

Por problemi del kur vlerësohen të dhënat e Censurit 2011. Sipas këtij Censuri edhe struktura moshore nuk është ajo që raporton Gjendja Civile. Censuri 2011 e nxjerr Raportin e Varësisë së Përgjithshme 47%, duke nënkuptuar që pesha e popullsisë ekonomikisht aktive është më e ulët sesa ajo e raportuar nga Gjendja Civile. Hipoteza më e qëndrueshme është që kjo popullsi, në këtë moshë aktive, është më e prirur të emigrojë/migrojë dhe prandaj ky raport ndryshon (pra ky segment ka lëvizur më shumë nga Bashkia e Pogradecit në drejtim të zonave të tjera brenda apo jashtë Shqipërisë).

Gjithsesi premisat duken se janë të tilla që Bashkia e Pogradecit, pavarësisht se nga treguesit ekonomikë është në nivele relativisht të larta të varfërisë (*sidomos për njësi të caktuara administrative*), ka një strukturë moshore që përbën potencial për zhvillimin ekonomik të zonës.

Tabela 20. Raporti i Varësisë Totale

Raporti i Varesise Totale - Pogradec		
Bashkia Pogradec - Gj.C 2016	38%	(Nr. i pop. 0-14 vjec + Nr. Pop. 65+)/Nr. Pop. 15-64 vjec
Bashkia Pogradec - Census 2011	47%	
Shqiperi - GJC 2016	43%	
Shqiperi - Census 2011	47%	

Burimi: Gjendja Civile 2016 dhe Census 2011

Nga një analizë më e thelluar e Varësisë Totale del se është vetë qyteti i Pogradecit ku ky raport është më favorizues. Pikërisht qendra potenciale ekonomike për të gjithë Bashkinë ka një raport pozitiv të grupmoshës me gjasa ekonomikisht aktive. Ky potencial, konfirmohet edhe nga të dhënat e Censurit 2011 megjithëse në nivele më të ulëta.

Tabela 21. Raporti i Varësisë Totale

Njesia Administrative	Raporti i Varesise Totale	
	GJC 2016	Census 2011
Pogradec	35%	44%

Bucimas	41%	49%
Cerrave	41%	47%
Udenisht	40%	52%
Proptisht	43%	47%
Trebinje	39%	52%
Verlcan	41%	49%
Dardhas	37%	48%

Burimi: GjC dhe Census

Elemente të tjera të rëndësishme për t'u vlerësuar janë:

- Varësia e të rinjve (raporti i të rinjve 0-14 vjeç mbi pjesën e popullsisë ekonomisht aktive -15-64 vjeç)
- Varësia e të Moshuarve (raporti i të moshuarve > 65 vjeç mbi pjesën e popullsisë ekonomisht aktive -15-64 vjeç)

Tabela 22. Raporti i varësive totale sipas njësive administrative


Njesia	Gjendja Civile 2016			Census 2011		
	Varesia Totale	Varesia e te rinjve	Varesia e te moshuarve	Varesia Totale	Varesia e te rinjve	Varesia e te moshuarve
Pogradec	35%	20%	14%	44%	27%	17%
Bucimas	41%	27%	14%	49%	33%	15%
Cerrave	41%	26%	15%	47%	31%	16%
Udenisht	40%	27%	13%	52%	37%	15%
Proptisht	43%	30%	13%	47%	33%	14%
Trebinje	39%	21%	17%	52%	34%	17%
Velcan	41%	27%	14%	49%	35%	13%
Dardhas	37%	24%	14%	48%	32%	16%

Lëvizjet dhe Projektioni i Popullsisë

Projeksioni i popullsisë për periudhën e ardhshme është një domosdoshmëri për planifikimin e zhvillimit social-ekonomik të Bashkisë. Në vijim, do të paraqitet projeksioni i popullsisë për 15 vitet e ardhshme i bazuar në parametrat që parashikon INSTAT.

Sipas studimit të INSTAT, në nivel kombëtar, popullsia e Shqipërisë është përfshirë, në këto 25 vite, në lëvizje të brendshme dhe ndërkombëtare në shkallë të gjerë dhe gjithashtu është reduktuar në mënyrë të konsiderueshme numri i lindjeve. Efektet e kombinuara të lindshmërisë së ulët dhe largimeve në shkallë të gjerë, kryesisht të të rinjve, përsheptuan ritmin e moshimit të popullsisë dhe kjo vihet re në pothuajse të gjitha qarqet/bashkitë. Nga ana tjetër zhvillimet e viteve të fundit ku vendet e destinacionit të migrantëve shqiptarë (kryesisht Greqi dhe Itali) kanë qënë pjesë e recesionit ekonomik ka dhënë disa shenja të kthimit të emigrantëve, dhe e bëjnë edhe parashikimin e popullsisë pak më të vështirë sesa duke u bazuar thjesht në trendet e mëparshme.

Figura 107. Popullsia dhe norma e rritjes së saj në % në Shqipëri



Burimi: CENSUS, 2011

Emigrimi i të rinjve, rënia e lindshmërisë, si dhe vdekshmëria më e ulët që nga viti 1989, kanë zvogëluar peshën e brezave të rinj dhe kanë rritur atë të brezave më të vjetër në popullsinë e përgjithshme, duke çuar drejt një moshimi demografik.

INSTAT ka bere nje perlllogaritje te projeksionit te popullise bazuar ne 3 skenare:

- 1- **Skenari 1** – Vdekshmeri e Larte, Lindshmeri e Ulet, Migrim i Larte
- 2- **Skenari 2** – Vdekshmeri e Mesme, Lindshmeri e Mesme, Migrim i mesem
- 3- **Skenari 3** – Vdekshmeri e Ulet, Lindshmeri e Ulet, Migrim i Ulet

Niveli më i ulët i projeksionit që vihet në dispozicion nga INSTAT është në nivel Qarku. Në këtë rast, për efekt të analizës së bashkisë Pogradec, është marrë Skenari 2 (I mesëm) dhe përlllogaritjet janë berë me nivelin e projeksioneve të Qarkut Korçë.

Tabela 23. Projeksioni i popullsisë

Qarku Korce	INSTAT	Perlllogaritje IDRA	
		Bashkia Pogradec (Census 2011)	Bashkia Pogradec (GjC 2016)
Viti	Qarku Korçë	Bashkia Pogradec (Census 2011)	Bashkia Pogradec (GjC 2016)
2011	230.261	61,530	
2016	224.872	60,090	90,726

2021	217.996	58,253	87,952
2026	210.114	56,146	84,772
2031	201.976	53,972	81,488

Sipas këtij projeksioni Bashkia Pogradec do të ketë një popullsi në rënie e cila nëse bazohemi tek Gjendja Civile në vitin 2013 do të jetë **81488 banorë** dhe nëse bazohemi tek Censusi do të jetë **53972 banorë**.

Ky trend duhet mbajtur parasysh gjatë llogaritjeve të planifikimit për planin e përgjithshëm vendor. Pavarësisht këtij trendi kombëtar, faktorë të tjerë të zhvillimit ekonomik, nxitja për hapjen e bizneseve të reja, gjenerimi i mundësive të reja për punësim, investime, nxitja e turizmit, mund të ndikojnë ndjeshëm në ndryshimin e këtij trendi.

Konkluzione

- Verifikimi i popullsisë rezidente në territorin e bashkisë duhet të jetë një objektiv i vazhdueshëm i strukturave të bashkisë. Duke qënë se shifrat e ofruara nga regjistrat e Gjendjes Civile ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga shifrat që ofrohen nga INSTAT/Censusi, është e domosdoshme që Bashkia të gjejë mekanizmat të tjerë për të verifikuar popullsinë. Mundësi për të pasur një vlerësim të përafert nga bashkia do të ishin:
 - o Vlerësimi në bazë të kontratave të ujit (për qytetin e Pogradecit) duke gjykuar numrin aktual të abonentëve dhe duke pasur edhe nje vlerësim (trend) për kontrata te reja në 5-10 vitet e fundit. Kujdes duhet bërë për të ndarë konsumatorët biznes me konsumatorët – individë.
 - o Vlerësimi në bazë të kontratave me OSHEE për energjinë elektrike – në nivel të plote bashkie. Edhe këtu duhet pasur kujdes ndarja sipas natyrës se konsumatorit (biznes – individ).
- Nga pikmpamja e planifikimit urban, dendësia dhe shpërndarja demografike e kombinuar me pozicionin gjeografik (lidhja me bregun liqenor) sugjerojnë se qyteti i Pogradecit, Njësia e Buçimasit dhe Njësia e Udënishtit, duhet të konsiderohen si një vijimësi-lidhje urbane. Kjo 3-she njësisish përbën edhe 73% të popullsisë së gjithë bashkisë. Raporti dizavantazhues që ka Bashkia e Pogradecit në lidhje me popullsinë urbane vs. popullsi rurale (lexo - me shumicë popullsi rurale) në fakt zbutet dukshëm nga trajtimi i kësaj “*makro-njësie*” urbane pasi lidhja infrastrukturore e këtyre njësive nuk është në nivele aq problematike sa ç’është në përgjithësi zona rurale tjetër.
- Struktura moshore e popullsisë së Bashkisë se Pogradecit tregon një potencial të madh përse i përket segmentit ekonomikisht aktiv të popullsisë (15-64 vjec). Ne kushtet e nxitjes së mundësive për punësim, ky segment ofron nje motorr të burimeve njerëzore që mund të shtyje pozitivisht zhvillimin ekonomik të Bashkisë. Bashkia duhet t’i përgjigjet këtij segmenti me politika qe nxisin punësimin.
- Nga ana tjetër, raportet e varësise totale janë relativisht të mira duke sugjeruar se barra që i bie segmentit moshor ekonomikisht aktiv për të mbështetur segmentet ekonomikisht jo-aktive (fëmijë + moshuar) nuk është shumë e rëndë. Në vlerësimet për mbështetje sociale që bashkia duhet të planifikojë për të ardhmen, duhet të mbajë parasysh këto raporte varësie.
- Duke vlerësuar diferencat që ekzistojne midis dy burimeve të ndryshme për popullsinë, sugjerohet që për efekt të planifikimit, të përdoret burimi i Gjendjes civile. Megjithate, kur të diskutohen shpërndarje specifike shërbimesh (mbulim me shkolla apo me ambjente shëndetëesore psh) duhen marrë parasysh edhe vlerësimet që vijnë nga përllogaritjet e Censusit të INSTAT.

Figura 108. Migrantë të kthyer 2011





Figura 109. Ndryshimi i popullsisë, 1999 - 2011



6.2 Aspektet Sociale

6.2.1 Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë


Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015–2020, adreson çështjet e skemës së ndihmës ekonomike aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror, etj.

Skemat e NE-së dhe PAK-ut janë përfshirë në një reformë të gjerë për të siguruar efikasitetin dhe barazinë në akses dhe transparencën e tyre.

Sfidat më të rëndësishme në lidhje me skemën e ndihmës ekonomike është kthimi nga një skemë pasive në një skemë aktive nëpërmjet programeve të ri-integrimit dhe alternimit të tyre me skemat e punësimit dhe rritja e efikasitetit të saj.

Mbulimi më i mirë i familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër është një kusht i domosdoshëm për cdo bashki.

Figura 110. Numri përfituesve dhe shpenzimet për skemën NE dhe Pagesat për Aftësinë e Kufizuar



Burimi: (PAK), 2005-2014

Fondi i Ndihmës ekonomike është më i ulët se fondi i ndihmës së aftësisë së kufizuar, konkretisht shuma e pagesës mesatare është 3800 Lekë si ndihmë ekonomike ndërsa ajo e aftësisë së kufizuar është 9900 Lekë në muaj. Për këtë arsye duket qartë dhe nga grafiku se numri i përfituesve ka ndryshuar nga një kategori tek tjetra. Duket nga grafiku që numri i përfituesve ka ndryshuar nga një kategori tek tjetra gjatë viteve.

Ndihma Ekonomike

Niveli i lartë i varfërisë, sidomos për zona të caktuara, në Bashkinë e Pogradecit konfirmohet edhe nga të dhënat që ekzistojnë për Ndhimën Ekonomike, me të cilën trajtohen familjet në nevojë. Sipas të dhënave të bashkisë janë 4 509 familje në të gjithë Bashkinë që trajtohet me ndihmë ekonomike, duke përbërë rreth 16% të totalit të gjithë familjeve sipas regjistrit të gjendjes civile. Duke marrë parasysh faktin që regjistri i gjendjes civile përgjithësisht përmban popullsi më të madhe se sa ajo që është realisht prezente në zonë (përfshin emigracionin dhe migrimin i brendshëm) kjo shifër (16%) është edhe më e madhe në realitet.

Tabela në të djathtë paraqet gjendjen e Ndhimës Ekonomike sipas njësive Administrative të Bashkisë Pogradec. Duke veçuar Bashkinë e Pogradecit dhe Njësinë e Buçimasit (ku trajtohen respektivisht 7% dhe 12% e familjeve të regjistruara në gjendjen civile) në të gjitha njësitë e tjera shifrat janë shumë të larta, duke shkuar deri në pothuajse 1 në 3 familje të trajtuara me Ndhimë Ekonomike në Velcan, Udenisht, Trebinjë apo Dardhas.

Për të vlerësuar edhe nga një burim tjetër këtë situatë që duket tejet problematike, janë parë edhe të dhënat e Censurit 2011, të rikategorizuara sipas njësive të bashkisë së re.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhënat e Censurit 2011 përsa i përket peshës së familjeve të trajtuara me Ndhimë Ekonomike kundrejt totalit të familjeve. Duke pasur parasysh që Censusi ka marrë në analizë vetëm familjet që janë gjetur si rezidente në zonë, shifrat janë edhe më të larta, duke shkuar edhe në 1 në 2 familje të trajtuara për zona si Dardhasi (50%), Udenisht (53%) dhe Velçan (57%). Mesatarja e bashkisë është shumë më lart se mesatarja kombëtare që ka dalë nga Censusi, duke nënkuptuar një nivel shumë më të lartë varfërie në këto zona.

Tabela 24. Familje me Ndhimë Ekonomike sipas Njesive Administrative

Nr	Njesite Administrative	Familje me Ndhimë Ekonomike	Nr. Total i familjeve	% e familjeve me Ndhimë Ekonomike
1	Pogradec	808	12,367	7%
2	Buçimas	625	5,259	12%
3	Trebinje	397	1,178	34%
4	Proptisht	533	1,941	27%
5	Çerrave	632	2,924	22%
6	Dardhas	387	1,283	30%
7	Udenisht	829	2,264	37%
8	Velçan	298	917	32%
	TOTALI	4509	28,133	16%

Burimi: Ndhimë Ekonomike – Bashkia Pogradec

Figura 1: Numri përfituesve dhe shpenzimet për skemën NE dhe Pagesat për Aftësinë e Kufizuar (PAK), 2005-2014

Figura 111. Indikatori i varfërisë






Figura 112. Familje me ndihmë ekonomike sipas NjA



Burimi – INSTAT, Census 2011.

Bashkia e Pogradecit (me fonde të deleguara) paguan rreth 17 milion lekë (të reja) në muaj për këto familje (që përkthehet në rreth 1,5 milion Euro në vit për ndihmë ekonomike). Duhet specifikuar që shuma mesatare që përfitojnë familjet në ndihmë ekonomike është rreth 3 700 lekë/muaj.

Nisur nga shifra e pasqyruar nga bashkia Pogradec, numri i personave që trajtohen me Ndihmën Ekonomike është 4509, pra 16% e numrit të familjeve në Bashkinë Pogradec. Fshati Udenisht ka numrin më të lartë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike 829, pra 37 % e numrit total të familjeve. Në vend të dytë është fshati Velçan 298, përkthyer në përqindje 32% e numrit total të familjeve për këtë njësi. Ndërsa qendra Pogradec ka numrin më të ulët të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, 808 nga 12 367 gjithsej, pra 7% e familjeve të kësaj njësie përfitojnë ndihmë ekonomike.

Figura 113. Familje me ndihmë ekonomike %**Figura 114. Treguesit e varfërisë në rang vendi, qarku**

Qarku	Treguesit e varfërisë		
	Përqindja	Hendeku	Ashpërsia
Shqipëria	14,3	3,0	1,0
Tirana	13,9	2,7	0,8
Korça	12,4	2,5	0,7

Burimi: Vjetari statistikor 2015, Instat

6.2.2 Personat me aftësi të kufizuar


“Pagesa e Aftësisë së Kufizuar” (PAK) sfida është për të përmirësuar cilësinë e jetesës nëpërmjet kësaj skeme dhe jo thjesht ndihmë monetare. Aktualisht PAK është mekanizmi i vetëm për mbështetjen e tyre. Aktualisht Masa e pagesës për aftësinë e kufizuar është shumë më i lartë se masa e NE-së. Fondi PAK dhe NE për rrethin e Pogradecit, gjatë periudhës janar 2016

Tabela 25. Masa e pagës për aftësinë e kufizuar

Nr	Njësitë	Janar 2016			Totali
		Nr	PAK	ENERGJ	PAK+EN
1	Pogradec	1945	15342635		15342635
2	Buçimas	730	6628390		6628390
3	Trebinje	206	2152165		2152165
4	Proptisht	317	2655785	58000	2713785
5	Çerravë	447	4591430	211320	4802750
6	Dardhas	161	1828875		1828875
7	Udenisht	347	2792872		2792872
8	Velçan	199	1724526		1724526
	Totali	4352	37716678	269320	37985998

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme, Fondi PAK në janar të këtij viti është 37 716 678 për 4352 persona në të gjithë bashkinë Pogradec. Numrin më të madh e mbulon qendra Pogradec me 1945 ose 44.6% ndërsa numrin më të ulët e ka njësia Velçan me 199 ose 4.5%. Shifrat janë të shprehura në varësi të numrit total të përfituesve të PAK-ut.

Figura 115. Numri i përfituesve të PAK, 2016



6.2.3 Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social

Shërbimet e Kujdesit Shoqëror, janë pjesë e Programit të Mbrojtjes Sociale. Aktualisht ka mangësi në mbulimin e të gjithë nevojave për shërbime të grupeve vulnerabël në nivel kombëtar. Ndryshe nga skemat e pagesave të NE dhe PAK, sfida këtu është ngritja e një sistemi shërbimesh të përkujdesit shoqëror që mund të mbulojë më gjerë nevojat e grupeve në nevojë për shërbime shoqërore të integruara dhe efikase, veçanërisht në zonat rurale dhe jo vetëm në ato urbane.

Shërbimet të kujdesit shoqëror të specializuara janë siguruar nga organizatat jofitimprurëse e financuara në baza vullnetare ose nga partnerët. Shërbimet mund të gjenden kryesisht në zonat e mëdha urbane (90% janë në zonat urbane) dhe 75% e tyre përqendrohen në zonat perëndimore dhe qendrore të vendit. Shërbimet e kujdesit social përbëjnë një përqindje të vogël (më pak se 5%) të shpenzimeve totale të Fondit për mbrojtjen sociale ku pjesën më të madhe të shpenzimeve vjetore e zënë Ndihma Ekonomike dhe PAK.

Krijimi dhe ngritja e një sistemi funksional dhe efektiv të kujdesit shoqëror (e një pakete bazë të shërbimeve) të bazuar në parimin e decentralizimit dhe deinstitucionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale, mbetet sfida kryesore për shërbimet e kujdesit shoqëror. Ndërgjegjësimi i bashkive si dhe financimi i tyre janë çështje kyçe, si dhe mbulimi i të gjithë territorit të Bashkive me këto shërbime, një planifikim më i mirë është i domosdoshëm për të ndihmuar dhe procesin e financimit, si dhe trajnimi i stafit që punon me çështje sociale.

Observim

Lista e shoqatave aktive në qytetin e Pogradecit.

“Drita e Shpresës”, “Unë Gruaja”, “Shkolla Amaro – Tan (pjesë e organizatës Nehemia)”, “Fëmijët jetimë”

Kryesisht organizatat aktive në qytetin e Pogradecit ofrojnë shërbime sociale në fusha të ndryshme si psh:

Mbështetje për komunitetin Rom dhe Egjiptian; mbështetje për target grupin e persona që janë të gjymtuar duke i pajisur ato me proteza; mbështetje social-psikologjike për personat e dhunuar fizikisht, emocionalisht dhe psikologjikisht; lobim në institucionet vendore dhe qendrore të vendit për të drejtat e barazisë gjinore; mbështetje të fëmijëve jetimë; mbështetje për fëmijët e komunitetit Rom dhe Egjiptian

Barazia gjinore

Bashkia Pogradec ka sot zyrën për barazi gjinore dhe luftë kundër dhunës në familje, e cila mban një databazë për evidentimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe bën rakordimin e veprimeve midis institucioneve shtetërore dhe OJF, për rastet e lëshimit të Urdhrave të Mbrojtjes dhe Urdhrave të Menjëhershëm të Mbrojtjes.

Kjo njësi grumbullon dokumentacionin përkatës, për dhunë në familje dhe bën përpjekje për t'i shpërndarë institucioneve sipas destinacionit dhe veprimtarisë së tyre në ndihmë të grave dhe familjeve në nevojë.

Janë ngritur strukturat e nevojshme të identifikimit të rasteve, të trajtimit të problemeve të ndryshme, të përgjegjësve për zbatimin e ligjit dhe vendimeve e udhëzimeve të dala prej tij, informohen viktimat e dhunës në familje, ose familjarët e tyre, për shërbimet aktuale ekzistuese, sociale, që shoqata të ndryshme që ofrojnë dhe operojnë në qytet.

Trajtohen me skemën e ndihmës ekonomike, pagesat për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, kur ato janë nën efektin e Urdhrit të Mbrojtjes, apo Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, të përcaktuar me vendim nga gjykata.

Rasteve të dhunës së ushtruar iu ofrohet:

Konsulencë psikologjike falas, konsulencë ligjore falas, paketë ushqimore dhe veshmbathje në raste të veçanta nga skema NE, kite shkollorë për fëmijet e tyre, kur familjet janë në nevojë formim profesional të diferencuar nga zyra e punësimit, konsulencë mjekësore falas.

Nga ana e punonjësve ngrihet shqetësimi për një përgatitje të një niveli më të lartë teorik e praktik të specialistëve të trajtimit të këtyre rasteve nga ekipi teknik dhe trajnime specifike të aktorëve që trajtojnë rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Konkluzione

Drejtoria e Kujdesit Social, duhet të marrë një rol të rëndësishëm për të verifikuar Situatën Sociale të Bashkisë duke pasur një situatë të qartë për rastet e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, PAK, si dhe çdo kategori familjesh ose individësh në nevojë. Vetëm duke pasur një situatë të qartë mund të planifikohen masa që mund të meren në vazhdim.

Është shumë e rëndësishme të bëhet një Plan Social, për të gjithë kategoritë në nevojë me të gjithë shërbimet që i nevojiten komunitetit, si dhe një kostim të këtij plani. Problemi i migrimit nga zonat rurale në urbane për shkak të varfërisë, duhet të evidentohet qartë në mënyrë që Bashkia të marrë masa për uljen e saj. Numri i shoqatave që punojnë në qytetin e Pogradecit është shumë i ulët. Kategoria për të cilat ato ofrojnë shërbime është shume e limituar, Drejtoria e Kujdesit Social duhet të ketë një databazë me të gjitha shërbimet që duhet të ketë në bashkinë Pogradec dhe shoqatat që i mbulojnë këto shërbime.

Gjithashtu, të shikohet mundësia që Bashkia të krijojë këto shërbime dhe duke përdorur bashkëpunime të ndryshme me shoqata private të specializuara në fusha të ndryshme, për të plotësuar spektrin e shërbimeve, si dhe duke vënë në dispozicion asete vendore për të ngritur qendra të ofrimit të shërbimeve të ndryshme, si dhe shtimin në buxhetin e saj të zërit të investimeve dhe në fushën

sociale, me politika të qarta për mbështetjen e kategorive në nevojë, zgjerimin e mundësive për aftësim dhe punësim për kategoritë në nevojë.

KRIMINALITETI

Veprat penale

Ne mungese të të dhënave për veprat penale në nivel bashkie, janë përdorur të dhënat për Qarkun e Korçës si një e dhënë e përafërt.

Në nivel rajonal, qarku Korçë ka një statistikë prej 39 krime kundër personit, e cila krahasuar me nivelin e përgjithshëm të Shqipërisë është në një normë mesatare si raport me qarqet e tjerë. Numrin më të lartë të kriminalitetit qarku i Korçës kap me krimet në sferën ekonomike ku përfshihen plot 175 të tilla brenda vitit 2014.

Figura 116. Veprat penale, 2014

Qarku	Kundër Personit	Kundër Pronës	Krime për Trafiqet e Paligjshme	Krime në fushën e drogës	Krime ekonomike financiare	Krime në fushën e korrupsionit	Krime në fushën e pastrimit të parasë	Akte kundër rendit dhe standardeve të sjelljes
Tiranë	95	34	171	565	616	299	108	6706
Korçë	39	4	49	120	175	44	26	1231

Burimi: Vjetari statistikor 2015 Instat

PAPUNËSIA

Papunësia mbetet një nga problemet më serioze me të cilin përballet Shqipëria në përgjithësi. Ky problem, gjykuar nga të dhënat, duket se është edhe më i theksuar në rastin e bashkisë së Pogradecit. Përpara se të kalojmë në një analizë më të detajuar të shifrave të papunësisë sipas njësive administrative duhet theksuar një çështje e përkufizimit të kategorive të punësimit.

Së pari INSTAT përdor dy lloje të dhënash mbi tregun e punës:

- Të dhëna administrative (*Zyrat e Punës*)
- Të dhëna nga anketa e punës

Të dyja burimet kanë nevojë për një trajtim të kujdesshëm kur u referohemi shifrave. Në rastin e të dhënave administrative janë dy probleme me përkufizimin


- i) Te papunë quhen ata të cilët janë regjistruar në zyrat e punës si të tillë. Pra çdo person i cili nuk është i regjistruar atje nuk llogaritet në segmentin e të papunëve.
- ii) Çdo person në fshat që ka tokë/arë konsiderohet i punësuar (pavarësisht sezonalitetit apo mundësisë që me këtë tokë të mund të mbajë gjithë familjen).

Në rastin e të dhënave nga anketa e punës gjithashtu ka një problem me përkufizimin. **Të punësuar**, sipas INSTAT konsiderohen persona që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës (një javë). Konceptin në këtë rast e “deformon” disi ideja e punës

që bëhet në fermën/token e vetë personit pasi konsiderohet i punësuar qoftë edhe sikur të ketë punuar pak gjatë javës së referencës. Keta persona që punojnë në tokën e tyre, edhe nëqoftëse prodhojnë vetëm për vetëkonsum (pra nuk shesin prodhimet e tyre) konsiderohen të punësuar.


Te dhënat më të plota për papunësinë të cilat shkojnë deri në nivel njësie administrative për Bashkinë e Pogradecit vijnë nga Censusi 2011. Harta e mëposhtme tregon gjendjen e papunësisë në bashkinë e Pogradecit sipas njësive administrative.

Figura 117. Niveli i papunësisë



Burimi: CENSUS, 2011

Sipas këtyre të dhënave, papunësia është në nivele shumë të larta të deklaruar për njesitë administrative. Per qytetin e Pogradecit, kjo shifër sipas Censurit 2011 është 35%, 6 pikë përqindjeje më lart se mesatarja kombëtare që është **në nivelin 29%**. Ndërkohë që për disa njësi administrative shkon mbi 50% (Buçimas – 54.7%, Velçan – 62.6% dhe Udënisht – 67.6%).


Figura 118. Shkalla e papunësisë sipas njësive administrative

Burimi: CENSUS, 2011

Sidomos dy prej këtyre njësive meritojnë vëmendje të veçantë në analizë.


- **Buçimas**, është njësia pranë qytetit të Pogradecit, e cila ka njohur edhe si e vetme, rritje pozitive të popullsisë gjate ketyre 20 viteve. Pra popullsi nga zona të tjera më të largëta kanë zbritur në Buçimas në kërkim dhe me shpresë të oportuniteteve më të mira për punë dhe jetesë. Ndërkohë që niveli i lartë i papunësisë tregon se oportunitetet mesa duket, pavarësisht lëvizjeve migratore të brendshme nuk janë të shumta në këtë zonë.
- **Udënisht** është njësia administrative që shtrihet pothuajse e gjitha në breg të liqenit të Ohrit. Fakti që papunësia në këtë njësi me akes të menjëhershëm në liqen, është kaq e madhe (67.6%) tregon së paku që liqeni nuk ka asnjë ekonomi për t'ju ofruar banorëve të tij. Pra nuk gjeneron të ardhura për atë popullsi që shtrihet në breg të saj. Kjo gjë duhet të marrë parasysh në planin e përgjithshëm vendor për këtë zonë me anë të trajtimit të oportuniteteve për ekonominë e liqenit.

Shifrat janë edhe me alarmante kur analizohet të dhenat për papunësi të rinjve (15-24 vjeç) në zone. Sipas këtyre të dhenave të paraqitura në grafikun e mëposhtëm, në qytetin e Pogradecit, pothuajse 7 në 10 të rinj janë të papunë dhe kjo shifër shkon edhe 9 në 10 të rinj në njësine e Udënishtit.


Figura 119. Papunësia e të rinjve

Burimi: INSTAT


Duke analizuar të dhënat më tej, del se pikërisht në njësitë të cilat raportojnë nivele më të ulëta të papunësisë (Çërravë, Trebinjë, Proptisht dhe Dardhas), edhe raporti i atyre që janë të vetëpunësuar (lexo – në bujqësi/blegtori) është më i lartë se sa të punësuarve me pagë. Mbi 70% e atyre që janë të punësuar në këto zona deklarojnë të jenë të vetëpunësuar (shiko grafikun më poshtë). Nga njëra anë në lidhje me planin e përgjithshëm vendor ky mund të jetë një potencial interesant për të stimuluar këta sektorë, por nga ana tjetër mund të jetë edhe çështje e mungesës së oportuniteteve të tjera për punësim.

Figura 120. Struktura e të punësuarve me pagë vs. të vetëpunësuarve

Punësimi në bujqësi në njësitë administrative ku ka më pak papunësi të deklaruar konfirmohet edhe nga të dhënat e strukturës së punësimit sipas sektoreve po nga Censusi 2011. Në njësitë Proptisht, Trebinjë, Çërravë dhe Dardhas përqindja e të punësuarve në bujqësi varion nga 58% deri në 68% të totalit të të punësuarve.

Figura 121. Punësimi sipas sektorëve

Struktura e të punësuarve sipas arsimit tregon një lidhje të drejtpërdrejtë midis njësive që kanë të vetëpunësuar në bujqësi dhe nivelit arsimor më të ulët të të punësuarve. Pikërisht në Trebinjë, Çërravë, Proptisht dhe Dardhas, niveli arsimor i të punësuarve është më së shumti me arsim 8-9 vjeçar ose më pak. Kjo është një shenjë që pavarësisht faktit që njerëzit në këto zona janë të zënë me punë në bujqësi apo blegtori (të vetëpunësuar) niveli i kualifikimit të tyre le për të dëshiruar.

Figura 122. Niveli arsimor

Burimi: CENSUS, 2011

Figura 123. Të ardhurat sipas NjA






Figura 124. Punëkerkues sipas grupmohave



Nga grafiku i mësipërm vihet re se përqindja më e lartë e punëkërkesve të papunë rreth 25,5 % është mosha mbi 50 vjeç.

Figura 125. Grupet e Papunesisë



Nga grafiku i mësipërm vihet re se ka një përqindje relativisht të ulët të punëkërkuessve të papunë me arsim të mesëm-profesional dhe me arsim universitar. Shkollimi profesional, sidomos në fushat specifike që ka tregu i punës i Pogradecit (psh. turizmi, aqua-kultura, bujqësia etj.) do të ishte element nxitës i punësimit.

Figura 126. Ndihmë ekonomike sipas grupmohave




Figura 127. Punëkërkuess afatgjatë




Figura 128. Sistemi arsimor, ndarja sipas kategorive




Figura 129. Sistemi arsimor, numri i nxënësve





Figura 130. Analfabetizmi



Sipas hartës së mësipërme, njësia Velçan ka përqindjen më të lartë të analfabetizmit, në të gjithë Bashkinë e Pogradecit. Institucione arsimore kjo zonë ka 4 kopshte, nga të cilët 2 nuk kanë edukatore, shkolla 9-vjeçare 5, shkollë e mesme 1. Numri i banorëve të njësisë Velçan është 3359, nga të cilët (0-14 vjeç) është 666. Ndërsa në këtë bashki, përqindjen më të ulët të analfabetizmit e ka qendra Pogradec me një popullsi 38 901. Në këtë njësi janë gjithsej tetë kopshte, nga të cilat pesë janë publike dhe tre private. Numri i 9-vjeçarëve është tetë, nga të cilat pesë janë publike dhe tre private. Shkolla të mesme janë pesë, tre publike dhe dy private. Nuk ka në këtë bashki asnjë çerdhe (fëmijë 0-3 vjeç).

Nishaveci nuk ka shkollë, pasi është jashtë funksionit dhe e amortizuar (është bërë një projekt për investim). Në Blacë, Çërrave dhe Petrushë janë nga 2 shkolla. Kopshtet janë brenda shkollave përgjithësisht.

Tabela 26. Numri i nxënësve sipas NjA

Njesia Administrative	Numri I nxenesve
Buçimas	2083
Çërrave	844
Dardhas	254
Hudënisht	663
Pogradec	2591
Proptisht	545
Trebinjë	299
Velçan	311

Tabela 27. Numri i nxënësve, shkolla të mesme

	Shkolla të mesme	Nga klasa X-XIII -Gjithsej
1	MUHARREM ÇOLLAKU	707
2	GJERGJ PEKMEZI	710
3	ENVER QIRAXHI	148
4	ENVER QIRAXHI	10
5	ENVER QIRAXHI	167
6	14 ENGJËJT	253
7	QEMAL BAZELLI	301
8	QEMAL BAZELLI	54
9	REXHEP XHEMOLLARI	89
10	DËSHMORËT E POJSKËS	130
11	RODOKAL SIPËR	94
12	SELIM GJONA	154
13	3 DËSHMORËT	81
14	VELÇAN	109
15	NEHEMIA	91
16	RILINDJA	77

Konkluzione :

Nga relacionet dhe takimet me sektorin e Arësimit në Bashkinë Pogradec, vihet re se ka zona në të cilat frekuentimi i shkollave është mjaft i ulët, ka institucione ku nr i fëmijëve shkon në 10 fëmijë, ky është një fenomen që ndodh në disa zona rurale.

Ka raste ku është për shkak të migrimit të familjeve dhe ka një numër të vogël fëmijësh. Ka raste ku nuk mund të përdoren një shkollë për dy fshatra kufitarë dhe ku mund të jetë më efiçiente të sigurohet fëmijëve transporti për të mos mbajtur shkolla hapur me pak mësues dhe fëmijë.

Spektori i Arsimit pranë Bashkisë duhet të njohë mirë gjëndjen numrin e fëmijëve për rregjistrim, për të mos marrë vendime të nxituara gjithësesi për ndryshimin e destinacionit të objekteve arësimore. Ka raste kur këto institucione mund të përdoren për shkolla profesionale, qendra shëndetësore etj. Në të gjitha sugjerimet e bëra do të një njohje të mirë të terrenit, të kontigjentit të fëmijëve për shkollim, dhe planifikimit dhe shpërndarjes së mirë të kapacitetit.

Në zonat rurale, gjendja e analfabetizimit duhet eliminuar, arësimi i detyrueshëm 9 vjeçar duhet të jetë një prioritet për Bashkinë pasi këta banorë pa arësim sdo të kenë mundësi të përfitojnë nga mundësitë që i jepen pa shkollim, vecanërisht brezat e rinj.

Në Pogradec, ka disa shkolla me mbi kapacitet, me turne dhe ndërkohë ka asete të identifikuar si mundësi për shkolla të tjera, për të shpërndarë këtë kapacitet. Gjithashtu ka nevojë për hapjen e shkollave të reja.

Pogradeci ka vetëm një cerdhe në të gjithë Bashkinë, hapja e institucioneve të tilla lehtëson nënat për të dhënë mundësi për punësim. Prandaj është e domosdoshme të krijohen këto mundësi.

Në lidhje me kopshtet, ka pak kopshte me dreke dhe ka një rritje të kërkesës për këto institucione arësimore. Është e rëndësishme të parashikohet nga Bashkia nevojat për vitet në vazhdim dhe të lirohen hapësirat e zëna aktuale nga banorë të ndryshëm, dhe planifikimi për institucione të tjera arësimore në zonat ku ka më shumë nevojë. Në zonat e banuara duke ju siguruar qytetarëve të bashkisë afërsi me këto institucione, ose transport të siguruar për fëmijët si në rastet e fshatrave fqinje.

Arësimi profesional, duhet të jetë nën kujdes të Bashkisë Pogradec, të investojë në këto asete, të mos i ndryshojë destinacionin, të nxisë rritjen e kapaciteteve në to pasi është një investim për të ardhmen e qytetit.

SHËNDETËSIA

Bashkia Pogradec është dhe njësi që ka mbulimin më të madh me qendra shëndetësore. Numri i qendrave të kujdesit shëndetësor që gjenden në këtë njësi janë:

- Qendra Spitalore Pogradec
- Materniteti Pogradec
- Poliklinika
- Konsultori i fëmijës (1 ambient)
- Konsultori i gruas (1 ambient)
- Qendër shëndetësore për lagjen 1-2 injeksione (1 ambient)
- Qendër shëndetësore për lagjen 3-4 injeksione (1 ambient)

Njësia administrative Buçimas ka në territorin e saj tetë qendra të kujdesit shëndetësor, praktikisht një për çdo fshat.

Njësia administrative Çërravë ka po të njëjtën mbulim për numër fshatrash, 11. Numri total i doktorëve është 3. Këta të fundit mbulojnë territorin sipas ndarjes së mëposhtme:

Çerravë, Leshnicë, Lumas, Qershizë – 1 Doktor

Petrushë, Grabozicë, Nishavec – 1 Doktor

Blacë, Alarup, Bletas – 1 Doktor

Në Çerrave është poliambulanca me 3-4 infermierë dhe 1 doktor, që mbulon dhe Leshnicën, Qershizën dhe Lumasin në ditë të caktuara. Infermiere nuk ka në Lumas, për punë pagese nga Komuna. Kompetenca aktuale e Komunës është për mirëmbajtje, jo për emërimë.

Njësia administrative Trebinjë ka në total 7 qendra shëndetësore, nga të cilat veçohet ekzistenca e një spitali dhe 6 qendrat e tjera janë funksionale.

Njësia administrative Udënisht ka pesë qendra shëndetësore, të cilat i mbulojnë vetëm 3 doktorë.

Njësia administrative Velçan ka një qendër shëndetësore të madhe.

Njësia administrative Proptisht, në Selishtë dhe Baribardhë nuk ka qendër shëndetësore. Fshatrat e tëra kanë nga një dhomë, por janë funksionale.

Konkluzione:

Si një funksion që pritet të delegohet, qendrat shëndetësore duhen pasur kujdes të evidentohen, dhe të dihen nevojat e fshatrave vecanërisht për këto qendra, për ti ardhur në ndihmë nevojave të qytetarëve e vecanërisht gruas dhe fëmijëve në zonat rurale.

6.3 Analiza e nevjave për Strehim

Si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, sektori i strehimeve ka si funksion kryesor implementimin e programeve të ndryshme sociale për strehimin e familjeve të pastreha.

Politikat e strehimit, kryesisht mbështeten mbi këtë bazë ligjore:

- Ligji nr 9232, datë 13. 05. 2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”
- VKM nr 574, date 29. 08. 2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”
- VKM nr 814, datë 03. 12. 2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”
- Udhëzimi nr 6257, datë 02. 09. 2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 4441, datë 19. 11. 2014.

Konkretisht, pranohen aplikimet, verifikohet dokumentacioni nga specialistët e Sektorit të Strehimit, si dhe hartohen listat. Projektvendimet dhe relacionet për në Këshillin e Bashkisë shqyrtohen nga Komisioni i Strehimit të Këshillit. Komisioni i Strehimit të Bashkisë u miratua me VKB nr. 35, datë 03. 10. 2014 “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”.

Regjistrimi i parë u krye në vitin 1993 dhe numri i të pastrehëve ishte 1080 familje.

Regjistrimi i dytë u krye në vitin 1997 dhe numri i të pastrehëve ishte 516 familje.


Në vitin 2005 u ndërtua një banesë nga Enti Kombëtar i banesave dhe Bashkia Pogradec, ku u sistemuan 15 familje të pastreha të kategorisë banues në ish pronë private.

Janë miratuar 16 VKB dhe kanë përfituar të drejtën për të marrë kredi të subvencionuar nga shteti 566 familje

	Vendimet e Këshillit	Nr. aplikantëve	Përfituesit
1	VKB nr 8, datë 23. 02. 2010	74	15
2	VKB nr 20, datë 28. 05. 2010	43	7
3	VKB nr 31, datë 21. 07. 2010	12	2
4	VKB nr 36, datë 13. 09. 2010	13	5
5	VKB nr 42, datë 11. 11. 2010	19	3
6	VKB nr 4, datë 16. 02. 2011	26	7
7	VKB nr 30, datë 23. 09. 2011	65	13
8	VKB nr 40, datë 25. 11. 2011	27	
9	VKB nr 3, datë 07. 02. 2012	36	
10	VKB nr 11, datë 06. 03. 2012	16	
11	VKB nr 19, datë 30. 03. 2012	20	
12	VKB nr 48, datë 13. 12. 2012	127	54
13	VKB nr 12, datë 28. 02. 2013	41	10
14	VKB nr 21, datë 17. 04. 2013	27	3
15	VKB nr 30, datë 28. 05. 2013	17	
16	VKB nr 37, datë 18. 06. 2013	3	1
	TOTALI	566	120

Këto familje kanë aplikuar për të përfituar kredi me interes 3%. Struktura e apartamentit për këto familje është Garsonierë, 1+1, 2+1, 3+1, në varësi të numrit të personave, sipas certifikatës familjare që paraqesin. Kanë përfituar kredi me interes 3%, 120 familje, me një vlerë totale 311 229 976 lekë.

Tabela Nr. 1						
	Numri i familjeve që kanë aplikuar për strehim që nga Janar 2005	Banesa sociale me qira	Banesa me kosto të ulët	Truall të pajisur me infrastrukturë	Bonus strehimi	Total
	Total aplikime	1	565			566
	Nga këto, kategoritë sipas nenit 5, të ligjit 9232/2004					
a.i	Familje që nuk kanë përfituar nga Ligji 7652/ 1992		562			562
a.ii	Familje ku k/fam është grua e ve ose e divorcuar		74			74
a.iii	Të moshuar në moshën e pensionit		12			12
a.iv	Individë me aftësi të kufiz., Inv pune, lufte, të verbër G I		39			39
b.i	Me moshë totale nën 55 vjeç		94			94
b.ii	Familje më shumë fëmijë		12			12
b.iii	Familje emigrante		14			14
b.iv	Individë me status jetimi		0			0



Në vitin 2015 kanë aplikuar për t'u përfshirë në listat e të pastrehëve 59 familje të miratuar në mbledhjet e Këshillit të Bashkisë, të cilët me VKB nr. 5, datë 10. 02. 2016 u miratuan për përfitimin e bonusit të strehimit nga Ministria e Zhvillimit Urban.

Me kërkesë të Ministrisë së Zhvillimit Urban u aplikua në projektin "Përmirësimi i kushteve të banimit të komunitetit rom dhe egjiptian". Ky projekt, që përfshiu edhe njësitë administrative, përbehej nga 4 pjesë:

1. Sistemimi i rrugës "Kajo Babieni" Lagja 4 me vlerë 3 638 120 lekë.
2. Rikonstruksion i banesave të 23 familjeve romë dhe egjiptiane me vlerë 14 135 932 lekë

3. Rikonstrukcion i ambienteve të përbashkëta me vlerë 5 403 270 lekë.
4. Rikonstrukcioni i objektit “Vendkomanda” në Kabash me vlerë 10 463 840 leke, me përfitues 19 familje.

Në zbatim të VKM nr 614, datë 07. 07. 2015 “Për përcaktimin e procedurave të privatizimit të banesave dhe objekteve të kthyera në fond banese, me vendime të organeve të qeverisjes vendore, në pronësi të njërive të qeverisjes vendore dhe të shtetit, ku janë sistemuar me strehim banorë të pajisur me autorizim nga organet kompetente” do të bëhet evidentimi i objekteve në pronësi ose jo të Bashkisë me qëllim privatizimin e tyre nga banorët që aktualisht jetojnë në këto banesa dhe që janë të pajisur me autorizim strehimi. Paraprakisht janë evidentuar pjesërisht këto banesa.

1. Konvikti i shkollës “Gjergj Pekmezi”
2. Palestra e shkollës “Gjergj Pekmezi”
3. Kati i parë tek Qendra Ditore Speciale
4. Një dhomë tek kopshti “E. A. Cici”
5. Çerdhja pranë Lumit të qytetit
6. Hoteli tek Miniera e Gurit të Kuq
7. Dy hyrje tek Drejtoria e Shëndetit Publik
8. Vend komanda në Kabash

Bashkia duhet të bëjë kalimin në fond banese të këtyre objekteve dhe t’i hapë rrugën privatizimit të tyre. Përcaktimi i trojeve të lira për ndërtim banesash sociale nga fondet e Bashkisë ose të buxhetit të shtetit është një hap tjetër për ndërtimin e banesave sociale dhe strehimit të familjeve të pastreha.

OBJEKTIVAT

Objektivi 1: Verifikimi i saktë i listave të të pastrehëve, prioritizimi sipas kriterëve që vë Bashkia, koha e aplikimit, kategoria, gjendja reale e familjeve. Numri i familjeve të strehuara është jashtë mase i ulët në krahasim me atë të aplikuesve.

Objektivi 2: Evidentimi i godinave në të cilat strehohen aktualisht, kushtet e tyre të banimit nëse janë të përshtatëshme ose jo për të kaluar në privatizim nga familjet që aktualisht strehohen. Nëse jo, këto godina duhet të shikohen për përdorim të asetit për funksion tjetër. Lirimi i këtyre godinave dhe vënia në funksionin e tyre më të kërkuar. Qoftë për shkolla, qendra shëndetësore etj.

Objektivi 3: Të shikohet çfarë asetesh ka Bashkia, truall etj, si dhe sipas planit rregullues, të evidentohen mundësitë për të ndërtuar Banesa Sociale, qoftë për dhënie me qira apo trajtim bonuse, kredi të buta etj.

Objektivi 4 : Regjistrimi i atyre aseteve që mund të përcaktohen për strehim, ose të trojeve për të pasur mundësinë e ndërtimit mbi to.

6.4 Aspektet ekonomike


6.4.1 Identiteti ekonomik i Bashkisë Pogradec

Numri i bizneseve te vogla dhe te mesme te regjistruara eshte 925.

Nga analiza e te dhenave të marra deri tani për bizneset e vogla , vihet re se numri i përgjithshëm i tyre është 925. Nuk ka të dhënat të mëparëshme për numrin e biznesve për t'ju referuar dhe bërë krahasime nëse është rritur ky numër ose jo nga viti në vit. Nuk kemi një kategorizim të mirë të bizneseve sipas fushave për të parë dhe Identitetin ekonomik të zonës, por vihet re se dominojnë me rreth 62 % të numrit të përgjithshëm, kryesisht bar - bufe - restorante, ushqimore dhe sherbime. Kategoria Indurstri nuk kuptohet qartë se çfarë përfshin.

Nga të dhënat e sjella nuk kuptohet qartë nëse janë të përfshira dhe të dhënat e Njërive Administrative për bizneset që operojnë aty. Ndërkohë, nga të dhënat paraqitet një aktivitet si Peshkimi apo Mjete Peshkimi ne nje qytet si Pogradeci jane te regjistruar vetem 1. (me e plote eshte tabela aneks 1), dhe në njësitë administrative raportohet për aktivitete si varka te licensuara etj. Mos verifikimi i mirë i zonës në lidhje me bizneset formale dhe informale që operojnë në Bashkinë Pogradec, sjell efekt në mbledhjen e taksave dhe tarifave, qër përbëjnë rreth 45 % të të ardhurave të Bashkisë.


Figura 131 . Biznese të vogla dhe të mëdha



Numri i bizneseve te mëdha të regjistruara është 139

E njëjta situatë paraqitet dhe me bizneset e mëdha. Nuk ka një detajim të mirë të pjesës Industriale, për të parë identitetin ekonomike të zonës. Nuk vihet re asnje Investimi i huaj nga kompanitë që ka në terren.

Nga mos koordinimi i shifrave për disa nga bizneset, po marim një shembull për agjencitë turistike apo hotelet, duket se Bashkia nuk e ka shumë të verifikuar situatën në terren të Bizneseve. Nuk ka një raportim të saktë të mënyrës si verifikohet potenciali i mundshëm, për të mbledhur të ardhurat, Verifikimi periodik i terrenit, si dhe parashikimi i qartë e real i të ardhurave për t'u mbledhur.

Figura 132. Bizese të mëdha

Sistemi që përdoret për mbledhjen e detyrimeve nuk funksionon më prej disa viteve. Çdo verifikim bëhet akoma më i vështirë në mungesë të një sistemi, si marja e statistikave për të bërë studime, krahasime si dhe planifikime të mundshme etj.




Figura 133. Biznes i vogël qyteti i Pogradecit**Figura 134. Biznes i madh Njësi Administrative**

Figura 135. Biznesi vogël Njësi Administrative**Konkluzione :**

Sic vihet re dhe nga tabelat e mëposhtëme krahasuese, vihet re se numri i bizneseve të mëdha ka pasur një rënie nga viti 2011, dhe deri në vitin 2015 ka arritur nivelin më të ulët në rënie, i njëjti fenomen dhe për biznesin e vogël që ka shënuar pikën më të ulët në vitin 2014. Por biznesi i vogël ka një rritjen në dy vitet e fundit të ndjeshme në Pogradec. Mendohet që dhe prishjet e lokaleve për shkak të rregullimit të rrugës kanë pasur efektin e tyre në uljen e numrit të bizneseve.

Për sa i takon komunave Bucimasi, Udënisht, Çërrava vihet re të kenë dhe numër biznesesh të regjistruar më shumë se njësitë e tjera administrative.

Për sa i përket Njësisive Administrative një veçori në lidhje me aktivitetet e tyre Bujqësore, është mos regjistrimi i Fermerëve lokale në skemën e subvencione që bën të mundur Ministria e Bujqësisë. Mungesa e regjistrimit të tyre, nuk u krijon mundësi fermerëve që të grumbullohen produktet e tyre nga pikat e caktuara të grumbullimit, dhe blerjen e produkteve me çmimet e stimuluar, sipas zonave. Heqja e kasës fiskale është një tjetër oportunitet që i ofrohet fermerëve për të rritur mundësinë e përfshirjes në skemat e subvencionit. Por ndihma e Bashkisë është e pashmangshme.

6.4.2 Bujqësia

I.POZITA GJEOGRAFIKE, RELIEVI, KLIMA

1.1 Pozita gjeografike (tiparet kryesore)

Bashkia e Pogradecit ndodhet në pjesën juglindore të Shqipërisë, midis gjerësisë gjeografike veriore $40^{\circ} 54' 05''$, dhe gjatësisë lindore $20^{\circ} 38' 48''$ Brenda kufijve administrativë rrethi i Pogradecit ka një sipërfaqe të përgjithshme 725 km^2 . Kufizohet në veri me rrethin e Librazhdit, nga jugu me rrethin e Korçës, nga lindja me FYROM dhe në perëndim nga rrethi i Gramshit. Në këtë territor ndodhet Liqeni i Ohrit (Pogradecit) me ndikim të madh në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror. Nëpërmjet Qafës së Thanës lidhet me Korridorin VIII Perëndim-Lindje (Lindje-Perëndim) me një ndikim të rëndësishëm në ekonominë e rrethit të Pogradecit. Po ashtu përshkohet nga korridori Selanik -Korçë-Durrës, (si degëzim i korridorit të tetë) që edhe ky ndikon në zhvillimin ekonomik të rrethit. Përfundimi i rrugës automobilistike Qukës-Plloçë do të ketë ndikime mjaft pozitive për zhvillimin ekonomik dhe social të një pjese të konsiderueshme të zonës rurale.

2.2 Relievi (tiparet kryesore)

Relievi i një territori ndikon në një shkallë të madhe në zhvillimin ekonomik të tij. Relievi i zonës së Pogradecit karakterizohet nga një shumëllojshmëri tipash dhe formash. Në të gjenden të tre tipat e relievit: fushor, kodrinor dhe malor, ku mbizotëron ai malor. Shumëllojshmëria e relievit duket dhe nga format e ndryshme të tij, të cilat shfaqen në njësi të caktuara fiziko-gjeografike. Njësitë më kryesore fiziko-gjeografike janë:

Gropa e Pogradecit. Shtrihet në pjesën jugore dhe jugë perëndimore të të gropës së Ohrit. Ka një lartësi nga 695 m deri në 800 m mbi nivelin e detit. Ndahet nga fushëgropa e Korçës nga pragu i Çërravës ndërsa Qafa e Thanës e ndan atë nga Fushë- Gropa e Përrenjasit. Pjesë përbërse e saj është fusha e Buçimasit. Theksojmë se një pjesë e Fushë-Gropës së Korçës (zona e Nizhavecit, Petrushë i takojnë territorit të Pogradecit.

Fusha e Buçimasit. Ka një gjatësi prej 8 km dhe gjerësi rreth 3 km. Në pjesën veriore dhe verilindore është e sheshtë ndërsa në drejtim të liqenit rritet pjerrësia.

Fusha e Linit. Ndodhet midis gadishullit me të njëjtin emër dhe Qafës së Thanës. Ka një gjatësi prej rreth 2 km dhe gjerësi prej 1 km. Është e sheshtë për shkak të mbetjeve liqenore.

Malësia e Mokrës. Ka një gjatësi dhe gjerësi prej rreth 20 km dhe shtrihet në jugë të Fushë- Gropës së Përrenjasit dhe Qafës së Thanës. Ka një lartësi nga 550 m deri në 1800 m mbi nivelin e detit, dhe përshkohet nga shumë degë të Shkumbinit që e kanë copëtuar atë. Karakterizohet nga një nivel i lartë i erozionit.

Mali i Thatë. Shtrihet midis Gropës së Ohrit dhe Gropës së Prespës së Madhe me drejtim veri-jug. Ka një shtrirje nga lartësia 900 m deri në 2288 m. Në rrethin e Pogradecit ndodhet pjesa veriore e tij.

Në këtë rreth bëjnë dhe pjesa veriore e Malësisë së Gorës, Mali i Gurit të Zi, mali i Gurit të Topit, dhe mali i Valamarës.

2.3 Klima

Rrethi i Pogradecit bën pjesë në zonën e tretë klimatike të vendit: zona klimatike mesdhetare – para malore dhe malore sipas njërive përkatëse të relievit. Vera është e ngrohtë dhe e thatë, kurse dimri është i ftohtë i gjatë dhe me reshje bore. Këto karakteristika klimatike ndikojnë zhvillimin ekonomik dhe sidomos të bujqësisë. Të dhënat klimatike shumëvjeçare karakterizohen: temperatura mesatare e muajit Janar 2.1°C ndërsa temperatura mesatare e muajit Korrik 20.8°C , temperatura mesatare vjetore maksimale 11.6°C . Temperatura minimale absolute është -4.5°C Sasia mesatare e reshjeve 747.8 mm. Mesatarisht janë regjistruar 18.7 ditë me reshje bore. Po ashtu ka 300 ditë me diell. Me ndryshimet globale të klimës këto kanë pësuar ndryshime rreth këtyre vlerave.

II. BUJQËSIA E HERSHME

Zbulimet arkeologjike në fushën e Korçës, hedhin dritë mbi fillimet e bujqësisë edhe në zonën e Pogradecit si një vazhdimësi natyrore dhe më shumë e saj. Zbulimet tregojnë se zona e Pogradecit qenë e që në fillim të epokës së re të gurit-neolitit, mijëvjeçari i gjashtë para erës sonë, nga një popullsi qëndruese e cila kishte filluar të merrej që në atë kohë me bujqësi dhe blegtori, me karakteristikat e përshkruara dhe në rastin e zonës së Korçës. Zbulimi i rëndësishëm në zonën e Pogradecit janë Pitosat prej balti (hambarë prej balti për ruajtjen e drithit.) që i takojnë gjysmës së dytë të mijëvjeçarit të parë para erës sonë, me zhvillimin që pati bujqësia me daljen e veglave prej hekuri. Në fshatrat e zonës së Mokrës (sidomos Veri, Senicë, Hondisht, Kriçkovë) janë gjetur shumë vegla prej hekuri që në formë ngjasin me veglat e përdorura edhe në kohën tonë. Këto vegla janë plore për punimin e tokës, kazma, kazma sëpatë, kosore, çelikanë, kiza dhe drapërinj. Zona e Mokrës, edhe pse malore, ka qenë që në shekullin IV-II para erës sonë një zonë me zhvillim ekonomik e shoqëror relativisht të lartë dhe njëkohësisht me rëndësi të madhe në Ilirinë Juglindore. Këtë e tregojnë zbulimet në Gradishtë e Selcës së Poshtme, ku mendohet se ka qenë Pelioni, kryeqendra e parë e shtetit Ilir në shekullin e IV para erës sonë. Kjo zonë ka vazhduar të jetë një krahinë me popullsi të dendur dhe me një bujqësi të përparuar edhe në kohën e vonë antike.

Veglat e gjetura tregojnë se bujqit përveç bimëve të arave kultivonin edhe vreshta dhe pemë të ndryshme frutore. Gjatë fillimit të mesjetës zhvillimi i bujqësisë u karakterizua nga një gjendje amullie që lidhet me sistemin feudal dhe luftrat e vazhdueshme. Megjithatë gjatë mesjetës dhe deri në fillim të shekullit të XX bujqësia ishte mjeshtëria dhe veprimtaria kryesore e pjesës dërmuese të popullsisë në zonën e Pogradecit, si pjesë e rajonit të Korçës, që merreshin me kultivimin e bimëve të arave, pemëtari, vreshtari dhe blegtori.

III. BUJQËSIA PARA ÇLIRIMIT TË VENDIT (një vështrim i shpejtë)

Para çlirimit të vendit, ashtu si në të gjithë vendin, bujqësia në rajonin e Pogradecit ishte e prapambetur. Në fshat mbizotëronin mbeturinat e marrëdhënieve feudale, që ishin në të njëjtën kohë dhe pengesë për zhvillimin e bujqësisë. Hapat e para për zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste në bujqësi në rajonin shfaqen në formën e përpjekjeve për të krijuar shoqëri dhe sipërmarrje kapitaliste bujqësore.

Faktorët për një prodhim bujqësor të krahasueshëm me vendet e tjera të Europës, mungonin në mënyrë dramatike. Në të gjithë prefekturën e Korçës punonin 3 specialistë me arsim të lartë: një agronom, një zooteknik dhe një veteriner. Po kaq dhe specialistë me arsim të mesëm. Këta specialistë duhet të shërbenin për 347 fshatra që kishte prefektura e Korçës. Mungonin pothuajse tërësisht

sistemet e kullimit dhe të ujitjes. Prodhimi bujqësor dhe blegtoral bazohej në punën e krahut dhe të kafshëve. Mjetet më të përdorura ishin plugu dhe parmenda që tërhiqeshin me kafshë. Të gjitha këto reflektoheshin në prodhimet e realizuara nga nën Prefektura e Pogradecit. Në vitin 1927.

(Tabela 1)

(kv)

Emërtimi	Prefektura (Korçë, Kolonjë, Leskovik, Bilisht, Pogradec)	Nënprefektura Pogradec	Në %
1. Grurë	75927	12000	15.8
2. Misër	68810	15000	21.8
3. Elb	15976	5000	31.3
4. Tërshërë	6180	1000	16.2
5. Duhan	337	40	11.9
6. Fasule	5709	2000	35.0
7. Patate	611	122	20.0
8. Rrush	11918	5000	41.9

Tabela 1. Prodhimet kryesore bujqësore në vitin 1927. (Teki Selenica. Bujqësia shqiptare në vitin 1927).

Nuk kishte asnjë traktor deri në vitin 1938. Në vitin 1938 u prodhuan 6928 ton cereale, kryesisht drithëra buke.

Para çlirimit blegtoria përbënte aktivitet të rëndësishëm duke pasur parasysh dhe kushtet e relievit. Sipas një regjistrimi të bërë në vitin 1937 tregon në rrethin e sotëm të Pogradecit janë mbarështuar pothuajse të gjithë llojet e kafshëve shtëpiake. (Tabela 2)

<i>Emërtimi</i>	<i>Krerë</i>
1. Kuaj	1748
2. Mushka	313
3. Gomerë	1263
4. Gjerdhë	11131
-Lopë	3303
5. Buallica	314
6. Të leshta gjithsej	22062
7. Të dhirta gjithsej	25432
8. Dera	80
9. Shpendë	22553
10. Bletë	758

Tabela 2. Blegtoria në rrethin e Pogradecit në vitin 1937.

Sikurse shihet blegtoria e imët ka qenë më relativisht e zhvilluar. Gjatë kësaj periudhe u bënë përpjekje për kryerjen e dy reformave agrare përkatësisht nga qeveria e Fan S. Nolit dhe mbreti Zog por që nuk shkuan deri në fund.

IV. BUJQËSIA MBAS ÇLIRIMIT DERI NË VITIN 1990 (Një vështrim i shpejtë)

Kjo periudhë mund të karakterizohet si periudha e ndryshimeve dramatike në jetën shoqërore dhe ekonomike të rajonit ashtu si në të gjithë vendin. Reforma agrare, kolektivizimi i bujqësisë dhe futja e bujqësisë në kuadrin e zhvillimit socialist, mund të konsiderohen ngjarjet më të mëdha mbas çlirimit, në fushën e bujqësisë. Ato përcaktuan trendet kryesore të zhvillimit ekonomik të fshatit dhe fatet e tij për më se 45 vjet.

4.1 Reforma e Tretë Agrare ose Reforma Radikale

U zhvillua në vitet 1945-1946. Në përgjithësi rajoni i Korçës duke përfshirë dhe Pogradecin si pjesë e tij, konsiderohet rajoni ku reforma u zhvillua me shpejtësi. Në rrethin e Pogradecit u shpërndanë 562 ha ha tokë, dhe përfituan 184 familje. *(Ky informacion është gjetur në arkivin e Pogradecit.)*

4.2 Reforma e IV Agrare ose Kolektivizimi i Bujqësisë

Kolektivizimi i bujqësisë në tërësi u zhvillua me një herë mbas reformës agrare dhe u zhvillua në tre faza dhe zgjati përreth 20 vjet. Megjithëse nuk ka ndonjë punim të veçantë për kolektivizimin e bujqësisë në këtë rreth nga hulumtime tona mund të konkludojmë lidhur me ecurinë e këtij procesi sa ekonomik aq e politik. (Tabela 3) Kooperativa e parë u krijua në dhjetor të vitit 1950 por u miratua në vitin 1951. Ajo ishte kooperativa e Zdërvaskës (Gështenjas). Në fillim ecuria e këtij procesi ishte i ngadalshëm . Në vitet 1953-1954 nuk u krijua ndonjë një kooperativë. Ai u shpejtua gjatë viteve 1956-1957-1958 kur u ngritën edhe përkatësisht 13, 26 dhe 19 kooperativa.

Numri më i madh i kooperativave u arrit në fund vitin 1958. Mbas këtij viti filloi bashkimi i kooperativave prandaj dhe numri i tyre u pakësua në Kështu në vitin 1964 ishin 35 kooperativa me 8500 ha tokë dhe 4100 familje dhe më vonë vetëm 17 kooperativa të bashkuara. Në këtë rreth vetëm kooperativa e Buçimasit kaloi në KTL (Kooperativa të Tipit të Lartë), ku edhe shteti merrte pjesë me investime të pakthyeshme. Kooperativa e qendrës kaloi në NB shtetërore.

Vitet	Numri i kooperativave të reja
1951	1
1955	3
1956	13
1957	26
1958	19

Tabela 3. Ecuria e kolektivizimit në rrethin e Pogradecit.

Me gjithë bashkimin e tyre ato ishin relativisht të vogla. (Tabela 4)

Emërtimi	Numri i kooperativave	Krahë pune (nr)	Tokë nën kulturë (ha)
Deri 100 ha	7	554	433
101-500 ha	24	6354	2932
501-1000	4	5342	2532

Tabela 4. Përbërja e kooperativave të bashkuara në vitin 1964.

4.3 Faktorët dhe zhvillimi i bujqësisë deri në vitin 1990

Në prodhimin bujqësor ka një sërë faktorësh materialë dhe humanë që ndikojnë krahas me faktorët natyrorë të cilët në këtë sektor ndikojnë fuqishëm në raport me sektorët e tjerë të ekonomisë. Po analizojmë shkurtimisht disa prej tyre.

4.3.1 Njerëzit faktor i rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë.

Në vendet në zhvillim është karakteristikë prania e në përqindje të lartë të popullsisë që banon dhe punon në fshat. Në vendin tonë përqindja e popullsisë me banim në fshat ka qenë shumë e lartë, dhe e pa krahasueshme me asnjë vend evropian. Edhe rrethi i Pogradecit nuk bën përjashtim nga ky fenomen. (Tabela 5)

Vitet	Popullsia gjithsej (nr.)	Nga kjo:		
		Qytet	Fshat	Fshati (%)
1938	23900	3600	20300	84.9
1970	47619	10100	37519	79.1
1980	59000	13700	45300	76.8
1990	73333	21123	53210	72.6

Tabela 5. Popullsia në rrethin e Pogradecit në disa vite.

Sikurse shihet në fshat ka jetuar 72.6 deri 84.9 për qind e popullsisë së rrethit në 70 fshatra. Kjo reflektonte zhvillimin ekonomik relativisht të ulët ekonomik të vendit, shtesë natyrale më të lartë të popullsisë në fshat si dhe ndalimi i lëvizjes së lirë nga fshati në qytet. Numri i lartë i popullsisë në fshat shoqërohej nga një numër i lartë i kraheve të punës në bujqësi. Kështu në kooperativat bujqësore numri i kraheve të punës ka qenë si më poshtë. (Tabela 6)

Vitet	Krahë pune në kooperativat (nr.)
1970	5793
1985	14671
1989	15069

Tabela 6. Krahët e punës në kooperativat bujqësore

Gjatë kësaj periudhe bujqësia u fuqizua ndjeshëm me specialistë me arsim të lartë dhe të mesëm të profilit bujqësor. (Tabela 7)

Emërtimi	1970	1980	1989
Gjithsej:	16	122	256
- Agronomë	11	50	80
- Veterinerë	2	17	39
- Zooteknikë	2	11	27
- Ekonomistë agrarë, etj.	1	43	85
- Të tjerë	-	1	25

Tabela 7. Specialistë me arsim të lartë në kooperativa dhe NB.

Sikurse shihet për afro 20 vjet, nëpunësit me arsim të lartë janë rritur 16 herë, agronomët 8 herë, ekonomistët 85 herë etj. Në vitin 1989 vetëm në kooperativa ishin 74 agronomë, 74 ekonomistë etj. Vlen të theksohet se kujdes iu kushtua edhe arsimimit të mesëm në vetë zonën rurale. Kështu në këtë

zonë ishin në vitin 1990, 11 shkolla të mesme që kishin edhe paralele për përgatitjen e agronomëve të mesëm, zooveterinerë etj. Në vitin 1990 ishin 1505 nxënës që ndiqnin arsimin bujqësor.

4.3.2 Faktorët materialë dhe natyrorë të prodhimit bujqësor.

- Ujitja dhe kullimi

Për vetë kushtet klimaterike në të cilat shtrihet rrethi i Pogradecit, ujitja e bimëve sidomos në vite të veçantë ka qenë domosdoshmëri, për të siguruar sasi të parashikuara të prodhimit në të gjitha bimët por sidomos në ato prashitëse. Për këtë arsye në sistemin ujitës janë bërë investime të rëndësishme edhe në zonat më të thella. Në vitin 1989 në këtë rreth në ndihmë të bujqësisë ishin ndërtuar 23 rezervuarë me aftësi ujitëse në total prej 2410 ha., hauze 140 me aftësi ujitëse 1200 ha. etj. Ishin ndërtuar një numër i madh stacione pompimi, nga të cilët 19 me aftësi ujitëse nga 10 ha deri 400 ha, punonin 100 shihedhës të përhershëm dhe 850 me anën e traktopompave. Kjo solli rritjen e aftësisë ujitëse. (Tabela 8)

Vitet	Aftësia ujitëse (ha)	Në % ndaj tokës së punuar
1938	700	---
1964	1800	16.2
1990	6400	36.2

Tabela 8. Aftësia ujitëse në rrethin e Pogradecit.

Në periudha të ndryshme janë përdorur mënyra të ndryshme të ujitjes si me përmytje, me brazda dhe në fund me sisteme në formë shiu.

- Mekanizimi

Mekanizimi i bujqësisë është konsideruar faktor i rëndësishëm i prodhimit bujqësor dhe është parë në raport me përdorimin e krahëve të punës. E gjithë mekanika ishte organizuar në SMT (Stacioni i Makinave dhe Traktorëve) që iu shërbenin kooperativave bujqësore. Sikurse përmendëm në vitin 1938 nuk kishte asnjë traktor. Ndërmarrjet Bujqësore pronë e shtetit kishin mekanikën e vet. Në vitet në vazhdim parqet e makinave dhe traktorëve u fuqizuan. (Tabela 9)

Emërtimi	1958	1986	1989
1. Traktorë 15k.f	---	386.3	414.7
-SMT	----	335.6	364.0
2. Volumi i punës(000/ha.u)	9.3	233.7	245.7
-SMT	9.3	203.8	213.3

Tabela 9. Mekanizimi i bujqësisë.

Vetëm në SMT në vitin 1989 kundrejt vitit 1958 rriti volumin e punimeve me 23 herë.

Relievi në pjesën dërmuese kodrinor dhe malor ndikon në nivelin e mekanizimit të proceseve të ndryshëm. Pjesa më e madhe e punimeve kryheshin me mjete mekanike dhe një pjesë me kafshë dhe krahë pune. (Tabela 10)

Tabela 10. Niveli i mekanizimit në proceset kryesore në kooperativat bujqësore (1989)

<i>Emërtimi</i>	<i>Kooperativa (Ha)</i>	<i>Kooperativa (%)</i>
<i>1.Lëvrime gjithsej</i>	15338	100
<i>-Me SMT</i>	8788	57.3
<i>-Me kafshë</i>	3024	19.7
<i>-Me krahë</i>	3526	23.0
<i>2.Mbjellje gjithsej</i>	11775	100
<i>-Me SMT</i>	5520	46.9
<i>-Me kafshë</i>	3084	26.7
<i>-Me krahë</i>	3171	26.9
<i>3.Prashitje gjiths.</i>	12938	100
<i>-Me SMT</i>	2720	21.0
<i>-Me kafshë</i>	1970	15.2
<i>-Me krahë</i>	8248	63.8

Prashitjet që përfaqësojnë dhe një volum të madh pune realizoheshin kryesisht me krahë pune 64 për qind. Në vitin 1989 në rrethin e Pogradecit ishin 14 autokombajna. Mekanika e rëndë ishte pronë e shtetit, dhe për punët që kryenin në kooperativat bujqësore paguheshin sipas tarifave të miratuara nga qeveria. Kooperativat mund të blinin pajisje të thjeshta dhe makina transporti. Në vitin 1989 ato dispononin makina mbjellëse të lashta që tërhiqeshin me kafshë 212, makina mbjellëse misri 44, makina shirëse 23, kamionë 37, etj.

-Përdorimi i plehrave kimike

Plehrat kimike për bujqësinë tonë kanë qenë elementi më novator për rritjen e prodhimit. Megjithëse përdorimi i tyre ka filluar vonë, ndërtimi i dy uzinave në vend për prodhimin e plehrave azotike dhe fosforike rriti në mënyrë të ndjeshme përdorimin e tyre. (Tabela 11)

<i>Emërtimi</i>	<i>Përdorimi i plehrave kimike (tonë)</i>
Plehra gjithsej:	7834.1
-Ure	1767.0
-Nitrat amoni	2498.3
-Fosfatike	3417.8
-Potasike	151.0

Tabela 11. Përdorimi i plehrave kimike në vitin 1989.

Në vitin 1989 për çdo ha tokë arë në kooperativat bujqësore janë përdorur 535.8 kg plehra kimike.

-Toka bujqësore si faktor bazë i zhvillimit të bujqësisë

Toka konsiderohet si një faktor natyror por edhe njerëzor i prodhimit bujqësor. Si rezultat çeljes së tokave të reja në kodra dhe male fondi i tokës së punuar është rritur me ritme të shpejtë. (Tabela 12)

<i>Viti</i>	<i>Tokë gjithsej e punuar (ha)</i>	<i>-Arë</i>	<i>-Pemishte</i>	<i>-Vreshta</i>
1958	10500	10100	200	200
1980	17500	14600	2500	400
1990	17700	14600	2700	400

Tabela 12. Fondi i tokës së punuar në disa vite.

Ajo që tërheq vëmendjen është që sipërfaqja e zënë me pemë frutore kundrejt tokës së punuar është relativisht e lartë, 15.2 për qind nga 8.1 për qind që është ky tregues në bashkinë e Korçës.

Nga çelja e tokave të reja (që në shumë raste ishin të pa argumentuara ekonomikisht) edhe në këtë rreth u dëmtuan sipërfaqe të tëra me pyje dhe shkurre si dhe kullota natyrore.

4.3.3 Bimët e arave

Kushtet klimaterike dhe tokësore të rrethit të Pogradecit si dhe kërkesat e ekonomisë së vendit në kushtet e izolimit, kanë përcaktuar prodhimin dhe strukturën e bimëve të arave. Prodhimi nga bimët e arave ka qenë drejtuese në strukturën e prodhimit bujqësor në tërësi. Nga bimët e arave, prodhimi i drithërave të bukës, dhe në veçanti prodhimi i grurit ka qenë prioritar. Kjo ka përcaktuar strukturën e mbjelljeve, përqendrimin e imputove, etj.

a. Struktura e mbjelljeve (Tabela 13)

<i>Emërtimi</i>	<i>1958</i>	<i>1970</i>	<i>1980</i>	<i>1989</i>
1..Drithra buke	7506	6871	8002	8259
-Grurë	2888	3770	5431	5526
-Misër	3125	2102	1718	1134
2.Patate	12	1084	530	76
3.Duhan	315	675	1001	1155
4.Panxhar sheqeri	-	-	298	-
5.Elb distik	-	112	303	365
6.Perime gjithsej	137	217	250	226
7.Fasule	1	25	826	855
8.Tagjira,foragjere	742	1864	2614	2813

Tabela 13. Struktura e mbjelljeve në bimët e arave.

Sikurse shihet drithërat e bukës kanë zënë pjesën më të madhe të sipërfaqes së tokës. Po ashtu vend të rëndësish ka zënë tagjirat dhe foragjeret, fasulja direkt, duhani dhe elb distik sidomos mbas viteve 1970. Në këtë rreth është mbjellë dhe lule dielli në vitin 1970. Vlen të theksohet që mbjellja e duhanit dhe e elbit distik është bërë dhe në kooperativat tërësisht malore.

b. Rendimentet e realizuara

Si rezultat i përmirësimit të teknikave dhe teknologjive të kultivimit të bimëve të arave produktivitetit për ha është rritur. (Tabela 14)

(kv/ha)

<i>Emërtimi</i>	<i>1958</i>	<i>1970</i>	<i>1985</i>	<i>1990</i>
1 .Grurë	11.0	15.0	26.0	22.9
2.Patate	44.0	39.9	43.8	51.0
3.Duhan	9.0	8.5	6.7	3.9
4.Panxhar sheqeri	-	-	191.3	-
5.Elb distik	-	-	8.1	6.1
6.Perime gjithsej	74.8	142.6	131.0	128.0
7.Fasule	6	7	3.1	---

Tabela 14. Rendimentet në bimët e arave.

Rendimenti më i lartë si rreth në gjithë vitet në grurë është arritur në vitin 1988, 26.6 kv/ha. në misër në vitin 1989, 29.6 kv/ha, në patate po në këtë vit, 96.1 kv/ha, etj.

c. Prodhimet në bimët e arave

Prodhimi i bimëve të arave është funksion i të gjithë faktorëve të prodhimit: tokë, punë, kapital, dhe menaxhim. Prodhimi i drithërave të bukës është konsideruar detyrë prioritare nga pikëpamja ekonomike por sidomos politike, duke e konsideruar si element të sigurimit të pavarësisë së vendit. Prodhimi i tyre ka pasur tendencë në rritje. (Tabela 15)

<i>Emërtimi</i>	<i>1958</i>	<i>1970</i>	<i>1980</i>	<i>1990</i>
1.Drithra buke	7612	10300	16400	16400
-Grurë	3185	5500	11700	11700
-Misër	3255	4700	3600	1600
2.Patate	52	4000	2100	2100
3.Duhan	283	600	600	600
4.Panxhar sheqeri	-	-	7100	7100
5.Perime gjithsej	1023	2900	4700	4700
6. Fasule gjithsej	273	253	300	300

Tabela 15. Prodhimet e bimëve të arave (tonë)

Kështu në vitin 1990 kundrejt vitit 1958, prodhimi i drithërave të bukës është rritur 2.2 herë, i patates mbi 40 herë, etj. Në vite të veçantë janë realizuar: drithëra buke 19500 tonë , grurë 14300 tonë, patate 4000 tonë n, duhan 1000 tonë në vitin, etj.

c. Bimët e arave në kooperativat që tani përbëjnë njësitë vendore.

Një sitë vendore sipas gjendjes së tanishme kanë përfshirë 17 ish kooperativa bujqësore në të gjithë rrethin. Për të analizuar në mënyrë më të plotë bujqësinë sipas njësive vendore të tanishme kemi menduar të paraqesim shkurtimisht arritjen e kooperativave sidomos në fund të viteve 1980.

-Struktura e mbjelljeve (Ha)

Drithëra buke

(Tabela 16)

<i>Emërtimi</i>	<i>1980</i>	<i>1985</i>	<i>1989</i>
1.Hudenisht	410	456	444
2.Buçimas	812	761	886
3.Çëravë	1605	1618	1780
-Blacë	955	982	1100
-Leshnicë	650	636	680
4.Dardhas	913	860	779
-Osnat	385	367	336
-Grunjas	528	493	443
5.Trebinjë	1882	1773	1775
-Trebinjë	537	480	470
-Dunicë	354	330	354
-Çezmë	531	513	497
-Pleshisht	460	450	454
6.Proptisht	1197	1103	1160
-Kriçkovë	352	348	350
-Rodokal	395	360	390
-Vëri	450	395	420

7.Velçan	1098	1122	1128
-Velçan	449	437	445
-Jollë	52	65	59
-Sllabinjë	330	332	349
-Laktesh	267	288	275

Tabela 16. Struktura e mbjelljeve në ish kooperativat që formojnë njësitë vendore.

Peshë të rëndësishme në mbjelljen e drithërave të bukës ka mbajtur Trebinja, Çërava, dhe Proptishti.

-Grurë

(Tabela 17)

<i>Emërtimi</i>	<i>1980</i>	<i>1985</i>	<i>1989</i>
1.Hudenisht	265	256	309
2.Buçimas	530	584	623
3.Çëravë	1236	1135	1330
-Blacë	760	695	800
-Leshnicë	476	440	530
4.Dardhas	635	534	500
-Osnat	240	230	210
-Grunjas	395	304	290
5.Trebinjë	1280	1136	1058
-Trebinjë	377	342	300
-Dunicë	212	170	168
-Çezmë	371	323	300
-Pleshisht	320	301	290
6.Proptisht	745	669	830
-Kriçkovë	215	207	260
-Rodokal	245	203	270
-Vëri	285	259	300
7.Velçan	699	701	817
-Velçan	282	270	300
-Jollë	32	40	36
-Sllabinjë	215	215	281
-Laktosh	170	176	200

Tabela 17. Sipërfaqet e mbjella me grurë në ish kooperativat bujqësore sipas njësive vendore.

Sipërfaqja e mbjellë me grurë është rritur lehtë në vitin 1989 kundrejt vitit 1980. Në disa kooperativa është pakësuar. Gjatë këtyre viteve ka qenë bima bazë e drithërave të bukës.

-Misër

(Tabela 18)

<i>Emërtimi</i>	<i>1980</i>	<i>1985</i>	<i>1989</i>
1.Hudenisht	100	100	49
2.Buçimas	157	88	161
3.Çëravë	227	253	100

-Blacë	135	113	30
-Leshnicë	92	140	70
4.Dardhas	115	140	59
-Osnat	45	60	26
-Grunjas	70	80	33
5.Trebinjë	376	387	293
-Trebinjë	115	98	80
-Dunicë	42	50	6
-Çezmë	110	120	87
-Pleshisht	109	119	120
6.Proptisht	397	370	240
-Kriçkovë	122	130	60
-Rodokal	125	120	100
-Vëri	150	120	80
7.Velçan	345	336	230
-Velçan	140	120	105
-Jollë	15	20	17
-Sllabinjë	105	106	48
-Laktesh	85	90	60

Tabela 18. Sipërfaqja e mbjellë me misër në ish kooperativat sipas njësive vendore.

Në vitin 1989 sipërfaqja e misrit në tërësi pëson një ulje të ndjeshme. Megjithëse duhet thënë se për kushtet e zonës sipërfaqet e mbjella kanë qenë relativisht të larta. Kjo shpjegohet me të qenit të kufizuar në bimë të tjera prashitëse për tu mbjellë në sipërfaqe të mëdha.

-Patate

Bima e patates është mbjellë pothuajse në të gjitha kooperativat. (Tabela 19)

<i>Emërtimi</i>	<i>1980</i>	<i>1985</i>	<i>1989</i>
1.Hudenisht	45	30	3
2.Buçimas	63	55	0.5
3.Çëravë	75	89	14
-Blacë	35	69	11
-Leshnicë	40	20	3
4.Dardhas	60	20	8
-Osnat	30	10	2
-Grunjas	30	10	6
5.Trebinjë	157	66	5
- Trebinjë	54	30	-
-Dunicë	30	5	-
-Çezmë	40	15	2
-Pleshisht	33	16	3
6.Proptisht	54	28	16.5
-Kriçkovë	12	10	3.5
-Rodokal	30	10	8
-Vëri	12	8	5
7.Velçan	93	82	27.5
-Velçan	40	50	13
-Jollë	10	5	1.5
-Sllabinjë	13	7	3

-Laktesh	30	20	10
----------	----	----	----

Tabela 19. Sipërfaqja e mbjellë me patate në ish kooperativat sipas njësisive vendore.

Sikurse shihet sipërfaqja e mbjellë me patate në vitin 1989 është ulur ndjeshëm. Kjo shpjegohet dhe me faktin se në vitet e fundit të viteve 1980 pati një farë liberalizimi lidhur me sipërfaqet që do të mbilleshin me bimët e arave. Patatja për vetë kushtet nuk ishte e preferuar shumë për t'a mbjellë.

-Duhan

Ashtu sikurse është theksuar sipërfaqet e mbjella kanë qenë relativisht të mëdha në kooperativat që mbillej, megjithëse nuk mbillej në të gjitha ekonomitë. (Tabela 20)

<i>Emërtimi</i>	<i>1980</i>	<i>1985</i>	<i>1989</i>
1.Hudenisht	118	100	132
2.Buçimas	216	219	195
3.Çëravë	285	353	345
-Blacë	160	223	190
-Leshnicë	125	130	155
4.Dardhas	-	-	16
-Osnat	-	-	6
-Grunjas	-	-	10
5.Trebinjë	131	53	90
- Trebinjë	47	-	27
-Dunicë	-	-	-
-Çezmë	42	23	23
-Pleshisht	42	30	40
6.Proptisht	139	210	224
-Kriçkovë	42	60	54
-Rodokal	42	57	76
-Vëri	55	93	94
7.Velçan	112	115	153
-Velçan	40	25	50
-Jollë	-	-	-
-Sllabinjë	42	65	71
-Laktesh	30	25	32

Tabela 20. Sipërfaqja e mbjellë me duhan në ish kooperativat sipas njësisive vendore.

- Perime

Perimet janë mbjellë në të gjitha ish kooperativat. Ish kooperativat malore kryesisht për nevojat e veta , ndërsa të tjerat edhe për treg. (Tabela 21).

<i>Emërtimi</i>	<i>1980</i>	<i>1985</i>	<i>1989</i>
1.Hudenisht	28	12	10
2.Buçimas	103	110	76
3.Çëravë	32	26	39
-Blacë	15	14	17
-Leshnicë	17	12	22
4.Dardhas	6	10	6
-Osnat	3	5	3

-Grunjas	3	5	3
5.Trebinjë	21	15.4	13
- Trebinjë	8	5	3
-Dunicë	3	3	3
-Çezmë	5	3	4
-Pleshisht	5	4.5	3
6.Proptisht	30	26.4	29
-Kriçkovë	4	3	4
-Rodokal	12	13.4	12
-Vëri	14	10	13
7.Velçan	11.4	10	13
-Velçan	3.4	3	4
-Jollë	1	1	1
-Sllabinjë	4	3	4
-Laktesh	3	3	4

Tabela 21. Sipërfaqet e mbjella me perime në ish kooperativat e njësisve vendore.

-Fasule direkt

Fasule direkt janë mbjellë në të gjitha kooperativat. Në fund të viteve 1980 për të furnizuar më mirë kooperativistët nga sipërfaqja e kooperativës u caktuan toka për çdo brigadë për ti mbjellë me fasule, perime, patate. Kjo shpjegon dhe rritjen e sipërfaqes me fasule. (Tabela 22)

<i>Emërtimi</i>	<i>1980</i>	<i>1985</i>	<i>1989</i>
1.Hudenisht	25	34	34
2.Buçimas	103	57	72
3.Çëravë	137	139	118
-Blacë	110	99	100
-Leshnicë	27	40	18
4.Dardhas	131	65	123
-Osnat	61	-	54
-Grunjas	71	65	69.5
5.Trebinjë	262	273	301
- Trebinjë	58	67	85
-Dunicë	55	42	46
-Çezmë	91	103	81
-Pleshisht	58	61	89
6.Proptisht	102	152	90.5
-Kriçkovë	20	100	100
-Rodokal	36	24	28
-Vëri	46	28	39
7.Velçan	66	20	76
-Velçan	16	20	37
-Jollë	10	-	6
-Sllabinjë	20	-	25
-Laktesh	20	-	8

Tabela 22. Sipërfaqet e mbjella në kooperativat sipas njësisve vendore.

Në rrethin në vite të caktuara janë mbjellë panxhar sheqeri, humulus ndërsa elbi distik ka qenë më i përhapur.

-Prodhimet nga bimët e arave.

Në bazë të sipërfaqeve të mbjella, produktivitetit si dhe prodhimin në bashkëshoqërim në ish kooperativat janë realizuar prodhime që në përgjithësi kanë ardhur në rritje.

-Prodhim drithëra buke dhe patate

Prioriteti në sipërfaqet e mbjella është shoqëruar edhe në prodhimin e drithërave të bukës që ka përbërë dhe drejtimin kryesor të aktivitetit në rrethin e Pogradecit. (Tabela 23)

(Kv)

Emërtimi	<i>Drithëra buke</i>			<i>- Grurë</i>			<i>Patate</i>		
	<i>1980</i>	<i>1985</i>	<i>1989</i>	<i>1980</i>	<i>1985</i>	<i>1989</i>	<i>1980</i>	<i>1985</i>	<i>1989</i>
1.Hudenisht	7896	10529	10679	5565	6928	8102	1600	433	68
2.Buçimas	28217	30254	34888	18008	22653	22317	2120	2037	271
3.Çëravë	41915	46177	41518	33634	37311	34271	4514	1767	2171
-Blacë	24940	29384	24765	20620	23367	20287	2510	1154	1759
-Leshnicë	16975	16793	16753	13014	13944	13984	2004	613	412
4.Dardhas	10696	10673	7651	8493	7474	5438	1163	501	509
-Osnat	4160	4833	2925	2908	3187	2050	200	100	112
-Grunjas	6536	5840	4726	5585	4287	3388	963	401	397
5.Trebinjë	25454	32687	27456	18682	24858	20719	4990	1728	190
- Trebinjë	8304	10898	7890	6055	9397	6300	2511	409	-
-Dunicë	3689	4440	3447	2532	2330	2232	430	100	-
-Çezmë	5573	7295	4648	4194	5410	3357	607	220	94
-Pleshisht	7888	9923	11471	5901	7721	8830	1442	999	96
6.Proptisht	20790	21973	25411	14403	15862	19911	947	924	1009
-Kriçkovë	6532	6576	8241	5100	5157	6468	321	262	217
-Rodokal	6723	7397	8384	4137	5104	6697	195	91	231
-Vëri	7535	8000	8786	5166	5601	6746	431	571	561
7.Velçan	20520	23079	23930	14775	16157	16551	5222	6097	3563
-Velçan	7316	8366	8225	5448	5700	5735	2065	3600	1246
-Jollë	833	1128	859	534	813	475	110	160	127
-Sllabinjë	6251	7006	7884	4578	5666	5715	997	487	275
-Laktesh	5850	6579	6962	4215	3978	4626	2050	1850	1915

Tabela 23. Prodhimi i drithërave të bukës dhe patates sipas njërive administrative.

-Prodhimi i duhanit dhe perime

(Kv.)

(Tabela 24)

Emërtimi	<i>Duhan</i>			<i>Perime</i>		
	<i>1980</i>	<i>1985</i>	<i>1989</i>	<i>1980</i>	<i>1985</i>	<i>1989</i>
1.Hudenisht	689	830	956	2038	1255	2510
2.Buçimas	1656	1561	1987	18592	16503	17836
3.Çëravë	1948	2394	2281	6129	3645	6055
-Blacë	997	1390	1167	3720	2141	2643
-Leshnicë	951	1004	1114	2409	1504	3412

4.Dardhas	-	-	89	2693	886	559
-Osnat	-	-	14	2409	399	234
-Grunjas	-	-	75	284	487	325
5.Trebinjë	435	354	329	1269	1669	892
- Trebinjë	133	122	78	296	462	325
-Dunicë	-	-	-	229	173	113
-Çezmë	88	36	46	213	497	104
-Pleshisht	214	196	205	531	537	350
6.Proptisht	714	1273	759	3471	2388	3330
-Kriçkovë	185	367	168	342	332	418
-Rodokal	183	347	410	1282	1271	1460
-Vëri	346	559	181	1847	785	1452
7.Velçan	445	834	652	1311	1295	1346
-Velçan	105	84	103	408	400	486
-Jollë	-	-	-	46	93	53
-Sllabinjë	235	574	381	507	458	443
-Laktesh	105	176	168	350	344	364

Tabela 24. Prodhimi i duhanit dhe perimeve në kooperativat sipas njësisive administrative.

Tabela tregon prodhimi i perimeve për furnizimin e qytetit ka qenë përqendruar në Buçimas dhe Çëravë.

- Prodhimi i elbit distik dhe fasuleve

(Kv)

(Tabela 25)

<i>Emërtimi</i>	<i>Elb distik</i>		<i>Fasule gjithsej</i>		
	<i>1980</i>	<i>1989</i>	<i>1980</i>	<i>1985</i>	<i>1989</i>
1.Hudenisht	213	-	336	134	626
2.Buçimas	-	-	513	168	691
3.Çëravë	926	-	359	300	1501
-Blacë	926	-	240	202	867
-Leshnicë	-	-	154	98	634
4.Dardhas	278	1086	311	149	533
-Osnat	278	178	152	27	228
-Grunjas	-	908	159	122	305
5.Trebinjë	591	1679	650	736	1358
- Trebinjë	-	398	173	152	216
-Dunicë	242	-	123	109	365
-Çezmë	349	481	179	220	259
-Pleshisht	-	800	175	255	518
6.Proptisht	-	505	523	571	1597
-Kriçkovë	-	130	108	131	500
-Rodokal	-	72	164	183	323
-Vëri	-	303	251	257	774
7.Velçan	-	-	446	380	1284
-Velçan	-	-	167	194	449
-Jollë	-	-	20	13	79
-Sllabinjë	-	-	128	85	428
-Laktesh	-	-	131	88	328

Tabela 25. Prodhimi i elbit distik dhe fasules.

Në vitin 1989 prodhimi i fasules është rritur ndjeshëm sepse u dhanë orientimet për të ndarë sipërfaqen e fasules edhe sipas brigadave për të prodhuar për nevojat e veta. (Këto sipërfaqe në atë kohë u quajtën arëza. Sikurse është theksuar disa kooperativa kanë prodhuar në vite të caktuara edhe panxhar sheqeri si Buçimas, Blacë, Leshnicë.

4.3.4 Pemëtaria dhe vreshtaria

Pemëtaria ka qenë një aktivitet i rëndësishëm prodhues në zonën rurale të rrethit të Pogradecit. Janë kultivuar një shumëllojshmëri species si molla, kumbulla, dardha, gështenja, arra, etj. Sikurse përmendëm një përqindje relativisht e tokës së punuar ka qenë zënë me drufrutorë.

a. Sipërfaqet e mbjella

Sipërfaqet me pemëtari në rrethin e Pogradecit është rritur gjatë viteve duke përfshirë edhe kooperativat e thella malore. Ajo ka përbërë një aktivitet të rëndësishëm ekonomik. Nga ana tjetër sipërfaqet e mbjella me vreshta kanë qenë më stabile. (Tabela 26).

<i>Vitet</i>	<i>Pemëtore (ha)</i>	<i>Vreshta (ha)</i>
1958	200	200
1964	600	400
1975	2100	400
1980	2500	400
1985	2600	400
1990	2700	400

Tabela 26. Sipërfaqet me pemëtore dhe vreshta.

Pemëtoret dhe vreshtat zakonisht mbilleshin në toka më pak produktive për bimët e arave dhe janë përqendruar më shumë sidomos në zonën kodrinore.

-Rrënjët e pemëve frutore

Numri gjithsej i drurëve frutorë tregohet në tabelën 27.

<i>Viti</i>	<i>Rrënjë (000)</i>
1956	162.3
1970	334.6
1980	675.3
1985	915.0
1990	899.0

Tabela 27. Drurë frutorë gjithsej.

Peshën kryesore në drurët frutorë e përbënin mollët dhe kumbullat.

Prodhimi i frutave është rritur nga viti në vit. (Tabela 28)

<i>Vitet</i>	<i>Prodhim fruta (tonë)</i>
--------------	-----------------------------

1970	3853
1975	2503
1980	3773
1985	3639
1990	3600

Tabela 28. Prodhimi i frutave.

Rrethi i Pogradecit është përmendur në rajon për prodhimin e kumbullave, mollëve, arave dhe gështenjave .

Prodhimi i rrushit gjithsej

Prodhimi i rrushit tregohet në tabelën 29.

<i>Vitet</i>	<i>Prodhim gjithsej (Tonë)</i>
1970	1439
1975	1027
1980	1724
1985	1507
1990	1100

Tabela 29 Prodhimi i rrushit.

Në zonën e Ploçës, Leshnicës janë prodhuar sasitë më të mëdha të rrushit. Kjo duket është dhe zona më e mirë për rritjen dhe prodhimin e rrushit, nga i cili është prodhuar verë që kërkohej nga tregu.

-Pemëtaria dhe vreshtaria në kooperativat pjesë e bashkisë Pogradec.

Sipërfaqet me pemë dhe vreshta

Sipërfaqet e mbjella me pemë e vreshta për secilën ish kooperativë për vitin 1989 tregohen në tabelën 30.

<i>Emërtimi</i>	<i>Pemëtaria (Ha)</i>	<i>Vreshta (Ha)</i>
1.Hudenisht	152	18
2.Buçimas	419	85
3.Çeravë	673.0	71
-Blacë	328	31
-Leshnicë	345	40
4.Dardhas	131.2	4
-Osnat	62.2	2
-Grunjas	69	2
5.Trebinjë	227.3	14.8
- Trebinjë	141	6

-Dunicë	50	-
-Çezmë	83.3	4.8
-Pleshisht	94	4
6.Proptisht	227.0	44
-Kriçkovë	69	11
-Rodokal	89	13
-Vëri	69	20
7.Velçan	207.2	22.0
-Velçan	70.6	4.4
-Jollë	10	-
-Sllabinjë	52.6	11.6
-Laktesh	74	6

Tabela 30. Sipërfaqet e mbjella me pemëtore dhe vreshta.

Sikurse tregohet pjesa më e madhe e sipërfaqeve të mbjella me pemëtari është përqendruar kryesisht në komunën e Çëravës dhe Buçimasit. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për sipërfaqen e mbjellë me vreshta.

- Prodhimi i frutave dhe rrushit.

Prodhimi i frutave dhe rrushit për vitin 1989 tregohen në tabelën 31.

<i>Emërtimi</i>	<i>Pemë gjithsej (rrënjë)</i>	<i>Në prodhim (rrënjë)</i>	<i>Prodhim fruta (kv)</i>	<i>Prodhim rrush (kv)</i>
1.Hudenisht	34469	15432	2272	115
2.Buçimas	102387	74850	9909	569
3.Çëravë	150482	77913	13036	909
-Blacë	69923	38559	4898	379
-Leshnicë	80559	39354	8138	530
4.Dardhas	39377	20635	1242	30
-Osnat	16050	7222	548	-
-Grunjas	23237	13413	694	30
5.Trebinjë	56113	26622	2503	10
- Trebinjë	17085	7000	671	-
-Dunicë	9900	5630	460	-
-Çezmë	15028	7592	472	-
-Pleshisht	14100	6400	900	10
6.Proptisht	59052	27203	3042	303
-Kriçkovë	15846	8760	1175	61
-Rodokal	19464	9530	723	172
-Vëri	23724	8913	1144	70
7.Velçan	69813	42634	3984	4
-Velçan	22654	11444	1276	-
-Jollë	3478	3026	117	-
-Sllabinjë	13515	7903	784	4
-Laktesh	30166	20261	1807	-

Tabela 31. Prodhimi i frutave dhe rrushit.

Është e pritshme që në prodhimin e frutave peshën kryesore ta ketë mbajtur kooperativa Buçimas, dhe kooperativa e Leshnicës. Si njësi vendore të tanishme Çërava, Buçimasi, Velçani. Në prodhimin e rrushit gjithsej kooperativat Buçimas dhe Leshnica.

4.3.5 Blegtoria

Sikurse është theksuar zona e Pogradecit që në hershmëri është marrë me blegtori. Këtë e kanë diktuar relievi, kushtet tokësore dhe klimatike. Para çlirimit duke pasur parasysh territorin janë mbarështuar një llojshmëri kafshësh shtëpiake më tepër në kushte ekstensive. Mbazotëronin bagëtia e imët karakteristike për relievin kryesisht malor. Mbas çlirimit të vendit, në kuadrin e përgjithshëm të bujqësisë, edhe blegtorisë iu kushtua vëmendje dhe kujdes i veçantë, duke e kthyer në një degë të rëndësishme të ekonomisë bujqësore. Ajo është zhvilluar pothuajse tërësisht në kooperativat bujqësore.

4.3.5.1 Zhvillimi numerik i blegtorisë

Mbas çlirimit të vendit dhe njëherazi me kolektivizimin e bujqësisë, ndryshuan ekuilibrat shekullorë në rritjen e llojeve të ndryshme të kafshëve për prodhim. Ajo që konstatohet lehtë është shtimi me ritme më të shpejta i numrit të gjedhit në përgjithësi dhe i lopës në veçanti, në krahasim me bagëtitë e imëta (Tabela 32).

(Mijëra krerë)

Vitet	Gjedhë gjithsej	-Lopë	Të leshta	Të dhirta	Derra	Shpendë	Bletë zgjoj	Një thundrakë
1964	9.1	3.2	30.7	26.8	0.8	28.9	1.3	1.3
1970	9.5	3.6	25.8	14.4	0.6	44.8	0.7	6.2
1975	12.6	4.7	29.0	20.6	1.8	55.3		3.8
1980	15.8	6.7	26.5	17.8	0.9	54.9	2.3	4.7
1985	13.4	5.3	30.5	20.4	0.8	53.2	3.1	5.9
1990	13.6	7.0	39.6	26.1	1.0	126.5	2.5	6.5

Tabela 32. Numri i krerëve të blegtorisë.

- Numri i krerëve në kooperativat pjesë e Bashkisë Pogradec.

Numri i krerëve në kooperativat që formojnë bashkinë e Pogradecit për vitin 1989 tregohet në tabelën 33.

(krerë)

Emërtimi	Gjedhë gjithsej	-Lopë	Të leshta	Të dhirta	Shpendë
1.Hudenisht	434	192	1065	1790	1354
2.Buçimas	1917	852	1573	779	6301
3.Çëravë	2171	942	4176	821	2019
-Blacë	1279	530	3185	463	178
-Leshnicë	892	412	991	358	1841
4.Dardhas	454	149	2775	1807	774
-Osnat	236	70	1740	1200	321
-Grunjas	218	79	1035	607	453
5.Trebinjë	1082	371	5966	3699	1963
- Trebinjë	307	122	1671	1105	455

-Dunicë	181	59	1456	701	549
-Çezmë	254	78	1498	1020	536
-Pleshisht	340	112	1341	873	423
6.Proptisht	1101	420	3025	3052	2606
-Kriçkovë	408	160	343	530	1047
-Rodokal	315	147	1160	1313	833
-Vëri	378	113	1522	1209	726
7.Velçan	1293	477	3749	3570	2004
-Velçan	375	150	1945	1692	476
-Jollë	56	23	220	546	331
-Sllabinjë	287	93	740	563	482
-Laktesh	575	211	844	769	715

Tabela 33. Numri i krrerëve në kooperativat që janë pjesë e bashkisë Pogradec.

Sikurse tregohet në tabelë kooperativat Buçimas, Blacë dhe Leshnicë kanë mbarështuar numrin më të madh të lopëve. Të leshta kanë mbarështuar në numër më të madh kooperativat Blacë, Velçan, Osnat, etj.

Të dhirta kanë mbarështuar më shumë kooperativat Velçan, Rodokal, Vëri, etj.

4.3.5.2 Prodhimet blegtorale

Edhe prodhimet blegtorale kanë pësuar rritje nga viti në vit me synim plotësimin më të mirë të nevojave. (Tabela 34)

(Tonë, vezët 000 /kokra)

Emërtimi	1970	1975	1980	1985	1990
Qumësht	5425	8296	8858	8000	10200
Mish peshë e gjallë	898	644	1498	1000	1700
Vezë	1227	2877	2270	1800	6800

Tabela 34. Prodhimet blegtorale në shkallë rrethi.

Mbas vitit 1985 prodhimi i vezëve u rrit ndjeshëm nga hyrja në prodhim e kompleksit për prodhimin e vezëve.

-Prodhimet blegtorale në kooperativat që formojnë bashkinë Pogradec

Prodhimet blegtorale për kooperativat që formojnë bashkinë Pogradec tregohen në tabelën 35.

<i>Emërtimi</i>	<i>Qumësht gjithsej (kv)</i>	<i>Mish gjithsej (kv)</i>	<i>Vezë (kokra)</i>
1.Hudenisht	3591	431	21674
2.Buçimas	15079	1476	331400
3.Çëravë	14068	1972	93300
-Blacë	8124	1243	33300
-Leshnicë	5944	729	60000
4.Dardhas	3296	762	9600
-Osnat	1852	317	4900
-Grunjas	1444	445	4700
5.Trebinjë	6632	1528	42500
- Trebinjë	2081	405	13800
-Dunicë	1208	295	5000

-Çezmë	1463	404	8500
-Pleshisht	1880	424	15200
6.Proptisht	5545	803	36500
-Kriçkovë	1635	225	16000
-Rodokal	2038	302	13100
-Vëri	1872	276	7400
7.Velçan	7780	1465	38700
-Velçan	2829	678	12900
-Jollë	589	68	2200
-Sllabinjë	1720	273	2300
-Laktesh	2642	446	21300

Tabela

Prodhimet blegtorale në kooperativat që formojnë bashkinë Pogradec.

35.

Në prodhimin e qumështit sasi më të madhe kanë prodhuar kooperativat Buçimas Blacë, Leshnicë dhe Velçan. Në prodhimin e qumështit Buçimas, Blacë, Leshnicë dhe Laktesh.

-Produktiviteti për krerë

Produktiviteti për krerë është rritur gjithashtu nga viti në vit. (Tabela 36)

<i>Emërtimi</i>	<i>1970</i>	<i>1975</i>	<i>1980</i>	<i>1985</i>	<i>1990</i>
Qumësht lope kg/kr.	1058	1478	1142	1188	1170
Qumësht dele kg/kr.	33.2	39	31.5	39.4	40.3
Qumësht dhie kg/kr.	64.9	76.2	61.5	88.5	83.8
Vezë për pulë (kokrra)	49	66	54	50	91

Tabela 36.. Produktiviteti për krerë në shkallë rrethi.

Produktiviteti për krerë është tipike e zonave kryesisht malore.

V. ZHVILLIMI BUJQËSISË NË PERIUdhËN E TRANZICIONIT NË ZONËN RURALE TË BASHKISË POGRADEC.

Mbas vitit 1990, si rezultat i ndryshimeve politike dhe shoqërore, bujqësia pësoi një ndryshim të dukshëm si në pronësi, strukturën e prodhimit si dhe në gjerësinë dhe thellësinë e përdorimit të faktorëve të prodhimit.

Në fillim të viteve 1990 me një shpejtësi të madhe u krye reforma e pestë agrare ose dekollektivizimi i bujqësisë. Sipas kësaj reforme toka e kooperativave u shpërnda fshatarëve, toka e NB u dha fillimisht në përdorim punëtorëve të tyre dhe më vonë në pronësi, u shpërndanë SMT, u riorganizuan Drejtoritë e Ujrave, Bazat e Furnizimit Materialo Teknik të bujqësisë, etj. Mbas të gjitha këtyre fotografia e bujqësisë ndryshoi. Me realizimin e Reformës Territoriale në vitin 2015, në rrethnë e Pogradecit u formua një njësi administrative- Bashkia Pogradec.

Në Bashkinë e Pogradecit janë përfshirë ish komunat: Hudenisht, Buçimas, Çëravë, Dardhas, Trebinjë, Proptisht dhe Velçan.. *Objekt i përshkrimit dhe analizës së zhvillimit të bujqësisë në periudhën mbas vitit 1990 do të jenë këto njësi administrative.*

5.1. Popullsia, numri i familjeve dhe fshatrat

(Tabela 37) (viti 2015)

<i>Emërtimi</i>	<i>Sasia</i>
1. Familje gjithsej (nr)	16070
2. Popullsia (nr)	53730
3. Madhësia mesatare e familjes (nr)	Mbi 3
4. Fshatra (nr)	70

Tabela 37. Popullsia në zonën rurale.

Popullsia më e madhe është përqendruar në njësitë : Buçimas 34.7 për qind, Çëravë 18.3 për qind dhe Hudenisht 14.6 për qind.

5.2 Fondi i tokës së punuar

Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas zërave për vitin 2015 tregohet në tabelën 38.

<i>Emërtimi</i>	<i>Ha</i>	<i>Në %</i>
1. Tokë bujqësore gjithsej :	8137.0	100
Nga kjo:		
-Arë	7470.2	91.8
-Pemtore	406.1	5.0
-Vreshta	260.7	3.2

Tabela 38. Fondi i tokës së punuar.

Sikurse shihet në njësitë e administrative sipërfaqja e tokës arë përbën mbi 92 për qind të tokës bujqësore, gjithsej dhe vetëm 8 për qind përbëhet nga pemëtari dhe vreshta. Kjo do të përcaktojë dhe strukturën e prodhimit bujqësor. Në qoftë se do të shohim tokën e ndarë sipas Ligjit 7501, rezulton se ajo është në një sipërfaqe prej **8137ha**. Për vitin 2015 rezultojnë rreth **234 ha**, e cila është lënë djerr dhe përbën rreth 3 për qind të tokës së punuar. Nënvizojmë se janë refuzuar nga ndarja e tokave sipas ligjit mbi 9820 ha. që është sipërfaqe shumë e madhe.

Zona rurale e Bashkisë Pogradec për sa i takon tokës bujqësore shtrihet në tre relievet: fushë, kodër mal ose në pjerrësi të ndryshme. Tabela 39.

<i>Eërtimi</i>	<i>Ha</i>	<i>Në %</i>
1. Tokë gjithsej	8137.0	100
Nga kjo:		
Pjerrësi deri 5 %	2096	25.7
Pjerrësi 6-45 %	4949	60.8
Pjerrësi Mbi 46 %	1092	13.5

Tabela 39. Sipërfaqja e tokës sipas pjerrësisë.

Sipërfaqe e konsiderueshme rreth 61 për qind e tokës shtrihet në pjerrësinë deri 6-45 për qind, që konsiderohet kodër, rreth 25.7 për qind shtrihet në pjerrësinë deri 5 për qind që konsiderohet fushë dhe pjesa tjetër në pjerrësi mbi 45 për qind, që konsiderohet mal. ***Kjo influencon në mekanizim, ujitje, strukturën e mbjelljeve, prodhimtarinë etj.***

5.3 Aftësi ujitëse

Në dallim nga zona e Bashkisë Korçë infrastruktura bazë e ujitjes (rezervuarët) nuk pësoj dëmtime serioze. Në fund të vitit 1990 aftësia ujitëse ishte 6700 ose 36.2 për qind të tokës së punuar. Sipas gjendjes së tyre rezultojnë që vetëm rezervuarët Qafë thanë dhe Malinë 1+2 janë në gjendje jo të mirë. Problem i përgjithshëm është gjendja jo e mirë e kanaleve marrës të ujit nga rezervuarët dhe kanalet ushqyes, që në përgjithësi kanë nxjerrë jashtë funksionimit të disa rezervuarë si ai i Qafës së Thanës etj. Me dëmtime serioze ose mos kujdes u shoqëruan stacionet e rëndësishëm të pompimit. Kështu 6 prej tyre janë jashtë funksionit dhe një me difekt. Për të parë se si ka ndryshuar aftësia ujitëse dhe ajo e vaditur mjafton të përmendim, që tani aftësia ujitëse potenciale është **3960 ha**, ajo aktuale **2312 ha** ndërsa sipërfaqja e ujitur **2312 ha**. ***Mungesa e aftësisë ujitëse dhe mandej përdorimi i ujit për vaditje konsiderohet faktor kufizues në prodhimin bujqësor.***

5.4 Mekanika bujqësore dhe mekanizimi

Mos funksionimi i SMT-së solli që mjetet e mekanikës bujqësore të zotërohen nga individët. Në vitin 2015 ishin në inventar **158** traktorë me rrota, **1** me zinxhirë, **142** minitraktorë, **17** autokombajna, **102** makina mbjellëse, **102** freza, etj.

Kur flitet për mekanizimin duhet të mbahet parasysh se fshat aktualisht banon dhe punon një numër relativisht i madh i njerëzve të aftë për punë, si dhe relievi i vendit. Shkalla e mekanizimit duke pasur parasysh punimet tregohet në tabelën 40.

<i>Emërtimi</i>	<i>Në %</i>
1. Gjithsej punime	100.0
-Me mekanikë	77.4
-Kafshë	17.1
-Krahë pune	5.5

Tabela 40. Mënyrat e punimeve.

Duhet thënë se pjesa dërmuese e prashitjeve, vjeljes së prodhimeve, që kërkojnë volume të mëdha pune kryhen kryesisht me dorë. Në këto drejtime mund të shtohet mekanizimi.

5.5 Përdorimi i plehrave

Përdorimi i plehrave kimike është faktor i rëndësishëm për shtimin e prodhimit në bimët bujqësore. Përdorimi i plehrave kimike për dy vitet e fundit tregohet në tabelën 41.

<i>Emërtimi</i>	<i>Përdorur plehra kimik (tonë)</i>		<i>Kg/ha, tokë Arë</i>	
	<i>2014</i>	<i>2015</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
Plehra gjithsej	2167	2408	288	320
-Dap	871	905	-	-
-Nitrat	1556	944	-	-
-Ure	440	559	-	-

Tabela 41. Përdorimi i plehrave në vitet 2014 dhe 2015.

Për çdo ha tokë të arë janë përdorur sipas viteve 288 dhe 320 kg/ha plehra kimike. Kjo sasi duhet të konsiderohet e ulët, po të kemi parasysh që në vitin 1990 është përdorur mesatarisht për ish kooperativat bujqësore 535.8 kg/ha. **Mungesa e përdorimit të plehrave në sasi më të mëdha është i lidhur me gjendjen financiare të fermerëve, mbasi plehrat kërkojnë shpenzime të larta.**

5.6 Struktura e sipërfaqeve të mbjella me bimët e arave

Sipërfaqet e mbjella me bimët e arave, sipas bimëve kanë ndryshuar në krahasim me periudhën para vitit 1989. Kjo shpjegohet para së gjithash me kërkesat e tregut, plotësimi i nevojave për ushqimin e familjes fermere, mundësitë materiale dhe njerëzore për kultivimin e tyre etj. (Tabela 42) (Ha)

<i>Bimët</i>	<i>1989</i>	<i>2005</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Drithra buke	8259	2933	2930	2883	2777
-Grurë	5526	1843	2040	2020	1944
-Misër	1134	970	849	810	775
2.Patate	76	300	330	335	348
3.Perime,bostan	226	380	369	385	400
4.Fasule	855	460	533	528	507
5.Duhan	1155	48	17	18	21
6. Bimë medicinale	-	-	47	50	60
7.Foragjere,tagjira	2813	2710	3285	3293	3340

Tabela 42. Struktura e mbjelljeve në bimët e arave.

Sikurse shihet në krahasim me 1989, ka tokë të pambjellë. Është shtuar sipërfaqja e mbjellë me foragjere dhe tagjira të para, është pakësuar në minimum deri në zhdukje e duhanit, ashtu panxhar sheqeri ,dhe është reduktuar sipërfaqja me elb distik. Nuk mbillet Humulusi për prodhimin për industrinë e birrës, në të vetmin rreth që mbillej. Në vitet e tranzicionit është rritur gjithashtu sipërfaqja e mbjellë me perime. Ka një përshtatje më të mirë me tregun.

5.7 Prodhimet në bimët e arave

Kufizimi i sipërfaqeve për bimët kryesore, mbjellja në tokat më të mira ka rezultuar me rritjen e rendimenteve në bimët bazë. Kjo është reflektuar në prodhimet e realizuar. (Tabela 43)

Tabela 43. Prodhimet në bimët kryesore të arave.

<i>Emërtimi</i>	<i>2005 (tonë)</i>	<i>2013 tonë)</i>	<i>2014(tonë)</i>	<i>2015 (tonë)</i>
1.Drith buke	7675	9547	9894	9371
-Grurë	4359	6634	6940	6564
2.Patate	7200	8512	9837	9590
3.Fasule	577	412	448	412
4.Perime,bostan	9805	8466	9215	9877
5.Duhan	75	16	18	21

Në përgjithësi prodhimi në bimët e ndryshme në vitet e fundit në tërësi është i stabilizuar me një rritje në patate dhe në perime. Në krahasim me vitin 2005 ka rritje të ndjeshme në drithra, patate dhe perime. Në krahasim me vitin 1989 në vitin 2015 janë prodhuar më pak drithra buke **7792 tonë, por ka rritje të madhe në patate dhe perime.**

5.8 Pemëtaria dhe vreshtaria

Është aktivitet prodhues i shtrirë në të gjithë zonën rurale të Bashkisë Pogradec. Në pemëtari konstatohet se në krahasim me vitet para 1990, ka përmirësime në teknologjinë e kultivimit sidomos preferimi i formave të ulëta për të lehtësuar shërbimet dhe vjeljen. Është rritur po ashtu ndjeshëm numri i pemëve për ha. etj. Kjo sidomos në zonat e ulëta. Në vitin 2015 kanë qenë të mbjella me pemë frutore mbi 400 ha ose 4.9 për qind e sipërfaqes së tokës së punuar dhe 237.6 ha me vreshta ose rreth 3 për qind të sipërfaqes së punuar.

Numri i pemëve dhe prodhimi

Numri i pemëve dhe prodhimi në disa vite tregohet në tabelën 44.

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Pemë gjithsej (000/rr.	323.2	335.6	354.6
-Në prodhim	208.1	235.1	247.5
-Prodhimi (tonë)	3706	4853	5127

Tabela 44. Prodhimi i frutave.

Sikurse shihet prodhimi i frutave është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Në krahasim me vitin 1980 në shkallë rrethi, që është një nga vitet më të mirë, janë prodhuar afërsisht 1354 tonë më shumë fruta vetëm në këto ekonomi. Nga prodhimi gjithsej molla përbën 45.3 për qind. **Për të ardhmen kujdes duhet të përmirësohet struktura varietore e mollës duke synuar eksportin.**

Vreshtaria

Në bashkinë e Pogradecit ka mikrozona të favorshme nga pikëpamja tokësore dhe klimatike për rritjen e ardisë dhe prodhimin e rrushit. Të tilla janë kodrat në të majtë të rrugës Plloçë- Çëravë me ekspozim nga jugu çka lejon grumbullimin e një sasive të lartë sheqeri çka influencën në cilësinë e verës, në aromën e rrushit etj. Përveç kësaj edhe mikrozona të tjera në Dardhas, Buçimas, Proptisht. Prodhimi i rrushit tregohet në tabelën 45.

<i>Emërtimi</i>	<i>2005</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1. Vreshta gjithsej (ha)	228	242.3	247.3	260.7
Në prodhim (ha)	214	232	233	237.6
2.Prodhim rrush gjithsej (ton)	1962	3372	3606	3868

Tabela 45. Prodhimi i rrushit.

Në vitin 2015 në krahasim me vitin 2005 prodhimi i rrushit është rritur mbi 97 për qind. Komuna Çëravë dhe Buçimas kanë pasur peshën kryesore të prodhimit.

5.9 Zhvillimi i blegtorisë

Blegtoria me të gjithë llojet e saj, është zhvilluar në zonën rurale të Bashkisë Pogradec. Kuptohet që zonën malore zhvillim më të madh kanë pasur blegtoria e imët.

Zhvillimi numerik

Numri i krerëve në njësitë vendore të zonës rurale tregohet në tabelën 46.(Krerë)

<i>Emërtimi</i>	<i>2005</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Gjedhë gjithsej	12000	8000	9090	9479
-Lopë	9000	6600	7509	7649
2.Të leshta	37000	47000	54681	53261
-Dele	29000	39000	42158	41285
3.Të dhirta	19000	20000	24858	27327
-Dhi	15000	17000	19574	21489
4.Derra	500	1350	1792	1988
-Dosa	----	170	330	326
5.Shpendë	62400	320000	78626	84327
6.Bletë	3400	8000	7985	10167
7.Njëthundrakë	5900	3753	3946	4068

Tabela 46. Numri i krerëve.

Me përjashtim të numrit gjedhit, numri i krerëve për llojet e tjera të kafshëve është rritur gjatë viteve të tranzicionit. Në krahasim me vitin 1990 tani mbarështohen më shumë të leshta , të dhirta, derra etj.

-Prodhimet blegtorale

Prodhimet blegtorale tregohen në tabelën 47. (tonë)

<i>Emërtimi</i>	<i>2005</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
Qumësht gjithsej	20938	17370	33542	21131
-Lope	17453	13650	28638	16274
-Dele	1544	1995	2438	2167
-Dhie	1941	1725	2466	2690
Mish gjithsej	2089	3291	5014	3717
-Gjedhi	1295	1247	2153	1671
-Të imtash	753	1359	2566	1584
-Derri	33	208	223	346
-Shpendësh	8	417	122	116
3.Vezë (000/kokrra)	5192	8344	8733	8882

Tabela 47. Prodhimet blegtorale

Gjatë periudhës pas vitit 1990 prodhimet blegtorale kanë tendën e përgjithshme në rritje. Rritje të dukshme ka në krahasim me vitin 1990. Kundrejt tij, prodhimi i qumështit është dyfishuar, prodhimi i mishit është rritur rreth 2.2 herë.

VI. BUJQËSIA SIPAS NJËSIVE ADMINISTRATIVE TË ZONËS RURALE

Sikurse dihet, në zonën rurale të Bashkisë Pogradec, zhvillojnë aktivitetin bujqësor 7 njësi administrative: Hudenisht, Buçimas, Çëravë, Dardhas, Trebinjë, Proptisht dhe Velçan. Në këtë seksion do të trajtohet zhvillimi i bujqësisë në secilën njësi.

6.1 Njësia administrative Udenisht

Shtrihet kryesisht për gjatë bregut të liqenit, prandaj dhe peshkimi është aktivitet i rëndësishëm. Ka një popullsi prej 7841 banorë e shpërndarë në 5 fshatra., 2456 familje dhe 1239 ferma. Madhësia e fermës 0.36 ha. Territori i saj përshkohet nga 25 km rrugë ose 0.88 km/km²

Faktorët e prodhimit

Fondi i tokës.

(Tabela 48)

<i>Emërtimi</i>	<i>Ha</i>
1.Territori gjithsej	5162 (2014)
-Tokë e punuar	962
-Pyje	3894
-Kullota,livadhe	306
-Tokë e refuzuar	(511)
2.Tokë e ndarë sipas ligjit	451
3.Tokë e punuar (2015)	451
-Arë	422
-Pemtore	13
-Vreshta	16

Tabela 48. Fondi i tokës gjithsej.

Kjo njësi administrative përbën 13.5 për qind të territorit gjithsej, 5.5 për qind të tokës bujqësore. Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas të dhënave të vitit 2010, nga pikëpamja e pjerrësisë është: (Tabela 49)

Emërtimi	Sipërfaqja (ha)	Në %
1. Tokë bujqësore	476	100
0-5 %	380	79.8
5-10 %	10	2.1
10-15 %	15	3.1
15-20 %	25	5.3
Mbi 20 %	46	9.7

Tabela 49. Sipërfaqja e tokës sipas pjerrësisë.

Sikurse shihet rreth 80 e sipërfaqes bujqësore shtrihet në pjerrësinë 0-5 përqind.

Ujitja

Sipërfaqja potenciale 325 ha. Sipërfaqja aktuale 225 Ha. Sipërfaqja faktike 185 ha. Rezervuari i Qafës së Thanës sikurse përmendëm është jashtë funksionit sepse nuk është në gatishmëri kanali ushqyes, portat e shkarkimit si dhe kanali kryesor ujitës. Rezervuari Jama e Omezhit nuk funksionon kanali ujëmbledhës.

Mekanizimi

Disponon traktorë me rrota gome 19, minitraktorë 13 ,makina mbjellëse 3 dhe freza 28.

Mënyrat e kryerjes së punimeve është: (Tabela 50)

Emërtimi	Sipërfaqja (ha)	Në %
1. Tokë bujqësore	451	100.0
- Me mekanikë	355	78.7
- Me kafshë	83	18.4
- Me krahë	13	2.9

Tabela 50. Mekanizimi i punimeve viti 2015.

Sikurse shihet shtrirja e sipërfaqes së tokës në pjerrësinë 0-5 për qind krijon mundësi për të kryer me mjete mekanike rreth 79 për qind të punimeve.

Përdorimi i plehrave

Për vitin 2015 janë përdorur 136 ton plehra kimike ose 301 kg/ha tokë bujqësore, që konsiderohet nivel relativisht i ulët.

Struktura e mbjelljeve

Vendndodhja dhe kushtet e tjera përcaktojnë në një farë mase strukturën e mbjelljeve të njësisë administrative të Udenishtit. (Tabela 51) (Ha)

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Drithra buke	191	178	169
-Grurë	135	125	120
2.Patate	10	10	8
3.Fasule gjithsej	40	40	35
4.Duhan	-	-	1
5.Perime bostan	18	20	21.5
6.Foragjere,tagjira	168	177	185
7.B.medicinale	-	-	2
Gjithsej	427	425	421.5

Tabela 51 . Struktura e mbjelljeve.

Sikurse shihet drithërat e bukës përbëjnë 40.1- 44.7 për qind të mbjelljeve, ku gruri e zë peshën kryesore. Sipërfaqet e mbjella me patate dhe perime me sa duket janë destinuar kryesisht për nevojat e familjeve . Peshë të konsiderueshme zënë dhe foragjeret dhe tagjirat, 39-44 për qind, e lidhur kjo me numrin e bagëtive. Pothuajse janë zhdukur mbjellja e bimëve industriale.Në vitin 1985 mbilleshin 100 ha duhan.

Prodhimet e bimëve të arave

Prodhimet nga bimët e arave tregohen në tabelën 52. (Tonë)

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Drithra buke	689	673	625
-Grurë	513	500	474
2.Patate	230	268	216
3.Fasule	40	31	49
4.Duhan	-	-	1.2
5.Perime e bostan	418	602	616

Tabela 52. Prodhimet nga bimët e arave.

Edhe në të ardhmen mund të ruhet kjo strukturë e prodhimit. Nëse zhvillohet zona turistike mund të shtohet prodhimi i perimeve të freskëta.

Pemtaria dhe vreshtaria

Zhvillimi i pemëtarisë tregohet në tabelën 53.

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Pemishte (ha)	9.3	10.3	13
2.Pemë gjithsej (rrënjë)	14100	14741	16347
-Në prodhim	9760	10141	10650
3.Rendimenti (kg/rr.)	19.8	24.7	23.3
4.Prodhimi (ton)	193	251	248
5.Vreshta (ha)	15	15.5	16
6.Prodhim rrush gjithsej (ton)	190	256	284

Tabela 53. Prodhimi nga pemët dhe vreshtat.

Nga prodhimi i frutave prodhimi i mollës është 134 tonë, kumbulla 47, qershi 19 tonë, arra 8 tonë, etj . Në njësi janë 1.8 ha. arra (2015). Sipërfaqja e arrave mund të shtohet.

Zhvillimi i blegtorisë

Mbarështohen pothuajse të gjithë llojet e kafshëve për prodhim. Numri i krerëve ka ndryshuar si më poshtë, (Tabela 54) (Krerë)

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Gjedhë gjithsej	600	869	933
-Lopë	490	729	746
2.Të leshta	2100	2560	3460
-Dele	1700	1932	2422
3.Të dhirta	1400	2077	3089
-Dhi	1200	1687	2240
4.Derra	450	742	796
-Dosa	70	194	187
5.Shpendë	8000	8186	8670
6.Njëthundrakë	300	397	318
7.Bletë (zgjoje)	300	303	550

Tabela 54. Numri i krerëve të blegtorisë.

Në përgjithësi numri i krerëve është rritur në viteve të fundit. Numri i gjedhit dhe në veçanti numri i lopëve janë rritur përkatësisht 55.5 për qind dhe 52.2 për qind. Po ashtu numri i të leshtave është më shumë se dyfishuar.

Prodhimet blegtorale

Në vartësi të numrit të krerëve dhe rendimenteve, prodhimi nga blegtoria tregohet në tabelën 55.

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Qumësht gjithsej j(tonë)	1231	3217	2194.4
-Lope	1002	2907	1775.0
-Dele	85	104	133.4
-Dhie	144	206	286.0
2.Mish gjithsej peshë e gjallë, (tonë)	242	451	455.6
-Gjedhi	77	201	158.0
-Dhentë	35	75	60.7
-Dhitë	25	73	70.0
-Derri	95	90	6.6
-Shpendi	10	12	3.0
3.Vezë (000/kokrra)	931.5	657	1092

Tabela 55. Prodhimet blegtorale.

Në vitin 2015 në krahasim me vitin 2013 të gjitha prodhimet blegtorale janë rritur. Po ashtu rritje të madhe ka dhe në krahasim me vitin 1989. **Problem është prodhimi i mishit sidomos nga gjedhi dhe që lidhet me moshën e viçave. Përgjithësisht shiten për mish në moshë të vogël deri në një vit, dhe me peshë rëndom 70- 100 kg. Kjo shoqërohet me pakësim të prodhimit të mishit. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për qingjat. Një veprim i tillë është për të ulur kostot e mbajtjes së viçave për mish. Janë prodhuar dhe 10 ton mjaltë. (2015)**

Tregtimi i produkteve

Me qenë se shtrihet në gjatësinë e rrugës nacionale krijon mundësi për shitjen anës rrugës sidomos fshatrat për rreth Linit, në qytet, nga parcela etj. Aktualisht ka pak shqetësim lidhur me shitjen e frutave dhe perimeve prodhojnë kryesisht për nevojat e veta.

6.2 Njësia administrative Buçimas

Është njësia vendore që fillon nga qyteti i Pogradecit, buzë liqenit dhe vazhdon me fshatra që shtrihen në kodrina të buta. Ka një pikë të rëndësishme turistike si Tushemishti. Të gjitha këto përbëjnë avantazhe për zhvillimin ekonomik të saj. Mund të jetë një model i zhvillimit të agroturizmit. Është njësia vendore më e madhe me 18649 banorë e shpërndarë në 8 fshatra, 5156 familje dhe 2748 ferma. Madhësia e fermës 0.51 ha. Territori i saj përshkohet nga 140 km rrugë ose 2.38 km/km²

Faktorët e prodhimit

Fondi i tokës.

(Tabela 56)

<i>Emërtimi</i>	<i>Ha</i>
-----------------	-----------

1.Territori gjithsej (2014)	4822 .0
-Tokë e punuar	2517.0
-Pyje	2261.0
-Kullota,livadhe	44.0
-Tokë e refuzuar	(1088)
2.Tokë e ndarë sipas ligjit	1409.9
3.Tokë e punuar (2015)	1409.0
-Arë	1265.3
-Pemtore	86.0
-Vreshta	57.7

Tabela 56. Fondi i tokës gjithsej.

Kjo njësi administrative përbën 12.5 për qind të territorit gjithsej, 15.2 për qind të tokës bujqësore. Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas të dhënave të vitit 2010, nga pikëpamja e pjerrësisë është: (Tabela 57)

<i>Emërtimi</i>	<i>Sipërfaqja (ha)</i>	<i>Në %</i>
2. Tokë bujqësore	1409	100.0
0-5 %	805	57.1
5-10 %	140	9.9
10-15 %	120	8.6
15-20 %	80	5.7
Mbi 20 %	264	18.7

Tabela 57. Sipërfaqja e tokës sipas pjerrësisë.

Sikurse shihet rreth 57 e sipërfaqes bujqësore shtrihet në pjerrësinë 0-5 për qind.

Ujtja

Sipërfaqja potenciale 835 ha. Sipërfaqja aktuale 500 Ha. Sipërfaqja faktike 300 ha. Në këtë njësi është shkatërruar në vitin 1997 elektro-pompat që merrnin ujë nga liqeni.

Mekanizimi

Disponon traktorë me rrota gome 22, mini traktorë 25 ,makina mbjellëse 13 dhe freza 12, autokombajna 2.

Mënyrat e kryerjes së punimeve është: (Tabela 58)

<i>Emërtimi</i>	<i>Sipërfaqja (ha)</i>	<i>Në %</i>
2. Tokë bujqësore	1409	100.0
- Me mekanikë	1241	88.0
- Me kafshë	122	8.6
- Me krahë	46	3.4

Tabela 58. Mekanizimi i punimeve viti 2015.

Sikurse shihet shtrirja e sipërfaqes së tokës në pjerrësinë 0-5 për qind krijon mundësi për të kryer me mjete mekanike rreth 88 për qind të punimeve.

Përdorimi i plehrave

Për vitin 2015 janë përdorur 522 ton plehra kimike ose 370.4 kg/ha tokë bujqësore, që konsiderohet nivel relativisht i ulët.

Struktura e mbjelljeve

Vendndodhja afër qytetit dhe kushtet e tjera përcaktojnë në një farë mase strukturën e mbjelljeve të njësisë administrative Buçimas. (Tabela 59)

(Ha)

<i>Emërtimi</i>	2013	2014	2015
1.Drithra buke	390	375	366
-Grurë	240	235	220
2.Patate	60	60	62
3.Fasule gjithsej	55	55	53
4.Duhan	6.2	6.4	7
5.Perime bostan	152	155	159
6.Foragjere,tagjira	596	602	596
7.B.medicinale	20	20	22
8.Të tjera	1.8	2.8	-
Gjithsej	1281	1276.2	1265

Tabela 59 . Struktura e mbjelljeve.

Sikurse shihet drithërat e bukës përbëjnë 29- 30.4 për qind të mbjelljeve, ku gruri e zë peshën kryesore. Sipërfaqet e mbjella me perime diktohet nga nevoja për furnizimin e qytetit . Peshë të konsiderueshme zënë dhe foragjeret dhe tagjirat, rreth 47 për qind, e lidhur kjo me numrin e bagëtive. Në vite të veçantë para vitit 1990 ka mbjellë panxhar sheqeri si dhe sipërfaqe të konsiderueshme me duhan. Kështu vitin 1985 mbilleshin 219 ha duhan,100 ha panxhar sheqeri si dhe 12 ha humulus (tani 1-2 ha) .

Prodhimet e bimëve të arave

Prodhimet nga bimët e arave tregohen në tabelën 60. (Tonë)

<i>Emërtimi</i>	2013	2014	2015
1.Drithra buke	1720	1730	1721
-Grurë	1075	1099	1088
2.Patate	1754	1808	1878
3.Fasule	64	134	142
4.Duhan	-	-	10
5.Perime e bostan	4395	3874	3702

Tabela 60. Prodhimet nga bimët e arave.

Edhe në të ardhmen mund të ruhet kjo strukturë e prodhimit. Nëse zhvillohet zona turistike mund të shtohet prodhimi i perimeve të freskëta dhe patates.

Pemtaria dhe vreshtaria

Zhvillimi i pemëtarisë tregohet në tabelën 61.

<i>Emërtimi</i>	2013	2014	2015
1.Pemishte (ha)	75.4	79.5	86

2.Pemë gjithsej (rrënjë)	66474	68349	72498
-Në prodhim	43390	46570	48070
3.Rendimenti (kg/rr.)	22.2	24.9	24.9
4.Prodhimi (ton)	965	1161	1199
5.Vreshta (ha)	52.4	55.7	56.4
6.Prodhim rrush gjithsej (ton)	610	727	863

Tabela 61. Prodhimi nga pemët dhe vreshtat.

Nga prodhimi i frutave prodhimi i mollës është 696 tonë, kumbulla 150,qershi 156 tonë, arra 22 tonë, etj . Në njësi janë 1.7 ha. arra (2015). Sipërfaqja e arrave mund të shtohet.

Zhvillimi i blegtorisë

Mbarështohen pothuajse të gjithë llojet e kafshëve për prodhim. Numri i krerëve ka ndryshuar si më poshtë, (Tabela 62)

(Krerë)

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Gjedhë gjithsej	2010	2040	2036
-Lopë	1600	1644	1621
2.Të leshta	6150	7739	8095
-Dele	5100	5715	5715
3.Të dhirta	3100	4055	4112
-Dhi	2800	3095	3266
4.Derra	400	474	489
-Dosa	60	71	71
5.Shpëndë	16500	17927	18604
6.Njëthundrakë	600	600	629
7.Bletë (zgjoje)	1590	2396	2518

Tabela 62. Numri i krerëve të blegtorisë.

Numri i krerëve në gjedhë ka qenë i stabilizuar në viteve të fundit. Rritje të lehta ka në blegtorinë e imët.

Prodhimet blegtorale

Në vartësi të numrit të krerëve dhe rendimenteve, prodhimi nga blegtoria tregohet në tabelën 63.

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Qumësht gjithsej j(tonë)	3762	8231	4404
-Lope	3120	7455	3672
-Dele	306	343	313.5
-Dhie	336	433	418.5
2.Mish gjithsej peshë e gjallë, (tonë)	2131	1024	744
-Gjedhi	193.2	510	380.6
-Dhentë	1230	271	155.2
-Dhitë	620.4	150	92.4
-Derri	81	62	93.5
-Shpendi	6.4	31	22.3
3.Vezë (000/kokrra)	2760	1817	2133

Tabela 63. Prodhimet blegtorale.

Në vitin 2015 në krahasim me vitin 2013 është rritur prodhimi i qumështit. Po ashtu rritje të madhe ka dhe në krahasim me vitin 1989. Për këtë njësi meqenëse gjedhi ka peshë të rëndësishme në prodhimet blegtorale merr vëmendje të veçantë **problem i prodhimit të mishit sidomos nga gjedhi dhe që lidhet me moshën e viçave. Përgjithësisht shiten për mish në moshë të vogël deri në një vit, dhe me peshë rëndom 70- 100 kg. Kjo shoqërohet me pakësim të prodhimit të mishit. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për qingjat. Një veprim i tillë është për të ulur kostot e mbajtjes së viçave për mish. Janë prodhuar dhe 43 ton mjaltë.(2015)**

Tregtimi i produkteve

Për vetë strukturën e prodhimit dhe vend ndodhjen, ka mundësi për përdorimin e të gjithë mënyrave të shitjes së produkteve direkt në familje (qumësht), nëpërmjet tregtarëve, nga parcela, etj. Problem ka në shitjen e frutave dhe perimeve por jo shqetësuese.

6.3 Njësia administrative Çërravë

Është njësia vendore që shtrihet edhe në të dy anët e rrugës nacionale Korçë-Pogradec, vazhdim i njësisë Buçimas. Një pjesë e fshatrave si Nizhavec e Petrushë mbyllin kufirin verior të fushës së Korçës. Nga pikëpamja e popullsisë është mbas njësisë Buçimas. Ka 9853 banorë e shpërndarë në 9 fshatra, 3040 familje dhe 1730 ferma. Madhësia e fermës 1.21 ha. Territori i saj përshkohet nga 21.8 km rrugë ose 0.24 km/km²

Faktorët e prodhimit

Fondi i tokës.

(Tabela 64)

<i>Emërtimi</i>	<i>Ha</i>
1.Territori gjithsej (2014)	5869
-Tokë e punuar	3736
-Pyje	1532
-Kullota,livadhe	600
-Tokë e refuzuar	(1644)
2.Tokë e ndarë sipas ligjit	2092
3.Tokë e punuar (2015)	2092
-Arë	1872
-Pemtore	119
-Vreshta	101

Tabela 64. Fondi i tokës gjithsej.

Kjo njësia administrative përbën 20.1 për qind të territorit gjithsej, 22.6 për qind të tokës bujqësore. Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas të dhënave të vitit 2010, nga pikëpamja e pjerrësisë është: (Tabela 65)

<i>Emërtimi</i>	<i>Sipërfaqja (ha)</i>	<i>Në %</i>
3. Tokë bujqësore	2092	100.0
0-5 %	500	23.9
5-10 %	180	8.6
10-15 %	220	10.5
15-20 %	210	10.1
Mbi 20 %	1123	46.9

Tabela 65. Sipërfaqja e tokës sipas pjerrësisë.

Sikurse shihet rreth 24 e sipërfaqes bujqësore shtrihet në pjerrësinë 0-5 për qind. Sipërfaqe e konsiderueshme 47 për qind është në pjerrësinë mbi 20 për qind.

Ujitja

Sipërfaqja potenciale 1130 ha. Sipërfaqja aktuale 1080 Ha. Sipërfaqja faktike 1050 ha. Problem është se rezervuarët (Pllaçë, Grabovicë etj.) janë jashtë funksionit për shkak të kanaleve të furnizimit me ujë të cilët janë të pa përdorshëm për shkak të mbushjeve etj. Stacionet e pompimit janë shkatërruar.

Mekanizimi

Disponon traktorë me rrota gome 30, mini traktorë 67 ,makina mbjellëse 25 dhe freza 35, autokombajna 4.

Mënyrat e kryerjes së punimeve është: (Tabela 66)

<i>Emërtimi</i>	<i>Sipërfaqja (ha)</i>	<i>Në %</i>
3. Tokë bujqësore	2092	100.0
- Me mekanikë	1535	73.4
- Me kafshë	407	19.4
- Me krahë	150	7.2

Tabela 66. Mekanizimi i punimeve viti 2015.

Sikurse shihet shtrirja e sipërfaqes së tokës në pjerrësinë 0-5 për qind krijon mundësi për të kryer me mjete mekanike rreth 73 për qind të punimeve.

Përdorimi i plehrave

Për vitin 2015 janë përdorur 541 ton plehra kimike ose 258.6 kg/ha tokë bujqësore, që konsiderohet nivel i ulët.

Struktura e mbjelljeve

Vendndodhja relativisht afër qytetit dhe kushtet e tjera përcaktojnë në një farë mase strukturën e mbjelljeve të njësisë administrative Çëravë. (Tabela 67)

(Ha)

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Drithra buke	650	652	623
-Grurë	380	390	365
2.Patate	150	155	161
3.Fasule gjithsej	150	145	140
4.Duhan	9.2	9.4	9
5.Perime bostan	95	92	96
6.Foragjere,tagjira	811	800	811
7.B.medicinale	25	30	32

8.Të tjera(humulus)	-	-	-
Gjithsej	1890.2	1883.4	1872

Tabela 67. Struktura e mbjelljeve.

Sikurse shihet drithërat e bukës përbëjnë 34-35 për qind të mbjelljeve, ku gruri e zë peshën kryesore. Sipërfaqet e mbjella me perime dhe patate krijon mundësinë edhe për shitje . Peshë të konsiderueshme zënë dhe foragjeret dhe tagjirat, mbi 43 për qind, e lidhur kjo me numrin e bagëtive. Në vite të veçantë para vitit 1990 ka mbjellë panxhar sheqeri si dhe sipërfaqe të konsiderueshme me duhan. Kështu vitin 1985 mbilleshin 353 ha duhan dhe 100 ha panxharsheqeri. Mbjellja e duhanit shkon drejt minimumit ndërsa panxhari për qëllime industriale nuk mbillet. Po ashtu mbillej sipërfaqe e konsiderueshme me elb distik.

Prodhimet e bimëve të arave

Prodhimet nga bimët e arave tregohen në tabelën 68. (Tonë)

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Drithra buke	2378	2506	2329
-Grurë	1432	1516	1383
2.Patate	4014	4763	4978
3.Fasule	150	112	130
4.Duhan	8	8	7
5.Perime e bostan	2199	2357	2480

Tabela 68. Prodhimet nga bimët e arave.

Edhe në të ardhmen mund të ruhet kjo strukturë e prodhimit. Por prodhimi i perimeve të thata dhe patateve mund të shtohet me synim tregun.

Pemtaria dhe vreshtaria

Zhvillimi i pemëtarisë tregohet në tabelën 69.

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Pemishte (ha)	106.5	112.5	119
2.Pemë gjithsej (rrënjë)	77930	81281	87775
-Në prodhim	32700	51210	53840
3.Rendimenti (kg/rr.)	19.7	23.2	22.9
4.Prodhimi (ton)	645	1188	1236
5.Vreshta (ha)	95.2	96.2	101
6.Prodhim rrush gjithsej (ton)	1285	1325	1336

Tabela 69. Prodhimi nga pemët dhe vreshtat.

Nga prodhimi i frutave prodhimi i mollës është 661 tonë, kumbulla 227,qershshi 238 tonë, arra 23 tonë, etj . Në njësi janë 1.3 ha. arra dhe 12 ha me lajthi (2015). Sipërfaqja e arrave mund të shtohet. Është një zonë nga më të mirat për prodhimin e rrushit dhe që mund të zhvillohet në të ardhmen.

Zhvillimi i blegtorisë

Mbarështohen pothuajse të gjithë llojet e kafshëve për prodhim. Numri i krerëve ka ndryshuar si më poshtë, (Tabela 70) (Krerë)

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Gjedhë gjithsej	1660	1748	1761

-Lopë	1380	1478	1497
2.Të leshta	11200	12813	12843
-Dele	9400	10627	10723
3.Të dhirta	2800	3711	3784
-Dhi	2350	2828	2828
4.Derra	160	174	174
-Dosa	10	12	12
5.Shpëndë	13000	13703	13735
6.Njëthundrakë	750	750	756
7.Bletë (zgjoje)	1480	1505	1547

Tabela 70. Numri i krerëve të blegtorisë.

Numri i krerëve në gjedhë ka qenë i stabilizuar në viteve të fundit. Rritje relativisht të lehta ka në blegtorinë e imët.

Prodhimet blegtorale

Në vartësi të numrit të krerëve dhe rendimenteve, prodhimi nga blegtoria tregohet në tabelën 71.

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Qumësht gjithsej j(tonë)	3950	7065	4743
-Lope	3208	6054	3848
-Dele	517	651	577
-Dhie	225	360	318
2.Mish gjithsej peshë e gjallë, (tonë)	537	984	732
-Gjedhi	233	422	330
-Dhentë	228	395	260
-Dhitë	48	122	73
-Derri	15	23	50
-Shpendi	13	22	19
3.Vezë (000/kokrra)	2260	1463	1416

Tabela 71. Prodhimet blegtorale.

Në vitin 2015 në krahasim me vitin 2013 është rritur prodhimi i qumështit dhe i mishit Po ashtu rritje ka dhe në krahasim me vitin 1989. Edhe në këtë lidhur me prodhimin e mishit janë të njëjtat probleme. Janë prodhuar dhe 23 ton mjaltë.(2015)

Tregtimi i produkteve

Për vetë strukturën e prodhimit dhe vend ndodhjen, ka mundësi për përdorimin e të gjithë

mënyrave të shitjes së produkteve direkt në familje (qumësht), nëpërmjettregtarëve, nga parcela, anës rrugës sidomos për fshatrat që janë anës rrugës nacionale si Leshnicë, etj. Ka probleme deri diku në shitjen e frutave.

6.4 Njësia administrative Dardhas

Është njësia vendore që i largohet rrugës nacionale Korçë-Pogradec dhe hyn disi në zonën malore të Bashkisë. Ka një popullsi pre 3781 banorë e shpërndarë në 9 fshatra, 1150 familje dhe 1140 ferma. Madhësia e fermës 0.65 ha. Territori i saj përshkohet nga 65 km rrugë ose 0.75 km/km²

Faktorët e prodhimit

Fondi i tokës.

(Tabela 72)

<i>Emërtimi</i>	<i>Ha</i>
1.Territori gjithsej (2014)	5159
-Tokë e punuar	2158
-Pyje	2513
-Kullota,livadhe	524
-Tokë e refuzuar	(1421)
2.Tokë e ndarë sipas ligjit	737
3.Tokë e punuar (2015)	737
-Arë	650
-Pemtore	37
-Vreshta	50

Tabela 72. Fondi i tokës gjithsej.

Kjo njësi administrative përbën 13.5 për qind të territorit gjithsej, 13.6 për qind të tokës bujqësore. Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas të dhënave të vitit 2010, nga pikëpamja e pjerrësisë është: (Tabela 73)

<i>Emërtimi</i>	<i>Sipërfaqja (ha)</i>	<i>Në %</i>
4. Tokë bujqësore	737	100.0
0-5 %	120	16.3
5-10 %	25	3.4
10-15 %	105	14.2
15-20 %	110	14.9
Mbi 20 %	377	51.2

Tabela 73. Sipërfaqja e tokës sipas pjerrësisë.

Sikurse shihet vetëm 16.3 për qind e sipërfaqes bujqësore shtrihet në pjerrësinë 0-5 për qind. Sipërfaqe e konsiderueshme mbi 51 për qind shtrihet në pjerrësinë mbi 20 për qind.

Ujitja

Sipërfaqja potenciale 415 ha. Sipërfaqja aktuale 340 Ha. Sipërfaqja faktike 305 ha. Diferenca relativisht e vogël midis këtyre treguesve të aftësisë ujitëse tregon se infrastruktura e ujitjes (rezervuarë, kanale etj.) ka probleme por jo të theksuara.

Mekanizimi

Disponon traktorë me rrota gome 9, mini traktorë 14 ,makina mbjellëse 3 dhe freza 12, autokombajna 1.

Mënyrat e kryerjes së punimeve është: (Tabela 74)

<i>Emërtimi</i>	<i>Sipërfaqja (ha)</i>	<i>Në %</i>
4. Tokë bujqësore	737	100.0
- Me mekanikë	404	54.7
- Me kafshë	238	32.3
- Me krahë	95	13.0

Tabela 74. Mekanizimi i punimeve viti 2015.

Sikurse shihet shtrirja e sipërfaqes së tokës në pjerrësinë 0-5 për qind krijon mundësi për të kryer me mjete mekanike rreth 55 për qind të punimeve. Një pjesë e konsiderueshme është e mundur të kryhet me kafshë

Përdorimi i plehrave

Për vitin 2015 janë përdorur 113 ton plehra kimike ose 153.3 kg/ha tokë bujqësore, që konsiderohet nivel i ulët.

Struktura e mbjelljeve

Struktura e mbjelljeve p;r disa vite. (Tabela 75)

(Ha)

Emërtimi	2013	2014	2015
1.Drithra buke	271	262	251
-Grurë	220	210	204
2.Patate	16	16	18
3.Fasule gjithsej	58	58	59
4.Duhan	-	-	-
5.Perime bostan	32	35	39
6.Foragjere,tagjira	280	283	282
7.B.medicinale	-	-	1
8.Të tjera(humulus)	-	-	-
Gjithsej	657	654	650

Tabela 75 . Struktura e mbjelljeve.

Sikurse shihet drithërat e bukës përbëjnë mbi 40 për qind të mbjelljeve, ku gruri e zë peshën kryesore. Peshë të konsiderueshme zënë dhe foragjeret dhe tagjirat, mbi 43 për qind, e lidhur kjo me numrin e bagëtive. Në vite të veçantë para vitit 1990 ka mbjellë duhan, elb distik.

Prodhimet e bimëve të arave

Prodhimet nga bimët e arave tregohen në tabelën 76. (Tonë)

Emërtimi	2013	2014	2015
1.Drithra buke	800	811	752
-Grurë	630	648	610
2.Patate	360	369	444
3.Fasule	74	80	29
4.Duhan	-	-	-
5.Perime e bostan	637	737	884

Tabela 76. Prodhimet nga bimët e arave.

Edhe në të ardhmen mund të ruhet kjo strukturë e prodhimit..

Pemtaria dhe vreshtaria

Zhvillimi i pemëtarisë tregohet në tabelën 77.

Emërtimi	2013	2014	2015
1.Pemishte (ha)	32.2	34.2	37
2.Pemë gjithsej (rrënjë)	31600	33013	34623
-Në prodhim	26620	27880	28790
3.Rendimenti (kg/rr.)	18.9	21.8	21.6
4.Prodhimi (ton)	504	608	623
5.Vreshta (ha)	47.5	48.5	50
6.Prodhim rrush gjithsej (ton)	618	647	660

Tabela 77. Prodhimi nga pemët dhe vreshtat.

Nga prodhimi i frutave prodhimi i mollës është 318 tonë, kumbulla 75 tonë, qershi 87 tonë, arra 49 tonë, etj. Në njësi janë 0.8 ha. arra dhe 3.2 ha me lajthi (2015). Sipërfaqja e arrave dhe lajthive mund të shtohet.

Zhvillimi i blegtorisë

Mbarështohen pothuajse të gjithë llojet e kafshëve për prodhim. Numri i krerëve ka ndryshuar si më poshtë, (Tabela 78) (Krerë)

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Gjedhë gjithsej	500	587	578
-Lopë	460	496	454
2.Të leshta	4500	6182	6143
-Dele	3800	4732	4516
3.Të dhirta	1000	1972	2000
-Dhi	850	1152	1501
4.Derra	50	50	51
-Dosa	4	4	5
5.Shpendë	2400	2730	3149
6.Njëthundrakë	430	430	412
7.Bletë (zgjoje)	700	884	999

Tabela 78. Numri i krerëve të blegtorisë.

Numri i krerëve në gjedhë ka qenë i stabilizuar në viteve të fundit. Rritje relativisht më të madhe ka në numrin e blegtorisë së imët e cila dhe mund të shtohet sidomos për mish.

Prodhimet blegtorale

Në vartësi të numrit të krerëve dhe rendimenteve, prodhimi nga blegtoria tregohet në tabelën 79.

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Qumësht gjithsej j(tonë)	1052	2188	1216
-Lope	789	1776	800
-Dele	196	270	218
-Dhie	73	142	188
2.Mish gjithsej peshë e gjallë, (tonë)	151	406	247.5
-Gjedhi	57.5	141	93.1
-Dhentë	68.5	189	108.3
-Dhitë	18	66	36.8
-Derri	5	6	5.2
-Shpendi	2	4	4.1
3.Vezë (000/kokrra)	336	256	368.7

Tabela 79. Prodhimet blegtorale.

Në vitin 2015 në krahasim me vitin 2013 është rritur prodhimi i qumështit dhe i mishit Po ashtu rritje ka dhe në krahasim me vitin 1989. Edhe në këtë lidhur me prodhimin e mishit janë të njëjtat

probleme. Prodhimet blegtorale sidomos mishi mund të shtohet. Janë prodhuar dhe 17 ton mjaltë.(2015)

Tregtimi i produkteve

Për vetë strukturën e prodhimit dhe vendndodhjen relativisht larg qytetit, ka probleme për tregtimin e produkteve sidomos të frutave dhe perimeve.. Ndërtimi i rrugës së re nacionale do të krijonte mundësi më të mira.

6.5 Njësia administrative Trebinjë

Është njësia vendore që i largohet rrugës nacionale Korçë-Pogradec dhe hyn në zonën malore të Bashkisë. Ka një popullsi pre 3756 banorë e shpërndarë në 15 fshatra, 1133 familje dhe 564 ferma. Madhësia e fermës 0.82 ha. Territori i saj përshkohet nga 75 km rrugë ose 0.64 km/km²

Faktorët e prodhimit

Fondi i tokës.

(Tabela 80)

<i>Emërtimi</i>	<i>Ha</i>
1.Territori gjithsej (2014)	6068
-Tokë e punuar	2920
-Pyje	3148
-Kullota,livadhe	524
-Tokë e refuzuar	(1368)
2.Tokë e ndarë sipas ligjit	1552
3.Tokë e punuar (2015)	1552
-Arë	1516
-Pemtore	31
-Vreshta	5

Tabela 80. Fondi i tokës gjithsej.

Kjo njësi administrative përbën 15.8 për qind të territorit gjithsej, 17.6 për qind të tokës bujqësore. Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas të dhënave të vitit 2010, nga pikëpamja e pjerrësisë është: (Tabela 81)

<i>Emërtimi</i>	<i>Sipërfaqja (ha)</i>	<i>Në %</i>
5. Tokë bujqësore	1552	100.0
0-5 %	80	5.1
5-10 %	50	3.2
10-15 %	62	4.0
15-20 %	150	9.7
Mbi 20 %	1210	78.0

Tabela 81. Sipërfaqja e tokës sipas pjerrësisë.

Sikurse shihet vetëm 5.1 për qind e sipërfaqes bujqësore shtrihet në pjerrësinë 0-5 për qind. Sipërfaqe e konsiderueshme 78 për qind shtrihet në pjerrësinë mbi 20 për qind.

Ujitja

Sipërfaqja potenciale 560 ha. Sipërfaqja aktuale 250 Ha. Sipërfaqja faktike 182 ha. Diferenca e dukshme e këtyre treguesve të aftësisë ujitëse tregon se infrastruktura e ujitjes (rezervuarë, kanale

etj.) ka probleme serioze. Gjendja e rezervuarve është e mirë por probleme serioze (jashtë funksionit) janë kanalet ushqyes dhe të ujitjes.

Mekanizimi

Disponon traktorë me rrota gome 15, mini traktorë 8 ,makina mbjellëse 5 dhe freza 9, autokombajna 5.Mënyrat e kryerjes së punimeve është: (Tabela 82)

Emërtimi	Sipërfaqja (ha)	Në %
5. Tokë bujqësore	1552	100.0
- Me mekanikë	1188	76.5
- Me kafshë	304	19.6
- Me krahë	60	3.9

Tabela 82. Mekanizimi i punimeve viti 2015.

Një sipërfaqe e konsiderueshme mbi 76 për qind punohet me mjete të mekanizuara dhe vetëm mbi 23 për qind me kafshë dhe krahë.

Përdorimi i plehrave

Për vitin 2015 janë përdorur 416 ton plehra kimike ose 268 kg/ha tokë bujqësore, që konsiderohet nivel i ulët.

Struktura e mbjelljeve

Struktura e mbjelljeve për disa vite. (Tabela 83) (Ha)

Emërtimi	2013	2014	2015
1.Drithra buke	572	563	543
-Grurë	430	425	410
2.Patate	14	14	12
3.Fasule gjithsej	120	120	110
4.Duhan	1	0.7	2
5.Perime bostan	18	22	20
6.Foragjere,tagjira	798	801	826
7.B.medicinale	-	-	-
8.Të tjera(humulus)	-	-	-
Gjithsej	1523	1520.7	1513

Tabela 83 . Struktura e mbjelljeve.

Sikurse shihet foragjeret dhe tagjirat përbëjnë mbi 52 për qind të mbjelljeve. Peshë të konsiderueshme zënë dhe drithërat e bukës, ku vendin kryesor e zë gruri. Në vite të veçantë para vitit 1990 ka mbjellë duhan, elb distik në sipërfaqe relativisht të mëdha.

Prodhimet e bimëve të arave

Prodhimet nga bimët e arave tregohen në tabelën 84.

(Tonë)

Emërtimi	2013	2014	2015
1.Drithra buke	1464	1549	1443
-Grurë	1161	1232	1151
2.Patate	294	312	270
3.Fasule	117	140	128
4.Duhan	0.4	0.7	2.2
5.Perime e bostan	368	520	481

Tabela 84. Prodhimet nga bimët e arave.

Edhe në të ardhmen mund të ruhet kjo strukturë e prodhimit.

Pemtaria dhe vreshtaria

Zhvillimi i pemëtarisë tregohet në tabelën 85.

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Pemishte (ha)	26	27.8	31
2.Pemë gjithsej (rrënjë)	32085	33603	35829
-Në prodhim	21490	23440	24620
3.Rendimenti (kg/rr.)	18.2	22.2	21.4
4.Prodhimi (ton)	391	520	528
5.Vreshta (ha)	3	3.5	5
6.Prodhim rrush gjithsej (ton)	68	97.5	111

Tabela 85. Prodhimi nga pemët dhe vreshtat.

Nga prodhimi i frutave prodhimi i mollës është 161 tonë, kumbulla 83 tonë, qershi 73 tonë, arra 85 tonë, etj . Në njësi janë 0.5 ha. arra dhe 2 ha me lajthi (2015). Sipërfaqja e arrave dhe lajthive mund të shtohet.

Zhvillimi i blegtorisë

Mbarështohen pothuajse të gjithë llojet e kafshëve për prodhim. Numri i krerëve ka ndryshuar si më poshtë, (Tabela 86) (Krerë)

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Gjedhë gjithsej	1100	1200	1250
-Lopë	940	1000	1031
2.Të leshta	8100	8700	8853
-Dele	6800	7100	7191
3.Të dhirta	4700	5200	5367
-Dhi	3850	4700	4770
4.Derra	160	200	234
-Dosa	15	20	27
5.Shpendë	8300	9000	9565
6.Njëthundrakë	780	810	829
7.Bletë (zgjoje)	1200	1400	1470

Tabela 86. Numri i krerëve të blegtorisë.

Numri i krerëve në gjedhë ka qenë i stabilizuar në viteve të fundit. Mban peshë të rëndësishme sidomos në numrin e të imtave .

Prodhimet blegtorale

Në vartësi të numrit të krerëve dhe rendimenteve, prodhimi nga blegtoria tregohet në tabelën 87.

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Qumësht gjithsej j(tonë)	2213	3902	2785
-Lope	1560	2963	1818
-Dele	230	378	351
-Dhie	423	561	616

2.Mish gjithsej peshë e gjallë, (tonë)	608	708	475.7
-Gjedhi	143	270	196.1
-Dhentë	340	234	153.6
-Dhitë	94	170	107.5
-Derri	20	23	7.0
-Shpendi	11	11	11.5
3.Vezë (000/kokrra)	961.5	983	1167.7

Tabela 87. Prodhimet blegtorale.

Në vitin 2015 në krahasim me vitin 2013 është rritur prodhimi i qumështit. Po ashtu rritje ka dhe në krahasim me vitin 1989. Edhe në këtë lidhur me prodhimin e mishit janë të njëjtat probleme. Prodhimet blegtorale sidomos mishi mund të shtohet. Janë prodhuar dhe 23.5 ton mjaltë.(2015)

Tregtimi i produkteve

Ka pak probleme në shitjen e frutave dhe perimeve se fermerët prodhojnë kryesisht për nevojat e veta. Me ndërtimin e rrugës së re mund të synohet më shumë prodhimi për treg

6.6 Njësia administrative Proptisht

Është njësia vendore larg rrugës nacionale Korçë-Pogradec dhe hyn në zonën malore të Bashkisë. Ka një popullsi pre 6208 banorë e shpërndarë në 15 fshatra, 188 familje dhe 1205 ferma. Madhësia e fermës 1.03 ha. Territori i saj përshkohet nga 105 km rrugë ose 1.37 km/km2.

Faktorët e prodhimit

Fondi i tokës.

(Tabela 88)

<i>Emërtimi</i>	<i>Ha</i>
1.Territori gjithsej (2014)	6604
-Tokë e punuar	2709
-Pyje	3412
-Kullota,livadhe	483
-Tokë e refuzuar	(1463)
2.Tokë e ndarë sipas ligjit	1262
3.Tokë e punuar (2015)	1262
-Arë	1152.9
-Pemtore	62.9
-Vreshta	31

Tabela 88. Fondi i tokës gjithsej.

Kjo njësi administrative përbën 17.2 për qind të territorit gjithsej, 16.4 për qind të tokës bujqësore. Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas të dhënave të vitit 2010, nga pikëpamja e pjerrësisë është: (Tabela 89)

<i>Emërtimi</i>	<i>Sipërfaqja (ha)</i>	<i>Në %</i>
6. Tokë bujqësore	1246	100.0
0-5 %	200	16.0
5-10 %	80	6.4
10-15 %	190	15.2
15-20 %	193	15.5

Mbi 20 %	583	46.9
----------	-----	------

Tabela 89. Sipërfaqja e tokës sipas pjerrësisë.

Sikurse shihet vetëm 16 për qind e sipërfaqes bujqësore shtrihet në pjerrësinë 0-5 për qind. Sipërfaqe e konsiderueshme 47 për qind shtrihet në pjerrësinë mbi 20 për qind.

Ujitja

Sipërfaqja potenciale 300 ha. Sipërfaqja aktuale 174 Ha. Sipërfaqja faktike 134 ha. Duke pasur parasysh sipërfaqen e tokës bujqësore mendojmë se aftësia ujitëse është e ulët. Po ashtu problem janë stacionet e pompim që janë jashtë funksionit.

Mekanizimi

Disponon traktorë me rrota gome 54, mini traktorë 12 ,makina mbjellëse 4 dhe freza 5, autokombajna 5.

Mënyrat e kryerjes së punimeve është: (Tabela 90)

<i>Emërtimi</i>	<i>Sipërfaqja (ha)</i>	<i>Në %</i>
6. Tokë bujqësore	1262	100.0
- Me mekanikë	1048	83.0
- Me kafshë	159	12.6
- Me krahë	55	4.4

Tabela 90. Mekanizimi i punimeve viti 2015.

Një sipërfaqe e konsiderueshme 80 për qind punohet me mjete të mekanizuara dhe vetëm mbi 17 për qind me kafshë dhe krahë.

Përdorimi i plehrave

Për vitin 2015 janë përdorur 447 ton plehra kimike ose 354.2 kg/ha tokë bujqësore, që konsiderohet nivel relativisht i ulët.

Struktura e mbjelljeve

Struktura e mbjelljeve për disa vite. (Tabela 91)

(Ha)

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Drithra buke	578	570	557
-Grurë	460	455	450
2.Patate	30	30	32
3.Fasule gjithsej	70	70	68
4.Duhan	1	1.5	2
5.Perime bostan	25	45	47
6.Foragjere,tagjira	444	443	447
7.B.medicinale	-	-	-
8.Të tjera(humulus)	-	-	-
Gjithsej	1148	1159	1153

Tabela 91 . Struktura e mbjelljeve.

Sikurse shihet foragjeret dhe tagjirat përbëjnë mbi 38.2 për qind të mbjelljeve. Peshë të konsiderueshme zënë dhe drithërat e bukës rreth 50 për qind, ku vendin kryesor e zë gruri. Në vite të veçantë para vitit 1990 ka mbjellë duhan, elb distik në sipërfaqe relativisht të mëdha. Kështu me duhan janë mbjellë mbi 220 ha duhan

Prodhimet e bimëve të arave

Prodhimet nga bimët e arave tregohen në tabelën 92. (Tonë)

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Drithra buke	1681	1770	1697
-Grurë	1334	1410	1350
2.Patate	660	616	670
3.Fasule	51	63	65
4.Duhan	0.6	0.9	1.2
5.Perime e bostan	836	1062	1113

Tabela 92. Prodhimet nga bimët e arave.

Edhe në të ardhmen mund të ruhet kjo strukturë e prodhimit.

Pemtaria dhe vreshtaria

Zhvillimi i pemëtarisë tregohet në tabelën 93.

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Pemishte (ha)	56.2	58.2	62
2.Pemë gjithsej (rrënjë)	53783	55244	58586
-Në prodhim	41407	42446	46239
3.Rendimenti (kg/rr.)	13.5	15.9	16.7
4.Prodhimi (ton)	560	677	774
5.Vreshta (ha)	27	27.9	31
6.Prodhim rrush gjithsej (ton)	380	445	380

Tabela 93. Prodhimi nga pemët dhe vreshtat.

Nga prodhimi i frutave prodhimi i mollës është 212 tonë, kumbulla 266 tonë, qershi 139 tonë, arra 34 tonë, etj . Në njësi janë 1.3 ha. arra (2015). Sipërfaqja e arrave mund të shtohet.

Zhvillimi i blegtorisë

Mbarështohen pothuajse të gjithë llojet e kafshëve për prodhim. Numri i krerëve ka ndryshuar si më poshtë, (Tabela 94) (Krerë)

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Gjedhë gjithsej	1590	1590	1677
-Lopë	1260	1320	1340
2.Të leshta	5500	6000	5752
-Dele	4600	4700	4522
3.Të dhirta	3600	3590	3635
-Dhi	3000	3000	3047
4.Derra	60	70	88
-Dosa	10	20	21
5.Shpendë	19000	19000	19800
6.Njëthundrakë	680	720	743
7.Bletë (zgjoje)	850	830	856

Tabela 94. Numri i krerëve të blegtorisë.

Numri i krerëve në gjedhë ka qenë i stabilizuar në viteve të fundit. Mban peshë të rëndësishme sidomos në numrin e lopëve .

Prodhimet blegtorale

Në vartësi të numrit të krerëve dhe rendimenteve, prodhimi nga blegtoria tregohet në tabelën 95.

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Qumësht gjithsej j(tonë)	3110	5271	3079
-Lope	2520	4620	2432
-Dele	230	273	234
-Dhie	360	378	413
2.Mish gjithsej peshë e gjallë, (tonë)	411	722	518.7
-Gjedhi	191	367	285
-Dhentë	110	186	116.1
-Dhitë	72	129	78.3
-Derri	14	9	9.6
-Shpendi	24	31	29.7
3.Vezë (000/kokrra)	1712	2628	1610

Tabela 95. Prodhimet blegtorale.

Në vitin 2015 në krahasim me vitin 2013 është rritur prodhimi i mishit. Po ashtu rritje ka dhe në krahasim me vitin 1989. Edhe në këtë lidhur me prodhimin e mishit janë të njëjtat probleme. Prodhimet blegtorale sidomos mishi mund të shtohet. Janë prodhuar dhe 15 tonë mjaltë.(2015)

Tregtimi i produkteve

Për vetë strukturën e prodhimit dhe vendndodhjen relativisht larg qytetit, ka probleme jo shqetësuese për tregtimin e produkteve si fruta dhe perime.

6.7 Njësia vendore Velçan

Bën pjesë në zonën malore të Bashkisë. Ka një popullsi prej 3642 banorë e shpërndarë në 8 fshatra, 1147 familje dhe 613 ferma. Madhësia e fermës 1.03 ha. Territori i saj përshkohet nga 73 km rrugë ose 0.64 km/km². Është njësia vendore më e vogël në Bashki.

Faktorët e prodhimit

Fondi i tokës.

(Tabela 96)

<i>Emërtimi</i>	<i>Ha</i>
1.Territori gjithsej (2014)	4622
-Tokë e punuar	1542
-Pyje	2539
-Kullota,livadhe	541
-Tokë e refuzuar	(908)
2.Tokë e ndarë sipas ligjit	634
3.Tokë e punuar (2015)	634
-Arë	576
-Pemtore	58
-Vreshta	0

Tabela 96. Fondi i tokës gjithsej.

Kjo njësi administrative përbën 12 për qind të territorit gjithsej, 9.3 për qind të tokës bujqësore. Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas të dhënave të vitit 2010, nga pikëpamja e pjerrësisë është: (Tabela 97)

<i>Emërtimi</i>	<i>Sipërfaqja (ha)</i>	<i>Në %</i>
7. Tokë bujqësore	634	100.0
0-5 %	60	9.5
5-10 %	35	5.5
10-15 %	70	11.1
15-20 %	110	17.3
Mbi 20 %	359	56.6

Tabela 97. Sipërfaqja e tokës sipas pjerrësisë.

Sikurse shihet vetëm 9.5 për qind e sipërfaqes bujqësore shtrihet në pjerrësinë 0-5 për qind. Sipërfaqe e konsiderueshme 56.6 për qind shtrihet në pjerrësinë mbi 20 për qind.

Ujitja

Sipërfaqja potenciale 400 ha. Sipërfaqja aktuale 165 Ha. Sipërfaqja faktike 156 ha. Rezervuarët janë në gjendje të mirë por janë jashtë funksionit kanalet ushqyes dh të ujitjes.

Mekanizimi

Disponon traktorë me rrota gome 9, 1 me zinxhirë ,mini traktorë 3 ,makina mbjellëse 3 dhe freza 1. Mënyrat e kryerjes së punimeve është: (Tabela 98)

<i>Emërtimi</i>	<i>Sipërfaqja (ha)</i>	<i>Në %</i>
7. Tokë bujqësore	634	100.0
- Me mekanikë	525	82.8
- Me kafshë	83	13.1
- Me krahë	26	4.1

Tabela 98. Mekanizimi i punimeve viti 2015.

Një sipërfaqe e konsiderueshme mbi 82 për qind punohet me mjete të mekanizuara dhe vetëm 17.2 për qind me kafshë dhe krahë.

Përdorimi i plehrave

Për vitin 2015 janë përdorur 233 ton plehra kimike ose 367.5 kg/ha tokë bujqësore, që konsiderohet nivel relativisht i ulët.

Struktura e mbjelljeve

Struktura e mbjelljeve për disa vite. (Tabela 99) (Ha)

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Drithra buke	281	254	268
-Grurë	175	180	175
2.Patate	50	50	55
3.Fasule gjithsej	40	40	42
4.Duhan	-	-	-
5.Perime bostan	14	16	18
6.Foragjere,tagjira	194	218	193
7.B.medicinale	-	-	-
8.Të tjera(humulus)	-	-	-
Gjithsej	579	578	576

Tabela 99 . Struktura e mbjelljeve.

Peshë të konsiderueshme zënë dhe drithërat e bukës rreth 44 për qind, ku vendin kryesor e zë gruri. Tagjirat dhe foragjeret zënë mbi 33 për qind. Në vite të veçantë para vitit 1990 ka mbjellë duhan, elb distik në sipërfaqe relativisht të mëdha. Kështu me duhan janë mbjellë edhe 90 ha duhan

Prodhimet e bimëve të arave

Prodhimet nga bimët e arave tregohen në tabelën 100. (Tonë)

Emërtimi	2013	2014	2015
1.Drithra buke	827	854	802
-Grurë	490	540	610
2.Patate	660	616	670
3.Fasule	36	46	55
4.Duhan	-	-	-
5.Perime e bostan	297	412	465

Tabela 100. Prodhimet nga bimët e arave.

Edhe në të ardhmen mund të ruhet kjo strukturë e prodhimit.

Pemtaria dhe vreshtaria

Zhvillimi i pemëtarisë tregohet në tabelën 101.

Emërtimi	2013	2014	2015
1.Pemishte (ha)	55	55.8	58
2.Pemë gjithsej (rrënjë)	47064	47890	48941
-Në prodhim	32495	32611	35257
3.Rendimenti (kg/rr.)	12.9		
4.Prodhimi (ton)	420	450	519
5.Vreshta (ha)	-	-	--
6.Prodhim rrush gjithsej (ton)	99	111	122

Tabela 101. Prodhimi nga pemët dhe vreshtat.

Nga prodhimi i frutave prodhimi i mollës është 119 tonë, kumbulla 211 tonë, qershi 62 tonë, arra 26 tonë, etj . Në njësi janë 4.5 ha. arra (2015). Sipërfaqja e arrave mund të shtohet.

Zhvillimi i blegtorisë

Mbarështohen pothuajse të gjithë llojet e kafshëve për prodhim. Numri i krerëve ka ndryshuar si më poshtë, (Tabela 102)

(Krerë)

Emërtimi	2013	2014	2015
1.Gjedhë gjithsej	850	1056	1145
-Lopë	700	842	880
2.Të leshta	9100	10687	7640
-Dele	7400	7352	5884
3.Të dhirta	3000	4279	4660
-Dhi	2600	3112	3385
4.Derra	20	82	104
-Dosa	1	9	4
5.Shpëndë	7600	8080	8650
6.Njëthundrakë	430	239	335

7.Bletë (zgjoje)	640	667	843
------------------	-----	-----	-----

Tabela 102. Numri i krerëve të blegtorisë.

Numri i krerëve në gjedhë ka qenë i stabilizuar në viteve të fundit me një rritje gjedhë. Mban peshë të rëndësishme sidomos në numrin e të leshtave. .

Prodhimet blegtorale

Në vartësi të numrit të krerëve dhe rendimenteve, prodhimi nga blegtoria tregohet në tabelën 103 (Tonë)

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Qumësht gjithsej j(tonë)	2056	3668	2503
-Lope	1400	2863	1785
-Dele	370	419	322
-Dhie	286	386	396
2.Mish gjithsej peshë e gjallë, (tonë)	355	719	488.6
-Gjedhi	102	242	203.7
-Dhentë	182	310	151.2
-Dhitë	60	146	100.7
-Derri	1	10	20.9
-Shpendi	10	11	12.1
3.Vezë (000/kokrra)	693	929	954

Tabela 103. Prodhimet blegtorale.

Në vitin 2015 në krahasim me vitin 2013 është rritur prodhimi i mishit. Edhe në këtë lidhur me prodhimin e mishit janë të njëjtat probleme. Prodhimet blegtorale sidomos mishi mund të shtohet. Janë prodhuar dhe 17 tonë mjaltë.(2015)

Tregtimi i produkteve

Për vetë strukturën e prodhimit dhe vendndodhjen relativisht larg qytetit, për prodhimet mbi nevojat e veta ka probleme sidomos për patatat dhe pak në frutat.

VII. PROBLEMET E ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË NË ZONËN RURALE TË BASHKISË POGRADEÇ

Kalimi nga një bujqësi që zhvillohej sipas ligjeve të socializmit, në një ekonomi të tregut të lirë e gjeti bujkun tonë dhe pse jo dhe specialistët e bujqësisë të pa përgatitur. Të mësuar me ekonominë e centralizuar për më se 45 vjet, ku bujku ishte vetëm ai që punonte ndërsa vendimet merreshin nga të tjerët, kalimi në ekonominë ku vendimet do të merren nga individit për të drejtuar prodhimin, ishte sikur të gdhiehej në një planet tjetër. Edhe pse ishte vendosur prona private mbi tokën, ku vendimet për prodhimin duheshin të merreshin nga individit, kërkohet që problemet t'i zgjidhte shteti. U desh kohë që njerëzit të formonin një mentalitet të ri, megjithëse i vjetri ekziston ende. Mënyra e ndarjes së tokës, e mjeteve të tjera të prodhimit, ekzistenca e një infrastrukture të prapambetur, një sistem marketingu i pa organizuar, mungesa e burimeve financiare etj. kanë sjellë probleme të vazhdueshme në zhvillimin e bujqësisë. Ne do të përmendim disa prej tyre. Problemi themelor që ka bujqësia është ai strukturor. Struktura e bujqësisë apo fermës është çështje e përhershme e zhvillimit të bujqësisë, si sektor i rëndësishëm për gjithë ekonominë e vendit. Ato mund të jenë nxitëse ose pengesë për zhvillimin e bujqësisë. Aktualisht tani ato konsiderohen pengesë e rëndësishme sidomos në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të këtij sektori. Por bujqësia ndeshet dhe me probleme të tjera. Zhvillimi ekonomik i vendit ndikon në zgjidhjen optimale të tyre.

7.1. Pronësia mbi tokën, mbrojtja e tokës

Përgjithësisht është shkaktuar nga mënyra e ndarjes së tokës- *për frymë të popullsisë*. Megjithëse jemi i vetmi vend në Evropën Lindore që e zbatuam, ajo u gjykua si mënyra më e pranueshme përmendin tonë. Edhe në Bashkinë Pogradec ndeshen dy probleme:

- a. *Trajtimi i pronarëve historikë të tokës*
- b. *Pajisja e fermerëve me certifikatat e pronësisë.*

Duhet thënë se edhe në rrethin e Pogradecit, ashtu si në Korçë, janë më të zbutur se në rrethet e tjera. Janë probleme që lidhen me njëri tjetrin. Problemi i parë nuk është i lehtë. Zgjidhja duke abroguar Ligjin 7501, nuk është racionale për të mos thënë e mundur. Kthimi fizik i pronës është alternativë por jo me shumë mundësi. Kompensimi është alternativa që krijon mundësi por është e kushtueshme dhe kërkon kohë. Kombinimi i të dyjave sikurse parashikohet në ligjin e ri mbi pronat është e vetmja mundësi. Pothuajse në të gjitha njësitë vendore është problem pajisja e fermerëve me certifikatat e pronësisë. Regjistrimi në hipoteka është i kushtueshëm mbasi dhe pagesa është për çdo ngastër dhe tarifa është 5000 lek për ngastër. (Fermerët kanë edhe 5-6 ngastra). Në fshatin Blacë të njësisë vendore Çëravë ka problem sepse nuk është bërë azhurnimi i tokës.

Para vitit 1990 përdorimi i tokës bujqësore për qëllime të jo bujqësore ishte tejet i kontrolluar. Mbas vitit 1990 zënia e tokës bujqësore për ndërtime biznesi dhe banimi është diçka rutinë. Kjo është një fenomen mjaft i përhapur por sidomos në zonat rreth qyteteve, anës rrugëve nacionale etj.

7.2. Madhësia e fermës

Është një nga problemet më të mprehta dhe të vështira për tu zgjidhur i cili kërkon kohë, mentalitet të përparuar dhe zhvillim në tërësi të ekonomisë së vendit. Sipas të dhënave madhësia e fermës për sa i takon sipërfaqes së tokës është si më poshtë: (Tabela 104) Madhësia e fermës në zonën rurale të bashkisë Pogradec është ai më poshtë. (Tabela 104)

Njësitë vendore	Sipërfaqja mesatare e fermës (ha)	Numri i fermave me sipërfaqe të fermës:				
		->0.5ha	0.5-1 ha	1-1.5 ha	1.5-2 ha	mbi 2 ha
1. Udenisht	0.36	957	224	41	17	0
2. Buçimas	0.51	2090	431	155	62	10
3. Çëravë	1.21	183	874	532	118	23
4. Dardhas	0.65	943	182	15	-	-
5. Trebinjë	0.82 +	115	312	89	40	8
6. Proptisht	1.03	605	397	136	60	7
7. Velçan	1.03	242	235	91	45	-

Tabela 104. Madhësia e fermës.

Sikurse shihet në tërësi fermat janë të vogla. Rreth 56 për qind e fermave kanë më pak se 1 ha tokë, rreth 29 për qind 0.5-1 ha dhe mbi 11 për qind 1-1.5 ha. Kjo situatë është e përgjithshme në vendin tonë ku madhësia e fermës është rreth 1.2 ha. Jemi vendi në Evropë me madhësi ferme më të vogël me përjashtim të Maltës (0.9 ha). (Kroacia 5.6 ha, Mali i Zi 3.2 ha, Serbia 4.55 ha,). Por njësitë rurale të Bashkisë Pogradec, ashtu si në gjithë vendin, ndeshen me fenomenin e shumë parcelave të tokës që përbëjnë sipërfaqen e një ferme. E thënë ndryshe një fermë e ka tokën deri në 6 parcela. Kjo e çon fragmentarizmin e fermës në mënyrë të skajshme. Një fermë e vogël ka një sërë disavantazhe:

-Nuk siguron të ardhurat e nevojshme për familjen fermere.

-Pëngon mekanizimin dhe përdorimin efektiv të tij.

- Pëngon përdorimin racional të sistemit të ujitjes.
- Pëngon përdorimin e inpueteve që rritin prodhimin për pamundësi financiare.
- Pëngon kreditimin nga sistem financiar.
- Dobëson fuqinë e tregut për fermerët.
- Rezultantja e këtyre është : Pëngon rritjen e eficeiencës së fermës.

Çfarë mund të bëhet për rritjen e madhësisë së fermës?

Përvoja e vendeve të tjera ka treguar se zmadhimi i fermës mund të realizohet nga disa faktorë madhorë të kushtëzuar nga njëri - tjetri.

Së pari. Rritja e madhësisë së fermës normalisht lidhet me zhvillimin e sektorëve ekonomikë të vendit. Zhvillimi i industrisë, turizmit, industrisë përpunuese ushqimore etj. do të kërkonte një tërheqje të fuqisë punëtore nga fshati.

Së dyti. Zhvillimi i tregut të tokës në dy nivelet: me *qira* dhe *shitja*. Për shkak të faktorit të parë zhvillimi i tregut të tokës është tepër i ngadaltë, dhe në të shumtë e rasteve toka blihet për ndërtime ose biznes jashtë bujqësisë. Dhënia me qira e tokës është rritur, por ende është shumë i ulët në krahasim me vendet e zhvilluara ku mbi 60-70 për qind e tokës jepet me qira. Negativisht ndikon dhe mos zgjidhja e pronësisë mbi tokën në disa raste.

Së treti. Blerja e tokës është investim. Mungesa e kreditimit vështirëson procesin.

Së katërti. Pasiguria për të jetuar. Kjo tregohet nga fakti se edhe familjet e larguara nga fshati e ruajnë pronësinë mbi tokën. Arsyeja është e thjeshtë: Toka të pasur nuk të bën, por nuk të lë vdesësh urie.

Së pesti. Nëpërmjet organizimit të prodhimit dhe shitjes në përmasa më të mëdha, nëpërmjet kooperimit.

Zgjidhjet për pakësimin e fragmentarizmit.

Kjo lidhet me konsolidimin e fermës. Është proces që ka zgjatur shumë. (Suedi rreth 150 vjet). Por përvoja tregon se mund të realizohet edhe më shpejt. Zgjidhjet janë disa:

Së pari. Ndërrimi i copave të tokave midis fermerëve brenda një parcele. Është rruga më e mirë. Mund të bëhet në sipërfaqe të barabartë por edhe me kompensim në sipërfaqe ose vlerë kur ngastrat kanë pjellori të ndryshme. Në këtë rast sikurse theksuam më sipër është regjistrimi i ndryshimeve në hipotekë.

Së dyti. Marrëveshje midis fermerëve për mbjelljen e bllokut me të njëjtën bimë.

Së treti. Puna me grupe. Punimet të kryhen së bashku në të gjithë bllokun.

7.3. Numri i fermave

Në zonën rurale të bashkisë Pogradec zhvillojnë aktivitetin 9239 ferma, një numër relativisht i madh në krahasim me sipërfaqen e tokës. Ky fenomen është në shkallë vendi me mbi 320 mijë ferma duke pasur numër më të madh se Anglia. *Numri i fermave në të ardhmen do të varet kryesisht nga zhvillimi ekonomik i vendit, kur njerëzit të kenë mundësi të punojnë aktivitete jashtë prodhimit bujqësor.* Është i lidhur me zmadhimin e fermave.

7.4. Fuqia punëtore në bujqësi

Në shkallë vendi në bujqësi janë të zënë me punë në bujqësi e pyje rreth 44-45 për qind e krahëve të aftë. Kjo është shifër shumë e lartë edhe në krahasim me vendet e rajonit (Kroaci 13 %, Mali i Zi 5.6 %, Maqedonia 18.1 %, Serbia 21.2 %). Në zonën rurale të Bashkisë Pogradec, sipas llogaritjeve të përafërta është më e madhe.. Mendojmë se në këtë zonë numri i njerëzve të zenë me punë në bujqësi mund të jetë në kufijtë 30 për qind. Pakësimi i numrit të fuqisë punëtore në fshat është tregues i zhvillimit të vendit por kërkon kohë. Pakësimi i numrit por dhe përdorimi efektiv i fuqisë punëtore mund të arrihet nëpërmjet:

-Përmirësimi i strukturës së prodhimit, duke mbjellë kultura intensive, kjo edhe duke mbajtur parasys mundësitë e tregtimit.

-Zënia në punë jashtë fermës por në zonën rurale, sidomos në sektorë të tillë si prodhimi i materialeve të ndërtimit, përpunimi i produkteve bujqësore, shërbime si turizmi, hoteleria, etj.

- Tërheqja e popullsisë në punësim në zonat urbane.

7.5. Përmirësimi i formave të organizimit me synim rritjen e kooperimit

Pothuajse tërësisht fermat tona janë familjare. Kjo nuk është karakteristikë vetëm për vendin tonë. Por duhet theksuar se format e tjera të organizimit ose mungojnë ose janë fillimet e veta. Dhe këtu e kemi fjalën edhe për ato me bazë kooperimin. Eksperiencia e keqe e kooperimit socialist si dhe mungesa e vizionit për të ardhmen lidhur me këtë organizim, u gjend rruga më e thjeshtë ajo radikale, zhdukja e gjurmëve të kooperimit, ndryshe nga vendet e tjera që përdorën rrugën e transformimit të tyre në kushtet e sistemit kapitalist. Gjatë kësaj ka shembuj të mirë si Sarandë, Lushnjë, Durrës etj. se kjo është një rrugë që duhet të zgjerohet sepse edhe në këtë drejtim vendet e rajonit janë më të avancuara. Kështu Serbia (superfuqia e bujqësisë në rajon) ka mbi 1246 ndërmarrje dhe kooperativa bujqësore dhe secila ka mesatarisht 335 dhe 170 ha tokë, në Kosovë janë rreth 1800 kooperativa dhe

ferma komerciale, etj. Funksionojnë forma të ndryshme të kooperimit, por mendoj se më e përshtatshme për kushtet tona do të ishte **ajo e marketingut me të drejtë kontrollit të prodhimit**. Kjo sepse tani fermerët po hasin vështirësi në shitjen e produkteve. Kooperativat mund të jenë në bazë fshati, njësi administrative, bashkie, bile dhe kombëtare. Synimi final i këtyre kooperativave do të jetë rritja në afat të gjatë të të ardhurave të fermerëve, nëpërmjet kapërcimit të disa kufizimeve që kanë fermerët në treg dhe më gjerë. Kjo sepse:

-Krijohet mundësia për pakësimin e shpenzimeve për inpute nëpërmjet blerjes me çmime më të ulëta, për shkak të sasisë së blerjes në shkallë kooperative.

- Krijohet kërkesa për produkte bujqësore duke rritur cilësinë, standardizimin, promocionin etj.

- Krijohet mundësia për të shitur produktet me çmime më të larta nëpërmjet dhe rritje së fuqisë negociuese të fermerit nëpërmjet kooperativës.

- Shtohet kontrolli i ofertës së produkteve bujqësore në raport me kërkesat e tregut.

- Mund të rritet kontrolli në kanalet e shpërndarjes.

-Sigurohet informacion më i mirë dhe me më pak shpenzime për tregjet.

Përveç këtyre puna në grupe e fermerëve do të ndikonte pozitivisht edhe:

-Në rritjen e koordinimit dhe orientimit të bujqësisë duke filluar nga ferma dhe deri në Ministri.

-Në krijimin e mundësive për të përfituar më shumë nga programet e qeverisë dhe BE-së.

-Krijohen mundësi për integrimin vertikal të prodhimit për të shtuar vlerën e prodhimeve të fermës.

E gjithë kjo të inspirohej nga slogani: ***Pronarë individualë jemi të fortë, kur bashkohemi bëhemi më të fortë.***

Krijimi i kooperativave në forma të ndryshme, është problem vullnetar i fermerëve. Por shteti nuk mund të mënjanohet. Ndërhyrja nxitëse e qeverisë është e nevojshme në dy aspekte kryesore: ***Ekspertizë*** dhe ***financiare***. Nxitja financiare mund të jetë në dy drejtime: E para ***kushtëzuese*** d.m.th për të fituar nga programet e qeverisë si subvencione etj. duhet të jesh në kooperativë dhe ***direkt*** duke ndihmuar financiarisht kooperativat sidomos në infrastrukturë (depo, pajisje, makineri, etj.) si përqindje ndaj investimeve direkt. (Kjo është zbatuar në vitet 1970 në vende të BE-së).

7.6 Mbi mbështetjen e bujqësisë

Për këtë temë ka një diskutim të gjerë. Çështjet bazë kanë qenë dhe vazhdojnë, janë:

E para. A duhet mbështetur? Kjo është zgjidhur pozitivisht për arsye ekonomike, historike, sociale, etj. Kjo është e përgjithshme. Por në kushtet kur bujqësia dhe përpunimi i produkteve të saj, konsiderohen prioritare si në rastin e vendit tonë, mbështetja duhet të jetë si domosdoshmëri. Prodhimi bujqësor dhe problemet social ekonomike të zonës rurale kanë qenë dhe do të vazhdojnë të jenë përcaktuese për fatet e zhvillimit të vendit tonë.

E dyta. Përse duhet mbështetur? Për këtë ka modele të ndryshme por mund t'i grupojmë:

-***Nxitës direkt.*** Synojnë të ndikojnë tregun në mënyrë direkt nëpërmjet reduktimit të kostove të prodhimit të produkteve bujqësore, duke siguruar kushte për të rritur furnizimin nga fermerët me produkte bujqësore. Këto masa mund të përfaqësohen nga pagesa direkt për njësi: për ha, për krerë, për litër (qumësht), mbi vlerën e sasisë së shitur.

-***Nxitës të tregut.*** Shpërndahen për aktivitete që synojnë të përmirësojnë vendosjen e produkteve të bujqësisë në tregjet ndërkombëtarë, stabilizimin e tregut të brendshëm për produkte bujqësore dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e balancuar dhe të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor. Këto masa

mund të zbatohen nëpërmjet nxitjes së prodhimit për eksport nëpërmjet tarifave doganore deri zero, pagesë për prodhimet për eksport, promocion në shkallë ndërkombëtar etj.

- **Mbështetje për përmirësimin e teknologjive të kultivimit dhe mbrojtjes së bimëve** (Lek për/ha), për mbarështimin e blegtorisë (lekë për krerë)

- **Nxitje për investime e kreditime.** Zbatohet në % të interesit, % ndaj vlerës së projektit, lekë/ha (sera).

Vlen të përmendet se në këtë vit , të gjitha këto forma përdoren në vendin tonë. Kërkohe më shumë transparencë.

E treta. Sa duhet mbështetur në vlerë financiare? Kjo varet nga zhvillimi ekonomik i vendit, prioritetet e qeverisë, etj. E vërteta është se niveli i mbështetjes në vendin tonë është e ulët, krahasuar dhe me vendet e rajonit. (Maqedonia për 1 ha tokë të dobishme 116 Euro, viti 2012 , ndërkohë që vendi ynë 13.3 Euro për ha.) Maqedonia vetëm për grurin dhe misrin ka dhënë 17 milion Euro. Në vitin 2014 ka shpenzuar si mbështetje të bujqësisë 140 milion Euro. Ne shumë herë më pak.

7.7 Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit

Pothujse të gjithë komunat kanë probleme me ujitjen e bimëve. Dy janë problemet kryesorë:

a. Qenia pothuajse jashtë përdorimit e kanaleve ushqyese të rezervuarve dhe e kanaleve marrës të ujit nga rezervuarët. Vetëm dy rezervuarë nuk janë gjendje të mirë Qafë Thana dhe Malina 1 dhe 2. Po ashtu qenia jashtë përdorimit e shumë stacioneve të pompimit është problem zjetër serioz.

b. Problemet e menaxhimit të ujitjes.

Zgjidhja e problemit të parë kërkon shumë investime. ***Për këtë është mirë të bëhet një projekt kompleks dhe vit pas viti të kërkohe investime nga qeveria. Rrjeti i kanaleve të tjera të përballohen nga vetë fermerët.***

Aktualisht uji për ujitjen e bimëve administrohet nga Shoqatat e ujitjes në njësitë vendore që veprojnë dhe mbi bazë fshati. Kështu 16 rezervuarë me aftësi ujitëse janë dhënë në administrim të SHPU-ve (Shoqatat e Përdorimit të Ujit) me aftësi ujitëse 672 ha. dhe të gjithë rezervuarët e vegjël (hause) me aftësi ujitëse 106 ha. Janë të organizuara keq dhe funksionojnë përgjithësisht dobët. Kalimi i këtij aktiviteti në vartësi të baskisë por sidomos financimi në makineri dhe pjesje, si dhe investime të tjera për riparime, mirëmbajtje etj. do të përmirësojë të gjithë punën në këto drejtime.

Në komunën e Çëravës problem është edhe pastrimi i kanaleve të parë dhe të dytë të kullimit.

7.8 Tregtimi i produkteve bujqësorë

Është një problem që do të ekzistojë gjithmonë për fermerët. Sikurse theksuam aktualisht me ndonjë përjashtim nuk janë probleme shumë shqetësuese për zonën rurale të Bashkisë. Kjo sepse në përgjithësi prodhohen për nevojat e veta me ndonjë përjashtim për frutat, perimet, patatet e ndonjë tjetër. Me gjithë atë kjo nuk duhet të lumturojë as fermerët dhe as institucionet relevante. Në të ardhmen duhet të bëhen të gjitha përpjekjet që dalja në treg e fermerëve të ndryshojë tërësisht, si një tregues i rritjes së të ardhurave të tyre. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore , përkrahja më e madhe nga shteti, zmadhimi i fermës, përdorimi në sasi dhe në mënyrë racionale i i puteve, etj. do të sjellë rritjen e sasive të produkteve bujqësorë të destinuar për treg. Për këtë arsye nga institucionet por edhe nga fermerët është mirë të punohet për t'iu paraprirë problemeve që tashmë janë të mprehta në rajonet të tjerë të vendit. Sidomos në këto drejtime kryesorë:

- *Orientimi i fermerëve për sasinë më optimale të prodhimit për bimët kryesore.* Kjo sepse fermerët marrin vendim se **çfarë** të prodhojnë dhe **sa** kryesisht, nga çmimi në vitin faktik. Kur çmimi i një produkti p.sh patate në vitin 2015 është i lartë, për vitin 2016 fermerët vendosin të mbjellin e të prodhojnë sasi të mëdha, e cila sjell ofertë të madhe që shoqërohet me mos shitje ose shitje me çmim të ulët. *Orientimi është një praktikë e konsoliduar në vendet e BE-së, bile dhe midis vendeve.*

- *Ndarja e kohës së prodhimit me kohën e konsumit.* Nëpërmjet kapaciteteve frigoriferike sidomos për frutat.

- *Krijimi i qendrave të grumbullimit të produkteve.* (Mundet në zonën e Çëravës, por edhe për zonën më malore të Bashkisë sidomos edhe me përfundimin e rrugës). *Këto qendra mund të jenë me kontribut privat por mund të ndihmojë dhe shteti.*

- *Rritja e cilësisë së prodhimeve.* Edhe këtë vit mollët me cilësi dhe të llojeve të kërkuara nga tregu u shitë pa shumë vështirësi. *Synimi të jetë dhe për eksport.*

- *Krijimi i kooperativave të marketingut.* Sikurse u diskutua më sipër.

- *Përpunimi i produkteve.* Fermerët nëpërmjet kooperativave por edhe me ndihmën e shtetit, mund të rritnin mundësinë e përpunimit vetë të produkteve për të rritur vlerën dhe për mos lënë të dëmtohen. *(Të mos shesin qumësht por djathë etj., të shesin verë, lëngje mollësh, etj.)*

- *Të synohet që duke shfrytëzuar mikrozonat dhe investime për ambiente të mbrojtura, të synohet dalja herët me perime të freskëta, etj.*

- *Si sintezë e këtyre është rritja e konkurrencës së produkteve tona. certifikimi dhe markëzimi i tyre.*

7.9 Infrastruktura rrugore.

Si për kudo, por në bujqësi veçanërisht, infrastruktura rrugore është element i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe social të zonës rurale. Përvoja tregon se ku sistemi rrugor është i mirë mundësisë për zhvillim rriten. Kjo ndikon në zhvillimin e tregut, konkurrencën, çmimin e produkteve të fermës, koston e transportit, etj. Në zonën rurale është punuar disi mirë për lidhjen e qendrave të njësive vendore me rrugë të asfaltuara që mund ose jo të jenë nacionale.. Lidhja e fshatrave midis tyre, brenda njësisë, bëhet me rrugë në gjendje jo të mirë. Por edhe rrugët deri në qendër të njësive që janë asfaltuar, për shkak të cilësisë jo të mirë të ndërtimit, mirëmbajtjes, kushteve të këqija ej. në disa raste janë gjendje jo të përshtatshme. Sigurisht që këto kërkojnë fonde të konsiderueshme, por duhet filluar.

7.10 Rritja e kapaciteteve menaxhuese të bujqësisë është një problem jo vetëm për zonën rurale të Pogradecit. Problemi është në numër por edhe në cilësi. Nëpër njësitë vendore ka një numër minimal të specialistëve të bujqësisë si agronomë, zooteknikë, veterinerë. Zbatimi i teknologjive të reja, trajtimi i kafshëve etj. kërkon njerëz të përgatitur. Sektori këshillimor publik dhe privat duhet të fuqizohet. Tani janë katër agronomë të shërbimit këshillimor ose afërsisht një agronom për dy njësi vendore.

6.4.3 Analiza e bonitetit të tokave

Ne proces dixhitalizimi i hartave

6.4.4 Sektori i Industrisë

Subjektet që operojnë në fushën e industrisë në bashkinë Pogradec

Bashkia e Pogradecit nuk ka një zhvillim të madh drejt sektorit të industrisë. Ai përfaqësohet nga prodhimet e konfeksioneve, shfrytëzim minierash dhe aktivitetet e Hec-eve. Zhvillimi I aktiviteteve të minierave në këtë bashki ka një potencial të madh, porë kjo edhe nga analizimi I burimeve metalore në seksionin e analizës së burimeve natyrore. Megjithatë zhvillimi I këtij sektori duhet të zhvillohet pa cënuar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Një potencial të madh ka edhe zhvillimi I energjitikës. Për shkak të rrjetit hidrografik të pasur që bashkia ka, ekziston mundësia e zhvillimit të mëtejshëm të këtij sektori. Në bashkinë e Pogradecit operon edhe industria e materialeve të ndërtimit siç janë guroret dhe shfrytëzimit të inerteve.

Në qytet operojnë 2 subjekte të prodhimeve të konfeksioneve

Nr	SUBJEKTI	AKTIVITETI
1	N.P.V. INTERNACIONAL KORCA SHPK	Prodhim te konfeksioneve per vendin dhe Import-Eksport
2	SPANIEL SHPK	Prodhim per llogari te saj si dhe per te trete (Fason)
3	FADA 1	Shfrytezim Miniere

Njësia administrative Udënisht

Subjektet me aktivitet Shfrytëzim Miniere

Tabela 28. Subjektet shfrytëzim miniere

Nr	SUBJEKTI	AKTIVITETI
1	Sara Mineral Trading	Sh. Miniere
2	Benaks- 94 IBI	Sh. Miniere
3	Kuarci Blace	Sh. Miniere
4	Xhire Ton F. Gora	Sh. Miniere
5	Rej Sh.P.K	Sh. Miniere
6	Delda Star	Sh. Miniere

Njesia administrative Proptisht

Subjektet me aktivitet Shfrytezim Miniere dhe HC

Tabela 29. Subjektet shfrytëzim miniere Proptisht

Nr	SUBJEKTI	AKTIVITETI
1	Poëer Elektrik Slabinja	HC(Çentral elektrik)
2	JOAL-06	Shfrytezim Miniere
3	ALB-XHOI	Shfrytezim Miniere

Njesia administrative Çërravë

Subjektet me aktivitet Shfrytëzim Miniere

Tabela 30. Subjektet shfrytëzim miniere Cërravë

Nr	SUBJEKTI	AKTIVITETI
1	BENAKS-94	Impianti i perpunimit te kuarcit

Njesia administrative Velçan

Subjektet me aktivitet HC

Tabela 31. Subjekte me aktivitet të HC, Velçan


Nr	SUBJEKTI	AKTIVITETI
1	HIDRO POUER ELEKTRIK	HC(Çentral elektrik)
2	HEC BISHNICA	HC(Çentral elektrik)

6.4.5 Turizmi

Turizmi si një sektor mjaft i rëndësishëm në Bashkinë Pogradec, sidomos viteve të fundit vihet re një ritje e fluksit të turistëve. Nga një anë infrastruktura rrugore, peisazhi i përmirësuar liqenor, kushtet klimaterike të Pogradecit, shërbimi cilësor, produktet bujqësore vendase, tradita e kulinarisë janë burime të rëndësishme për Turizmin e Pogradecit.

Nga tabela e mëposhtme, numri i turistëve sipas të dhënave të Bashkisë, është trefishuar nga viti 2007-2012. Në një periudhë 5-Vjeçare është rritja e numrit të turistëve është shume e ndjeshme. Ndërkohë që ky sektor po rritet në mënyrë progresive, nga ana e Bashkisë ende s'ka një plan të qartë, dhe objektiva për ta nxitur ekonominë vendase në shërbim të këtij sektori, dhe në mënyrë që ky turizëm të zhvillohet i organizuar dhe jo në mënyrë spontane. Ndërtimi i kioskave, dhe restoranteve buzë liqenit jo vetëm kishte prishur peisazhin liqenor, por ishte në dëm të bizneseve të tjera që mund të zhvilloheshin në krahun tjetër të rrugës, ku mundësia është me e madhe për një numër më të madh biznesesh që operojnë në fushën e turizmit. Megjithë kostot ekonomike dhe sociale që solli prishja e këtyre ambienteve pati dhe efektin e vet pozitiv. Nga ana e Bashkisë, duhet të dalë qartë mesazhi që moskoordinimi dhe rregullimi i këtij sektori sjell pasoja të mëdha për ekonominë vendase, papunësi, ulje të të ardhurave familjare, bashkisë etj.

Të dhëna statistike për numrin e turistëve në Pogradec

Figura 136 Numri i turistëve Pogradec, 2012

Zonat e pushimit/atraksionit më të preferuara nga turistët

Tabela 32. Atraksionet më të preferuara

Rrethi Pogradec	Taxi	Autobus
Burimi i Drilonit	8 min	15 min
Fshati turistik i Tushemishtit	10 min	20 min
Shpella e Najzmes	15 min	25 min
Guri i Kamjes	40 min	1 orë e 10 min
Shpella e Shen Marenës	2 orë e 30 min	4 orë
Manastiri i Shen Marenës	2 orë e 30 min	4 orë
Kanioni i Llëngës	2 orë e 50 min	4 orë e 30 min
Varret e Selcës	1 orë e 30 min	2 orë
Fshati turistik i Linit	20 min	35 min
Mozaikët e Linit	25 min	45 min

Një veçori tjetër e këtij sektori në Pogradec është sezonaliteti. Turizmi liqenor deri tani ka qenë sezonal vetëm në periudhën e verës. Momentalisht me intensitet më të lartë gjatë dy muajve të verës (korrik, gusht). Ky turizëm sipas Bashkisë konsiston në turizmin familjar, në hotelet e motelet ekzistuese²⁷. Kohët e fundit vihet re që ka frekuentim dhe ditore apo në ëekend-e.

Megjithatë, Bashkia Pogradec kërkon të promovojë më shumë opsione për turizmin përveç atij liqenor, atij kodrinoro-malor/agroturizëm, turizëm historiko-kulturor, rekreacioni etj.

Është e rëndësishme që të gjitha këto qëllime dhe objektiva të jenë të pasqyruara në plane konkrete dhe sidomos në njohje si fillim të zonës dhe kapaciteteve. Disa prej Njësisve Adiminsitrative të Bashkisë Pogradec mund të jenë potencial për atraksione turistike, por nuk kanë ende investimet bazë, si dhe nuk kanë ende vëmendje të mjaftueshme nga pushteti lokal për këto mundësi, dhe njohje te plotë të tyre.

Bashkia Pogradec duke njohur potencialet e Turizmit, dhe efektet ekonomike që sjell ky sektor mund të zbatojë politika fiskale te diferencuara për sektorët që do të stimulojë.

7. Zonat e rëndësisë kombëtare në territorin e bashkisë Pogradec


7.1 Përshkrimi i zonës

Bashkia e pogradecit është pjesë e rrjetit të zonave natyrore të mbrojtura dhe një pjesë e mirë e saj është pjesë e kategorisë së V të zonave të mbrojtura atë të “Peisazhit të Mbrojtur”. Kjo zonë është shallur zonë e mbrojtur me V E N D I M Nr.80, datë 18.2.1999.

Peisazhi i Mbrojtur Tokësor/Ujor i Pogradecit ka një sipërfaqe prej 27.323 ha. Peisazhi i Mbrojtur Tokësor/Ujor i Pogradecit ndodhet në juglindje të Shqipërisë, në kufi me Maqedoninë. Kufijtë e ZM-së përcaktohen me Vendimin Nr. 80, datë 18.2.1999 “Për shpalljen e territorit tokësor/ujor të Pogradecit “Zonë e mbrojtur”, si më poshtë:

- Veri Qafe Thane: kufiri shtetëror (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë);
- Lindje: kufiri shtetëror (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) dhe kufiri liqenor me Parkun Kombëtar të Prespës: (maja e Pusit: 2,288m, maja e Zonjës: 2,085 m) dhe kuotat 1,912 m;
- Jug: Kuota 1,912m, kuota 1,461 dhe kuota 1,589 m;
- Perëndim: kuota 1,461, dhe kuota 1,589m, maja e Beshenikut (1,411m) maja e Shullerit (1,226 m), maja e Fushës së Madhe (1,430m), maja e Muratit (1,520), Qafa e Kotodeshit, Qafa e Thanës.

Figura 137. Monumentet e kulturës dhe zona e mbrojtur



7.1.1 Monumentet Arkeologjike të bashkisë Pogradec

1. Kalaja e Pogradecit, me mure mesjetare te shek. V-VI pas Krishtit.
2. Varret monumentale te Selces se Poshtme shek. IV-III para Krishtit.
3. Bazilika e Linit , me mozaike shek. V-VI pas Krishtit.
4. Kalaja e Bllacës me mure shek V – VI pas krishtit

7.1.2 Tipet e gjeomonumenteve të bashkisë së Pogradecit

Gjeomonumentet në Bashkinë e Pogradecit janë të rëndësisë ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale. Për nga origjina e tyre, dominojnë gjeomonumentet me origjinë: stratigrafike, mineralogjike - ekonomike, gjeomorfologjike (erozionale-lumore, karstike, atmosferike), tektono-strukturore, paleontologjike-paleoambientale, hidrogeolo-gjike-termominerale etj. Konkretisht, kemi gjeomonumentet e klasifikuara si më poshtë:

I-Parqet Natyrore:

1. Pogradeci *Peisazh i Mbrojtur*
2. Guri i Nikës, *Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara*

II-Gjeomonumentet:

a) Gjeomonumente me vlera ndërkombëtare:

1. Liqeni i Pogradecit (Ohrit), *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, neotektonikliqenor*

b) Gjeomonumente me vlera kombëtare:

1. Guri i Kamjes (V-a-8), *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik*
2. Burimi i Drilonit, *Gjeomonument hidrogeologjik-karstik*

c) Gjeomonumente lokale:

1. Burimet e Tushemishtit, *Gjeomonument hidrogeologjik-karstik*
2. Gadishulli i Linit, *Gjeomonument tektono-strukturor*
3. Mullarët e Gurtë-Trebinjë (V-a-7) Format erozionale Trebinjë, *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik*
4. Gurët “nusja dhe dhëndërrit” Senisht, *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional*
5. Piramida e Tokës së Kalivaçit (Koka e Balos), *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik*
6. Piramida e Tokës së Qafë Panjës, *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik*
7. Fragment i shkëputjes tektonike të grabenit të Ohrit (Pogradec), *Gjeomonument tektono-strukturor*
8. Shpella e Memlishtit, *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, karstik*
9. Shpella e Radokalit, *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, karstik*
10. Shpella e Baribardhës, *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, karstik*
11. Shpella e Shën Marenës, *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, karstik*
12. Kanioni i Llëngës (V-b-23) Gryka e Llëngës, *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional lumor*
13. Shpella e Najzmës (Tushemisht), *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, karstik*

14. Bashkimi i Lumit Shkumbin me atë të Dushës, *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional lumor*
15. Liqenet e Lukovës, *Gjeomonumentgjeomorfologjik kompleks, akullnajor*
16. Mali i Niçës (V.-a-10), *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik*
17. Mali i Bletës (V.-a-11), *Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik*
18. Miniera e qymyrgurit Alarup (IX.-2), *Gjeomonumentpaleontologjik-paleoambiental*

Në varësi të mënyrës së formimit, karakteristikave që paraqesin dhe veçorive të tjera kemi bërë këtë klasifikim:

- 16 gjeomonumente gjeomorfologjike kompleksetë formuar si rezultat i proceseve erozionale
 - gjeologjike (lumore, atmosferike, akullnajore, karstike, neotektonike lumore e liqenore), etj.,
 - gjeomonumente janë të karakterit hidrogjeologjik;
 -
- jeomonumente të karakterit tektono-strukturor
- 1 gjeomonument i karakterit paleontologjik-paleoambiental
 - janë monumente arkeologjike;
 - 1 monument kulti.

g

PARQET NATYRORE

1. Pogradeci

Peisazhi i Mbrojtur Pogradeci ndodhet në Bashkinë e Pogradecit. Sipëfaqja aktuale e tij është 27323 ha. Ai përfaqëson një Zonë të Mbrojtur ndërkufitare. Në të, përfshihet liqeni tektonik më i thellë i Ballkanit (290 m) dhe një nga më të rëndësishmit në Europë e më gjërë. Së bashku me liqenjtë e Prespës përbëjnë bërthamën më të rëndësishme të një Rezerve BiosfereNjë zonë e rëndësishme turistike dhe pushimi si dhe për zhvillimin e aktiviteteve tradicionale kulturore e artistike me vëndet fqinje. Po përgatitet plani i menaxhimit me projektin SELEA.

2. Guri i Nikës

Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara Guri i Nikës ndodhet në Bashkinë e Pogradecit. Sipëfaqja aktuale e tij është 2200ha. Ai rrethohet nga ekonomi pyjore e kullosore të rëndësishme si: Qafë Panja, Bishnica, Guri i Topit, Valamars etj. dhe karakterizohet nga një shkallë e lartë biodiversiteti bimor, shtazor e habitatesh.

Gjeomonumentet

a) Gjeomonumente me vlera ndërkombëtare:

1. Liqeni i Pogradecit (Ohrit)

Liqeni i Pogradecit për nga mënyra e formimit është një gjeomonument tepër i veçantë. Është me origjinë tektonike si rezultat i uljes së madhe të një pjese të sipërfaqes së tokës në trajtë grabeni. Ky fenomen gjeologjik ndodhi nën efektin e dy zonave të fuqishme tektonike, ajo perëndimore Qafë Thanë-Lin-Peshkopi dhe ajo lindore Ohër-Alarup.

Figura 138. Liqeni i Pogradecit



Foto A. Fezollari

b) Gjeomonumente me vlera kombëtare:

1. Guri i Kamjes (V-a-8) Ky gur ndodhet pranë fshatit të Dardhës të ish Komunës së Dardhasit të Bashkisë Pogradec, në afërsi të Qafës së Lipovës, 1461 m mbi nivelin e detit. Është i gjatë rreth 100 m, i gjërë rreth 80 m dhe i lartë 70m.

Figura 139. Guri i Kamjes



Foto A. Fezollari

2. Burimi i Drilonit - Burimi i Drilonit (Zagorçan) gjëndet në të dalë të fshatit Zagorçan, në drejtim të Volorekës nga i cili rrjedh lumi i Drilonit. Burimi ka diametër 10 m dhe lartësi 5 m mbi nivelin e liqenit. Ai rrethohet nga një bimësi e dendur higrofile dhe ka një botë të pasur shtazore dhe pamje e bukuri të pakrahasueshme natyrore. Burimi krijon një mjedis shumë tërheqës. Fatkeqësisht, vërehen shenja ndotje dhe dëmtim të botes së gjallë por me mundësi ripërtëritje të vlerave të dëmtuara.

Figura 140. Burimet e Tushemishtit dhe Driloni*Foto L. Moisiu, A. Fezollari***b) Gjeomonumente me vlera lokale:****Figura 141. Burimet e Tushemishtit***Foto L.Mosiu*

15. Liqenet e Lukovës - Liqenet e Lukovës gjenden në shpatin lindor të Malit të Gurit të Topit, në afërsi të fshatit Bishnicë të ish Komunës Velçan të Bashkisë së Pogradecit, rreth 80 km nga qyteti i Pogradecit, në lartësitë 1700 m dhe 2027 m mbi nivelin e detit. Janë dy liqene akullnajorë (Liqeni i Vogël dhe Liqeni i Madh). Liqeni i Madh ndodhet në kuotën 1851 m mbi nivelin e detit me një sipërfaqe 0.05 km^2 , ndërsa Liqeni i Vogël ndodhet në kuotën 1706 m me sipërfaqe 0.035 km^2 me sipërfaqe $0,035 \text{ km}^2$.

7.2.3 Monumentet kulturore, historike dhe natyrore të peisazhit të mbrojtur

Në zonën e mbrojtur ndodhen 7 Monumente Natyrore (Kategoria III e Zonave të Mbrojtura në Shqipëri) si më poshtë (numri i tyre korrespondon me vendndodhjen e tyre në Hartën 1 më sipër):

Monumentet Bio

- Qiparisat e Kishës së Shën Mërisë (2)
- Sallkeni i Tushemishtit (4)

Monumentet Gjeografikë

- Guri i Kamjes (1)
- Shpella e Najzmës (3)
- Fragmenti i shkëputjes tektonike të Ohrit (6)
- Shpella e Memlishtit (7)

8. Situata financiare e bashkisë


8.1 Shpenzimet dhe Investimet

Në Tabelën e shpenzimeve vihet re se zërin më të rëndësishëm e kanë shpenzimet operative të Bashkisë me rreth 60 % të totalit të përgjithshëm. Është shumë e rëndësishme që Bashkia të ketë një analizë të mirë të kostove operative dhe mundësive për të pasur kosto sa me efëcente.

Ndërkohë për t'u theksuar është zëri i Investimeve, që në Bashkinë Pogradec është shumë i ulët rreth 18 %, sipas Bashkisë Pogradec, për shkak të Borxhit të lartë që ka krijuar ndër vite, dhe vendimeve gjyqësore që kanë arritur në fazën përmbarimore u kërkojnë bllokimin e fondeve të Bashkisë për interes të tyre për shlyerjen e detyrimeve të faturave të papaguara më parë.


Sigurisht mungesa e Investimeve është mjaft problematike për Bashkinë dhe Njësitë Administrative dhe banorët në këto njësi. Përveç mungesës së nxitjes ekonomike, mungesa e investimeve bazë që siguron dhe përmirësimin e kushteve bazë të cilësisë së jetës, bëhet dhe nxitje për migrim.

Figura 142. Përmbledhje e shpenzimeve, bashkia Pogradec



Në parashikimin që është bërë nga Bashkia për vitin 2016, rezulton një ulje e shpenzimeve e fokusuar në shpenzimet administrate. Ndërkohë Investimet parashikohen me rritje (gjithësesi ato janë në risk për tu realizuar për shkak të borxhit)

Figura 143. Përmbledhje e të ardhurave



Ndërkohë tek të ardhurat vihet re një ulje e parashikimit për tu mbledhur nga të ardhurat e veta, dhe një rritje nga transferta e pakushtëzuar.

Konkluzione :

Shpenzimet e Bashkisë zënë një % shumë të lartë rreth 60 % të shpenzimeve në total me peshë më të madhe në paga e sigurime shoqërore dhe shpenzime të tjera. Nisur nga Analiza e borxhit, del e nevojshme që Bashkia të ketë një pasqyrë më të saktë të zërave të shpenzimeve pasi aty janë krijuar dhe disa zëra të rëndësishëm të detyrimeve të prapambetura, dhe detyrimeve ndaj të tretëve.

Është e rëndësishme gjithashtu verifikimi i strukturave dhe funksioneve të Bashkisë, Institucioneve dhe Njësive Administrative, dhe për shkak të reformës por dhe për një efience më të mirë të organogramës.

Decentralizimet e funksioneve, duhet të kihet parasysh, që pjesa më e madhe transferojnë shpenzimet operative, kjo i shton detyrimet e bashkisë për këtë arsye duhet të njihet mire funksioni për tu përgatitur dhe për detyrimet që do të transferohen dhe masat që duhet të meren për të kontrolluar shpenzimet. Si në rastin e funksionit të arësimit etj.

8.2 Detyrime te papaguara

Bashkia Pogradec paraqitet në një situatë shumë të vështirë financiare. Kjo situatë është e trashëguar dhe Bashkia Pogradec dhe është adresuar për herë të parë nga kontrolli i bërë nga projekti STAR , Raport Kontrolli i konsoliduar, i cili paraqiti gjithë situatën financiare të Bashkisë Pogradec të Bashkuar për periudhën deri në 31.12.2013, paraqitet detyrimi i prapambetur në Shumen 533.254.000

Nga të dhënat sipas Bilancit të muajit Dhjetor 2015 të përpiluar nga Bashkia Pogradec dhe 7 Njesite Administrative rezultojnë 532.996.518 leke detyrime të papaguara në vite të detajuara si më poshtë :

Tabela 33. Detyrime të papaguara

Nr	Pershkrimi i detyrimeve	Bashkia Pogradec	Njesite Administrative	Totali i Detyrimeve
1	Mallra, Investime	244.071.475	62.525.704	306.597.179
2	Vendime Gjyqesore	131.499.451	9.188.172	140.687.623
3	Detyrime Ujesjellesi(Uje)	11.146.345	312.839	11.459.184
4	Telefon, Internet	287.784	187.566	475.35
5	Sherbim Postar	435.34	1.435.089	1.870.429
6	Paga Keshilltare,Kryetar	2.812.830	1.452.725	4.265.555
7	Paga Punonjesit	-	5.531.159	5.531.159
8	Honorare Klubi	6.721.300	-	6.721.300
9	Energji Elektrike	32.941.173	393.73	33.334.903
10	Kredi Bankare	22.053.836		22.053.836
	Totali	451.969.534	81.026.984	532.996.518

Edhe duke marrë në konsideratë pagesat e bera për detyrimet e prapambetura për periudhën 2014-2015, vlera është përsëri e njëjte, kjo pasi:

- Principali i detyrimeve të prapambetura rritet me 10% në vit. Kjo për shkak të interesave të përfituara nga Vendimet e Gjykatës. Zyrrat Permbarimore çdo 3M dergojnë shkresa ku kanë të pasqyruar detyrimin së bashku me interesat.

- Janë regjistruar dhe detyrime të reja të cilat kanë qenë të pa regjistruar në Finance por kishin ngelur në Drejtoritë e Bashkisë (Urbanistika, Arsimi, Punët Publike), sidomos për investimet e vitit 2011-2012.

- Detyrimet të cilat janë nëpërmjet Vendimeve të Gjykatës të cilat përveç principalit kanë vlerën me të lartë pasi janë përfshirë interesat e viteve të mëparshme, shpenzimet e gjyqit dhe të Permbarimit.

Detyrimet e mesipërme janë të pamundura për likuidim duke u bazuar në transferten e pakushtezuar për Bashkinë Pogradec në vlerën 261.066.000 Leke për vitin 2016 si dhe në të ardhurat e veta që parashikon të realizojë Bashkia gjatë vitit 2016.

Bashkia Pogradec nuk ka krijuar borxhe te reja si dhe nje pjese e të ardhurave te 2015 janë përdorur per te likujduar në menyre të barabarte te gjithë individet dhe firmat qe u detyrohet Bashkia.

Por shume e krijuar tashmë është pengesë jo vetem per faktin se nuk perballohet nga aftesite e veta paguese, por sepse moslikujdimi i kesaj shume do te behet problematike per shkak se cdo shume qe do te shkoje per likujdim, do te ulet vleres se investimeve te Bashkise Pogradec. Zyrat e permbarimit do te bllokoni cdo fond te mundshem te Bashkise per te siguruar te ardhurat e tyre. Duke e sjelle Bashkine ne nje nivel Falimenti.

Per me teper eshte e qarte se cdo vonese ne Investime, kuptohet do te vonoje zhvillimin ekonomik qe do te vinte si rezultat i Investimeve qe do te kryheshin ne kete Bashki, dhe kuptohet qe Investimet do te sillnin zhvillim, te ardhura me te larta te Bashkise dhe per rrjedhoje fuqi tjeter investuese per Bashkine.

Nga ana e bizneseve kerkohet likujdimi total i detyrimeve pasi ata ndodhen ne nje situatë shume te veshtire financiare ku te gjithë jane ne prag te falimentimit, si dhe kane detyrime te shumta prej afro 10 vitesh qe nuk kane mundesi likujdimi, kane dhe detyrime ndaj te treteve, bankave, drejtorive te tatimeve apo sigurime shoqerore, detyrime ndaj Bashkise etj.

Duke qene se Bashkia e ka te pamundur me buxhetin qe ka, per te kapercyer kete krize, te ardhurat e veta vjetore jane sa gjysma e te borxhit te akumuluar, dhe shpenzimet operative jane po aq, kerkesa e bizneseve per te shlyer borxhin brenda vitit ne menyre te menjhereshme sdo te ishte e mundur.

Marrja persiper e Borxhit nga ana e Pushtetit Qendror do ti jape mundesi funksionimit te Bashkise Pogradec per qytetaret e saj, por edhe turizmit si mundesi e rendesishme per zhvillimin ekonomik.

Per sa me siper Bashkia ka menduar disa rruge per te shmangur kete krize:

Konkluzione:

Detyrimet e papaguara të evidentuara në 31.12.2013 janë 533.254.000 lekë
Detyrimet e papaguara në 31.12.2015 janë 532.996.518 lekë

Shihet qartë që shifra ska ndryshuar pothuajse aspak në 2 vite. Kjo për arsye të interesit për disa vendime gjyqësore etj. Përvec kësaj dhe mungesës së aftësisë për ta shlyer këtë detyrim.

Shifra 533 milion lekë është më e madhe se të ardhurat që vetë Bashkia Pogradec krijon në një vit, dhe të shpenzimeve vjetore që ka në një vit kjo bashki

Vihet re se zërat kryesorë në detyrimet e papaguara janë :

Mallra,Investime	306.597.179
Vendime Gjyqësore	140.687.623
Detyrime Ujësjiellësi(Ujë)	11.459.184
Energji Elektrike	33.334.903
Kredi Bankare	22.053.836

Duket qartë se ka pasur një keqmenaxhim të fondeve publike, së pari në mospagesën e detyrimeve të prokurimeve që janë bërë për mallra dhe shërbime, si dhe në mos evidentimin e shpenzimeve të bëra nga institucionet e varësisë për shpenzimet operative energji elektrike, ujësjellësi etj..Një mos menaxhim i mirë është dhe në rastin e vendimeve gjyqësore, që kanë ardhur si rezultat i veprimeve aspak profesionale të Bashkisë Pogradec që kanë sjellë pasojë ligjore dhe financiare bazuar në vendimet e Gjykatës.

9. Konkluzione/Rekomandime dhe SWOT

Problemet mjedisore

- Nga vlerësimi i situatës nga pluhurat rezulton se nivelet e pluhurit PM₁₀ dhe PM_{2.5} rezultojnë të larta krahasuar me nivelet e BE. Veçanërisht në zonën e qytetit të Pogradecit dhe rrugës nacionale në Buçimas. Kjo shkaktohet nga numri i lartë i automjeteve, sasi e ulët e gjelbërimit etj.
 - Në mënyrë që të reduktohet niveli i pluhurit rekomandohet që të shtohet gjelbërimi, të shmangen aktivitetet industriale pranë qendrave të banuara, të shtohen rrugët ekologjike dhe të ulet intesiteti i ndërtimit.
- Nga vlerësimi I situatës së CO (monoksidit të karbonit) rezulton se emetimi I tij është në nivele të larta për shkak të përdorimit të druve të zjarrit për ngrohjen e banesave.
 - Rekomandohet që banorët e bashkisë të përdorin energjinë alternative në banesa dhe biznese, si panele diellore, mulli me ere, gjeotermi, peleta, etj.
- Lidhur me vendëpozitimin e mbetjeve të qytetit dhe njësive administrative të tjera rezulton se ato janë jashtë çdo standarti ndërkohë mungojnë skemat e ndarjes së diferencuar dhe riciklimit të mbetjeve.
 - Rekomandohet mbyllja dhe rehabilitimi i vendëpozitimit të mbetjeve të Alarupit, mbyllja e vendëpozitimeve të tjera në Nj.A dhe hartimi i skemave dhe programeve për ndarjen e diferencuar të mbetjeve. Gjithashtu rekomandohet t'i vihet theks i veçantë lidhjes me landfillin e Maliqit pas mbarimit të ndërtimit të tij.
- Ekziston një pikë e nxehtë mjedisore tepër e rrezikshme është ajo e “Gurit të Kuq” pranë NjA Udënisht. Nga një vështrim i vlerave të matura për metalet evidentohet se nikeli, deri në 40 herë më tepër se limiti i lejuar nga BE, kromi deri në 20 herë më tepër, kobalti deri në 6 herë dhe plumbi deri në 2 herë. Përmbajtja e metaleve të rënde në tokat pranë këtyre minierave në vlera kaq të larta është me pasojë në kultivimin e bimëve në këtë zonë, aq më tepër që konsiderohet zonë turistike.
- Gjenden edhe dy hotspote të tjera mjedisore: Fabrika e përpunimit të Fe- Ni e Gurit të Kuq dhe Damba e përhershme mbi fshatin Hudënisht.

- Rekomandohet pastrimi dhe rehabilitimi i këtyre hapësirave, zhvendosja e mbetjeve metalore dhe kthimi i këtyre zonave në hapësira në funksion të turizmit.

Përdorimi I tokës, sistemet dhe infrastrukturat

- Kapacitetet egzistuese të qarkullimit në bashkinë Pogradec nuk përbëjnë problem megjithatë vihet re një keqmenaxhim i sistemit të parkimeve. Ky fakt kthehet në problem në periudhën e sezonit turistik veror.
- Çështja e parkimeve në qytet duhet të zgjidhet duke përqafuar eksperiencat europiane atë të përdorimit të parkimeve me pagesë. Gjithashtu rekomandohet të rikthehen linjat e transportit urban sidomos për linjat Lin – Pogradec – Tushemisht.
- Lidhur me sistemin e kanalizimit të ujrave të zeza dhe të ujit të pijshëm duhet thënë se zona e qytetit të Pogradecit dhe e Tushemishtit është i pajisur me këtë shërbim ndërsa territoret e tjera të njësisë administrative vendore nuk janë pjesë e sistemit.
- Rekomandohet që territoret e njësisë administrative të bashkisë Pogradec që nuk janë pjesë e sistemit të kanalizimeve të ujrave të zeza dhe ujit të pijshëm të bëhen pjesë e sistemit. Rëndësi e veçantë t’i kushtohet zonave turistike.
- Sistemi hekurudhor është jashtë funksionit ndërsa në përgjithësi mungon sistemi i integruar i transportit publik.
- Duhet të konsiderohen mënyra rrizhullimi të sistemit hekurudhor, mënyra të rrizhullimit në rang vendi por edhe bërjen e këtij sistemi pjesë e rrjetit ndërkombëtar duke bashkëpunuar me shtetet fqinje si Maqedonia.
- Bashkia e Pogradecit ka mundësi që të zhvillojë linjat e transportit ujor nëpërmjet liqenit të Ohrit megjithatë cilësia fizike e Molit të qytetit nuk e mundëson këtë shërbim.
- Rekomandohet rivënia në funksion të Molit të qytetit si dhe funksionimi i linjës Pogradec – Ohër me traget në funksion të turistëve.

Pauritë minerale

- Nga analizat e kryera rezulton se bashkia Pogradec ka potenciale të shumta të burimeve minerale përfshirë këtu e Hekur – nikelit (Gur I Kuq, Gur I Përgjegjur, Gradishtë, Rodokal, Debrovë). Rezervat e Fe-Ni në bashkinë e Pogradecit janë të konsiderueshme, të shfrytëzuara dhe të përdorura deri në vitet 1992 tani shfrytëzohen vetëm 3% e tyre.

- Bashkia Pogradec ka potenciale të shumta të mineralit të kromit (Pojskë, Mëmëlisht, Pojska perëndimore, Gjordukë, Bregu i Pishës, Hija e zezë - Pojskë, Guri i Pëllumbit, Masha e Kolnekut - Rodokal, Bregu i Tolloviës- Rodokal, Cervenakë.
- Bashkia Pogradec ka në territorin e saj minerale të shumtë jometalorë si argjilat (Alarup dhe Zdërvaskë), rërat kuarcore (Alarup, Peshkëpi) Gëlqerorë (Gurras, Tushemisht, Saelishtë) dhe gurë dekorativë në fshatin Lin.
 - Rekomandohet fokusimi në industrinë minerale në zonat e ndodhura jashtë kufirit të peisazhit të mbrojtur të Pogradecit. Potencialet janë të shumta dhe duhet të shfrytëzohen në emër të zhvillimit ekonomik të bashkisë.
- Zona e Pogradecit shquhet edhe për përmbajtje të lartë të lëndëve të para energjitike si qymyri (Velçan vendburimi Dardhas – Vërdovë, vendburimi Grunjas, Malinë, Potkozhan, Qafëpanjë – Llëngë. Veçojmë këtu vendburimin e qymyreve Petrushë – Ieshnicë – Vërdovë.
 - Lidhur me burimet e qymyrit rekomandohet shfrytëzimi i këyre burimeve jo vetëm si një mënyrë për zhvillimin e ekonomisë por edhe si qasje ndaj zhvillimit të qëndrueshëm duke përdorur si lëndë djegëse për ngrohje burim e qymyrit.

Aspekti social dhe ekonomik

- Ekziston një diferencë e madhe midis numrit të popullsisë së gjeneruar nga të dhënat e INSTAT dhe Gjendjes Civile, kjo refletkon një mungesë të verifikimit të popullsisë prezente në territor.
 - Rekomandohet që të ribëhet vlerësimi i popullsisë në bazë të kontratave të ujit ose në bazë të kontratave të OSSHE, gjithsesi të dyja mënyrat kanë përjashtimet e tyre që duhen të meren parasysh.
- Nga analizat e kryera vihet re se ekziston një lidhje “organike” më e fortë midis NjA Hudënisht, Buçimas dhe qytetit të Pogradecit.
 - Rekomandohet që këto territore të trajtohen sëbashku dhe si një strukturë e tërë në propozimet dhe vizionin e bashkisë Pogradec.
- Rreth 70% e popullsisë së bashkisë rezulton të jetë në moshë aktive për punë dhe kjo përbën një potencial të madh për forcën punëtore ekonomike aktive.
 - Rekomandohet hartimi i politikave të posaçme punësimi në sektorët e turizmit, shërbimeve dhe industrisë.
- Popullsia më e madhe e bashkisë (59%) jeton në zonat rurale, kjo kushtëzon edhe adresimin e investimeve publike.

T’i vihet një theks i veçantë investimeve në territoret e ish – komunave aty ku dhe përqëndrimi i popullsisë është më i madh.

- Nga përlllogaritjet e bëra rezulton se në vitin 2031 bashkia Pogradec do ketë një rënie të numrit të popullsisë duke e çuar numrin e saj në 81, 488.
- Politikat e zhvillimit të territorit duhet të nxisin rikthimin e popullsisë së larguar dhe ardhjen e popullsisë së re.
- Lidhur me ndihmën ekonomike të NjA vihet re që numri më i lartë i familjeve në ndihmë ekonomike është NjA Udënisht me 37% të tyre. Kjo bie ndesh me mundësinë që kjo popullsi ka për t'u punësuar në sektorin e turizmit.
- Të ulët niveli i papunësisë në këtë NjA duke orjentuar fuqinë punëtore drejt punësimit në sektorin e turizmit.
- Në aspektin arsimor vihet re një nivel i lartë i analfabetizmit në zonat rurale si dhe mungesë e çerdheve, shkollave dhe kopshteve.
- Identifikimi aktual i nivelit të alfabetizmit, pajisja me institucione arsimore dhe marrja e nismave për uljen e analfabetizmit.

Bujqësia

- Fermerët nuk janë pjesë e skemave subvencionuese të Ministrisë së Bujqësisë, ndërkohë që mungojnë pikat e grumbullimit të produkteve bujqësore.
- Rekomandohet ngritja e pikave të grumbullimit të produkteve bujqësore pranë zonave me potencial më të madh bujqësor
- Evidentohen probleme në lidhje me sistemin ujitës, konkretisht me rezervuaret e Qafë Thanës dhe Malinës.
- Rekomandohet vlerësimi në terren i cilësisë së infrastrukturës bujqësore dhe kryerja e investimeve në bazë të prioriteteve.
- Nga analiza e sektorit të bujqësisë rezulton se fuqia punëtore e orjentuar drejt sektorit të bujqësisë është e pakualifikuar dhe e ulët.
- Rekomandohet që fuqia punëtore të kualifikohet në sektorin e bujqësisë në programet e shkollave profesionale bujqësore siç është ajo e Çërravës.

Turizmi

- Lidhur me turizmin evidentohet një mungesë e strukturave akomoduese si dhe një turizëm i orjentuar drejt atij liqenor duke lënë pas potenciale të tjera turistike në bashki.

- Nisur nga prezenca e lartë në numër të monumenteve arkeologjike, gjeomonumenteve, monumenteve të kulturës dhe të natyrës, mund të thuhet se bashkia Pogradec ka mundësi të mëdha për zhvillimin e sektorit të turizmit.
- Duhet të hartohet një plan turizmi i mirëfilltë për të konsideruar zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit si dhe duhet të vlerësohet zhvillimi i mundshëm i zonave të akomodimit të turistëve.

Situata financiare

- Bashkia Pogradec paraqitet e paqëndrueshme financiarisht duke pasur një vlerë investimesh prej 18% për shkak të Borxhit të lartë që ka krijuar në vite.
- Sot bashkia trashëgon prej së kaluarës një keqmenaxhim të fondeve publike duke sjellë pasoja ligjore dhe financiare.
- Qeveria Qendrore t'i konsiderojë dhe debitoret e krijuar nga Pushteti Vendor në të njejtën mënyrë si për ato debitore që u trajtuan me borxhin e qeverisë qendrore- pra me një huamarrje publike nga qeveria qendrore.
- Nje zgjidhje tjetër mund të ishte kalimi i projekteve të investimeve që janë kryer tashmë në portofolin e Fondit të Rajoneve dhe shlyerja e Detyrimeve nga ky Fond.
- Si zgjidhje të tretë mendohet marrja e Borxhit (kredite) nga sistemi bankar duke marrë garanci nga Ministria e Financave me interes zero (interesi të mbulohet nga Qeveria), si për kredine e të pastreheve me afat të gjatë.

Në diagramën e mëposhtme tregohet një përmbledhje e gjetjeve të seksionit të analizës së Dokumentit të Strategjisë së Territorit. Këto gjetje janë kategorizuar sipas analizës SËOT dhe në këtë mënyrë janë evidentuar pikat e forta që hasen në territorin e bashkisë, pika të dobëta të cilat lidhen më shumë me problematikat të cilat kanë dalë gjatë vlerësimit të territorit, mundësitë dhe kërcënimet që lidhen me faktorë ndihmues ose pengues të jashtëm.

- Pozicion gjeografik i favorshëm si pjesë e Korridorit të VIII dhe pjesë e rrjeteve të zonave natyrore të mbrojtura.
- Shtrirja pranë liqenit të Ohrit
- Pasuri të mëdha natyrore, monument arkeologjike, gjeomonumente, monumente kulturore, historike dhe natyrore të shumta (Kalaja, Monumentet e Selcës, Bazikila e Linit, Guri i Kamjes, Burimi i Drilonit, Guri i Nikës, liqenet e Lukovës etj).
- Bashkia Pogradec ka pasuri të shumta minerale të hekur nikelit (Gur I Kuq, Gur I Përgjegjur, Gradishtë, Rodokal, Debrovë).
- Përmbajtje të lartë të lëndëve të para ergjitike si qymyri (Velçan vendburimi Dardhas – Vërdovë, vendburimi Grunjas, Malinë, Potkozhan, Qafëpanjë – Llëngë).
- 70% e popullsisë, moshë aktive për punë.

S

W

- Zhvillimi i territorit udhëhiqet nga zhvillime spontane të pabazuara në dokumenteplanifikimi dhe kryesisht në bazë të zhvillimeve individuale.
- Nivele të larta të ndotjes së ajrit nga pluhurat PM₁₀ dhe PM_{2,5} dhe CO.
- Prezencë e pikave të nxehta mjedisore (Guri i Kuq, fabrika e përpunimit Fe – Ni,
- Damba mbi Udënisht dhe Pika e depozitimit të mbetjeve).
- Sistemi hekurudhor dhe ujqor është jashtë funksionit.
- Niveli i lartë i papunësisë dhe analfabetizmit në zonat rurale.
- Ka mungesë të infrastrukturës bujqësore; veçanërisht të pikave të grumbullimit dhe sistemeve të vaditjes dhe kullimit.
- Toka bujqësore është e pakët dhe e refuzuar
- Mungesë e strukturave akomoduese për turistët.
- Administrata publike e papërgatitur nga ana organizative dhe financiare për të përballuar zgjerimin e territorit dhe ofrimin e shërbimeve pas ndarjes territoriale.
- Situatë e vështirë financiare, detyrime të shumta të papaguara
- Mungesë e bazës së të dhënave mbi pronën publike
- Gjendje fizike e keqe e infrastrukturave rrugore në territorret e ish- komunave
- Mungesë e dokumenteve strategjike lokale mbi sektorin e turizmit
- Zona të caktuara rrezikojnë përmbytjen për shkak të proceseve erozive
- Shfrytëzim jo- eficient i potencialit turistik të vijës liqenore

- Mundësi bashkëpunimi ndërkufitar me Shtetin Maqedonas (Ohër, Strugë).
- 59% e popullsisë jeton në zonat rurale, kjo i jep mundësi zhvillimit të bujqësisë dhe blegtoirisë.
- Kualifikimi i fuqisë punëtore drejt sektorit të bujqësisë dhe turizmit nëpërmjet shkollave profesionale.
- Bazuar tek kushtet fizike dhe natyrore bashkia mund të zhvillojë turizmin multisezonal.
- Aksi i ri lidhës Qukës – Qafë Pllocë mundësi shumë e mirë për zhvillimin e zonës së Mokrës dhe lidhjen më të mirë me Bashkinë Korçë dhe pjesën tjetër të territorit të bashkisë Pogradec.
- Mundësi për mbrojtjen e peisazhit të mbrojur dhe Liqenit të Ohrit nëpërmjet programeve ndërkombëtare.
- Mundësi i rivitalizimit të transportit hekurudhor nëpërmjet programeve ndërkombëtare
- Mundësi e zhvillimit të turizmit rajonal (Ohër, Strugë, Korçë).
- Menaxhim e integruar të mbetjeve nëpërmjet Landfill-it të Maliqit.



- Projektion në rënie i popullsisë në 2031 në 81,488 banorë (10.000 banorë më pak).
- Mosmarrja pjesë në skemat e subvencioneve të Ministrisë së Bujqësisë do të ulë mundësitë për zhvillimin e bujqësisë.
- Rreziku i mosfrimit ndihmës nga qeveria qendrore, Fondi i rajoneve apo Ministria e Financave për shlyerjen e detyrimeve të papaguara.
- Konkurushmëri e lartë në sektorin turistik dhe bujqësor nga Bashkia Korçë dhe Komuna e Strugës dhe e Ohrit.
- Konkurueshmëri e lartë e ne sektorin bujqësor nga Bashkia Korçë dhe shteti Maqedonas

Shënime dhe Referenca

- ¹ Sipërfaqja e bashkisë ka dalë si rezultat i matjeve në sistemin GIS të territorit të bashkisë duke përfshirë në të edhe territoret e ish- komunave pas ndarjes territoriale
- ² Gjenerimi i numrit të popullsisë është bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Gjendjes Civile Pogradec. Megjithatë ka një mospërputhje midis numrit të popullsisë të gjeneruar nga Gjendja Civile dhe Census 2011. Sipas këtij burimi popullsia në bashkinë Pogradec është 61, 530
- ³ Të gjitha elementët e fortë territoriale do të trajtohen në seksionet e mëvonshme sipas tematikave.
- ⁴ Burimi: Bashkia Pogradec
- ⁵ Burimi i informacionit për historinë e zhvillimit të fshatrave është marrë nga libri “Mbi përhapjen e krishtëritimit dhe të Kishave në rrethin e Pogradecit” i profesorit Gjergji Gusho
- ⁶ Burimi i informacionit për tipologjinë e ndërtimeve të zonës të fshatrave të Pogradecit është botimi “Banesa tradicionale fshatare shqiptare”, e autorit Ali Muka (Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë)
- ^{vii} Detyrë projektimi I Planit Rregullues të Pogradecit, qershor 2003
- ^{viii} Initial Characterisation of Lakes Prespa, Ohrid and Shkodra/Skadar. Implementing the EU Water Framework Directive in South-Eastern Europe
- ^{ix} Agjensia Kombëtare e Mjedisit
- ^x S. GURI, UNDP, Vlerësimi Mjedisor dhe Rehabilitimi I ‘Hot Spoteve’ Shqiptare, 2012
- ¹¹ Agjensia Kombëtare e Mjedisit, 2015
- ¹² Ministria e Mjedisit, 2012&2013
- ¹³ Guri, S., etj., 2011-2013
- ¹⁴ UNDP, 2011 Sazan Guri, LDK Gris, G&G Group Studio
- ¹⁵ UNEP, (2008); UNDP, (2010); Guri, S., etj., 2011-2013).
- ¹⁶ Forster Eiller Italiana & G & G Group, 2012, Projekti “Rehabilitimi i Hot Spoteve Shqiptare, rasti Miniera Guri i kuq, UNDP
- ¹⁷ Drejtoria Rajonale e rrugëve
- ¹⁸ Kartelat e rrugëve , rrugëve lidhese , shesheve dhe blloqeve per qytetin e Pogradecit
- ¹⁹ Vlen të përmendet se analiza e pajisjes së rrugëve me trotuare është bërë vetëm për akset e përmendura në tabelë.
- ²⁰ Studimi i Fizibilitetit të Lidhjes Hekurudhore Shqipëri Maqedoni
- ²¹ Ky seksion do të trajtohet në mënyrë më të detajuar në analizën e thelluar të PPV-së
- ²² Burimi: Konsultime me stafin e bashkisë Pogradec
- ²³ Të dhëna të mara nga CEZ, Pogradec
- ²⁴ Lidhur me këto vendime në aneks mund të gjenden tabelat përkatëse të evidentimeve
- ²⁵ Shiko fotot në të njëjtin seksion

²⁶ Nderkohe që Fshati si concept administrative ekziston, pasi ka edhe një strukturë formale si Kryeplaku, lagja në qytet nuk ekziston si strukturë formale ndarese/administrative. Bashkia duhet të mendojë edhe për strukturimin e një ndarje “administrative” edhe brenda qytetit në nivel me formal lagjeje.

²⁷ Të dhënat e mësipërme të sektorit të turizmit nuk përputhen me të dhënat e bizneseve të regjistruara.

Shtojca

EVIDENCË MBI ZONAT INFORMALE TË MIRATUARA NË K.K.T sipas QARKUT KORCE - VENDIM NR. 2 DATE 30.12.2015

QARKU	BASHKIA	NJESIA ADMINISTRATIVE	NR TOTAL I Z.I. NJ.A.	EMERTIMI	VENDIM K.K.T.	SIP E ZONES INFORMALE TË PROPOZUAR (HA)	SIP. E ZONES INFORMAL E EKZISTUES E E RISHIKUAR (HA)	TË DHËNAT PËR ZONËN DHE NDËRTIMET					
								NR. TOTAL I DEKLARIM EVE / ZONE INFORMAL	LARTËSI E OBJEKTEVE TË DEKLARUAR A (MIN.-MAX)	% E OBJEKTEVE BANIM / ZONE INFORMALE	% E OBJEKTEVE SOCIAL-EKONOMIKE / ZONE INFORMALE	RAPORT I OBJ. SOC. - EKONOMIKE / OBJ. BANIM	% E SIP. SIPAS LLOJIT TË PRONËSISË
BASHKIA POGRADEC	C	N.J.A. POGRADEC	2	Z.I. NR.1	VENDIM NR.2 DT. 30.12.2015	56.29	126.9	84	1-3 kate	96%	4%	4%	S'KA TE DHENA
				Z.I. NR.9		48.83		200	1-6 kate	78%	22%	29%	S'KA TE DHENA
				Z.I. NR.2		56.54		263	1-4 kate	95%	5%	5%	S'KA TE DHENA
		Z.I. NR.3	37.94	120		1-3 kate		96%	4%	4%	S'KA TE DHENA		
		Z.I. NR.4	7.19	35		1-3 kate		97%	5%	3%	S'KA TE DHENA		
		Z.I. NR.5	14.68	96		1-4 kate		91%	9%	10%	S'KA TE DHENA		
		Z.I. NR.6	32.31	72		1-4 kate		94%	6%	28%	S'KA TE DHENA		
		Z.I. NR.7	33.92	86		1-4 kate		94%	6%	28%	S'KA TE DHENA		
		Z.I. NR.8	31.69	86		1-4 kate		74%	6%	28%	S'KA TE DHENA		

EVIDENCË MBI ZONAT INFORMALE TË MIRATUARA NË K.RR.T.R.SH - 2007/2008

QARKU	DREJTORIA ALUZHNI4	NJ.Q.V.	ZONA INFORMALE / VENDBANIMI INFORMAL	NR. VENDIM K.K.T. DT./ NR. Z.I+ V.I	TE RISHIKUARA- VENDIM NR.2 DT	NUMRI I V.I.	NUMRI I Z.I.	TË DHËNAT PËR ZONËN DHE NDËRTIMET					TE DHENA DEMOGRAFIKE	
								Sip. e zonës (ha)	Nr. total i objekteve	Nr. i obj. të vetëdeklaruar	Sip. e parcelave (Σ ne ha)	Sip. ndërtimore (Σ ne m2)	Numri i banorëve	
POGRADEC		K. Bucimas	Z.I. Bucimas-Verdove-Rremenj	15, 18.04.2008	RISHIKUAR	0	3	98.90	533	371	30.29	41352.10	1497	
		K. Bucimas	Z.I. Rruga e Tushemishtit					RISHIKUAR	28.00	215	153	10.04	15303.90	419
		K. Hudenisht	Z.I. Pole						15.00	94	38	1.79	3890.00	178
DREJTORIA POGRADEC				3		0	3	141.90	842	562	42.12	60546.00	2094	